

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Eruditi, juristi dhe komentuesi

NASER MEKARIM SHIRAZI

KOMENTIM I PËRSOSUR I KUR'ANIT

(Xhuzi i njëzet)

Nga ajeti 56 i sures "Neml" e deri te ajeti 45 i sures "Ankebut"

TIRANË, 2018

Titulli: ***KOMENTIM I PËRSOSUR I KUR'ANIT***

(Xhuzi i njëzet)

Autori: ***Eruditi, juristi dhe komentuesi***

Naser Mekarim SHIRAZI

Recensent: ***Vullnet MERJA***

E përktheu nga arabishtja: ***Haxhi Selim STAFA***

E redaktoi: ***Liseda RAMAJ***

Korrektura teknike: ***Vjollca KARAJ***

Përkujdesja grafike: ***Sabrie FEZA***

Kapaku: ***Sabrie FEZA***

Botoi: ***Shoqata "FLLADI"***

Copyright: ***Shoqata "FLLADI"***

Shtypshkronja e shtëpisë botuese ***LILLO***

Ajetet: 56 - 59

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿فَمَا كَانَ جَوَابَ قَوْمِهِ ۚ إِلَّا أَنْ قَالُوا أَخْرِجُوا آلَ لُوطٍ مِّنْ قَرْيَتِكُمْ ۖ إِنَّهُمْ
 أَنَاسٌ يَّتَطَهَّرُونَ﴾ ﴿٥٦﴾ فَأَنجَيْنَاهُ وَأَهْلَهُ ۖ إِلَّا أَمْرَأَتَهُ ۖ قَدَرْنَاهَا مِنَ الْغَابِرِينَ ﴿٥٧﴾
 وَأَمْطَرْنَا عَلَيْهِمْ مَطَرًا فَسَاءَ مَطَرُ الْمُنذِرِينَ ﴿٥٨﴾ قُلِ الْحَمْدُ لِلَّهِ وَسَلَامٌ عَلَىٰ
 عِبَادِهِ الَّذِينَ اصْطَفَىٰ ۚ اللَّهُ خَيْرٌ أَمَّا يُشْرِكُونَ ﴿٥٩﴾

**“Dhe përgjigjja e popullit të Lùtit nuk qe tjetër veçse thanë:
 Nxirreni jashtë vendit tuaj Lùtin dhe famijen e tij, ata janë
 njerëz që pastrohen.”**

**“Ne e shpëtuan atë (Lùtin) dhe familjen e tij, përveç gruas së tij,
 të cilën e vlerësuam të jetë me të dënuarit.”**

**“Ne lëshuam mbi ata një shi; sa i keq ishte shiu i të
 paralajmëruarve!”**

**“Thuaj: Elhamdu lil’lah (falënderimi, lavdërimi janë vetëm për
 All’llahun) dhe paqja e bekimi qoftë për robtë e Tij që Ai i
 zgjodhi (Profetët); A është All’llahu më i mirë (për t’i besuar) apo
 janë ato që ju i bëni shok Atij?”**

Komentimi

Kur pastërtia konsiderohet si një e metë e madhe

Në hulumtimet e mëparshme, pamë logjikën e Profetit të madh të All'llahut, Luti (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) përballë të devijuarve të ndytë. Pamë shpjegimin e tij argumentues me të cilin u kundërvihet atyre për punët e tyre të shëmtuara. Me atë argumentim ai zbuloi paditurinë e tyre ndaj ligjeve të krijimit dhe ndaj vlerave njerëzore.

Tani le të shohim përgjigjen e atyre të devijuarve nga rruga e natyrës njerëzore dhe mënyrën se si iu përgjigjën ata logjikës së Profetit Lut (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*): **“Dhe përgjigja e popullit të Lûtit nuk qe tjetër veçse thanë: Nxirreni jashtë vendit tuaj Lûtin dhe familjen e tij, ata janë njerëz që pastrohen!”**.

Përgjigja e tyre zbulon plotësisht devijimin ideor dhe rënien e tyre morale në thellësitë më të mëdha.

Në një mjedis të tillë të kontaminuar, pastërtia konsiderohej si e metë, prandaj këta njerëz të pastër, ose duheshin futur në burg, ose Lutin, këtë Profet të madh të All'llahut, duhej ta largonin, sepse ata i ruheshin ndotjes.

Fjalën e qartë të Kur'anit në lidhje me ata që janë shmangur prej rrugës së drejtë, e lexojmë në ajetin 7 të sures “El Bekare”: **“All'llahu ua ka mbyllur atyre zemrat e veshët dhe në shikimin e tyre ka një perde.”**.

Ka mundësi që frazën e ajetit: **“ata janë njerëz që pastrohen”**, populli i Lutit ta ketë thënë për shkak të devijimit të tyre dhe për shkak se ata ishin të zhytur në imoralitet dhe e kishin bërë zakon të jetonin në ndyrësi. Prandaj këtë fjalë, ata e thonin edhe si për të vënë në lojë dhe për tallje, sepse e shihnin se punët e tyre ishin të këqija dhe jo të pastra. Ata e kuptonin se Lutit dhe ndjekësve të tij, ruajtja prej ndyrësisë së imoralitetit u vinte nga pastërtia. Nuk mund të ketë fjalë më të çuditshme dhe qesharake se kjo fjalë e tyre.

Nuk është larg mendjes që ndjenjat e njeriut të tjetërsohen si rezultat i përshtatjes së tij me një punë të keqe dhe pastaj të ndryshojnë edhe sjellja, edhe pikëpamjet e tij. Tregohet që një lëkurëpunues, i cili ishte mjeshtër në punën e tij, u mësua me erën e rëndë të lëkurëve. Një ditë, kur ai shkoi në tregun ku shiteshin parfume, u turbullua shumë dhe i ra të fikët, për shkak se aroma e parfumeve ishte e ndryshme nga era që nuhaste çdo ditë. Prandaj një burrë i mençur urdhëroi që ai të largohej prej tregut të lëkurëpunuesve, në mënyrë që ta shpëtonin nga vdekja. Ky është një shembull shumë domethënës për logjikën e çështjes.

Në transmetimet islame thuhet se Luti (*Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!*) ia kumtoi popullit të tij mesazhin e All'Ilahut dhe e këshilloi atë afërsisht tridhjetë vjet me radhë, por ata nuk i besuan atij, me përjashtim të familjes së vet, përveç gruas së tij, e cila ishte së bashku me idhujtarët dhe mbante besimin e tyre.¹

Për njerëz të tillë nuk mund të ketë shpresa që ata të përmirësohen në këtë botë, prandaj sirtari i jetës së tyre duhet mbyllur. Për këtë, ajeti vijues njofton: **“Ne e shpëtuam atë (Lutin)**

¹ Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 2, f. 382.

dhe familjen e tij, përveç gruas së tij, të cilën e vlerësuam të jetë me të dënuarit.”.

Luti (*Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!*) doli nga qyteti së bashku me familjen e tij në kohën e caktuar, ndërsa qyteti vazhdonte ta gdhinte natën në imoralitet. Në mëngjes, mbi ta ranë gurë nga qielli. Në të njëjtën kohë, toka pati lëkundje të shumta nga një tërmet i fuqishëm dhe të gjithë ata u varrosën nën gërmadha, ashtu siç njofton ajeti vijues: **“Ne lëshuam mbi ata një shi; sa i keq ishte shiu i të paralajmëruarve!”.**

Në lidhje me popullin e Lutit dhe përfundimin e tmerrshëm të tij, si dhe në lidhje me efektet e devijimit seksual, kemi vënë një studim të detajuar në fundin e komentimit të ajeteve 77-83 të sures “Hud”.

Zoti ka caktuar për njerëzit rrugën ku ata duhet të ecin, e cila është edhe faktori vendimtar për plotësimin dhe për jetën tonë. Nëse do të devijojmë prej kësaj rruge, atëherë do të biem në humnerën e imoralitetit dhe do të asgjësohemi.

Ligji i krijimit e ka bërë tërheqjen midis dy gjineve të kundërta si faktorin bazë për vazhdimin e pasardhësve të njeriut dhe si një siguri shpirtërore për të. Prandaj, çdo rrugë e devijimit seksual, si homoseksualizmi dhe lezbizmi, bëjnë që njeriu të mos ketë siguri e qetësi shpirtërore dhe çojnë në prishjen e sistemit të shoqërisë.

Këto ligje shoqërore i kanë rrënjët në natyrën e pastër të krijimit, prandaj prapambetja ose devijimi shkaktojnë turbullira dhe e prishin harmoninë në vetë ekzistencën e njeriut.

Luti (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), ky Profet i nderuar i All'llahut, ia tërhoqi vëmendjen popullit të tij të devijuar, që të vështrojnë në bazën e krijimit dhe u tha atyre fjalën që e lexuam në ajetin 54 të kësaj sureje: “...qysh e bëni atë punë të shëmtuar që edhe ju vetë e shikoni (se është punë e keqe)?!”.

Ai u thotë se injoranca, mosnjohja prej tyre e ligjit të krijimit dhe mendjelehtësia, të gjitha ato i tërhiqnin në rrugën e humbjes.

Nuk është çudi që për atë popull të tjetërsoheshin të gjitha ligjet e krijimit, prandaj ata në vend që të ndihmoheshin me ujë prej qiellit, me ujin që dhuron jetën, mbi ta ra shi gurësh. Për ta, toka që ishte “djepi” ku ndiheshin të sigurtë, u lëkund nga një tërmet i fuqishëm dhe vendi i tyre u përmbys. Kjo ndodhi kështu, jo vetëm që të shkurtohej koha e asgjësimit të tyre, por edhe që të zhdukej çdo gjurmë e çdo shenjë prej atij populli.

Në ajetin e fundit të grupit të ajeteve që janë objekt studimi, pas shpjegimit të ngjarjeve që ndodhën me Lutin (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) si dhe fundin e popullit të tij, që kishte devijuar nga rruga e drejtë, fjala i drejtohet Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), që të nxirrte rezultatin e asaj ngjarjeje dhe e urdhëron atë: “**Thuaj: Elhamdulil'lah**” (falënderimi, lavdërimi janë vetëm për All'llahun).

Falënderim e lavdërim të veçantë vetëm për All'llahun, për Atë që asgjësoi popuj të shprishur e të zvetënuar, si populli i Lutit. Asgjësimi i atij populli të devijuar nga natyra e krijimit të njeriut u bë me qëllim që toka të mos ndotej nga ekzistenca e tyre.

Falënderimi e lavdërimi janë vetëm për All'llahun, i Cili asgjësoi popullin e Salihut, themudët, dhe që shkatërroi Faraonin së bashku me popullin e tij shpërdorues. All'llahu bëri që shenjat e mbetjet nga të zhdukurit të jenë provë për ata që duan të nxjerrin mësim nga pësimet e popujve të mëhershëm.

Falënderimi e lavdërimi janë vetëm për All'llahun, i Cili bëri mirësi dhe u dha përparësi, fuqi e forcë robve të zgjedhur prej Tij, Daudit e Sulejmanit, si dhe besimtarëve të ngjashëm me ta.

Falënderimi e lavdërimi janë vetëm për All'llahun që e udhëzoi popullin e Sebes në rrugën e së vërtetës dhe e largoi nga rruga e humbjes ku ishte më parë.

Në vijim, ky ajet shton: **"...dhe paqja e bekimi qoftë për robtë e Tij që Ai i zgjodhi (Profetët)".**

Paqja dhe bekimi qofshin për Musain, Salihun, Lutin, Sulejmanin, Daudin, për të gjithë Profetët e të Dërguarit, për robtë e mirë të All'llahut dhe për të gjithë ata që ecin në gjurmët e tyre me punë të mira!

Pastaj, në frazën vijuese të ajetit thuhet: **"A është All'llahu më i mirë (për t'i besuar) apo janë ato që ju i bëni shok Atij?!"**.

Në tregimet e këtyre Profetëve kemi parë se idhujt e punuar prej guri ose prej druri, kur zbriti dënimi, ose sprova, qenë të pafuqishëm ta largonin dënimin prej adhuruesve të tyre, ose t'u jepnin atyre qoftë edhe ndihmën më të vogël. Ndërsa All'llahu, i Gjithëfuqishmi, të Cilit nuk i mungon asgjë dhe që s'ka nevojë për asnjë send, nuk i ka lënë kurrë vetëm robtë e Tij, por me dashamirësinë e me butësinë e Vet të pafundme, i ka ndihmuar dhe është kujdesur për ta.

Ajetet: 60 - 64

أَمَّنْ خَلَقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ وَأَنْزَلَ لَكُمْ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً فَأَنْبَتْنَا بِهِ ۚ
 حَدَائِقَ ذَاتَ بَهْجَةٍ مَا كَانَ لَكُمْ أَنْ تُنْبِتُوا شَجَرَهَا ۗ أَعَلَيْهِ مَعَ اللَّهِ بَلْ هُمْ قَوْمٌ
 يَعْدِلُونَ ﴿٦٠﴾ أَمَّنْ جَعَلَ الْأَرْضَ قَرَارًا وَجَعَلَ خِلَالَهَا أَنْهَارًا وَجَعَلَ لَهَا رَوَاسِيَ
 وَجَعَلَ بَيْنَ الْبَحْرَيْنِ حَاجِزًا ۗ أَعَلَيْهِ مَعَ اللَّهِ بَلْ أَكْثَرُهُمْ لَا يَعْلَمُونَ ﴿٦١﴾ أَمَّنْ
 يُجِيبُ الْمُضْطَرَّ إِذَا دَعَاهُ وَيَكْشِفُ السُّوءَ وَيَجْعَلُكُمْ خُلَفَاءَ الْأَرْضِ ۗ أَعَلَيْهِ
 مَعَ اللَّهِ قَلِيلًا مَا تَذَكَّرُونَ ﴿٦٢﴾ أَمَّنْ يَهْدِيكُمْ فِي ظُلُمَاتِ الْبَرِّ وَالْبَحْرِ وَمَنْ
 يُرْسِلُ الرِّيَّحَ بُشْرًا بَيْنَ يَدَيْ رَحْمَتِهِ ۗ أَعَلَيْهِ مَعَ اللَّهِ تَعَالَى اللَّهُ عَمَّا يُشْرِكُونَ ﴿٦٣﴾
 أَمَّنْ يَبْدَأُ الْخَلْقَ ثُمَّ يُعِيدُهُ وَمَنْ يُرْزُقُكُمْ مِنَ السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ ۗ أَعَلَيْهِ مَعَ
 اللَّهِ قُلْ هَاتُوا بُرْهَانَكُمْ إِنْ كُنْتُمْ صَادِقِينَ ﴿٦٤﴾

“Apo Ai që krijoi qiejt e Tokën; për ju Ai lëshoi prej qiellit ujë me të cilin Ne bëmë që të lulëzojnë kopshte të bukura; ju e kishit të pamundur të bëni që në ato (kopshtet) të mbijnë pemët; a mund të ketë zot tjetër krahas All’llahut? Jo, por ata janë njerëz që shtrembërojnë (të vërtetën).”

“Apo Ai që e bëri tokën vend qëndrimi; Ai bëri që nëpër atë (tokën) të rrjedhin lumenj dhe për atë (tokën) Ai bëri përforcues

(malet); edhe në mes dy detrave Ai bëri një ndarës; si mund të ketë zot tjetër krahas All'Ilahut? Jo, por shumica e tyre nuk dinë."

"Apo Ai që i përgjigjet nevojtarit kur ai i kërkon ndihmë, duke i larguar të keqen dhe që u bëri ju zotërues të tokës; si mund të ketë zot tjetër krahas All'Ilahut? Jo, por janë pak ata që mendojnë për këtë."

"Apo Ai që u udhëzon ju në errësirat e tokës e të detit, Ai i dërgon erërat si përgëzuese para mëshirës së Tij (shiut); a mund të ketë zot tjetër krahas All'Ilahut? E lartë është madhëria e Tij nga ato që ata i vënë Atij për shokë."

"Apo Ai që e filloi krijimin (e njeriut) pastaj Ai e rikthen atë (e ringjall) dhe që u furnizon ju prej qiellit e prej Tokës? Si mund të ketë zot tjetër krahas All'Ilahut? Thuj: Silleni argumentin tuaj, nëse jeni të vërtetë (në pretendimin tuaj)!"

Komentimi

Edhe me kaq shumë argumente, ju vazhdoni t'i bëni shok All'Ilahut në adhurim!

Në ajetin e fundit të grupit të ajeteve të mësipërme, pas përmendjes së disa aspekteve nga jeta e pesë prej Profetëve të mëdhenj, lind pyetja e shkurtër por shumë domethënëse: **"A është**

All'Ilahu më i mirë (për t'i besuar) apo janë ato që ju i bëni shok Atij?".

Kurse ajetet që janë objekt studimi, i ndajnë pyetjet që u drejtohen politeistëve në të pesë ajetet e këtij grupi dhe që fillojnë me një rën prej pesë pyetjeve, me qëllim që të diskutohet me politeistët dhe të gjykohe ata; njëkohësisht nxirren në dukje argumentet që vërtetojnë se All'Ilahu është Zoti Një e i Vetëm. Kjo realizohet me pesë ajete që sjellin dymbëdhjetë shembuj.

Ajeti i parë prej këtij grupi ajetes flet për krijimin e qiejve e të tokës, për zbritjen e ujit nga qielli dhe për begatitë e shumta që vijnë nga uji. Në ajet bëhet pyetja: A mos janë më të mirë ata idhujt që ju adhuron? **"Apo Ai që krijoi qiejt e Tokën, për ju Ai lëshoi prej qiellit ujë me të cilin Ne bëmë që të lulëzojnë¹ kopshte të bukura."**²

Fjala e ajetit "*hadàik*", është shumësi i fjalës "*hadijkatun*". Sipas shumicës së interpretuesve të Kur'anit, kjo fjalë do të thotë: kopsht i rrethuar me mur dhe i ruajtur nga të gjitha anët. Kjo fjalë

¹ Sipas rregullave të gramatikës e të sintaksës së gjuhës arabe, fjala e ajetit "*dhâte*" në frazën "*dhâte behxhetin*" do të thotë **"të bukura"**. Kjo fjalë ka ardhur në numrin njëjës, ndonëse fjala "*hadàika*" - **"kopshte"** është në numrin shumës dhe është shumës jo i rregullt, por shumësi jo i rregullt disa herë mund të vijë në kuptimin e fjalës "*xhemà'atun*" - **"grup"** që si fjalë ndonëse shpreh shumicë, është në numrin njëjës. Për rrjedhojë, edhe cilësori i kësaj fjale është në numrin njëjës.

² Në të vërtetë, në këtë ajet kemi një heqje që vlerësohet me pyetjen: ato që ju i bëni shok All'Ilahut, janë më të denjë për t'u adhuruar, apo është më i denjë për t'u adhuruar Ai që ka krijuar qiejt dhe tokën? Në të vërtetë, pyetja në ajetin e kaluar ishte kështu: më i denjë për t'u besuar është All'Ilahu apo ato idhujt tuaj që ju ia bëni shok Atij? Pikërisht këtu fillon dhe pyetja e kundërt: ato që ju ia bëni për shok All'Ilahut në adhurim janë më të mirë apo është Ai që ka krijuar qiejt dhe tokën?

përdoret edhe për të zezën e syrit, në kuptimin që ajo është e ruajtur në zgavrën e syrit, në mes dy kapakëve e dy qerpikëve. Ndërsa Ragibi, në fjalorin e tij të fjalëve të Kur'anit "Mufredàtu el Fàdhil Kur'ani", shpjegon se fjala "*hadijkatun*" në origjinën e saj përdoret për tokën në të cilën është mbledhur ujë, ashtu siç është bebja e syrit, gjithmonë në ujë.

Prej këtyre mendimeve mësohet se fjala "*hadijkatun*" tregon një kopsht të rrethuar me mur, ku ka ujë të mjaftueshëm.

Fjala tjetër e ajetit "*behxhetin*" ka kuptimin e së bukurës, nga e cila kënaqen sytë e atyre që e shohin.

Në frazën e parafundit të këtij ajeti, Kur'ani u drejtohet njerëzve dhe u thotë: **"Ju e kishit të pamundur të bëni që në ato (kopshtet) të mbijnë pemët."**

Ju mund të mbillni farët dhe të vaditni tokën, por jetën në "zemrën" e farëzës e krijon vetëm Ai që e urdhëroi Diellin të lëshojë rrezet e tij mbi Tokën. Ai e zbret ujin prej qiellit, me të cilin mbijnë bimët, që më pas bëhen pemë. Ai që i bën të gjitha këto është vetëm All'Ilahu i Lartësuar!

Këto janë të vërteta që as nuk mund të mohohen e as nuk mund t'i adresohen ndonjë tjetri përveç All'Ilahut. All'Ilahu është Krijuesi i qiejve e i tokës. Ai e zbret shiun nga qielli. Ai e zbret ujin, që është fillesa e asaj bukurie që shihet në botën e gjallë.

Një meditim i vetëm mbi ngjyrën e bukur të luleve, mbi hijeshinë e petaleve aq të sistemuara, që në tërësinë e tyre formojnë atë pamje të mrekullueshme e mahnitëse, do të mjaftonte që njeriu ta njihnte madhësitë e Krijuesit, fuqinë dhe urtësinë e

Tij. Të gjitha këto janë fakte që e trondisin zemrën e njeriut dhe i bëjnë atij thirrje të besojë vetëm tek All'Ilahu.

Me fjalë të tjera, besimi në All'Ilahun, Zotin Një e të Vetëm, çon në atë që në terminologjinë e doktrinës islame quhet *"Teuhjidlul Khàlk"* - Krijuesi i vetëm dhe *"Teuhjiddurr Rrubùbij'jeh"* - Regulluesi i vetëm i gjithësisë, që është motiv detyrues për të adhuruar vetëm All'Ilahun. Në terminologjinë e doktrinës islame, ky detyrim quhet *"Teuhjidlul Ibàdeti"* - adhurim vetëm për All'Ilahun.

Për të gjitha këto, në fundin e ajetit, Kur'ani shtron pyetjen: **"Si mund të ketë zot tjetër krahas All'Ilahut?"**.

Megjithatë, ata injorantë hoqën dorë nga adhurimi kushtuar vetëm All'Ilahut. Ata adhuruan gjëra që i punuan me duart e veta dhe që natyrisht nuk u sjellin atyre as dobi e as dëm. Për këtë, ajeti njofton: **"Jo, por ata janë njerëz që shtrembërojnë (të vërtetën)."**¹

Pyetja e dytë ka të bëjë me dhuntinë e fortësisë së tokës, që është vendqëndrimi i njeriut në botën e madhe të gjithësisë. Për këtë, Kur'ani shtron pyetjen: Vallë ato idhujt tuaj janë më të mirë, **"Apo Ai që e bëri tokën vendqëndrim, Ai bëri që nëpër atë (tokën) të rrjedhin lumenj dhe për atë (tokën) Ai bëri përforcues (malet)";** Ai i bëri malet që ta ruajnë koren e tokës prej tërmetejeve si dhe: **"...edhe në mes dy detrave Ai bëri një ndarës"**, vuri një ndalues që uji i kripur i detit të mos përzihet me ujin e pijshëm.

¹ Fjala e ajetit *"ja'dilùne"* në rrënjën e saj *"adùl"* do të thotë devijim e heqje dorë nga e vërteta dhe shkarje në të gabuarën; por mund të jetë edhe në kuptimin e të ngjashmit. Në formën e parë, kuptimi i ajetit është: ata i shmangen adhurimit të All'Ilahut Një e të Vetëm dhe adhurojnë dikë tjetër; kurse në formën e dytë, kuptimi i ajetit është: ata bëjnë një të ngjashëm me All'Ilahun.

Siç shihet, në këtë ajet përmenden katër mirësi të mëdha, tri prej të cilave flasin për fortësinë e tokës. Ajeti njofton se toka ka stabilitet, edhe pse lëviz me shpejtësi në rrugën e saj rreth diellit e në të njëjtën kohë rrotullohet rreth vetes. Ky rrugëtim i tokës bëhet në kuadrin e sistemit diellor të planeteve. Megjithatë, lëvizja e tokës është e qetë dhe monotone, prandaj banorët e tokës nuk e ndjejnë atë dhe u duket sikur toka është e ngulur në një vend.

Mirësia tjetër është ekzistenca e maleve, për të cilët më lart kemi thënë se e rrethojnë tokën dhe rrënjët e tyre janë të puqura njëra me tjetrën si një digë e fuqishme dhe i rezistojnë jo vetëm presioneve të brendshme të tokës, por edhe lëvizjeve të fuqishme të fenomenit baticë-zbaticë, që siç dihet shkaktohet prej forcës tërheqëse të hënës. Veç kësaj, malet ndalojnë forcën e madhe të furtunave dhe të ujërave të furishme, që me furinë e tyre mund të shkatërrojnë tokën.

Mirësia tjetër është ekzistenca e ndarësit midis dy llojeve të ujërave, që shërben si një “mur” ndarës natyral në mes ujit të kripur dhe ujit të pijshëm. Ky ndarës, që nuk shihet me sy, ka të bëjë me ndryshimin e dendësisë midis ujit të ëmbël dhe atij të kripur, ose siç përdoret me termin shkencor, me ndryshimin në peshën specifike të çdonjërit prej dy llojeve të ujërave. Është pikërisht ky ndryshim ndarës, që ndalon përzierjen e ujërave të ëmbla të lumenjve të mëdhenj që derdhen në detrat e kripur për një kohë të gjatë. Në kohë batice, këto ujëra të ëmbla futen nëpër tokat bregdetare të përshtatshme për bujqësinë dhe i vadisin ato. (Në lidhje me këtë çështje kemi vënë një studim të veçantë në komentin e ajetit 53 të sure “El Furkàn”).

Në të njëjtën kohë, All'llahu i Lartësuar ka bërë që në pjesë të ndryshme të tokës të rrjedhin lumenj dhe me ujin e tyre vaditen të mbjellat dhe shuajnë etjen gjallesat; me këtë ujë gjelbërojnë kopshtet e japin fruta pemët. All'llahu i Lartësuar ka bërë që burimet e disa prej këtyre lumenjve të jenë në majat e maleve, ndërsa burimet e disa të tjerëve të jenë në mesin e shtresave të tokës.

Si mund të mendohet që ky sistem të jetë krijuar si rezultat i rastësisë?! Vallë, a mund të kenë idhujt ndonjë ndikim mbi këtë sistem të mrekullueshëm, para të cilit njeriu vetëm mahnitet?

As vetë adhuruesit e idhujve nuk kanë të tilla pretendime, prandaj në fundin e ajetit, Kur'ani përsëri thotë: **“Jo, por shumica e tyre nuk dinë”**.

Pyetja e tretë ndër këto pesë pyetje tregon dialogun dhe gjykimin e ndërsjellë si dhe flet për zgjidhjen e problemeve, për hapjen e rrugës së mbyllur dhe për përgjigjen e lutjes, ashtu siç e lexojmë në ajetin vijues: **“Apo Ai që i përgjigjet nevojtarit kur ai i kërkon ndihmë duke i larguar të keqen.”**.

Kur para njeriut mbyllen të gjitha portat e botës së shkaqeve, kur ai nuk di nga të shkojë dhe kur nevojat e tij janë aq të shumta sa nuk i përballon dot, Ai që e zgjidh problemin e këtij nevojtarit dhe që i hap bravat e portave, që i asgjëson gardhet e ngritura në rrugën e tij dhe fut shpresë në zemrën e tij është All'llahu i Lartësuar. Ai i hap nevojtarit portat e mëshirës së Tij atëherë kur ai nuk e di se çfarë të bëjë e ku të shkojë. Të gjitha këto vijnë vetëm prej All'llahut dhe nuk mund të vijnë kurrë prej ndonjë tjetri.

Kur të gjithë njerëzit ta kuptojnë këtë të vërtetë në thellësi të shpirtit të tyre në sajë të natyrës së tyre të krijimit, do të shohin se edhe politeistët kur gjenden në mes të dallgëve të mëdha të detit që përplasen me njëra-tjetrën nga të gjitha anët, i harrojnë zotat që adhurojnë dhe i drejtohen vetëm dashamirësisë e butësisë së All'llahut të Lartësuar, ashtu siç e lexojmë në ajetin 65 të sures "El Ankebût": **"Kur ata (idhujtarët) hipin në anije i luten All'llahut sinqerisht që t'i shpëtojë."**

Për këtë arsye, ajeti shton: Ai jo vetëm që u shpëton nga këto rrugë pa krye dhe nga këto gjendje tepër të rënduara, por: **"Ai u bëri ju zotërues të tokës"**; mirëpo ju nuk doni t'i shikoni këto argumente. Për këtë të vërtetë, ajeti njofton: **"...janë pak ata që mendojnë për këtë"**.

Kuptimin e fjalëve të ajetit: nevojtar, përgjigjja e lutjes dhe kushtet e saj, do ta trajtojmë në studimet në fundin e këtyre ajeteve.

Për sa i përket shprehjes së ajetit **"zotërues të Tokës"**, ajo mund të ketë kuptimin: "banorë të tokës" dhe pronarë të saj, sepse All'llahu e ka bërë njeriun sundues mbi këtë tokë; Ai është dorështrirë në të gjitha mirësitë që ka dhuruar për njerëzit, duke përfshirë edhe shkaqet e mirëqenies dhe sigurinë.

Kur njeriu ndodhet në gjendje të vështirë, atëherë kur ai ka nevojë të ngutshme, i drejtohet Krijuesit të tij bujar dhe i lutet që me bujarinë e Tij të largojë prej tij pësimet e rënda dhe pengesat, që të ndreqen sa më mirë themelet e këtij "zotërimi" të tokës; pikërisht këtu del qartë lidhja midis dy pjesëve të ajetit.

Por qëllimi me kuptimin e kësaj shprehjeje mund të jetë: All'llahu e bëri rregullin e jetës që njerëzit të vijnë vazhdimisht njëri pas tjetrit. Nëse nuk do të ekzistonte një rregull i tillë, forma e jetës nuk do të ishte e plotësuar.

Në vijim, Kur'ani shtron pyetjen e katërt rreth çështjes së udhëzimit në rrugën e së vërtetës, duke thënë: A janë më të mirë idhujt, **“Apo Ai që u udhëzon ju në errësirat e tokës e të detit”**, me anë të yjeve dhe: **“Apo Ai që i dërgon erërat si përgëzuese para mëshirës së Tij (shiut)”**?!

Erërat janë treguese të rënies së shiut. Gjithashtu, retë me lëvizjen që bëjnë para rënies së shiut, janë lajmëtare të këtij përgëzimi dhe u njoftojnë njerëzve drejtimin e rënies së shiut.

Fjala e ajetit *“bushren”* – *“përgëzim”* ka të bëjë me retë; kurse në frazën e ajetit *“bejne jedej rahmetihi”* – *“para mëshirës së Tij (shiut)”* me shiun shprehet mëshira e Zotit. Të dyja këto shprehje janë shumë kuptimplota, për faktin se retë janë mbartëset e lagështirës në atmosferë dhe transportojnë avujt e ujit prej sipërfaqes së oqeanëve në formën e pjesëve të reve, derisa këta avuj shndërrohen në pikëza uji. Janë pikërisht këto erëra që sjellin përgëzimin për ardhjen e shiut.

Shiu sjell jetë mbi sipërfaqen e tokës dhe aty ku zbret ai do të shihet begatia dhe mëshira.

(Në lidhje me ndikimin e reve në fenomenin e rënies së shiut, kemi vënë një studim të detajuar në komentin e ajetit 57 të sures *“El A'râf”*).

Në fundin e ajetit që është objekt studimi, Kur'ani u flet politeistëve edhe një herë dhe u thotë: **"...a mund të ketë zot tjetër krahas All'llahut?!"**.

Dhe pa pritur përgjigjen, menjëherë shton: **"E lartë është madhëria e Tij nga ato që ata i vënë Atij për shokë."**

Në ajetin e fundit të këtij grupi, Kur'ani Famëlartë shtron pyetjen e pestë në lidhje me çështjen e fillimit të krijimit dhe të ringjalljes pas vdekjes, duke thënë: A idhujt tuaj janë më të mirë: **"Apo Ai që e filloi krijimin (e njeriut) pastaj Ai e rikthen atë (e ringjall) dhe që u furnizon ju prej qiellit e prej tokës? A mund të ketë zot tjetër krahas All'llahut?"**.

Vallë, edhe pas kësaj do të besoni në ekzistencën e një të adhuruari tjetër përveç All'llahut?! Atëherë: **"Thuaj: Silleni argumentin tuaj, nëse jeni të vërtetë (në pretendimin tuaj)."**

Katër ajetet e para flasin për fillimin e krijimit, për madhështinë e All'llahut në botën e krijimit dhe të ekzistencës, si dhe për mirësitë që Ai ka dhuruar; kurse në ajetin e fundit, me një shprehje shumë domethënëse, studimi kalon në çështjen e ringjalljes, sepse vetë krijimi është një argument që e vërteton Ringjalljen. Gjithashtu, edhe fuqia për fillimin e krijimit, konsiderohet si argument shumë i qartë që vërteton Ringjalljen pas vdekjes.

Prej këtu bëhet e qartë edhe përgjigja për pyetjen që bëjnë shumë prej interpretuesve të Kur'anit, të cilët thonë: Si është e mundur që politeistëve, shumica e të cilëve nuk kanë besuar në "ringjalljen trupore", t'u shtrohet pyetja në lidhje me të dhe të kërkohet miratimi prej tyre?

Përgjigjja për këtë pyetje është e bashkëngjitur me argumentin që e çon palën tjetër të pohojë se fillimi i krijimit dhe të gjitha këto dhunti e mirësi janë prej All'llahut, me qëllim që mendjet e tyre të pranojnë edhe mundësinë e ringjalljes e të rikthimit në jetë edhe një herë tjetër në Ditën e Kiametit.

Me “furnizim qiellor” nënkuptohet shiu, drita e diellit e të ngjashme me to; kurse me “furnizim tokësor” nënkuptohen bimët, lëndët ushqimore që rriten mbi sipërfaqen e tokës drejtpërdrejt ose tërthorazi, si psh. bagëtia, mineralet dhe lëndët e ndryshme, nga të cilat njeriu përfiton gjatë jetës së tij.

Hulumtime

1- Cilit nevojtar i përgjigjet All'llahu kur ai i lutet Atij?

All'llahu i Lartësuar u përgjigjet të gjitha lutjeve kur plotësohen kushtet e lutjes, por në ajetet e lartpërmendura theksohet përgjigjja e lutjes për personin në nevojë të madhe, sepse vetëm në gjendjen e nevojave të mëdha plotësohet njëri prej kushteve që lutja të gjejë përgjigje; pra kur njeriut i janë mbyllur të gjitha mundësitë, ai dorëzohet me zemër e me shpirt para mëshirës së All'llahut. Gjithashtu, në këtë gjendje ai mendon se gjithçka vjen vetëm prej All'llahut dhe është vetëm për All'llahun. Në gjendjen e vështirësisë së madhe, nevojtar i është i bindur se zgjidhja e çdo problemi është vetëm në dorën e All'llahut.

Kjo botë është botë e shkaqeve dhe e pasojave. Këtu besimtari derdh edhe pikën e fundit të mundit e të përpjekjeve, por nuk humb kurrë në botën e shkaqeve, sepse ai beson se çdo begati vjen vetëm prej All'llahut. Duke e ditur këtë, ai i kërkon Atij gjërat që dëshiron.

Kur njeriu arrin në një gradë të tillë, ai i mundëson vetes kushtin më të rëndësishëm që lutja e tij të gjejë përgjigje.

Është interesant fakti se në disa transmetime që kanë ardhur në lidhje me interpretimin e këtij ajeti të nderuar, flitet për ardhjen e Mehdiut.

Në një transmetim të ardhur prej Imam Bäkirit, ai ka thënë: *"Pasha All'llahun, më bëhet sikur unë e shikoj sunduesin; ai e ka mbështetur shpinën e tij mbi gur dhe i kërkon All'llahut të drejtën e tij. Pasha All'llahun, ky është ai që ka nevojë të ngutshme e të madhe dhe që përmendet në Librin e All'llahut: **"Apo Ai që i përgjigjet nevojtarit kur ai i kërkon ndihmë duke i larguar të keqen dhe që u bëri ju zotërues të tokës."***¹

Në një transmetim tjetër të ardhur prej Imam Sadikut, lexojmë se ai ka thënë: *"Ajete ka zbritur për kryetarin prej familjes së Muhammedit (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Pasha All'llahun, ai do të falë dy rekat namaz pranë mekâmit (vendqëndrimi i Ibrahimit në Qabe). Aty do t'i lutet All'llahut të Lartësuar dhe lutja e tij do të gjejë përgjigje. All'llahu do të largojë të keqen dhe do ta bëjë atë kalifin e tokës."*²

¹ Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 4, f. 94.

² Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 4, f. 94.

S'ka dyshim se ky interpretim, ashtu si edhe shumë interpretime të ngjashme, nuk e kufizon qëllimin e këtij ajeti vetëm te Mehdiu (*Paqja qoftë mbi të!*), pasi kuptimi i tij është shumë i gjerë. Është koha kur të gjitha portat janë të mbyllura, degjenerimi e imoraliteti kanë përfshirë tokën mbarë dhe i gjithë njerëzimi gjendet në një rrugë të mbyllur. Pikërisht në atë kohë, gjendja e nevojës së madhe e të rëndë është e dukshme në të gjitha anët e botës; pikërisht në atë kohë, në vendin më të shenjtë do të shfaqet Imam Mehdiu. Ai do të kërkojë largimin e së keqes dhe All'llahu i Lartësuar do t'i përgjigjet lutjes së tij qysh në fillim të shfaqjes së tij në botë dhe do ta bëjë sundimtar të tokës, së bashku me shokët e tij. Kështu, kjo ngjarje do të jetë një prej fakteve që vërtetojnë fjalën e All'llahut: **"Ai u bëri ju zotërues të Tokës"**.

(Në lidhje me kushtet e pranimet të lutjes, rëndësinë dhe shkaqet e mospërgjigjes së saj, kemi vënë një studim të detajuar në komentin e ajetit 186 të sures "El Bekare").

2- Arsyetim logjik në të gjitha çështjet

Shpesh lexojmë në ajetet e Kur'anit kërkesën që u bëhet kundërshtarëve për të sjellë argument dhe në mënyrë të veçantë me frazën: **"...silleni argumentin tuaj"**. Kjo frazë kërkesë ka ardhur në katër sure të Kur'anit: "El Bekare", ajeti 115; "El Enbijà", ajeti 24; "En Neml", ajeti 64 dhe në suren "El Kasas", ajeti 75. Gjithashtu, në sure të tjera, kjo kërkesë është theksuar vetëm me fjalën "*burhàn*" - "*argument*". Kjo fjalë ka kuptimin: "*argument më i vërtetë*".

Kjo logjikë e Islamit, pra kërkimi i argumentit, tregon përmbajtjen e fuqishme të argumentit të All'llahut dhe faktin se Ai

nuk ka nevojë për asnjë lloj ndihme. Islami është ballafaquar vazhdimisht me kundërshtarët e tij vetëm me logjikë. Pra, si është e mundur që Kur'ani u kërkon të tjerëve argumentin, ndërsa ata nuk shqetësohen aspak?! Ajetet e Kur'anit Famëlartë janë të mbushura me arsyeime logjike dhe me argumente shkencore në shumë çështje.

Kjo është e kundërta e devijimit që i është bërë kristianizmit në ditët tona. Në të thuhet se feja është ajo që frymëzon zemrat dhe se logjika është e ndarë prej saj. Puna ka arritur deri aty sa të besohet në kontradiktat logjike, siç është çështja e monoteizmit të paraqitur në formën e trinitetit, duke lejuar të futen në fe mite të shumta. Kur feja zhvishet prej arsyetimit logjik, shumë shpejt nuk do të ketë argument kundër saj, çka bën që vetë feja të barazohet me të kundërtat e saj.

Madhështia e Kur'anit shpaloset qartë edhe në programin kur'anor për kërkimin e argumentit (interesimi i veçantë i Kur'anit për të kërkuar argument dhe thirrja e tij drejtuar kundërshtarëve për arsyeime logjike), ndonëse Islami u shfaq në një mjedis ku lulëzonin mite të pabaza, duke shtuar edhe çështje jologjike në fushën e mendimit e të dijes.

3- Përmbledhje e përgjithshme mbi ajetet që janë objekt studimi

Në grupin e ajeteve që janë objekt studimi vërehet interesimi i madh i Kur'anit, që është përqendruar në vërtetimin e përparësisë së parimit se i Adhuruari është vetëm **Një (Teuhijdul-Maëbùdi)** ndaj parimit se Krijuesi është vetëm **Një (Teuhijdul-**

Khàliki) si dhe ndaj parimit se Rregulluesi është vetëm **Një (Teuhjduurr Rrubùbij'jeh)**. Gjithashtu, këto ajete flasin për dymbëdhjetë argumente e shenja të All'Ilahut të Madhëruar në botën e ekzistencës:

- 1- Qielli dhe Toka.
- 2- Rënia e shiut.
- 3- Begatitë e ujit në botën e gjallë.
- 4- Stabiliteti i Tokës.
- 5- Lumenjtë.
- 6- Malet.
- 7- Ndarësi midis dy ujrave (të ëmbël dhe të kripur).
- 8- Përgjigjja e lutjes së njerëzve.
- 9- Udhëzimi i njerëzve.
- 10- Lëshimi i erërave si përgëzuese për ardhjen e mëshirës së Zotit.
- 11- Fillimi i krijimit dhe Ringjallja.
- 12- Furnizimi me ushqim i njeriut dhe i të gjitha krijesave prej qiellit e Tokës.

Këto dymbëdhjetë dhurata e mirësi janë shpjeguar në pesë ajete në kuadrin e pesë pyetjeve që trajtojnë çështjet e mëposhtme:

- 1- Krijimi.
- 2- Stabiliteti.
- 3- Largimi i gjendjes së rëndë.
- 4- Udhëzimi.
- 5- Rikthimi i jetës (pas vdekjes).

Pas çdonjërës prej këtyre pesë çështjeve ka ardhur fraza pyetëse habitore: *“e ilàhun meall'Ilàhi”* - **“si mund të ketë zot tjetër krahas All'Ilahut”**.

Në fundin e çdonjërës prej këtyre pesë pyetjeve, Kur'ani Famëlartë shpjegon qartë dhe e vë theksin mbi çështjet vijuese:

Në ajetin e parë thekson devijimin e kundërshtarëve nga rruga e vërtetë.

Në ajetin e dytë thekson injorancën e tyre.

Në ajetin e tretë thekson faktin se ata nuk mendojnë.

Në ajetin e katërt thekson degradimin e tyre ideor.

Dhe në fundin e ajetit të pestë u kërkon atyre të sjellin argument.

Në këtë grup ajetesh, Kur'ani Famëlartë ka shpalosur në një formë përgjithësuese një tubë çështjesh gjithëpërfshirëse e të harmonizuara me njëra-tjetrën.

Ajetet: 65 - 68

قُلْ لَا يَعْلَمُ مَنْ فِي السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ الْغَيْبَ إِلَّا اللَّهُ وَمَا يَشْعُرُونَ أَيَّانَ يُبْعَثُونَ ﴿٦٥﴾ بَلِ أَذْرَكَ عِلْمُهُمْ فِي الْآخِرَةِ بَلْ هُمْ فِي شَكٍّ مِنْهَا بَلْ هُمْ مِنْهَا عَمُونَ ﴿٦٦﴾ وَقَالَ الَّذِينَ كَفَرُوا أَإِذَا كُنَّا تُرَابًا وَعَآبَآؤُنَا أَنِنَا لَمُخْرَجُونَ ﴿٦٧﴾ لَقَدْ وَعَدْنَا هَذَا نَحْنُ وَعَآبَآؤُنَا مِنْ قَبْلُ إِنْ هَذَا إِلَّا أَسَاطِيرُ الْأَوَّلِينَ ﴿٦٨﴾

“Thuaj: Askush përveç All’Ilahut, as në qiej e as në Tokë nuk e di të fshehtë; ata nuk e dinë se kur do të ringjallen.”

“Por dijenia për ato (të fshehtat) arrihet në Botën Tjetër; porse ata dyshojnë në atë (Ringjalljen), madje ata për Botën Tjetër janë të verbër.”

“Ndërsa ata që nuk besuan thanë: A pasi ne dhe prindërit tanë të bëhemi tokë e pluhur, do të ringjallemi?”

“Kjo na është premtuar ne dhe prindërve tanë më përpara, por kjo nuk është gjë tjetër veçse prej legjendave të mëparshmëve.”

Komentimi

Në ajetin e fundit të grupit të ajeteve të mëparshme u fol për Kiametin dhe Ringjalljen pas vdekjes, kurse në ajetet që janë objekt studimi, kjo çështje trajtohet në disa aspekte. Në fillim i jepet përgjigje pyetjes që politeistët e bënin vazhdimisht: Kur do të bëhet Kiameti? Kur do të vijë ky premtim?

Dhe ajeti përgjigjet: **“Thuaj: Askush përveç All’llahut, as në qiej e as në Tokë nuk e di të fshehtë, ata nuk e dinë se kur do të ringjallen.”**.

Pa dyshim që dituria për të panjohurën, pra edhe koha kur do të ndodhë Kiameti, janë dituri të veçanta për All’llahun, por Ai mund t’u japë disa prej robve të Tij një pjesë prej kësaj diturie, ashtu siç njoftojnë ajetet 26 dhe 27 të sures “El Xhinn”: **“Ai di të fshehtë dhe të fshehtë e Tij nuk ia tregon askujt, me përjashtim të ndonjë të Dërguari prej të cilit Ai është i kënaqur.”**.

Me fjalë të tjera, vetë dituria e së fshehtës me mënyrën e saj të pavarur dhe të pakufizuar, është e veçantë vetëm për All’llahun, të Gjithëfuqishmin. Të gjitha dituritë që kanë të tjerët, u janë dhënë atyre prej të Lartit, por çështja e kohës se kur do të ndodhë Kiameti bën përjashtim nga ky rregull, sepse atë nuk e di askush përveç All’llahut.¹

¹ Në lidhje me diturinë e së panjohurës, kemi vënë një studim të detajuar në pjesët e mëparshme të këtij tefsiri.

Kur'ani tregon se politeistët, jo vetëm që nuk mund të kishin dijeni për kohën e ndodhjes së Kiametit, por paditurinë e tyre e shfaqnin sheshit me dyshime të shumta. Për këtë, në Kur'an thuhet: **“Por dijenia për ato (të fshehtat) arrihet në Botën Tjetër; porse ata dyshojnë në atë (Ringjalljen), madje ata për Botën Tjetër janë të verbër.”**

Fjala e ajetit *“id'dàreke”*, që në origjinë është *“tedàreke”*, do të thotë: njëri pas tjetrit, ose bashkimi i të fundmit me të parin. Kështu, fraza e ajetit **“Por dijenia për ato (të fshehtat) arrihet në Botën Tjetër”**, do të thotë se ata nuk kanë arritur të mësojnë asgjë, ndonëse kanë shfaqur mendime të shumta dhe kanë mbledhur të dhëna në lidhje me këtë çështje. Prandaj, Kur'ani shton menjëherë frazën vijuese: **“...porse ata dyshojnë në atë (Ringjalljen), madje ata për Botën Tjetër janë të verbër”**.

Në të vërtetë, argumentet e Botës Tjetër janë të dukshme edhe në këtë botë: rikthimi i jetës në tokat e vdekura gjatë stinës së pranverës, çelja e luleve të pemët dhe më pas lidhja e frutave, ndonëse gjatë dimrit ato pemë ishin të zhveshura, shfaqja e madhështisë së All'llahut në tërësinë e krijimit dhe të botës së gjallë, - të gjitha këto janë argumente që vërtetojnë mundësinë e rikthimit të jetës pas vdekjes, por ata të verbërit nuk i shohin këto që ndodhin para syve të tyre!

Për frazën e mësipërme ka edhe interpretime të tjera. Disa kanë thënë se fraza **“Por dijenia për ato (të fshehtat) arrihet në Botën Tjetër”**, tregon se shkaqet e arritjes së diturisë në lidhje me Botën Tjetër janë të shumta dhe vijnë njëri pas tjetrit, por ata nuk i shihnin dot ato për shkak të *“verbërisë”* së tyre.

Disa të tjerë kanë thënë se qëllimi me këtë frazë të ajetit është se kur atyre do t'u hiqet perdja në Ditën e Kiametit, ata do të njohin të vërtetat e Botës Tjetër në mënyrë të mjaftueshme.

Interpretimi më i moderuar mbetet interpretimi i parë, pasi ai është në përputhje jo vetëm me frazat e tjera të këtij ajeti, por edhe me studimet që do të shohim në ajetet e tjera.

Etapat e injorancës së atyre që e mohojnë Botën Tjetër, mund të përmbliidhen në tretë tilla:

E para: mohimi dhe paradoksi i atyre është se ata nuk i dinë karakteristikat e Botës Tjetër dhe meqenëse nuk i shohin ato, ata mendojnë se Kiameti e Ringjallja pas vdekjes janë imagjinatë e fantazi.

E dyta: qysh në bazë ata janë skeptikë për Botën Tjetër dhe pyetja e tyre për kohën se kur do të ndodhë Kiameti del nga fakti se ata dyshojnë në ndodhjen e tij.

E treta: injoranca e skepticizmi i tyre nuk burojnë nga mungesa e argumenteve të mjaftueshme në lidhje me Botën Tjetër. Përkundrazi, argumentet ndër ta janë të shumta, por sytë e tyre janë të verbër dhe nuk i shohin ato.

Ajeti vijues e përmbledh logjikën e mohuesve në lidhje me Kiametin dhe Ringjalljen pas vdekjes, në një fjali të vetme: **“Ndërsa ata që nuk besuan thanë: a pasi ne dhe prindërit tanë të bëhemi tokë e pluhur, do të ringjallemi?!”**.

Ata janë të vetëkënaqur me fjalët e veta kur thonë: është shumë larg mendjes që njeriu të rikthehet në jetë pasi është bërë tokë dhe pluhur. Por ata harrojnë se në fillim njeriu ishte tokë, u krijua prej saj dhe përsëri do të futet në tokë. Atëherë, pse atyre u duket i palogjikshëm fakti se do të ringjallen pasi të jenë bërë baltë e pluhur?!

Është shumë domethënës fakti se një mospërputhje të tillë në mendimin e politeistëve e ndeshim në tetë ajete të Kur'anit Famëlartë, ku njoftohet se ata dyshonin në lidhje me çështjen e Kiametit. Ashtu siç e pamë në ajetin që është objekt studimi, ata dyshonin thjesht ngaqë mendojnë se nuk mund të imagjinohet kthimi i tyre në jetë për herë të dytë prej tokës.

Pastaj Kur'ani tregon fjalët që shtojnë politeistët: **“Kjo na është premtuar ne dhe prindërve tanë më përpara”**, por ne as kemi gjetur e as nuk mund të gjendet ndonjë shenjë prej këtij premtimi: **“...por kjo nuk është gjë tjetër veçse prej legjendave të mëparshmëve”**; këto që na thuhet s'janë gjë tjetër veçse mite e përralla të të parëve.

Duke u bazuar mbi këtë shpjegim, mësojmë se politeistët nisëshin nga mendimi i tyre për pamundësinë e rikthimit në jetë. Këtë mendim ata e marrin si bazë për mohimin e tyre në mënyrë absolute. Nga fjalët e tyre duket se ata prisnin që Kiameti të ndodhte shumë shpejt, pastaj menjëherë shtonin: në jetën tonë nuk kemi parë një gjë të tillë, prandaj e mohojmë Ringjalljen pas vdekjes.

Gjithsesi, shprehjet kur'anore tregojnë se sa të shkujdesur ishin ata, sa pa logjikë flisnin dhe sa mendjemëdhenj tregoheshin.

Nga brendia e kësaj shprehjeje mësohet se ata deshën të vinin në lojë fjalët e Profetit në lidhje me Ditën e Gjykimit, prandaj e sulmuan këtë besim dhe thanë se të gjitha këto premtime të rreme u ishin bërë edhe të parëve të tyre dhe se s'kishte asgjë për të menduar në to apo për të mësuar se si do të jetë Ringjallja.

Ajetet: 69 - 75

قُلْ سِيرُوا فِي الْأَرْضِ فَانظُرُوا كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ الْمُجْرِمِينَ ﴿٦٩﴾ وَلَا تَحْزَنْ عَلَيْهِمْ وَلَا تَكُنْ فِي ضَيْقٍ مِّمَّا يَمْكُرُونَ ﴿٧٠﴾ وَيَقُولُونَ مَتَى هَذَا الْوَعْدُ إِنْ كُنْتُمْ صَادِقِينَ ﴿٧١﴾ قُلْ عَسَى أَنْ يَكُونَ رَدِفَ لَكُمْ بَعْضُ الَّذِي تَسْتَعْجِلُونَ ﴿٧٢﴾ وَإِنَّ رَبَّكَ لَذُو فَضْلٍ عَلَى النَّاسِ وَلَٰكِنَّ أَكْثَرَهُمْ لَا يَشْكُرُونَ ﴿٧٣﴾ وَإِنَّ رَبَّكَ لَيَعْلَمُ مَا تُكِنُّ صُدُورُهُمْ وَمَا يُعْلِنُونَ ﴿٧٤﴾ وَمَا مِنْ غَائِبَةٍ فِي السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ إِلَّا فِي كِتَابٍ مُبِينٍ ﴿٧٥﴾

“Thuaj: Udhëtoni nëpër tokë dhe shikoni se si ishte përfundimi i mizorëve.”

“Ti (o Muhammed) mos u dëshpëro për ata dhe mos e shiko veten ngushtë nga dredhitë që ata kurdisin!”

“Ata (jobesimtarët) thanë: Nëse jeni të vërtetë (në fjalët që na thoni) kur do të vijë ai premtimi?”

“Thuaj: Tanimë u është afruar shumë një pjesë e atij premtimi që ju e kërkonit të vijë sa më shpejt.”

“S’ka dyshim se Zoti yt është shumë bamirës ndaj njerëzve, por shumica e tyre nuk e falënderojnë.”

“Sigurisht që Zoti yt di çka fshehin zemrat e tyre dhe atë çka ata e shfaqin hapur.”

“Nuk ka asgjë të fshehur në qiell e në Tokë që ajo të mos jetë e shënuar në Librin e saktë.”

Komentimi

Zemra ime nuk ngushtohet prej kompleteve që ata kurdisin

Në ajetet e mësipërme tregohet se adhuruesit e idhujve e mohonin Ringjalljen. Gjithashtu, aty tregohet edhe tallja e përgënjeshtrimi që ata bënin për Ditën e Fundit.

Studimi logjik nuk u mor seriozisht prej atyre kundërshtarëve e armiqve të betuar; as argumentet e shumta që sollën ajetet e mëparshme në lidhje me ringjalljen pas vdekjes, në një kohë kur ringjallja shihet çdo ditë në botën e gjallë. Ajetet që janë objekt studimi, në vend që të sillnin për ta një argument, i kërcënojnë ata me dënimin e All’llahut, dënim i cili ka përfshirë edhe jobesimtarët para tyre. Këto ajete i paralajmërojnë jobesimtarët me dënimin turpërues të All’llahut, paralajmërim që bëhet duke i drejtuar fjalën Profetit (*Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), të cilin e urdhëron: **“Thuaj: udhëtoni nëpër tokë dhe shikoni si ishte përfundimi i mizorëve.”**

Ju pohoni se të tilla premtime kanë marrë edhe të parët tuaj, por ata nuk ua vunë veshin dhe nuk menduan se do të pësonin ndonjë dëm. A keni udhëtuar nëpër botë? Nëse do të udhëtoni qoftë edhe jo shumë larg, do të shihni shenja prej atyre mizorëve që nuk besonin në Zotin Një e të Vetëm e që nuk besonin as në Ringjallje. Këto shenja gjenden në rajonet e afërta me Hixhazin. Udhëtoni që të shihni se gjërat nuk janë ashtu siç i mendoni ju.

Edhe koha që është caktuar për ju, do të vijë shumë shpejt, prandaj mos kërkoni përshpejtimin e saj. Nëse nuk do ta përmirësoni veten, atëherë do të përballeni me një të ardhme të pashmangshme, shumë të keqe për ju, dhe me një dënim turpërues.

Kur'ani Famëlartë shpeshherë bën thirrje për të udhëtuar nëpër tokë, që njerëzit të shohin shenjat e mbetura nga popujt e mëparshëm, të shohin vendbanimet e tyre të zbrazura e të kthyer në rrënoja, nën të cilat banorët e tyre u goditën me dënimin më të keq. Kur'ani u thotë jobesimtarëve që të udhëtojnë nëpër tokë për të parë pallatet e mizorëve që pretendonin aq shumë, varrezat e sheshuara dhe kockat e bëra pluhur si dhe pasuritë që lanë pas vetes pronarët mendjemëdhenj.

Njohja me ato shenja që shprehin historinë e gjallë të popujve të mëparshëm, duhet të zgjojë zemrat e shkujdesura. Shikimi i shenjave të tilla tregon të vërtetën e banorëve të atyre rrënojave. Në fakt, shikimi i vetëm njëres prej atyre shenjave, lë në zemër një gjurmë të atillë që nuk e lë dot as leximi i disa librave të historisë.

(Në komentin e ajetit 137 të sures “Ali Imran” kemi vënë një studim të detajuar në lidhje me këtë çështje).

Duhet theksuar se në këtë ajet ka ardhur fjala: “*el muxhrimijne*” – “*mizorët*” në vend të fjalës “*el mukedh’dhibijne*” – “*përgënjeshtresit*”. Kjo shprehje tregon se përgënjeshtrimi i tyre nuk ishte për shkak se ata gabuan në vërtetimin e çështjes. Jo, origjina e atij përgënjeshtrimi ishte inati, kokëfortësia dhe ndotja e tyre me llojet e shumta të mizorive.

Meqenëse i Dërguari (*Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kishte mëshirë për ta edhe pse ishin mohues, ai sërish dëshpërohej shumë për ta ngaqë kishin aq shumë inat brenda vetes. Atij i digjej zemra për ta dhe punonte për t’i udhëzuar në rrugën e së vërtetës, ndonëse përballej vazhdimisht me komplotet që ata kurdisnin kundër tij. Për këtë, në ajetin vijues, All’llahu e gëzon dhe e qetëson zemrën e Profetit (*Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), duke i thënë: **“Ti (o Muhammed) mos u dëshpëro për ata”**; as mos u shqetëso për komplotet që ata kurdisin. Më pas, në ajet thuhet: **“dhe mos e shiko veten ngushtë nga dredhitë që ata kurdisin”**.

Mohuesit, në vend që ta merrnin me seriozitet paralajmërimin që u bënë atyre Profeti, i cili shfaqte aq shumë mëshirë ndaj tyre, në vend që t’i merrnin parasysh këshillat e tij dhe me to të orientoreshin në rrugën e së vërtetës, ata filluan të tallen me të. Për këtë sjellje të mohuesve, ajeti njofton: **“Ata (jobesimtarët) thonë: nëse jeni të vërtetë (në fjalët që na thoni) kur do të vijë ai premtimi?”**.

Ndonëse bashkëbiseduesi është Profeti (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), çështja është përmendur në numrin shumë, kur mohuesit thonë: **“nëse jeni të vërtetë** (në fjalët që na thoni)”. Kjo tregon se edhe besimtarët e kishin bashkuar zërin e tyre me zërin e Profetit (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), prandaj kjo kërkesë e mohuesve u drejtohej njëkohësisht besimtarëve dhe Profetit të tyre.

Këtu Kur'ani Famëllartë i përgjigjet talljes së tyre me një gjuhë konkrete dhe i drejtohet Profetit (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), duke e urdhëruar: **“Thuaj: tanimë u është afruar shumë një pjesë e atij premtimi që ju e kërkonit të vijë sa më shpejt.”**

Përse kërkonit që dënimi i All'llahut të vijë sa më shpejt?! Përse e merrni për gjë të vogël atë dënim? A nuk keni mëshirë për veten tuaj?! A mos është dënimi i All'llahut humor apo shaka?! Shumë shpejt, ai dënim do të bjerë mbi ju për shkak të fjalëve që thoni dhe do t'ju asgjësojë të gjithëve. Përse gjithë ky inat, përse kaq shumë kokëfortësi e ashpërsi?!

Fjala e ajetit *“redife”* do të thotë: ardhja e një sendi pas një sendi tjetër. Prandaj kjo fjalë përdoret për të treguar edhe personin që ka hipur mbi kalë pas shokut të tij; në këtë rast, atij që është prapa i thuhet *“redijf”*. Gjithashtu, fjala *“redijf”* përdoret për individë dhe për sende të vëna në rresht njëra pas tjetrës.

Edhe në lidhje me qëllimin e fjalës së ajetit **“kërkojnë që t'u vijë sa më shpejt”** janë dhënë disa mundësi. Thuhet se qëllimi me dënimin që ata kërkonin është disfata e tyre e madhe në luftën e

Bedrit. Në këtë luftë u vranë shtatëdhjetë burra prej parisë së mohuesve dhe shtatëdhjetë të tjerë u zunë robër lufte.

Ka mundësi që qëllimi me këtë fjalë të jetë për dënimin e përgjithshëm, dënim që është shtyrë për në fundin e kësaj bote. Kjo shtyrje është bërë me begatinë e me praninë e të Dërguarit të All'llahut (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i cili është mëshirë për të gjithë, ashtu siç e dëshmon edhe ajeti 33 i sures "El Enfâl": **"All'llahu nuk i dënon ata derisa ti (o Muhammed) je në mesin e tyre."**

Shprehja e ajetit "*asà*" – "*tanimë*" mund të jetë fjalë që duhet ta thotë Profeti (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Edhe nëse është thënie e All'llahut të Lartësuar, ndryshe nga ajo që mund ta imagjinojë dikush, nuk përbën ndonjë problem, pasi kjo fjalë është një shenjë që tregon premisat e diçkaje dhe rrjedhojat e saj, krahas mundësisë që premisat të jenë së bashku me ndaluesin, por nuk arrin në rezultatin përfundimtar.

Në ajetin vijues, Kur'ani Famëlartë flet për një çështje shumë të qartë: nëse All'llahu nuk shpejton ta lëshojë dënimin mbi ju, kjo vjen për shkak të butësisë dhe të mëshirës së Tij. All'llahu u jep robve të Tij kohë të mjaftueshme që ata të përmirësojnë veten. Për këtë, Kur'ani njofton: **"S'ka dyshim që Zoti yt është shumë bamirës ndaj njerëzve, por shumica e tyre nuk e falënderojnë."**

Nëse imagjinojnë se vonesa e ndëshkimit vjen si pasojë e padijes së All'llahut të Lartësuar rreth asaj që u sillet nëpër mend prej qëllimeve të këqija dhe mendimeve devijuese, atëherë ata janë

krejtësisht gabim: **“Sigurisht që Zoti yt di çka fshehin zemrat e tyre dhe atë çka ata e shfaqin hapur.”**¹

All'Ilahu ka dijeni për të fshehtat e tyre. Ai ka dijeni edhe për punët që ata i bëjnë sheshit. Në diturinë e All'Ilahut, e fshehta dhe e dukshmja janë të barabarta.

Këto kuptime janë rezultat i diturisë tonë të kufizuar. Përballë diturisë së pakufizuar, të gjitha kuptimet e diturisë tonë humbasin.

Në lidhje me këtë çështje, thuhet se dituria e All'Ilahut për ato që janë në brendësi të zemrave, është para diturisë së Tij për punët e jashtme. Kjo është thënë për shkak të rëndësisë së madhe që ka qëllimi dhe vullneti. Gjithashtu, kjo përparësi mund të jetë edhe për shkak se punët e jashtme e kanë burimin te qëllimi dhe dituria për shkakun vjen para diturisë për pasojën.

Më pas, Kur'ani shpjegon: sigurisht që dituria e All'Ilahut nuk mund të kufizohet në ato që janë në brendësi të zemrës dhe as në ato që bëhen sheshit. Jo! Dituria e All'Ilahut është absolutisht e gjerë dhe e pakufizuar. Për këtë, ajeti njofton: **“Nuk ka asgjë të fshehur në qiell e në Tokë që ajo të mos jetë e shënuar në librin e saktë.”**²

¹ Fjala e ajetit *“tukin’nu”* është marrë prej foljes *“ken’ne”*. Kjo folje tregon mbështjelljen që mbulon dhe ruan sendet. Gjithashtu, ajo përdoret për të treguar edhe ato mendime e qëllime të rrezikshme armiqësore që bluajnë mohuesit në zemrat e veta.

² Në gjuhën arabe, fjala e ajetit *“gàibetin”* është emër veprues që tregon cilësinë. Disa mendojnë se germa *“t”* në fundin e fjalës, nuk tregon se emri është i gjinisë femërore, sepse kjo fjalë nuk ka gjini femërore. Veç kësaj, kjo fjalë tregon sendet e fshehura, madje shumë të fshehura. Megjithatë, mund të themi se germa *“t”* e kësaj fjale tregon se ajo është e gjinisë femërore dhe se i cilësuar i saj është

Fjala “*gàibetin*” ka një kuptim të gjerë dhe përfshin çdo gjë që për shqisat tona është e panjohur. Gjithashtu, ajo përfshin punët që bëjnë njerëzit në fshehtësi, si dhe qëllimet që kanë ata në zemrat e tyre. Kjo fjalë përfshin edhe sekretet e qiejve e të tokës, e sigurisht edhe Ditën e Kiametit, ditën kur njerëzit do të japin llogari; ajo përfshin edhe kohën e zbritjes së dënimit dhe të fshehta të tjera të ngjashme. Siç janë shprehur disa interpretues të Kur’anit, nuk ka ndonjë argument që fjala “*gàibetin*” të interpretohet vetëm me njerën prej punëve të lartpërmendura.

Qëllimi me fjalën e ajetit “*kitàbin mubijnin*” është “*Leuhi Mahfùdhi*”. Gjithashtu, kjo fjalë tregon se dituria e All’llahut s’ka fund. Në lidhje me këtë çështje kemi vënë një studim në komentin e ajetit 59 të sures “*El En’am*”.

Hulumtime

Studimi i hollësishëm i ajeteve të mësipërme tregon se mohuesit e Ringjalljes, me qëllim që të largohen nga përgjegjësia e besimit në Kiamet dhe nga përgjegjësitë e tjera që dalin prej këtij besimi, arsyetonin sipas tri mënyrave:

1- E shihnin si diçka larg logjikës rikthimin e jetës pasi njeriu të jetë bërë baltë e pluhur, sepse ata besonin se është e pamundur që toka të jetë bazë për jetën.

hequr. Për rrjedhojë, vlerësimi do të ishte: s’ka asnjë cilësi të fshehur, ose sende të fshehura, për të cilat All’llahu të mos ketë dituri të gjithanshme. Referohu në librin “*Tràbul Kur’ani*”, vëll.7, f. 250.

2- Në vjetërsinë e këtij besimi dhe në mungesën e rrisë në të.

3- Moszbritja e dënimit mbi ata që mohonin ringjalljen pas vdekjes. Nëse do të ishte e vërtetë se mohuesit e ringjalljes do të dënoheshin, atëherë përse nuk bie dënimi mbi ta?!

Kur'ani ka dhënë përgjigje për dyshimet që ata hedhin, sepse në të vërtetë ne e shohim me sytë tanë se toka është burimi dhe baza e jetës; në fillim ne ishim tokë dhe pastaj u bëmë të gjallë.

Fakti që një send është i vjetër, nuk ia ul rëndësinë e tij, sepse ligjet e kësaj bote janë origjinale dhe të qëndrueshme përgjithmonë. Edhe në bazat e filozofisë, në matematikë dhe në shkencat e tjera ka shumë baza të pandryshueshme. Mos vallë lashtësia e teorisë për pamundësinë e bashkimit të dy të kundërtave, ose teorema e Pitagorës, janë argumente që vërtetojnë se kjo teori, ose ajo teoremë, është e gabuar? Nëse ne e kemi konsideruar drejtësinë si të mirë dhe padrejtësinë si të keqe qysh në kohët e hershme dhe vazhdojmë t'i konsiderojmë kështu edhe sot, mos vallë edhe kjo është argument për të vërtetuar kotësinë e konsideratës sonë? Janë të shumta rastet që tregojnë se vjetërsia është një argument që vërteton origjinalitetin.

Përsa i përket paradoksit të tretë të atyre që mohojnë Ringjalljen, Kur'ani përgjigjet dhe u thotë qartë: mos e kërkon shpejtimin e zbritjes së dënimit, sepse vonimi i tij është vetëm prej mëshirës e dashamirësisë së All'llahut. Ai u jep kohë dhe nuk nxiton të lëshojë dënimin mbi ju. Por kur vjen dënimi i All'llahut, atëherë atij nuk mund t'i largohet askush.

Ajetet: 76 - 81

إِنَّ هَذَا الْقُرْآنَ يَقُصُّ عَلَى بَنِي إِسْرَءِيلَ أَكْثَرَ الَّذِي هُمْ فِيهِ يَخْتَلِفُونَ ﴿٧٦﴾
وَأَنَّهُ لَهْدَى وَرَحْمَةً لِّلْمُؤْمِنِينَ ﴿٧٧﴾ إِنَّ رَبَّكَ يَقْضِي بَيْنَهُم بِحُكْمِهِ ۖ وَهُوَ الْعَزِيزُ
الْعَلِيمُ ﴿٧٨﴾ فَتَوَكَّلْ عَلَى اللَّهِ إِنَّكَ عَلَى الْحَقِّ الْمُبِينِ ﴿٧٩﴾ إِنَّكَ لَا تَسْمِعُ الْمَوْتَى وَلَا
تُسْمِعُ الصُّمَّ الدُّعَاءَ إِذَا وَلَّوْا مُدْبِرِينَ ﴿٨٠﴾ وَمَا أَنْتَ بِهَادِي الْعُمَىٰ عَنِ ضَلَالَتِهِمْ
إِنْ تَسْمِعُ إِلَّا مَنْ يُؤْمِنُ بِآيَاتِنَا فَهُمْ مُسْلِمُونَ

“Me të vërtetë, ky Kur'an u sqaron Beni Israilëve shumë prej çështjeve rreth të cilave ata kanë kundërshtime.”

“Me të vërtetë, ai (Kur'ani) është udhëzues dhe mëshirë për besimtarët.”

“Pa dyshim, Zoti yt do të gjykojë në mes tyre me drejtësinë e Tij, Ai është i Gjithëfuqishmi, i Gjithëdituri.”

“Prandaj, ti mbështetu në All'llahun dhe ti je me të vërtetën e qartë.”

“Ti nuk mund t'i bësh të vdekurit të dëgjojnë, as shurdhin të dëgjojë thirrjen, kur ata të kthejnë shpinën.”

“Ti nuk i largon dot të verbërit nga rruga e tyre e humbjes; ti mund të bësh të dëgjojë vetëm atë që beson në argumentet Tona dhe janë myslimanë.”

Komentimi

Ata që kanë zemra të verbuara nuk e pranojnë thirrjen tënde

Në ajetet e mësipërme flitej për fillimin e krijimit dhe për Ringjalljen, kurse në ajetet që janë objekt studimi fjala kalon në çështjet e Profetësisë dhe të vërtetësisë së Kur'anit. Ky studim do të plotësohet pikërisht me këto dy elemente. Gjithashtu, në ajetet e mësipërme flitej për diturinë e pafundme të All'llahut të lartësuar, kurse në ajetet që janë objekt studimi ka edhe një shtesë të detajuar në lidhje me këtë çështje; në ajetet e mësipërme, fjala u drejtohej politeistëve, kurse në ajetet që janë objekt studimi fjala u drejtohet mohuesve të tjerë, si jehudive, dhe kundërshtimeve të tyre.

Në ajetin e parë të këtij grupi ajetesh thuhet: **“Me të vërtetë, ky Kur'an i sqaron Beni Israilëve shumë prej çështjeve rreth të cilave ata kanë kundërshtime.”**

Beni Israilët kanë kundërshtime të mëdha në mesin e tyre në lidhje me shumë çështje. Ata kanë kundërshtime për çështjen e

Merjemes dhe të Isait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!*), ose për çështjen e Profetit, për të cilin jep sihariq Teurati se do të vinte.

Veç kësaj, ata patën kundërshtime në mesin e tyre për shumë çështje fetare dhe për shumë dispozita të ligjit të fesë. Prandaj Kur'ani i shpjegon qartë çështje të tilla. Për shembull, në lidhje me Isain (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), Kur'ani thotë se ai e bëri të njohur veten e tij shumë qartë, kur tha: **“Ai (Isài) tha: unë jam rob i All'llahut, Ai më ka dhënë mua librin dhe më ka bërë Profet.”**¹

Gjithashtu, Kur'ani njofton se Mesihu u lind pa baba dhe se lindja e tij në atë formë nuk është e pamundur: **“Vërtet, çështja e Isait (i lindur pa baba) është si çështja e Ademit, të cilin Ai e krijoi nga dheu.”**²

Cilësitë e Profetit, për ardhjen e të cilit njofton Teurati, përputhen plotësisht me Profetin e Islamit, Muhammedin (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Gjithsesi, njëra prej çështjeve më të rëndësishme që trajton Kur'ani, është ballafaqimi me kundërshtimet e lindura prej përzierjes së miteve me të vërtetat e mësimëve të Profetëve. Çdo Profet është përgjegjës për ndarjen e së vërtetës nga e gabuara. Fakti që një barrë e tillë iu ngarkua një njeriu analfabet, i cili në jetën e tij as kishte lexuar, e as kishte shkruar, tregon qartë se ai nuk mund të ishte tjetër veçse i dërguar prej All'llahut.

Përballja me kundërshtimet e bën të detyrueshëm udhëzimin dhe mëshirën. Ajeti vijues e thekson këtë, duke thënë:

¹ Sure “Merjem”, ajeti 30.

² Sure “Ali Imran”, ajeti 59.

“Me të vërtetë, ai (Kur’ani) është udhëzues dhe mëshirë për besimtarët.”.

Pa dyshim, Kur’ani është udhëzues e mëshirë, sepse argumenti për vërtetësinë e tij gjendet në përmbajtjen e tij.

Ai është udhëzues e mëshirë, sepse udhëzon në rrugën e vërtetë dhe e argumenton atë.

Në këtë ajet, përmendja në mënyrë të veçantë e fjalës *“lil mu'miniyne”* - *“për besimtarët”* shpjegon më qartë atë që kemi thënë më lart, se njeriu duhet të jetë i gatshëm për të pranuar të vërtetën dhe për t’iu dorëzuar All’llahut; përndryshe, ai nuk përfiton dot prej këtij burimi të shenjtë.

Një grup prej Beni Israilëve iu kundërvunë Kur’anit dhe të vërtetave të tij. Në lidhje me ta, ajeti vijues thotë: **“Pa dyshim, Zoti yt do të gjykojë në mes tyre me drejtësinë e Tij. Ai është i Gjithëfuqishmi, i Gjithëdituri.”.**

Ndonëse në ajet nuk thuhet se gjykimi i All’llahut për ta do të bëhet në Ditën e Kiametit, duke e krahasuar me dy ajetet e mësipërme, që flasin për kundërshtimet në mesin e Beni Israilëve, rezulton se All’llahu do t’i gjykojë ata në atë Ditë.

Në ajetin 17 të sures “El Xhathije”, i Gjithëfuqishmi njofton: **“...patjetër Zoti yt do të gjykojë në mes atyre Ditën e Kiametit për çështje rreth të cilave ata kanë kundërshtime”.**

I njëjti tekst është përmendur edhe në ajetin 93 të sures “Junus”.

Përshkrimi i All’llahut me dy emrat e Tij të bukur: “i Gjithëfuqishmi” dhe “i Gjithëdituri”, tregon se gjykatësi duhet t’i

ketë patjetër këto dy cilësi; pra, ai duhet të ketë dituri të mjaftueshme dhe fuqi për të bërë gjykimin. Mbi këtë bazë, All'llahu i Lartësuar është më i dituri dhe më i fuqishmi i të gjithë gjykatësve.

Këto fjalë mbi Kur'anin, jo vetëm që shpjegojnë plotësisht madhësinë e tij, por janë edhe një kërcënim për Beni Israilët. Gjithashtu, ato e gëzojnë dhe e qetësojnë zemrën e Profetit (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), prandaj në frazën e parë të ajetit vijues thuhet: **“Prandaj ti mbështetu në All'llahun”**.

Mbështetu në All'llahun, të Gjithëfuqishmin; mbështetu tek Ai që nuk mposhtet, në të Gjithëditurin, në Atë që ka dijeni për çdo gjë; mbështetu tek Ai që me madhësinë e Tij zbriti Kur'anin dhe bëri që ky libër të jetë pranë teje; mbështetu në All'llahun dhe mos u shqetëso as prej adhuruesve të idhujve e as prej kundërshtarëve kokëfortë, sepse All'llahu kujdeset për ty dhe **“ti je me të vërtetën e qartë”**.

Lind pyetja: Meqë Kur'ani është e vërtetë e qartë, atëherë përse e kundërshtuan ata? Ajeti vijues i përgjigjet kësaj pyetjeje duke thënë: Derisa ata nuk i nënshtrohen të vërtetës së qartë, nuk është çudi që kjo fjalë e fuqishme të mos lërë asnjë gjurmë në zemrën e tyre, sepse: **“Ti nuk mund t'i bësh të vdekurit të dëgjojnë.”**¹

¹ Një grup interpretuesish të Kur'anit kanë thënë se kjo fjali si dhe të tjerat në vijim, janë argumente që vërtetojnë domosdoshmërinë e mbështetjes në All'llahun dhe në Profetin, megjithëse kjo është përgjigje për pyetjen e mësipërme rreth pozitës së Kur'anit si “e vërteta e qartë”.

Por ti i bën të dëgjojnë të gjallët, ata që e kërkojnë All'llahun, ata që u ndizen shpirtrat flakë për Të. Kurse për ringjalljen e të vdekurve, ose të të gjallëve të vdekur për shkak të fanatizmit, të kokëfortësisë dhe mëkateve të tyre, mos e mundo veten dhe mos mendo për punën e tyre, sepse edhe sikur të ishin të gjallë, në të vërtetë ata janë të shurdhër; ata as nuk kanë mundësi ta dëgjojnë zërin tënd, sidomos kur të kthejnë shpinën dhe largohen prej teje: **“Ti nuk mund t’i bësh të vdekurit të dëgjojnë, as shurdhin të dëgjojë thirrjen, kur ata të kthejnë shpinën.”**.

Sikur ata të ishin pranë teje dhe do t’u flisje me zë të lartë, sigurisht që ai zë do të kishte arritur në veshët e tyre, por megjithë shurdhërinë e tyre, ata largohen prej teje.

Sikur jobesimtarët të shihnin me sytë e tyre, patjetër që do të ishin udhëzuar në rrugën e drejtë, qoftë edhe vetëm me disa shenja, por ata mbetën të verbër: **“Ti nuk i largon dot të verbërit nga rruga e tyre e humbjes.”**.

Atyre u janë zënë të gjitha rrugët që mundësojnë të kuptuarit e së vërtetës. Zemrat e tyre janë të vdekura, veshët e tyre janë shurdhuar dhe sytë e tyre të verbuar.

Prandaj, o i Dërguar i All'llahut: **“...ti mund të bësh të dëgjojë vetëm atë që beson në argumentet Tona dhe ata janë myslimanë”**.

Në të vërtetë, dy ajetet e lartpërmendura bëjnë fjalë për disa elementë të njohjes dhe lidhjes së njeriut me botën e jashtme. Ata janë:

Shqisa e dallimit dhe mendja vigjilente kundrejt zemrës së vdekur.

Syri vëzhgues për të parë fytyrën e së vërtetës dhe të gabuarës nëpërmjet shikimit të vëmendshëm.

Por armiqësia e ashpërsia, tradita e verbër dhe mëkati - të gjitha këto i verbojnë sytë me të cilët njeriu e shikon të vërtetën; ai e ka dëgjimin të mirë, por zemrën të vdekur.

Sikur te të tillë kundërshtarë mëkatarë të vinin për t'i udhëzuar të gjithë Profetët, të gjithë njerëzit e afërm tek All'llahu dhe të gjithë engjëjt, nuk do të kishin ndikuar aspak tek ata, sepse lidhja e tyre me botën e jashtme është ndërprerë. Ata janë fundosur në "kënetën e vetvetes".

Shprehje të ngjashme si kjo kanë ardhur në suret: "El Bekare", "Err Rrùm" dhe në sure të tjera të Kur'anit. (Në lidhje me mirësitë e njohjes, kemi vënë një studim në komentin e ajetit 78 të sures "En Nahl".

E rikujtojmë përsëri këtë shprehje të bukur e kuptimplotë, se qëllimi me besimin dhe me dorëzimin nuk do të thotë se ata i kishin pranuar të vërtetat e fesë më përpara. Jo, qëllimi këtu është se kur te njeriu mungon dashuria për ta njohur të vërtetën dhe gatishmëria për t'iu nënshtruar urdhrit të All'llahut, ai nuk e dëgjon kurrë fjalën e Profetit.

Dy hulumtime

1- Shkaqet e mbështetjes tek All'llahu

Fjala “*tevek'kul*” është marrë prej fjalës “*vekàletun*”, që në gjuhën e Kur'anit do të thotë: të mbështetesh tek All'llahu, ta bësh Atë ndihmësin dhe të autorizuarin tënd, të mos shqetësohesh e të mos kesh frikë prej problemeve të shumta e prej pengesave sado të mëdha qofshin ato.

Ky është vetëm njëri prej argumenteve të rëndësishme të besimit dhe një shkak për ardhjen e ndihmës dhe të mbarësisë. Është shumë domethënës fakti se ajetet e mësipërme e bazojnë mbështetjen tek All'llahu në dy gjëra:

E para: fuqia dhe dituria e Atij mbi të cilin mbështetet njeriu.

E dyta: qartësia e rrugës që ka zgjedhur njeriu.

Në të vërtetë, Kur'ani thotë se nuk ka shkak për pafuqi, për frikë dhe barbari. Nga njëra anë, ti je mbështetur në All'llahun, të Gjithëfuqishmin që nuk mund të mposhtet, në të Gjithëditurin, në Atë që ka informacion për të gjitha gjërat; nga ana tjetër, ti je në rrugën e qartë dhe në të vërtetën e padiskutueshme. Ti je mbrojtës i së vërtetës së qartë. Atëherë, nga se duhet të frikësohesh?!

Kur e sheh se një grup njerëzish të kundërshtojnë, mos u dëshpëro! Është e qartë se ata nuk kanë as sy që shikojnë dhe as veshë që dëgjojnë; zemrat e tyre nuk janë të gjalla. Në të vërtetë, ata janë jashtë rrugës së udhëzimit në rrugën e vërtetë, në atë

rrugë ku merret mesazhi hyjnor. Rreth teje mbliidhen vetëm ata që kërkojnë të vërtetën, ata që janë dashuruar me All'llahun, mbliidhen të eturit për drejtësi, ata që shkojnë në drejtim të burimeve të freskëta të Kur'anit, për të shuar etjen e tyre me mirësinë dhe ëmbëlsinë e tij.

2- Vdekja dhe jeta në logjikën e Kur'anit

Është folur shumë në lidhje me kuptimin e fjalëve “jetë” dhe “vdekje”. Natyrisht që këto kuptime janë të ndryshme sipas pikëpamjeve të ndryshme. Nga pikëpamja materialiste, “jetë” do të thotë: jeta natyrore fizike dhe vetëm kaq; pra, derisa zemra pulson dhe gjaku lëviz nëpër të gjitha gjymtyrët e trupit, derisa vazhdon procesi i tërheqjes dhe i shtytjes, trupi është i gjallë; kurse ndalimi i kësaj lëvizjeje tregon vdekjen përfundimtare, e cila njihet brenda disa çasteve me anë të një prove të bërë me kujdes.

Kurse pikëpamja kur'anore për jetën është ndryshe nga pikëpamja materialiste. Shumë njerëz e llogarisin jetën sipas pikëpamjes materialiste, mirëpo sipas pikëpamjes kur'anore ata janë të vdekur; janë si ata për të cilët tregojnë ajetet e mësipërme të Kur'anit. Madje ndodh edhe e kundërta. Prej të vdekurve mund të ketë edhe dëshmorë, të cilët fizikisht janë të vdekur, por sipas logjikës kur'anore, ata janë përjetësisht të gjallë.

Shkaku për këtë ndryshim midis dy pikëpamjeve është se Islami, jo vetëm që e mbështet kriterin e jetës njerëzore dhe personalitetin e njeriut në vlerat shpirtërore, por edhe arritjen e dobisë të tjerët, e shikon si një kriter për jetën ose vdekjen.

Njeriu, për të cilin mendohet se është i gjallë vetëm duke u nisur nga ana e jashtme, ndonëse ai është fundosur në llumin e dëshirave të ulëta, nuk e dëgjon britmën e dhimbjes së atij që i bëhet padrejtësi; ai nuk dëgjon as zërin e atij që thërret në të vërtetën. Njeriu që nuk vështron shenjat e All'llahut në krijimin e tij dhe që nuk mendon qoftë dhe vetëm për një çast, as në të ardhmen e as në të kaluarën e tij, në logjikën e Islamit konsiderohet si njeri i vdekur. Kategoria e njerëzve që kanë bërë punë të mëdha, dobia e të cilave vazhdon edhe pas vdekjes së tyre, janë shembulli më i mirë që duhet të ndiqet prej të tjerëve; njerëz të tillë janë të gjallë përjetësisht.¹

Islami beson në jetën pas vdekjes, kohë e cila shtrihet deri në ringjalljen e njerëzve. Ka edhe nga ata që e mohojnë këtë lloj jete e diturie pas vdekjes. Madje ata arrijnë deri aty, sa e ndalojnë ndërmjetësimin me Profetin, sepse sipas pretendimit të tyre, ai është i vdekur dhe i vdekuri s'ka ndikim. Është e çuditshme se për ta mbështetur këtë pretendim, ata bazohen pikërisht në ajetet që janë objekt studimi.

Disa të tjerë thonë se për Profetin ka një lloj jete pas vdekjes, që është më e nderuar se ajo e dëshmorëve, për të cilën flet qartazi Kur'ani. Sipas tyre, Profeti e dëgjon selamin e atij që e përshëndet atë.²

Transmetimet islame të ardhura me rrugët e synitëve dhe shiitëve në lidhje me këtë çështje janë të qarta e të shumta. Ato tregojnë se Profeti dhe të ruajturit nga mëkatet i dëgjojnë

¹ Në lidhje me vdekjen dhe jetën shpirtërore, kemi vënë një studim të detajuar në komentin e ajetit 24 të sures "El Enfâl".

² Kumtesa e dytë, "El Hedij'jetu Sunnijetu", Muhammed bin Abdul Vehhàb, f. 41.

përshëndetjet që u dërgohen, qoftë nga afër qoftë nga larg, dhe i kthejnë ato. Gjithashtu, Profeti ka dijeni edhe për punët që bën ymeti i tij.¹

Në një hadith të ardhur në “Sahihun” e Buhariut mbi ngjarjen e Luftës së Bedrit, lexojmë se Profeti (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) qëndroi mbi pusin, ku ishin hedhur trupat e idhujtarëve të vrarë në luftën e Bedrit dhe i thërriste ata me emër, duke u thënë: “A iu bindët apo jo All'llahut dhe të Dërguarit të Tij? Ne e gjetëm të vërtetën që na e kishte premtuar All'llahu. Po ju, a e gjetët të vërtetën që u kishte premtuar Zoti juaj?” Umeri i tha: “O i Dërguar i All'llahut! A po u flet trupave pa jetë?” Profeti (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) tha: “Pasha Atë, në dorën e të Cilit është shpirti i Muhammedit! Ju nuk i dëgjoni fjalët e mia më mirë sesa ata.”²

Edhe në tregimin në lidhje me Betejën e Xhemelit lexojmë një transmetim të përcjellë prej Asbag bin Nebàtete, i cili tregon se pas disfatës së ushtrisë së Xhemelit, Aliu hipi mbi mushkën ngjyrë hiri të të Dërguarit të All'llahut. Ai eci nëpër fushën e betejës duke parë të vrarët dhe kur kaloi pranë trupit të pajetë të Ka'b bin Sùrit, i cili ishte gjykatësi i Basrës, ndaloi dhe tha: “Ngrejeni ndenjurr”. Pastaj i foli të vrarit: “I mjeri ti, o Ka'b bin Sùr! Kishe dituri, e cila duhej të të sillte dobi, por djalli të shmangu nga rruga e vërtetë dhe bëri që shumë shpejt të shkosh për në zjarr.”³

¹ Për më shumë shpjegime, referohu në librin “Keshful Irtijàb”, f. 109, të autorit Sejjid Muhsin El Emijn El Āmilij.

² “Sahihu” i Buhariut, vëll. 5, f. 97, kapitulli: Vrasja e Ebù Xhehlit.

³ Sherh “Nehxhul Belaga”, Ibni Ebul Hadijd, vëll. 1, f. 248.

Gjithashtu, në veprën “Nehxhul Belàga” lexojmë se gjatë kthimit prej Betejës së Sifijnit, Aliu arriti pranë një varreze që ishte prapa murit të Kufes dhe nisi t’u fliste të vdekurve rreth përmbysjes së botës. Më pas, u tha: *“Këto janë lajmet nga ne. Po nga ju, ç’lajme kemi?”*. Pastaj shtoi: *“Sikur atyre t’u lejohej të përgjigjeshin, pa dyshim që do t’u njoftonin se furnizimi më i mirë për udhëtim është frika ndaj All’llahut.”*⁽¹⁾.¹

Të gjitha këto janë argumente që vërtetojnë se të vdekurit i dëgjojnë fjalët që u thuhet, por atyre nuk u lejohet të përgjigjen. Këto argumente tregojnë për jetën e njeriut pas vdekjes, për atë jetë që në terminologjinë islame njihet me termin *el hajätul-berzekijeh*.

¹ “Nehxhul Belaga”, thëniet e shkurtëra.

Ajetet: 82 - 85

وَإِذَا وَقَعَ الْقَوْلُ عَلَيْهِمْ أَخْرَجْنَا لَهُمْ دَابَّةً مِّنَ الْأَرْضِ تُكَلِّمُهُمْ أَنَّ
الْإِنْسَانَ لِرَبِّهِ لَكَاذِبٌ ۚ يَوْمَ تَأْتِي سَأَلَ يَوْمَ تَحْشُرُ مِنْ كُلِّ أُمَّةٍ فَوْجًا مِّمَّنْ
يَكْذِبُ بِعِثْنَاهُ فَهُمْ يَوْمَ يُصْعَقُونَ ۚ إِذَا جُلُوعًا لَّكَذِبْتُمْ بِعِثْنَاهُ يَوْمَ
تُحِيطُوا بِهَا عِلْمًا أَمَّا ذَا كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ ﴿٨٤﴾ وَوَقَعَ الْقَوْلُ عَلَيْهِمْ بِمَا ظَلَمُوا
فَهُمْ لَا يَنْطِقُونَ ﴿٨٥﴾

“Dhe kur dënimi mbi ata do të bëhet realitet, për ata Ne do të nxjerrim një kafshë prej tokës, e cila do t’u flasë atyre, sepse njerëzit nuk besonin në argumentet Tona.”

“Dhe Ditën kur Ne prej çdo populli do të mbledhim grupe prej atyre që përgënjeshtrojnë argumentet Tona, ata do të jenë të ndaluar, derisa të vijnë (në vendin e llogaridhënies). Ai u thotë: ju i përgënjeshtruat argumentet e Mia pa pasur asnjë dijeni për ato se çfarë po bëni.”

“Dënimi ra mbi ata për shkak të padrejtësive që bënin dhe ata nuk do të flasin.”

Komentimi

Ajetet e mësipërme flisnin për këmbënguljen e politeistëve që mbi ta të vinte dënimi sa më shpejt. Ata e prisnin me padurim ndodhjen e Kiametit dhe, për këtë të fundit, për t'u tallur e pyesnin Profetin (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): **"...nëse jeni të vërtetë** (në fjalët që na thoni), **kur do të vijë ai premtimi?"** dhe kur do të ndodhë Dita e Kiametit? Ajetet që janë objekt studimi tregojnë për disa ngjarje që do të ndodhin para Ditës së Kiametit dhe konkretizojnë dënimin e pashmangshëm e të rëndë të politeistëve. Për këtë, ajeti i parë njofton: **"Dhe kur dënimi mbi ata do të bëhet realitet, për ata Ne do të nxjerrim një kafshë prej tokës, e cila do t'u flasë atyre, sepse njerëzit nuk besonin në argumentet Tona."**

Qëllimi me fjalën e të Lartit: **"kur dënimi mbi ata do të bëhet realitet"**, është dalja e urdhrit të All'llahut për lëshimin e dënimit mbi ta, ose për ndodhjen e Ditës së Kiametit, ose për ardhjen e shenjave të asaj Dite. Ndaj atyre shenjave do të përulet e do të nënshtrohet kushdo që do t'i shohë dhe do të dorëzohet menjëherë para urdhrit e fuqisë së All'llahut. Atëherë, tek ai njeri do të arrihet dituria e plotë se Kiameti me të vërtetë është afruar. Në atë kohë do të mbyllen portat e pendimit (*teubes*), sepse besimi (*imani*) në këto kushte do të jetë besim nga halli.

Këto dy kuptime janë të pandara, sepse afrimi i Ditës së Kiametit është i bashkëngjitur me zbritjen e ndëshkimit dhe dënimin e mohuesve.

Por ç'është "kafsha e tokës" (*dàb'betul erdi*)? Cila është detyra e saj?

Në formë të përmbledhur, ajeti thotë: All'llahu do të nxjerrë një qenie që lëviz, ose "kafshën e tokës" para ndodhjes së Kiametit. Kjo kafshë do të flasë me njerëzit dhe do t'u thotë: **"Njerëzit nuk besuan në argumentet e All'llahut."**

Me fjalë të tjera, detyra e kësaj kafshe është ndarja e radhëve dhe dallimi i hipokritëve (*munafikëve*) e mohuesve prej besimtarëve.

Është kuptimplotë fakti se mohuesit, kur të shohin këto argumente, do ta qortojnë vetveten dhe do të pendohen për punët që kanë lënë pa i bërë; ata do të pendohen edhe për ditët e tyre të errëta. Por, sa dobi do t'u sjellë atyre pendimi, kur portat e tij janë mbyllur tashmë?

Në transmetimet islame të ardhura në librat e dy grupeve islame, synitëve dhe shiitëve, flitet gjerësisht për karakteristikat e kafshës së tokës. Disa prej këtyre cilësive do t'i përmendim në pjesën e studimeve rreth ajeteve që janë objekt studimi.

Më pas, ajetet vënë në dukje një shenjë tjetër prej shenjave të Kiametit: **"Dhe Ditën kur Ne prej çdo populli do të mbledhim grupe prej atyre që përgënjeshtrojnë argumentet Tona, ata do të jenë të ndaluar."**

Fjala e ajetit "*hashr*" do të thotë: nxjerrja e një grupi prej vendit ku është dhe ecja me të drejt fushës së betejës, ose drejt ndonjë vendi tjetër.

Edhe fjala tjetër e ajetit: “*feuxh*”, ashtu siç e shpjegon Ràgib El Isfehàni në fjalorin e tij të fjalëve të Kur'anit, “Mufredàt El Fàdhul Kur'àni”, ka kuptimin e një grupi që lëviz me shpejtësi.

Kurse folja “*jùzeùne*” do të thotë: ndalimi i një grupi derisa të bashkohet me grupin tjetër që është i pari. Zakonisht, kjo shprehje përdoret për grupe të shumta. Një shembull të ngjashëm e kemi parë edhe në lidhje me ushtrinë e Sulejmanit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*).

Duke u bazuar mbi këto shpjegime, ajeti në tërësi thekson se All'llahu do të mbledhë grupe prej çdo populli. Këto grupe do të nisen për të shkuar në vendin e llogaridhënies dhe për marrjen e dënimit për shkak të punëve që kanë bërë.

Shumë prej interpretuesve të mëdhenj mendojnë se ky ajet tregon çështjen e rikthimit në këtë botë para Ditës së Kiametit të një grupi njerëzish që kanë bërë punë të mira dhe të një grupi tjetër, që kanë bërë punë të këqija. Këtë mendim ata e bazojnë në fjalën e All'llahut, të Lartit: “**prej çdo populli do të mbledhim grupe**”; këtu përdoret fjala “**grup**” në kuptimin e disa njerëzve, pasi në Ditën e Kiametit mbledhja do të jetë për të gjithë, ashtu siç njofton ajeti 47 i sures “El Kehf”: “**Ne i mbledhim ata dhe asnjëri nuk do të mbetet pa u mbledhur.**”.

Ajeti i mësipërm dëshmon për ngjarjet që do të ndodhin në pragun e Ditës së Kiametit. Në tërësi, ajetet që janë objekt studimi flasin edhe për ngjarjet që do të ndodhin pikërisht në atë Ditë.

Disa interpretues të Kur'anit nga Ehli Synneti mendojnë se ajeti në fjalë flet për ngjarjet që do të ndodhin në Ditën e Kiametit.

Ata thonë se qëllimi me fjalën “grupe” në këtë ajet, është për krerët e grupeve dhe prijësit e tyre.

Por ne e dimë se komenti i fjalës “*feuxhun*”, siç e pamë më sipër, është e kundërta e kuptimit të dukshëm të fjalës, ashtu siç e lexojmë në ajetin vijues: **“Derisa të vijnë** (në vendin e llogaridhënies), **Ai u thotë: ju i përgënjeshtruat argumentet e Mia pa pasur asnjë dijeni për ato se çfarë po bëni.”**¹

Dhe ai që e thotë këtë fjalë është All’llahu, i Gjithëfuqishmi, të Cilit nuk i mungon asgjë dhe që s’ka nevojë për asnjë send; kurse qëllimi me fjalën “*el àjàt*” është për mrekullitë me të cilat erdhën Profetët, ose për urdhrat e All’llahut, ose për të dyja.

Edhe qëllimi më fjalinë **“pa pasur asnjë dijeni për ato”** është: Ju i përgënjeshtruat argumentet pa i vërtetuar dhe pa u njohur me të vërtetën e çështjes; por kur njeriu përgënjeshton dhe mohon diçka pa bërë asnjë studim, apo hetim rreth saj, në të vërtetë ai është treguar injorant.

Jobesimtarët do të japin llogari për dy gjëra:

- për mohimin që bënë pa e shqyrtuar të vërtetën.
- për punët e tyre.

Kur ajeti që u përmend më lart flet për Kiametin, kuptimi i tij është i qartë, por kur flet për çështjen e kthimit, në këtë rast është një shenjë që tregon kthimin e një grupi jobesimtarësh në këtë botë; natyrisht që rikthimin e tyre e ka në dorë vetëm All’llahu, kurse përfaqësuesi i pushtetit dhe zbatuesi i autoritetit

¹ Frazja e ajetit **“për ato se çfarë po bëni”**, është fjali pyetëse dhe si e tillë, kuptimi i saj është ashtu siç u tha më lart: “Çfarë jeni duke bërë?”.

të Tij në tokë, do të bëjë hetime rreth atyre të kthyerve dhe do t'u kërkojë llogari për punët që ata kanë bërë gjatë jetës. Më pas, ai i dënon ata sipas asaj që meritojnë prej dënimit tokësor, por ky dënim nuk është pengesë që ata të mos ndëshkohen në Botën Tjetër. Shumë kriminelë e marrin dënimin ligjor në këtë botë, por nëse pas tij ata nuk janë penduar, patjetër që dënimi i pret edhe në Botën Tjetër.

Është e vërtetë se jobesimtarët nuk kanë mundësi t'i përgjigjen asnjërës prej këtyre dy pyetjeve, prandaj ajeti i fundit i grupit të ajeteve që janë objekt studimi, shton: **“Dënimi ra mbi ata për shkak të padrejtësive që bënë dhe ata nuk do të flasin.”**

Kur e interpretojmë fjalën e ajetit *“el kaulu”*, me dënimin në këtë botë, kuptohet se është dënimi në këtë botë, ndërsa kur e interpretojmë me dënimin në Ditën e Kiametit, atëherë flitet për dënimin në Botën Tjetër.

Hulumtime

Ç'është “dàb'betu erdi”?

Fjala e ajetit *“dàb'beten”* do të thotë: çdo gjallesë që ushtron presion mbi tokë dhe lëviz. Disa mendojnë se kjo fjalë përdoret për të gjitha gjallesat me përjashtim të njeriut, por nuk është kështu, sepse në ajetin 6 të sures “Hùd”, lexojmë: **“s'ka asnjë gjallesë në tokë që All'Ilahu të mos i ketë garantuar asaj**

ushqimin"; gjithashtu, edhe në ajetin 61 të sures "En Nahl" lexojmë: **"Sikur All'Ilahu të dënonte njerëzit për shkak të mizorisë së tyre, nuk do të linte mbi të (tokë) asnjë gjallesë."**

Edhe në ajetin 22 të sures "El Enfâl" lexojmë: **"Gjallesat më të këqija tek All'Ilahu janë të shurdhuarit (ata që nuk dëgjojnë të vërtetën) dhe memecët (ata që nuk e pohojnë të drejtën), ata nuk mendojnë."**

Më lart, në komentin e ajetit kemi thënë se Kur'ani nuk jep hollësi në shpjegimin e frazës **"kafshët e tokës"**, por e përmend atë në tërësinë e saj. E vetmja gjë që thuhet për të, është se ajo do t'u flasë njerëzve dhe do të dallojë besimtarin prej jobesimtarit. Transmetimet islame dhe mendimet e interpretuesve të Kur'anit në lidhje me kafshën e tokës mund të përmbliidhen në dy interpretimet e mëposhtme:

1- Njëri grup mendon se kjo kafshë është e panjohur, nuk ka ngjashmëri me njeriun, ka një formë të çuditshme dhe karakterizohet nga punë të jashtëzakonshme e mrekulli.

2- Grupi tjetër është shprehur se kafsha e tokës ka trajtën e një njeriu të jashtëzakonshëm, që lëviz shumë e që i dallon besimtarët prej hipokritëve. Në disa transmetime thuhet se ai ka shkopin e Musait (*Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!*) dhe unazën e Sulejmanit (*Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!*). Ne dimë se shkopi i Musait simbolizon fuqinë, ndërsa unaza e Sulejmanit simbolizon qeverisjen dhe pushtetin e All'Ilahut. Pra, ky njeri është një burrë i fuqishëm dhe me pushtet hegjemon. Në një hadith të përcjellë prej Hudhejfe bin El Jemànit, thuhet se i Dërguari i All'Ilahut (*Paqja dhe bekimi i All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), duke e

përshkruar këtë **“kafshë”**, ka thënë: *“Atë nuk e arrin asnjë kërkues dhe prej saj nuk shpëton ai që largohet. Ai i vë shenjë besimtarit në mes të dy syve të tij dhe shkruan aty fjalën “besimtar”. Gjithashtu, ai i vë shenjë jobesimtarit në mes të dy syve të tij dhe i shkruan aty fjalën “mohues”. Ai ka me vete shkopin e Musait dhe unazën e Sulejmanit.”*¹

Duke u bazuar në transmetimet islame, Ebul Futùh Err Rràzij në tefsirin e tij, është shprehur se fjala e Kur'anit **“kafsha e tokës”** (*dàb'betul erdi*) është aludim për prijësin e kohës, Mehdiun (*Paqja qoftë mbi të!*).²

Duke marrë në konsideratë transmetimet islame, mësojmë se fraza **“kafsha e tokës”** ka një kuptim shumë të gjerë dhe mund të përputhet me cilindo prijë të madh që mund të dalë në kohën e fundit, i cili do të ndajë të vërtetën nga e gabuara.

Shkopi i Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) që mendohet se do të ketë **“kafsha e tokës”** simbolizon fuqinë dhe fitoren, ndërsa unaza e Sulejmanit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) simbolizon qeverinë e All'llahut. Këto janë shenja që tregojnë se **“kafshët e tokës”** (*dàb'betul erdi*) është një njeri aktiv që bën punë të jashtëzakonshme.

Në transmetimet islame njoftohet se ai do të vërë shenjë midis syve të besimtarit dhe do të shkruajë aty fjalën *“besimtar”*, si dhe do të vërë shenjë edhe midis syve të mohuesit dhe do të shkruajë aty fjalën *“mohues”*. Por këto veprime përputhen me cilësitë e njeriut, çka tregon se ajo do të jetë njeri.

¹ Tefsiri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 7, f. 234; fundi i ajetit që është objekt studimi.

² Tefsiri “Rùhul Meànij”, vëll. 8, f. 423.

Këtu duhet shtuar se Kur'ani e përshkruan **“kafshën e tokës”** me cilësinë e të folurit, çka e përforcon më shumë mendimin se ajo do të jetë njeri.

Nga të gjitha këto që u përmendën, ne arrijmë në përfundimin se fjala e ajetit *“dàb'betul erdi”* - **“kafshët e tokës”**, përdoret më shumë për të treguar gjallesat, me përjashtim të njeriut, por Kur'ani e ka përdorur atë në mënyrë përgjithësuese për të gjitha gjallesat, duke përfshirë këtu dhe njeriun. Gjithashtu, në Kur'an kjo fjalë ka ardhur edhe për të treguar vetëm njeriun. Shembujt krahasues të përmendur në këtë ajet dhe në shumë transmetime islame rreth interpretimit të tij, tregojnë se me shprehjen *“dàb'betul erdi”* - **“kafsha e tokës”**, qëllimi është për një njeri aktiv me të gjitha cilësitë që i përmendëm më lart. Ky njeri do të ndajë të vërtetën nga e gabuara dhe do të bëjë dallimin midis besimtarit dhe hipokritit e mohuesit.

Me fjalë të përmbledhura: ai njeri do të dalë në kohën e fundit, në pragun e Ditës së Kiametit dhe do të jetë njëri prej argumenteve që vërtetojnë madhësitinë e Krijuesit.

Ajetet: 86 - 88

أَلَمْ يَرَوْا أَنَّا جَعَلْنَا اللَّيْلَ لَيْسَكُنَا فِيهِ وَ النَّهَارَ مُبْصِرًا إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ
لِّقَوْمٍ يُؤْمِنُونَ ﴿٨٦﴾ وَيَوْمَ يُنْفَخُ فِي الصُّورِ فَفَزِعَ مَنْ فِي السَّمَوَاتِ وَمَنْ فِي
الْأَرْضِ إِلَّا مَنْ شَاءَ اللَّهُ وَكُلُّ أَتَوَّهٍ دَاخِرِينَ ﴿٨٧﴾ وَتَرَى الْجِبَالَ تَحْسَبُهَا جَامِدَةً
وَهِيَ تَمْرٌ مَرَّ السَّحَابِ صُنْعَ اللَّهِ الَّذِي أَتَقَنَ كُلُّ شَيْءٍ إِنَّهُ وَ خَيْرُ بَمَا
تَفْعَلُونَ ﴿٨٨﴾

“A nuk e shohin ata se Ne ua bëmë natën që të pushojnë gjatë saj, kurse ditën e bëmë shikuese? Në këtë ka argumente për një popull që beson.”

“Ditën kur do t’i fryhet ‘Surit’, do të frikësohen kush është në qiell dhe kush është në tokë, me përjashtim të atij që do All’llahu; të gjithë do t’i vijnë Atij të përulur.”

“Ti i sheh malet dhe i mendon të palëvizshëm, ndërsa ato lëvizin si retë, mjeshtëria e All’llahut, Atij që përsosi të gjitha sendet, Ai është i mirinformuar për ato që ju bëni.”

Komentimi

Lëvizja e Tokës, njëra prej mrekullive shkencore të Kur'anit

Ajetet që janë objekt studimi flasin edhe për fillimin e krijimit dhe ringjalljen pas vdekjes, për shenjat e madhështisë së All'llahut, për argumentet e fuqisë së Tij në botën e gjallë dhe për ndodhitë e Ditës së Kiametit. Në ajetin e parë të këtij grupi ajetesh, thuhet: **“A nuk e shohin ata se Ne ua bënë natën që të pushojnë gjatë saj, kurse ditën e bëmë shikuese.”**. Në këtë ka shenja e argumente të qarta që dëshmojnë fuqinë e All'llahut dhe Urtësinë e Tij për cilindo që është përgatitur të besojë. Ajeti vijon: **“...në këtë ka argumente për një popull që beson.”**.

Nuk është hera e parë por as hera e fundit, që Kur'ani flet për gjallërinë e natës e të ditës dhe për sistemin dritë-hije, sepse ai është si libër mësimi dhe edukimi që ka si qëllim ndërtimin e personalitetit njerëzor. Ne dimë nga se bazat e mësimdhënies dhe të edukimit, disa herë kërkojnë përsëritjen e çështjes në kapituj të ndryshëm. Këtë gjë bën Kur'ani me qëllim që t'u kujtojë njerëzve se fjalët e tij duhet të mbeten në mendjet e tyre ashtu siç janë thënë.

Pushimi e qetësia që arrihet në errësirën e natës, është një e vërtetë e pranuar shkencërisht. Hyrja e natës nuk sjell shkaqe detyruese për ndërprerjen e aktiviteteve ditore, por pushimi e qetësia e natës kanë ndikime të thella te nervat e njeriut dhe te të gjitha kafshët. Veç kësaj, errësira e natës i tërheq kafshët dhe

njerëzit drejt qetësisë dhe gjumit të thellë, ose siç është shprehur Kur'ani, drejt pushimit.

Edhe drita e diellit nuk ndriçon vetëm mjedisin që njeriu të shohë vendin ku jeton. Jo, ajo zgjon edhe grimcat më të vogla të trupit të njeriut dhe i orienton ato drejt lëvizjes dhe aktivitetit.

Ajeti që është objekt studimi shpjegon qartë njërën anë të Njësisimit të All'Ilahut (Zoti Një dhe i Vetëm); shpjegon qartë se i adhuruari i vërtetë është vetëm Zoti i botës së ekzistencës dhe Rregulluesi e Sistemuesi i saj. Ajeti e bën të qartë kotësinë e idhujve dhe u bën thirrje adhuruesve të tyre që të mendojnë në lidhje me adhurimin që u bëjnë idhujve.

Duhet tërhequr vëmendja në faktin se njeriu e ka për detyrë ta harmonizojë veten me sistemin e botës. Në këtë sistem, ai është përshtatur që të pushojë gjatë natës dhe të aktivizohet e të lëvizë gjatë ditës, sepse vetëm kështu mbetet gjithmonë aktiv dhe i shëndetshëm. Ai nuk duhet të veprojë ashtu siç bëjnë ata që ndjekin dëshirat e ulëta, duke qëndruar zgjuar natën e duke fjetur deri në mesditë.

Është shumë domethënëse fakti se në këtë ajet, me fjalën *"mubsiren"* - *"shikuese"* është cilësuar dita, ndonëse të parët është cilësi e njeriut gjatë ditës, por ky lloj theksimi i bukur bëhet për të treguar rëndësinë e madhe të aktivitetit gjatë ditës, ashtu siç cilësohet edhe nata disa herë me shprehjen *"natë e fjetur"*.

Ky ndryshim në shprehje në këtë ajet, shpjegon dobinë e natës dhe të ditës, pasi për natën thuhet: *"lejskunù fijhi"* - **"që të pushojnë gjatë saj"**, kurse për ditën përdoret fjala *"mubsiren"* - **"shikuese"**. Kjo tregon se qëllimi për ekzistencën e natës është

qetësia e pushimi, kurse qëllimi me dritën e ditës nuk është vetëm që njeriu të shikojë, por edhe të shohë mjetet që e çojnë atë drejt dhuntive të jetës dhe që të përfitojë e të kënaqet me to.

Gjithsesi, ky ajet flet drejtpërdrejt për çështjen e besimit në All'llahun, Zotin Një e të Vetëm. Në të njëjtën kohë, aty flitet bukur për çështjen e ringjalljes pas vdekjes, sepse gjumi është i njëjtë me vdekjen dhe zgjimi është i njëjtë me ringjalljen pas vdekjes.

Ajeti vijues i këtij grupi ajetesh flet për dukuritë e Ditës së Kiametit dhe ndodhitë paraprake të asaj Dite. Për këtë, ajeti thotë: **“Ditën kur do t’i fryhet ‘Surit’, do të frikësohen kush është në qiell dhe kush është në tokë, me përjashtim të atij që do All’llahu; të gjithë do t’i vijnë Atij të përulur”**, pra të gjithë do të vijnë para All’llahut të nënshtuar.

Nga ajetet e Kur’anit mësohet se “*Surit*” do t’i fryhet dy ose tri herë.

Herën e parë, fryerja e *Surit* do të ndodhë në përfundimin e kësaj bote dhe në prapun e Kiametit. Me këtë fryrje frikësohen ata që janë në qiej dhe ata që janë në tokë, me përjashtim të atyre që do All’llahu të mos frikësohen.

Herën e dytë që i fryhet *Surit* do të vdesin të gjithë nga britma e fortë e saj.

Herën e tretë fryhet në “*Sûr*” në kohën e ringjalljes pas vdekjes dhe ndodhjes së Kiametit. Me këtë fryrje do të ringjallen të gjithë të vdekurit dhe bashkë me ringjalljen fillon jeta e re. Në lidhje me fjalën e ajetit “*junfekhu*” ka mendime të ndryshme në

mesin e interpretuesve të Kur'anit, nëse ajo tregon fryrjen e parë, të dytën apo të tretën. Shembujt krahasues në këtë ajet dhe në ajetet që vijnë pas tij përputhen plotësisht me dy fryrjet; gjithashtu, është thënë se kjo fjalë i përfshin të gjitha fryrjet.

Në të vërtetë, fjalët e ajetit tregojnë se fryrja për të cilën flet ai, është fryrja e parë, që do të ndodhë në fundin e kësaj bote, sepse folja *"fezia"*, që do të thotë *"frikë"*, apo ndjenja që lind te njeriu nga tmerri kur ai është i vetëm, do të depërtojë në të gjitha zemrat. Ndjenja e frikës është shenjë e kësaj fryrjeje. Ne e dimë se frika tmerruese në Ditën e Kiametit lind për shkak të punëve të njerëzve dhe jo për shkak të fryrjes.

Ardhja e fjalës *"fezia"* ngjitur me lidhësen *"fe"*, ashtu siç e lexojmë në fjalën e ajetit: *"fefezia"*, tregon se frika vjen prej fryrjes në *"Sûr"*; por kjo është e veçantë vetëm për fryrjen e parë, sepse fryrja e fundit, jo vetëm që nuk shkakton frikë, por është lajmëtari për jetë e lëvizje dhe kur të ndodhë ajo, atëherë njeriu do të kthehet në gjendjen e punëve të tij jetësore.

Përsa i përket përgjigjes për pyetjen se cili është qëllimi i fryrjes në *"sûr"*, në mesin e interpretuesve të Kur'anit ka mendime të shumta, të cilat do t'i paraqesim në fundin e komentit të ajetit 68 të sures *"Ez Zumer"*.

Fjalja e ajetit ***"me përjashtim të atij që do All'Ilahu"***, tregon se të përjashtuarit nga frikësimi janë besimtarët dhe punëmirët. Besimtarët kanë një siguri të veçantë. Ata nuk i frikëson as fryrja e parë në *"sûr"* e as fryrja e fundit, ashtu siç thuhet në ajetet vijuese: ***"...kush vjen me një punë të mirë, ai do të ketë një më të mirë se ajo dhe prej tmerrit të asaj Dite ata janë të siguar."***

Nga kuptimi i jashtëm i fjalisë së fundit të ajetit që është objekt studimi: **“të gjithë do t’i vijnë Atij të përulur”**, shihet se përulja do të jetë e përgjithshme dhe nuk do të ketë përjashtim, duke përfshirë edhe Profetët e njerëzit e afërm tek All’llahu (eulijatë). Të gjithë do të vijnë të përulur para All’llahut dhe të nënshtruar ndaj vullnetit të Tij. Nëse do të shohim me kujdes në ajetin 127 të sures “Es Sâffât”: **“ata do të jenë prezent (në Xhehen’nem). Me përjashtim të robve besnikë ndaj All’llahut”**, do të vëmë re se nuk ka asnjë kontradiktë midis këtij ajeti dhe ajetit që është objekt studimi, sepse të dy tregojnë praninë në vendgrumbullim, kurse ajeti i dytë tregon praninë në fushën e llogaridhënies dhe shikimit të punëve të njerëzve.

Ajeti vijues thekson njërin prej argumenteve të madhështisë së All’llahut në botën e gjithësisë dhe thotë: **“Ti i sheh malet dhe i mendon të palëvizshëm, ndërsa ato lëvizin si retë, mjeshtëria e All’llahut, Atij që përsosi të gjitha sendet.”**.

Kush ka fuqi për të krijuar një sistem si ky dhe një përsosuri në krijim?! Patjetër që për diturinë e Tij s’ka asnjë dyshim. Dhe ajeti njofton: **“Ai është i mirinformuar për ato që ju bëni.”**.

Shumë interpretues të Kur’anit mendojnë se ky ajet flet për ngjarjet që do të ndodhin në çastet e ndodhjes së Kiametit. Ne dimë se në fundin e kësaj bote do të ndodhin tërmete të fuqishme dhe shpërthime të mëdha. Malet do të ndahen prej njëri-tjetrit dhe do të shkërmoqen. Kjo e vërtetë është theksuar shpesh në suret e fundit të Kur’anit.

Por shembuj të tjerë krahasues përforcojnë interpretimin, sipas të cilit ajeti i lartpërmendur, përveç vërtetimit të Njësimit të All'Ilahut dhe të argumenteve që tregojnë madhështinë e Tij në këtë botë, thekson edhe lëvizjen e tokës, të cilën ne njerëzit nuk e ndjejmë.

Shpjegimi i lëvizjes së Tokës

1- Ajeti njofton: ti i sheh malet si të ngurta e të palëvizshme, ndonëse ato ecin e lëvizin ashtu si retë. Kjo shprehje është e qartë dhe tregon se lëvizja e maleve nuk është e njehershme me ngjarjet që do të ndodhin në Ditën e Kiametit, ashtu siç e lexojmë në ajetin 2 të sures "El Haxh": **"...atë Ditë ju do të shihni se çdo grua që e ushqen fëmijën me gjirin e saj, do të braktisë atë që ka për gjiri, shtatzana do të lëshojë barrën që ka në barkun e saj; ti do të shikosh se njerëzit duken si të dehur; por jo, ata nuk janë të dehur, porse dënimi i All'Ilahut është shumë i ashpër."**

2- Përngjasimi i lëvizjes së maleve me atë të reve është në përputhje me lëvizjet e qeta të koordinuara dhe jo me shpërthimet e mëdha, nga të cilat shurdhohen veshët.

3- Shprehja e mësipërme tregon se në kohën kur ti i sheh malet të ngurta, ashtu siç duken nga jashtë, në të vërtetë ato lëvizin me shpejtësi, pra të dyja gjendjet e maleve vërtetojnë të njëjtën gjë: lëvizjen e tyre.

4- Shprehja e ajetit *"etkane"* - **"e përsosi"** nga të gjitha anët, përfshin edhe anën e organizimit. Kjo shprehje përputhet me gjendjen e stabilitetit të sistemit të botës, por nuk është në përputhje dhe me kohën kur bota do të shembet e do të asgjësohet.

5- Fraza e ajetit **“Ai është i mirinformuar për ato që ju bëni”**, - duke marrë në konsideratë faktin se folja *“ta' melûne”* - **“që ju bëni”** është në kohën e tashme, tregon se punët kanë lidhje me këtë botë; por ajeti njofton se All’llahu ka dijeni të gjithanshme për punët që ju bëni, si në të tashmen ashtu edhe në të ardhmen. Sikur punët të kishin lidhje me fundin e botës, patjetër që ajeti do të thoshte: All’llahu është i mirinformuar për punët që keni bërë.

Nga shembujt krahasues, mësohet se ky ajet zbulon njërrën prej dukurive të habitshme të krijimit dhe është e ngjashme me shprehjen që ka ardhur në dy ajetet e mësipërme: **“A nuk e shohin ata se Ne ua bënë natën që të pushojnë gjatë saj?”**.

Duke u bazuar mbi këtë shpjegim, një pjesë e ajeteve që janë objekt studimi flasin për Njësimin e All’llahut dhe pjesa tjetër flet për ringjalljen pas vdekjes.

Nga ky interpretim ne dalim në përfundimin se malet, që ne i përfytyrojmë si të palëvizshme e të ngurta, lëvizin me shpejtësi që vjen duke u shtuar. Vetëkuptohet se nuk mund të flitet për lëvizjen e maleve pa lëvizjen e tokës. Nga ajeti del qartë se edhe toka lëviz ashtu siç lëvizin retë.

Shkencëtarët kanë llogaritur se shpejtësia e rrotullimit të tokës rreth boshtit të vet është afërsisht 30 km/sekond, kurse shpejtësia e rrotullimit të tokës rreth diellit është më shumë se kaq.

Por, përse ajeti flet për malet dhe jo për ndonjë gjë tjetër? Ato janë marrë si shembull për shkak të madhësisë dhe peshës së rëndë që mbajnë në brendësi të tyre. Megjithatë, malet me urdhrin e All’llahut lëvizin së bashku me tokën, ashtu siç lëvizin retë.

Fuqia e All'llahut është mbi të gjitha sendet; ajo fuqi është e madhe dhe e qëndrueshme.

Gjithsesi, ajeti i mësipërm numërohet prej mrekullive shkencore të Kur'anit. Ne dimë se shkencëtarët e parë që zbuluan lëvizjen e globit tokësor ishin Galileu dhe Koperniku. Të dy këta shkencëtarë e shpalosën këtë të vërtetë para publikut nga fundi i shekullit të gjashtëmbëdhjetë dhe fillimi i shekullit të shtatëmbëdhjetë. Në atë kohë, kur sundimi i kishës ishte absolut, krerët e kishës i dënuan të dy këta shkencëtarë me dënime shumë të rënda.

Por Kur'ani e kishte shpalosur këtë të vërtetë afërsisht para një mijë vjetësh, madje ai e ka shpjeguar lëvizjen e tokës sipas mënyrës së përshkruar më lart; njëkohësisht, kjo lëvizje e tokës vërteton Njësimin e All'llahut, vërteton faktin se All'llahu është Zoti Një e i Vetëm.

Disa filozofë myslimanë pranojnë edhe një interpretim të dytë dhe thonë se lëvizja e maleve në këtë botë, e shprehur në këtë ajet, tregon atë që quhet "lëvizja esenciale" të sendet. Ata mendojnë se ky ajet është në përputhje me teorinë e njohur të lëvizjes esenciale dhe e mbështet atë.¹

Ajetet: 89 - 93

¹ Sipas teorisë së lëvizjes esenciale, sendeve të botës së materies, përveç ndryshimeve të ndryshme që pësojnë në sasi, cilësi, në kohë e në hapësirë, në brendësi (në esencë) të tyre u ndodh edhe një lëvizje; një gjë e tillë do të thotë se të gjitha sendet janë trupa të lëvizshëm.

مَنْ جَاءَ بِالْحَسَنَةِ فَلَهُ وَخَيْرٌ مِّنْهَا وَهُمْ مِّنْ فَزَعٍ يَوْمَئِذٍ ؕ ءَامِنُونَ ﴿٨٩﴾ وَمَنْ جَاءَ
 بِاللَّسِيئَةِ فُكِّبَتْ وَجُوهُهُمْ فِي النَّارِ هَلْ يُجْزَوْنَ إِلَّا مَا كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ ﴿٩٠﴾ إِنَّمَا
 أُمِرْتُ أَنْ أَعْبُدَ رَبَّ هَذِهِ الْبَلَدَةِ الَّذِي حَرَّمَهَا وَلَهُ كُلُّ شَيْءٍ ؕ وَأُمِرْتُ أَنْ
 أَكُونَ مِنَ الْمُسْلِمِينَ ﴿٩١﴾ وَأَنْ أَتْلُوَ الْقُرْآنَ فَمَنِ اهْتَدَىٰ فَإِنَّمَا يَهْتَدِي
 لِنَفْسِهِ ؕ وَمَنْ ضَلَّ فَقُلْ إِنَّمَا أَنَا مِنَ الْمُنذِرِينَ ﴿٩٢﴾ وَقُلِ الْحَمْدُ لِلَّهِ سَيُرِيكُمْ
 ءَايَاتِهِ ؕ فَتَعْرِفُونَهَا وَمَا رَبُّكَ بِغَافِلٍ عَمَّا تَعْمَلُونَ ﴿٩٣﴾

“Kush vjen me një punë të mirë, ai do të ketë një më të mirë se ajo (puna me të cilën erdhi) dhe ata prej frikës së asaj Dite janë të siguar.”

“Dhe kush vjen me një punë të keqe, ata hidhen në zjarr me fytyrë përmbysur, a nuk po dënoheni vetëm për punët që keni bërë?”

“Unë jam urdhëruar të adhuroj vetëm Zotin e këtij qyteti, të cilin Ai e shenjtëroi; Atij i takon çdo send dhe unë jam urdhëruar të jem prej të nënshtruarve.”

“Dhe që të lexoj Kur'anin; kush udhëzohet në rrugën e vërtetë, ai është udhëzuar për veten e tij dhe atij që shkon në rrugën e humbjes, i thuaj: unë jam prej paralajmëruesve.”

“Dhe thuaj: falënderimi e lavdërimi janë vetëm për All’llahun. Ai do t’ua tregojë argumentet e Veta dhe atëherë ju do t’i kuptoni ato; Zoti yt nuk është indiferent ndaj punëve tuaja.”

Komentimi

Gjëja e fundit për të cilën u urdhërua Profeti

Ajetet e mësipërme bënë fjalë për punët e robve dhe për diturinë e All’llahut; kurse ajetet që janë objekt studimi, qysh në fillim flasin për shpërblimin që do të kenë punëmirët dhe për sigurinë që do të kenë ata prej frikës së Ditës së Kiametit. Për këtë, ajeti thotë: **“Kush vjen me një punë të mirë, ai do të ketë një më të mirë se ajo (puna me të cilën erdhi) dhe ata prej frikës së asaj Dite janë të sigurvear.”**

Në mesin e interpretuesve të Kur’anit ka mendime të ndryshme në lidhje me qëllimin e fjalës së këtij ajeti *“el haseneti”* – **“punë e mire”**.

Disa prej tyre e kanë interpretuar me fjalën e Njësimit: *“lâ ilâhe il’lell’lâh”* – **“nuk ka zot tjetër përveç All’llahut”**.

Kuptimi i ajetit është shumë i gjerë, gjë që e kemi theksuar shpeshherë. Gjithashtu, edhe kuptimi i fjalës *“el haseneti”* – **“punë e mire”** ka një kuptim të gjerë dhe përfshin punët e mira dhe të singerta, ndër të cilat edhe besimin në All’llahun e në të Dërguarin

e Tij. Pra, në kuptimin e këtij ajeti përfshihen edhe punë të tjera të mira.

Disa kanë thënë se në fjalën “*el haseneti*” – **“punë e mire”** përfshihet besimi në All’llahun, por, a mund të ketë diçka më të mirë se besimi në All’llahun, përderisa i Gjithëfuqishmi thotë: **“Kush vjen me një punë të mirë, ai do të ketë një më të mirë se ajo (puna me të cilën erdhi)?”**.

Përgjigjja për këtë çështje që mund të duket e paqartë është krejt e qartë: kënaqësia e All’llahut është më e mirë se besimi; me fjalë të tjera: të gjitha punët e mira i paraprijnë arritjes së kënaqësisë së All’llahut dhe kjo e fundit është më e mirë se të parat.

Nga kuptimi i fjalëve të disa ajeteve, si për shembull të ajetit 3 të sures “El Haxhxh”, lind edhe një pyetje tjetër. Aty lexojmë se në Ditën e Kiametit, frika do t’i përfshijë të gjithë njerëzit. Atëherë, si mund të jenë të përjashtuar prej saj punëmirët?

Ajeti 103 i sures “El Enbijà” e sqaron këtë përgjigje duke thënë: **“Ata nuk do të jenë të dëshpëruar prej frikës më të madhe dhe ata do t’i takojnë engjëjt (duke u thënë) kjo është Dita që u premtohet.”**.

Siç e dimë **“frika më e madhe”** është frika e Ditës së Kiametit dhe e hyrjes në zjarrin e Xhehennemit, dhe jo frika e shkaktuar prej fryerjes në “Sùr”.

Më pas, Kur'ani flet për grupin e kundërt të punëmirëve dhe thotë: **“Dhe kush vjen me një punë të keqe, ata hidhen në zjarr me fytyrë përmbysur.”**.

Dhe për këtë grup s'ka si të ndodhë ndryshe: **“a nuk po dënoheni vetëm për punët që keni bërë?”**.

Fjala e ajetit *“kub'bet”* është marrë prej rrënjës së saj *“keb'be”*, që në origjinë do të thotë: hedhja e sendit në tokë me fytyrë përmbys. Duke u bazuar mbi këtë shpjegim, përmendja e fjalës *“fytyrë”* në fjalinë e këtij ajeti, është bërë vetëm për të theksuar mënyrën se si do të flaken punëkëqinjtë në zjarr.

Flakja e këtij grupi në zjarr me fytyrë të përmbysur, është lloji më i keq i dënimit, duke shtuar se kur ata viheshin përballë së vërtetës, ngryseshin në fytyrë dhe tundnin kokat, por kur mëkatonin, fytyrat e tyre shprehnin gëzim; kështu tani, ata e kanë merituar patjetër një dënim të tillë.

Fraza e ajetit: **“...a nuk po dënoheni vetëm për punët që keni bërë?”** është edhe një përgjigje për pyetjen: A nuk është shumë i rëndë ky dënim? Pra, përgjigja është se ky dënim nuk është gjë tjetër përveç punës që ke bërë në këtë botë (**“a nuk po dënoheni vetëm për punët që keni bërë?”**).

Në tre ajetet e fundit të këtij grupi, fjala i drejtohet Profetit (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ato e sigurojnë Profetin se kjo është e vërteta dhe e urdhërojnë të paralajmërojë ata që i vënë shok All'llahut në adhurim; detyra me të cilën është ngarkuar, e detyron ta plotësojë kumtimin e mesazhit që mban dhe t'u thotë atyre: është njëlloj, nëse ju besoni ose jo.

Dhe ajeti i tretë prej këtyre ajeteve që janë objekt studimi, thotë:
“Unë jam urdhëruar të adhuroj vetëm Zotin e këtij qyteti.”

Ky është qyteti i shenjtë; me të shprehet ekzistenca dhe nderi juaj. Këtë qytet të shenjtë e ka nderuar All’llahu. Ai u ka nderuar me begatitë që ka zbritur për ju në këtë qytet, por ju, në vend që të falënderoni për mirësitë e Tij, po tregoheni mosmirënjohës duke i mohuar ato.

Qyteti i shenjtë, ku ndodhet xhamia e shenjtë e sigurisë së All’llahut, kjo copë toke, është më e nderuara në të gjithë sipërfaqen e tokës. Në këtë qytet të shenjtë gjendet faltorja më e vjetër, në të cilën është adhuruar All’llahu, Zoti Një e i Vetëm.

Pa dyshim që unë adhuroj Zotin e këtij qyteti të shenjtë: **“të cilin Ai e shenjtëroi”**, -dhe caktoi për të veçanti, dispozita dhe paprekshmëri, si dhe karakteristika të tjera, të cilat nuk i gëzon asnjë qytet tjetër në të gjithë tokën.

Por mos mendoni se për All’llahun është vetëm ky qytet. Jo, për Të është çdo send që gjendet në të gjithë botën e gjallë:
“Atij i takon çdo send.”

Puna e dytë për të cilën unë jam urdhëruar, është që të nënshtrohem: **“dhe unë jam urdhëruar të jem prej të nënshtruarve”**.

Siç shihet, ajeti shpjegon dy detyra shumë të rëndësishme, me të cilat u ngarkua Profeti (*Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ato janë: adhurimi ndaj All’llahut, që është Një dhe i Vetëm, dhe dorëzimi pa kushte ndaj urdhrit të Tij”.

Ajeti vijues shpjegon shkaqet që mundësojnë arritjen e këtyre dy objektivave dhe thotë: **“Dhe që të lexoj Kur'anin”**, - Të lexoj Kur'anin që të ndriçohem me dritën e tij, të ngazëllem me ëmbëlsinë e tij, që dhuron gjallëri. Jam urdhëruar gjithashtu, që të gjitha punët e mia t'i kryej vetëm nën udhëzimin e Kur'anit. Kur'ani është mjeti im për të arritur në këto dy objektiva të shenjta; ai është mjeti që më mundëson të përballem me të gjitha llojet e vënies shok All'llahut në adhurim (*shirkut*). Kur'ani më mëson dhe më ndihmon të përballem me çdo lloj devijimi nga rruga e drejtë, me çdo shkarje në rrugën e humbjes dhe të luftoj këto dukuri negative.

Më pas, ajeti tregon me gjuhën e Profetit (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i cili i flet popullit të tij, duke i thënë: Mos mendoni se unë kam ndonjë përftim personal prej besimit tuaj. Ju them se All'llahu s'ka nevojë për ju, por dijeni se: **“kush udhëzohet në rrugën e vërtetë, ai është udhëzuar për veten e tij”**.

Mirësitë për këtë botë, ose për Botën Tjetër, që vijnë prej udhëzimit në rrugën e së vërtetës, janë të gjitha për të mirën e atij që udhëzohet në rrugën e së vërtetës, por është edhe e kundërta: **“dhe atij që shkon në rrugën e humbjes, i thuaj: unë jam prej paralajmëruesve”** - nuk më prek përfundimi i rëndë i atij që shkon në rrugën e humbjes, sepse detyra ime është të kumtoj mesazhin, të paralajmëroj, t'ua tregoj të tjerëve rrugën e vërtetë dhe të punoj me këmbëngulje që ju ta ndiqni atë. Por ai që ka dëshirë të qëndrojë në rrugën e humbjes, i bën keq vetes dhe do të jetë prej të humburve.

Është shumë domethënës fakti se për udhëzimin në rrugën e së vërtetës, Kur'anit thotë: **“kush udhëzohet në rrugën e vërtetë, ai është udhëzuar për veten e tij”**, ndërsa kur flet për rrugën e humbjes, nuk thotë: kush shkon në rrugën e humbjes, dëmi bie mbi vetë atë, por e urdhëron Profetin të thotë: **“dhe thuaj: unë jam prej paralajmëruesve”**.

Ky ndryshim në shprehje mbase është një shenjë për fjalën e Profetit (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): *“Kurrë nuk do të hesht para atyre që kanë shkarë në rrugën e humbjes dhe nuk do t'i lë ata në gjendjen që janë, por do t'i paralajmëroj vazhdimisht, sepse unë jam prej paralajmëruesve.”*. Në ajetet e Kur'anit ka shumë shprehje ku flitet për udhëzimin në rrugën e së vërtetës dhe për shkarjen në rrugën e humbjes. Ndër to është shprehja që ndodhet në ajetin që po trajtojmë, ku thuhet: “për të mirën e vetes dhe kundër vetvetes”. Kjo shprehje tregon për të dyja gjendjet: për të “mirën e vetes” në rastin e udhëzimit në të vërtetën dhe “kundër vetes”, në rastin e shkarjes në rrugën e humbjes: **“...kush udhëzohet në rrugën e vërtetë, ai është udhëzuar për veten e tij dhe atij që shkon në rrugën e humbjes...”**; por ne dimë se kjo mënyrë e ndryshme në të shprehur, është në përpjestim të drejtë me ndryshimin e pozitive, por mbase ka ardhur kështu edhe për shkak të kuptimeve të ndryshme të shprehjeve.

Vlen të përmendim se kjo sure filloi me shpjegimin e rëndësisë së madhe të Kur'anit dhe mbyllet me urdhrin për ta lexuar atë; pra fillimi e fundi i kësaj sureje flasin për Kur'anin.

Urdhri i fundit drejtuar Profetit (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në ajetin e fundit të kësaj sureje është që të falënderojë All'llahun për këto mirësi të mëdha,

sidomos për mirësinë e udhëzimit në rrugën e së vërtetës. Për këtë, në ajet urdhërohet: **“Dhe thuaj: falënderimi e lavdërimi janë vetëm për All’llahun.”**.

Ky falënderim dhe lavdërim i referohet mirësisë së Kur’anit si dhe udhëzimit në rrugën e së vërtetës, por mund të jetë edhe si një parathënie për fjalinë vijuese të ajetit: **“Ai do t’ua tregojë argumentet e Veta dhe atëherë ju do t’i kuptoni ato.”**.

Kjo shprehje kur’anore tregon se me kalimin e kohës dhe me përparimin e shkencës e të diturive, çdo ditë do të zbulohen sekretet e botës së gjallë, do të hiqet nga një perde e re prej këtyre sekreteve dhe ditë pas dite, ju do t’i kuptoni mirësitë e All’llahut, do të njiheni me madhështinë e fuqisë dhe me thellësinë e urtësisë së Tij. Shpalosja e këtyre argumenteve do të jetë e vazhdueshme dhe nuk do të ndërpritet gjatë gjithë jetës së njerëzimit.

Por juve, duke vazhduar në rrugën e kundërshtimeve dhe të shmangies nga e vërteta, All’llahu nuk do t’ju lërë të shkoni kot më kot, sepse: **“Zoti yt nuk është indiferent ndaj punëve tuaja.”**.

Fraza **“Zoti yt nuk është indiferent ndaj punëve tuaja”**, në këtë formë të shkurtër, apo edhe me një ndonjë ndryshim fare të vogël, ka ardhur në nëntë ajete të Kur’anit dhe në të vërtetë është një kërcënim me një kuptim të thellë, por edhe një paralajmërim për të gjithë njerëzit.

Falënderimi dhe lavdërimi janë vetëm për All’llahun, Zotin e botëve.

SURE El Kasas

E zbritur në Mekë – 88 ajete

Përmbajtja

Kjo sure ka zbritur në Mekë dhe si rrjedhojë, përmbajtja dhe temat që trajtohen në të janë të ngjashme me suret e tjera të zbritura në Mekë.¹ Megjithatë, disa interpretues të Kur'anit kanë thënë se ajeti 85 dhe ajetet 51-55 të kësaj sureje nuk kanë zbritur në Mekë. Ata mendojnë se ajeti 85 ka zbritur në “Xhuhfeh” – rajon që shtrihet ndërmjet Mekës dhe Medines, kurse për katër ajetet e tjera thonë se kanë zbritur në Medine, ndonëse nuk ka ndonjë argument të qartë që e vërteton fjalën e tyre.

Këtë thënie mbase e mbështesin në faktin se të pesë ajetet e lartpërmendura flasin për ithtarët e librave të mëparshëm, shumica e të cilëve në atë kohë banonin në Medine; megjithëse zbritja e ajeteve të Kur'anit në Mekë nuk do të thotë se ato duhet të flasin patjetër vetëm për idhujtarët e Mekës. Veç kësaj, banorët e Mekës dhe të Medines udhëtonin shpesh nëpër të dy këto qytete dhe kishin marrëdhënie e lidhje fisnore dhe tregtare në mes tyre. Interpretuesit e Kur'anit kanë përmendur një shkak tjetër për zbritjen e ajeteve 51-55, i cili është në përputhje me arsyetimin që ato të jenë prej ajeteve të zbritura në Medine.

Kurse ajeti 85 flet për kthimin e Profetit (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në vendlindjen e tij, pra në Mekë, prandaj ka mundësi që ky ajet të ketë zbritur në

¹ Në lidhje me këtë çështje, referohu në librin “Tàrijkhul Kur’ànì” të autorit Ebù Abdull’llàh Ez Zenxhànij, si dhe në “Katalogun” e autorit Inbi Nedijm dhe në librat e tjerë të tefsireve.

kohën kur ai emigroi prej Mekës, diku në afërsi të kësaj toke të shenjtë. Veç kësaj, Profeti (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kishte një dashuri të veçantë për Mekën, qytetin e shenjtë dhe qytetin e sigurisë së All'llahut. Me këtë ajet, i Gjithëfuqishmi e përgëzon të Dërguarin se shumë shpejt Ai do ta kthejë atë në vatrën e tij, në Mekën e Nderuar.

Duke u bazuar mbi këtë shpjegim, ajeti i lartpërmendur, pra ajeti 85 i kësaj sureje, mund të konsiderohet prej ajeteve të zbritura në Mekë, edhe nëse do të supozojmë se ka zbritur në "Xhuhfeh", sepse ajo ndodhet më afër Mekës sesa Medines.

Gjithnjë duke u bazuar mbi këtë shpjegim, nuk kemi mundësi t'i ndajmë ajetet në dy grupe, në ajete të zbritura në Mekë dhe në Medine, kështu që nuk na mbetet gjë tjetër veçse ta konsiderojmë edhe ajetin 85 të kësaj sureje prej ajeteve të zbritura në Mekë.

Kjo sure ka zbritur në Mekë, në kohën kur besimtarët ishin një grusht njerëzish nën kthetrat e armiqve të shumtë dhe të fuqishëm në të gjitha drejtimet.

Besimtarët e paktë myslimanë të asaj kohe gjendeshin nën shtypjen e armiqve, por ishin të shqetësuar e të frikësuar për të ardhmen e Islamit. Gjendja e tyre në atë kohë ishte e ngjashme me atë të Beni Israilëve në kohën kur vuanin nën shtypjen e faraonëve dhe ishin nën kthetrat e tyre. Në një pjesë të mirë të kësaj sureje flitet për Beni Israilët, për Musain (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) dhe për ata që e rrethonin Faraonin.

Afërsisht gjysma e kësaj sureje flet për Beni Israilët, veçanërisht për kohën kur Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*)

ishte foshnje që mëkohej në dorën e Faraonit të fuqishëm; por fuqisë së Sunduesit të botës së gjallë nuk mund t'i dalë përballë asnjë lloj fuqie e force tjetër. Ky fëmijë i vogël u rrit nën kujdesin e në gjirin e armiqve të tij më të egër dhe qëndroi në shtëpinë e Faraonit, derisa All'llahu i dha atë fuqi të madhe, që i mundësoi të largohej prej pushtetit të Faraonit, të thyente kurorat dhe të shembte pallatet e tyre.

Kjo sure i siguron myslimanët për dashamirësinë e për fuqinë e All'llahut dhe u thotë atyre që të mos tmerrohen nga fakti që armiqtë janë të shumtë e të fuqishëm e të mos kenë frikë nga rruga që po ndjekin.

Pjesa e parë e kësaj sureje përmban këtë histori të mbushur me mësimë dhe përvoja. Qysh në fillim të saj, besimtarët përgëzohen se ata do të kenë qeverinë e së vërtetës, qeverinë e drejtësisë dhe se do të thyejnë fuqinë e mizorëve. Ky përgëzim u jepte atyre siguri dhe forcë.

Surja "El Kasas" tregon se Beni Israilët ishin të lidhur me prangat që ua kishin hedhur mbi qafa armiqtë e tyre qysh kur ata ishin larg besimit tek All'llahu dhe kishin hequr dorë nga çdo përpjekje për t'u ngritur kundër tyre. Por kur ata e gjetën udhëheqësin e vet, kur i ndriçuan zemrat e tyre me dritën e diturisë dhe të besimit në All'llahun, Zotin Një e të Vetëm (*Teuhid*), ata u ngritën kundër faraonëve, morën në dorë pushtetin dhe u çliruan prej zgjedhës.

Pjesa tjetër e kësaj sureje flet për Karunin, njeriun mendjemadh shumë të pasur, i cili mbështetej mbi punën edhe mbi pasurinë e tij, madje gjurmët e mendjemadhësisë së tij janë edhe më të zeza se ato të Faraonit.

Faraoni u mbyt në ujë, kurse Karuni u fundos në tokë. Për të garantuar sundimin e tij, Faraoni mbështetej në pushtetin e në ushtrinë, kurse Karuni në dhunën që ushtronte ndaj Beni Israilëve, bazohej mbi pasuritë e mbi pronat e tij të shumta. Këto ajete u shpjegonin myslimanëve se tregtarët, të pasurit, të fuqishmit dhe prijësit e idhujtarëve të Mekës, nuk mund të rezistonin para fuqisë së All'llahut dhe të ndalonin fitoren e të pafuqishmëve mbi shtypësit mendjemëdhenj.

Kjo pjesë vjen në fundin e sures.

Ndërmjet dy pjesëve të kësaj sureje ka mësimë shumë të vlefshme. Aty flitet për Njësimin e All'llahut, për Ringjalljen pas vdekjes dhe për rëndësinë e madhe të Kur'anit. Gjithashtu, në të shpjegohet gjendja e jobesimtarëve në Ditën e Kiametit, trajtohen çështje të udhëzimit në rrugën e drejtë dhe të shkarjes në rrugën e humbjes dhe u jepet përgjigje argumenteve të të pafuqishmëve. Të gjitha këto janë rezultat paraprak dhe një parathënie për pjesën e dytë të sures.

Mirësia e leximit të sures "El Kasas"

Në disa hadithe të ardhura prej të Dërguarit të All'llahut, lexojmë se ai ka thënë: *"Kush e lexon suren "El Kasas", i jepen mirësi sa dhjetëfishi i numrit të atyre që i besuan Musait (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) dhe sa dhjetëfishi i numrit të atyre që e përgënjeshtroan atë. Në Ditën e Gjykimit nuk do të mbetet asnjë engjell në qiej e në tokë, që nuk do të dëshmojë për të se ai është njeri i drejtë."*¹

¹ Tefsiri "Mexhmaul Bejan", fillimi i sures "El Kasas".

Gjithashtu, në një transmetim të ardhur prej Imam Sadikut, lexojmë se ai ka thënë: *“Kush e lexon suren “El Kasas” në natën e së premtes, ai është prej miqve të All’llahut, pranë Tij dhe nën ruajtjen e Tij; ai nuk do të preket nga varfëria e nga vuajtjet as në këtë botë e as në Botën Tjetër. Atij do t’i jepet aq sa do të mbetet i kënaqur, madje edhe më shumë. Këtë njeri, All’llahu do ta martojë me njëqind gra prej hyrive të Xhennetit.”*¹

Ky shpërblim kaq i madh do të jetë për ata njerëz, që gjatë leximit të kësaj sureje qëndrojnë krah për krah me përkrahësit e Musait (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*), përkrah besimtarëve të singertë, dhe janë të gatshëm të përballen jo vetëm me faraonët, por edhe me të gjithë *Kàrùnët* e kohës, në të cilën jetojnë. Këta besimtarë nuk janë prej atyre që fshihen nëpër vrima, ose tundin kokat kur përballen me rreziqe, me probleme e me armiq, dhe as prej atyre që lejojnë që talentet e tyre të shkojnë kot ose që ato t’i shfrytëzojnë të tjerët.

Ky shpërblim është i veçantë për ata që jo vetëm e lexojnë, por edhe mendojnë rreth asaj që lexojnë dhe që e planifikojnë jetën e tyre nën dritën e kësaj sureje.

¹ “Theuàbul A’màli”, cituar sipas tefsirit “Nuruth Thekalejn”, vëll. 4, f. 106; fillimi i sures “El Kasas”.

Ajetet: 1 - 6

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

طَسَمَ ① تِلْكَ ءَايَاتُ الْكِتَابِ الْمُبِينِ ② نَتْلُوا عَلَيْكَ مِنْ نَبَأِ مُوسَى
وَفِرْعَوْنَ بِالْحَقِّ لِقَوْمٍ يُؤْمِنُونَ ③ إِنَّ فِرْعَوْنَ عَلَا فِي الْأَرْضِ وَجَعَلَ أَهْلَهَا
شِيْعًا يَسْتَضِعُّ طَائِفَةً مِنْهُمْ يُدَيِّحُ أَبْنَاءَهُمْ وَيَسْتَحْيِي نِسَاءَهُمْ إِنَّهُ كَانَ مِنَ
الْمُفْسِدِينَ ④ وَنُرِيدُ أَنْ نَمُنَّ عَلَى الَّذِينَ اسْتَضَعُّوا فِي الْأَرْضِ وَنَجْعَلَهُمْ أَئِمَّةً
وَنَجْعَلَهُمُ الْوَارِثِينَ ⑤ وَنُمَكِّنَ لَهُمْ فِي الْأَرْضِ وَنُرِيَ فِرْعَوْنَ وَهَمَانَ
وَجُنُودَهُمَا مِنْهُمْ مَا كَانُوا يَحْذَرُونَ ⑥

Me emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

“Tà, Sijn, Mijm.”

“Këto janë ajete të Librit (Kur'anit) të qartë.”

“Po të lexojmë ty (o Muhammed) prej njoftimit të Mùsait e Faraonit dhe që është i vërtetë për ata që besojnë.”

“Me të vërtetë, Faraoni u lartësua (me mendjemadhësi e tirani) në tokë, popullin e vendit (Egjiptit) ai e ndau në kasta; ai shtypte njërën kastë, ai i therte djemtë e tyre, kurse gratë e tyre i linte të jetonin; me të vërtetë, ai ishte prej shkatërruesve.”

“Ne duam t’i bëjmë mirësi të shtypurve në tokë, t’i bëjmë udhëheqës dhe t’i bëjmë ata trashëgues.”

“(Ne duam) që atyre t’u japim pushtet në tokë, kurse Faraonin, Hamanin dhe ushtrinë e atyre të dyve t’i bëjmë që të shohin atë prej së cilës ata kishin frikë.”

Komentimi

Vullneti hyjnor i All’llahut kërkon fitore

Është e katërmëdhjeta herë që në fillimet e sureve të Kur’anit ndeshemi me germa të ndara. Germat e ndara **“Tà, Sijn, Mijm”** përsëriten në tri sure dhe kjo është hera e fundit që do të ndeshemi me to në fillim të sureve të Kur’anit.

Shpesh kemi shpjeguar dhe përsëritur se në lidhje me germat e ndara ka interpretime të ndryshme dhe të shumta. Për to kemi vënë studime të mjaftueshme në fillimin e sureve: “El Bekare”, “Ali Imran” dhe “El A’ràf”.

Veç kësaj, në shumë transmetime islame është shpjeguar se germat e ndara janë shenja të shkurtuara të cilësive të të Gjithëfuqishmit, ose tregojnë vende të shenjta. Në të njëjtën kohë, ekziston edhe interpretimi i njohur, sipas të cilit me këto germa të ndara, All’llahu do të sqarojë për të gjithë, të vërtetën e madhe se ky Libër i madh qiellor, që është baza e ndryshimit të madh në historinë e njerëzimit, ky Libër që mban programet e plotësuara të

jetës së ndershme për njerëzimin, përbëhet prej këtyre germave të thjeshta të alfabetit, që mund të shqiptohen nga çdo fëmijë.

Qoftë edhe vetëm prej këtij fakti bëhet e qartë madhështia dhe rëndësia e madhe e Kur'anit, edhe pse ai shkruhet me këto germa të thjeshta që kanë mundësi t'i lexojnë të gjithë.

Mbase ardhja e këtyre germave të ndara në fillim të sures është një prej shkaqeve që e bën të domosdoshme që menjëherë pas tyre të flitet për madhësinë e Kur'anit: **"Këto janë ajete të Librit (Kur'anit) të qartë"**, ndonëse fraza *"el kitàbil mubijni"* ka ardhur edhe në kuptimin e *"Leuhi Mahfùdh"*, ashtu siç thuhet në ajetin 61 të sures "Junus": **"...as më e vogël se ajo e as më e madhe, por vetëm aq sa është në Librin e ruajtur"**; në këtë kuptim, fraza *"el kitàbil mubijni"* ka ardhur edhe në ajetin 6 të sures Hùd: **"të gjitha këto janë në Librin e njohur (Leuhi Mahfùdh)"**. Por në ajetin që është objekt studimi, fraza *"el kitàbil mubijni"* duke e krahasuar me ajetet e tjera, ka ardhur në kuptimin e Kur'anit. E tillë është edhe fraza që vjen në ajetin vijues: **"Po të lexojmë ty"**.

Në këtë ajet, Kur'ani cilësohet si "i qartë". Nga ana gramatikore, kjo fjalë e arabishtes përdoret në dy kuptime: në kuptimin e formës pësore dhe në kuptimin e formës veprorë; pra Kur'ani është vetë i qartë dhe qartëson për të tjerët. Me brendinë e tij dritëdhënëse ai bën dallimin midis të vërtetës dhe të gabuarës, shpjegon qartë rrugën e drejtë prej rrugës së devijuar.¹

¹ Ndër të tjera, shprehja *"tilke"* përdoret për të bërë shenjë për një send të largët, ashtu siç e kemi shpjeguar më sipër, me qëllim që të bëhet e qartë madhështia e këtyre ajeteve.

Pas kësaj parathënieje të shkurtër, Kur'ani Famëlartë vazhdon me tregimin e Faraonit e të Musait, duke thënë: **“Po të lexojmë ty (o Muhammed) prej njoftimit të Mùsàit e Faraonit dhe që është i vërtetë për ata që besojnë.”**.

Pra, fjala e arabishtes *“min”* – **“prej”** tregon pjesë të këtij tregimi të bukur dhe të hollësishëm. Gjithashtu, kjo parafjalë tregon se Kur'ani në këtë tregim shpalos ngjarje të mëdha, që janë në përputhje me atë çka kërkon domosdoshmëria.

Shprehja tjetër e ajetit *“bil hak'ki”* - **“i vërtetë”** tregon se në ato që thuhet këtu, s'ka asnjë lloj miti e legjende dhe se janë larg çdo të pavërtete e gënjeshtre. Leximi i Kur'anit është gjithmonë i lidhur me të vërtetën.

Shprehja e ajetit *“li kaumin ju'minùne”* – **“për ata që besojnë”** është përforsim i së vërtetës, se besimtarët e atij shekulli rënkonin nën llojet e shumta të presioneve e dhunës që ushtronin mbi ta politeistët dhe armiqtë. Besimtarët duhej ta kuptonin të vërtetën, se sado e madhe të ishte fuqia e armiqve, sado shumë që të ishin ata në numër dhe sado shumë furnizime të kishin, ata nuk duhet të ndihen as të dobësuar dhe as të shmangen nga rruga e vërtetë, sepse tek All'llahu i Lartësuar çdo gjë është lehtësisht e mundshme.

All'llahu i Lartësuar e rriti dhe e edukoi Musain (*Pagja e All'llahut qoftë mbi të!*) në prehërin e Faraonit, që ta shkatërronte dhe ta asgjësonte atë; All'llahu mundësoi që skllevërit e pafuqishëm të bëhen sundues në tokë; Ai i poshtëroi tiranët mendjemëdhenj dhe i asgjësoi ata.

All'llahu u kujdes për foshnjën e hedhur në mes të vorbullave të ujërave të lumit Nil; Ai e ruajti, e shpëtoi atë dhe mbyti në ujë mijëra prej ndjekësve të Faraonit po në të njëjtat vorbulla uji, ku Ai e shpëtoi foshnjën e hedhur në ujë. Dhe All'llahu është i Fuqishmi që t'i shpëtojë edhe besimtarët.

Qëllimi kryesor me këto ajete janë besimtarët dhe ky lexim është për ta. Besimtarët frymëzohen prej kuptimeve të këtyre ajeteve dhe me to ecin të sigurtë në rrugën e tyre në mesin e morisë së problemeve e të rreziqeve.

Në të vërtetë, kjo është një deklaratë e përgjithshme, të cilën Kur'ani e shkoqit duke thënë: **“Me të vërtetë Faraoni u lartësua (me mendjemadhësi e tirani) në tokë.”**

Në fakt, Faraoni ishte njeri i pafuqishëm dhe duke ndjekur rrugën e injorancës e të padijes së tij, ai e humbi personalitetin, madje nga mendjemadhësia arriti deri aty sa të pretendonte se ishte zot. Shprehja *“el erd”* është një shenjë që tregon tokën e Egjiptit dhe që në atë kohë ajo tokë ishte pjesa më e populluar; por shprehja *“në tokë”* tregon edhe tokën në përgjithësi.

Gjithashtu, ka mundësi që nyja shquese e emrit në gjuhën arabe *“el”*, të tregojë pikërisht tokën e Egjiptit.

Gjithsesi, për të forcuar pozitat e tij të mendjemadhësisë, Faraoni nuk ngurroi të kryente shumë krime të rënda.

Krimi i tij i parë ishte se ai e ndau popullsinë e Egjiptit, ashtu siç njofton ajeti: **“...popullin e vendit (Egjiptit) ai e ndau në kasta.”**

Përçarja e popullatës është një politikë e njohur, që tiranët e kanë ndjekur gjatë gjithë historisë. Mbi këtë politikë, ata kanë

mbështetur sundimin e tyre. Në fakt, është e pamundur që pakica, e cila në krahasim me shumicën nuk përbën ndonjë fuqi të madhe, të ushtrojë sundimin e saj mbi shumicën. Pakica e ka arritur sundimin e saj mbi shumicën vetëm duke u bazuar mbi planin e njohur “përça e sundo”. Faraoni dhe mendjemëdhenjtë e parisë së tij tmerroheshin prej frazës “Njësimit i All’llahut” dhe prej besimit se “All’llahu është Zoti Një e i Vetëm”; ata janë tmerruar gjithmonë prej këtyre dy frazave.

Tiranët kishin frikë se njerëzit do të bashkoheshin në mes tyre, prandaj për të siguruar sundimin, ata vunë në zbatim rrugën e ndarjes klasore, si të vetmen rrugë që garantonte qëndrimin e tyre në qeverisjen e vendit; ashtu siç bëri Faraoni me popullsinë e Egjiptit, ashtu siç kanë bërë dhe bëjnë faraonët në çdo kohë e në çdo vend.

Faraoni i ndau banorët e Egjiptit në “koptë” dhe në “esbatë”.

Koptët ishin banorët autentikë të Egjiptit dhe gëzonin të gjitha mjetet që sigurojnë jetë të begatshme dhe qetësi. Në duart e tyre ishin pallatet dhe të gjitha zyrat e shtetit e të qeverisë.

Esbatët ishin emigrantë prej Beni Israilëve, të cilët në atë kohë në Egjipt kishin statusin e skllëvërve e të shërbyesve dhe ishin nën sundimin e koptëve. Esbatët jetonin në varfëri dhe u privoheshin shumë gjëra. Ata bënë punët më të rënda pa pasur ndonjë përftim për veten e tyre. Shprehja “banorë” si për koptët, ashtu edhe për esbatët thuhet për faktin se Beni Israilët banonin në Egjipt prej një kohe shumë të gjatë, prandaj me të drejtë ata konsideroheshin si banorë të Egjiptit.

Kur dëgjojmë se disa faraonë kanë vënë të punojnë mijëra skllevër për ndërtimin e piramidës së njohur “Khofo”, që ndodhet në afërsi të Kajros, kryeqytetit të Egjiptit, apo kur lexojmë se mijëra skllevër e robër vdisnin nga rrahjet e rënda dhe nga puna e rëndë, e kuptojmë shumë mirë gjendjen e terrorit që sundonte në atë shoqëri.

Krimi i dytë i Faraonit ishte se ai mposhti një pjesë të popullsisë së Egjiptit me rrugë gjakësore, ashtu siç njofton Kur’ani me fjalën e tij: **“...ai i therte djemtë e tyre, kurse gratë e tyre i linte të jetonin”**.

Faraoni kishte nxjerrë një urdhër që të vëzhgohej lindja e fëmijëve të Beni Israilëve dhe meshkujt e sapolindur të thereshin; fëmijët e lindur femra, nuk i vrisnin, por i linin të rriteshin për të shërbyer më vonë në shtëpitë e koptëve.

Vallë, ç’qëllim kishte Faraoni me këtë krim makabër që bënte?

Ai kishte parë në ëndërr një shkëndijë zjarri që shkëlqeu prej *Bejti Mukad’desit* dhe që i dogji të gjitha shtëpitë e Egjiptit. Asnjë shtëpi kopti nuk mbeti pa u djegur, por ato të Beni Israilëve mbetën të paprekura. Për këtë ëndërr, Faraoni pyeti falltarët që pretendonin se i shpjegonin ëndrrat dhe ata i thanë se prej *Bejtu Mukad’desit* do të dilte një njeri, që do të vriste Faraonin dhe koptët e që do ta asgjësonte pushtetin e Faraonit.¹

¹ Për këtë çështje, lexo tefsiret: “Mexhmaul Bejan”, vëll. 7, f. 239; tefsiri “Kebijr”, vëll. 24, f. 225, fundi i ajetit që është objekt studimi.

Fjala e falltarëve ishte një shkak më shumë që Faraoni të nxirrte urdhrin që të vriteshin të gjitha foshnjët meshkuj të Beni Israilëve.¹

Ka mundësi që Profetët e mëparshëm të kishin dhënë lajmin për ardhjen e Musait (*Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!*); ata mund të kishin njoftuar edhe për karakteristikat e tij. Njoftimi për ardhjen e këtij njeriu e kishte dëshpëruar Faraonin dhe sapo mori këtë lajm, u hodh ta sfidonte atë.²

Ardhja e frazës: **“ai therte djemtë e tyre”** pas frazës **“ai shtyp njërën kastë”**, tregon se faraonët vunë në zbatim planin e tyre për të dobësuar Beni Israilët, duke i vrarë djemtë e tyre, me qëllim që ata të mos kishin mundësi të ngriheshin kundër tyre për të luftuar; kurse fëmijët femra ata nuk i vrisnin, sepse ato nuk kishin fuqi të luftonin. Veç kësaj, ata i lanë të jetonin fëmijët femra të Beni Israilëve me qëllim që kur të rriteshin, të shërbenin në shtëpitë e tyre.

Ajeti 25 i sures “El Gàfir” vërteton se plani i faraonëve për të vrarë të lindurit meshkuj dhe për të lënë gjallë foshnjët femra të Beni Israilëve, ka vazhduar edhe pas lindjes së Musait (*Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!*) ose edhe pas ardhjes së tij te Faraoni: **“Dhe kur ai i erdhi atyre me të vërtetën nga ana e Jonë, ata thanë: vrisni djemtë e atyre që i besuan atij dhe lini të jetojnë gratë e tyre, por dredhitë e mohuesve nuk qenë gjë tjetër veçse rruga e humbjes.”**.

Fraza e ajetit **“linde të jetonin gratë e tyre”** shpjegon qartë se ata këmbëngulnin që vajzat e gratë e Beni Israilëve të mos

¹ Burimi i mësipërm.

² Lexo Tefsiri “Kebijr”, vëll. 24, f. 225, fundi i ajetit që është objekt studimi.

vriteshin, me qëllim që ato të shërbenin në shtëpitë e koptëve, ose me qëllim që të shërbenin për të plotësuar orekset e tyre seksuale, ose për të dyja qëllimet njëherësh.

Në fund, ajeti mbyllet me një shprehje përgjithësuese, ku shpjegohet shkaku se përse i bëri ai këto krime. Për këtë, ajeti njofton: **“me të vërtetë, ai ishte prej shkatërruesve”**.

Me pak fjalë, e gjithë puna e Faraonit mund të përmblihet me shkatërrimin në tokë; por shkatërrim ishte edhe mendjemadhësia dhe ndarja e popullit në klasa. Shkatërrimi i tretë i Faraonit ishte tortura e mundimet e shumta që ai u shkaktonte Beni Israilëve, duke pasur si qëllim dobësimin e tyre; shkatërrim ishte edhe therja e djemve dhe lënia gjallë e femrave të tyre, me qëllim që ato të shërbenin në shtëpitë e koptëve.

Fjala e ajetit *“judheb’bihi”*- **“ai theri”** tregon se faraonët i trajtonin Beni Israilët ashtu siç trajtojnë kasapët bagëtinë. Ata kishin urdhëruar që të priteshin kokat e foshnjeve të pafajshme.

Në këtë plan kriminal të faraonëve për gjurmimin grave me barrë të Beni Israilëve, ka shumë tregime rrëqethëse. Disa kanë thënë se Faraoni kishte lëshuar një urdhër për një kontroll shumë të rreptë mbi të gjitha gratë me barrë të Beni Israilëve. Sipas këtij urdhri, gratë e Beni Israilëve nuk mund të lindnin pa praninë e një mamie prej koptëve dhe, nëse fëmija i lindur ishte djalë, menjëherë vinin policët e pallatit të Faraonit për të marrë në dorëzim *“kurbanin”* e tyre.¹

¹ Tefsiri *“Kebijr”*, vëll. 24, ajeti që është objekt studimi.

Nuk dihet me saktësi se sa arriti numri i viktimave prej foshnjeve të lindura meshkuj ndër Beni Israilët prej zbatimit të këtij plani kriminal. Disa kanë thënë se ai numër arriti në nëntëdhjetë mijë, ndërsa të tjerë kanë thënë se arriti në qindra mijë.

Ata mendonin se me këto krime barbare do t'i kundërviheshin vullnetit të pashmangshëm të All'llahut; ata mendonin se duke vrarë meshkujt, Beni Israilët nuk do të kishin mundësi të ngriheshin kundër tyre dhe kështu pushteti i tyre nuk do të asgjësohej.

Në vijim vjen ajeti tjetër për të njoftuar se vullneti i All'llahut ishte që të pafuqishmit të përfshiheshin në dashamirësinë dhe në bujarinë e Tij: **“Ne duam t'i bëjmë mirësi të shtypurve në tokë”**; Ne duam që ata të përfshihen në kujdesin Tonë dhe në dhuratat Tona; Ne duam që në dorën e tyre të jetë qeveria dhe ata të kenë në dorë drejtimin e punëve: **“t'i bëjmë udhëheqës dhe t'i bëjmë ata trashëgues”**.

Sa lart qëndrojnë këto ajete në mënyrën e të shprehurit dhe sa shpresa të mëdha që ngjallin! Këto dy ajete kanë ardhur me foljen në kohën e tashme, e cila tregon vazhdueshmëri. Në mënyrë që askush të mos mendojë se këto dy ajete janë vetëm për të pafuqishmit e Beni Israilëve dhe për qeverinë e faraonëve, ajeti fillon me frazën **“Ne duam t'i bëjmë mirësi”**.

Faraoni kishte për qëllim të shkaktonte rrëmujë ndër Beni Israilët; ai synonte që me këto raprezalje të papara, të thyente vullnetin dhe të dobësonte fuqinë e tyre, por Zoti deshi t'i ndihmonte që ata të ishin të fuqishëm.

Faraoni kishte për qëllim që pushteti të ishte përgjithmonë në dorën e mendjemëdhenjve, por Zoti deshi që pushteti të ishte në dorën e të pafuqishmëve dhe u bë ashtu siç ishte vullneti i Tij.

Siç e theksuam më lart, fjala e ajetit “*nemun’ne*”, do të thotë dhënie e mirësive. Me mirësitë nënkuptohet edhe përbuzja për palën e shtypësve, e cila pa dyshim që është e poshtëruar.

Në këto dy ajete, All’llahu i Lartësuar shfaq vullnetin e dëshirën e Tij në lidhje me të pafuqishmit dhe përmend pesë gjëra që janë të lidhura dhe të përafërta me njëra-tjetrën:

E para: “nemun’ne” - duam të bëjmë që ata të kenë dhunti dhe mirësi të shumta etj.

E dyta: “t’i bëjmë ata prijës”.

E treta: “dhe t’i bëjmë ata trashëgues”.

E katërta: “Dhe që atyre t’u japim mundësi në tokë”, pra: Ne bëjmë që ata të jenë sundues në tokë dhe pushteti dhe fuqia të jenë në dorën e tyre.

E pesta: i paralajmëron armiqtë dhe u thotë se me gjithë përgatitjen e mundësitë që kanë, ata do të përballen me fuqinë e erërave dhe përfundimi do të jetë në favorin e të pafuqishmëve: **“kurse Faraonin, Hamanin dhe ushtrinë e atyre të dyve do të bëjmë që të shohin atë prej së cilës ata kishin frikë”.**

Kjo është dashamirësia, butësia e kujdesi i All’llahut për të pafuqishmit. Por kush janë këta të pafuqishëm? Cilat janë cilësitë e tyre? Për të gjitha këto do të flasim në vijim.

Emri “Hàmàn” i përmendur në këtë ajet, është emri i ministrit të Faraonit. Ky ministër kishte një ndikim aq të madh, sa në ajet thuhet se ushtria e Egjiptit ishte nën komandën e Faraonit dhe të këtij. (Shpjegime më të zgjeruara në lidhje me statusin e Hâmânit, do të jepen në komentin e ajetit 38 të kësaj sureje).

Hulumtime

1- Qeveria botërore e të pafuqishmëve

Më sipër thamë se ajetet që janë objekt studimi nuk flasin vetëm për një periudhë kohe të caktuar dhe nuk janë të veçanta vetëm për Beni Israilët. Këto ajete qartësojnë një ligj të përgjithshëm veprues në të gjitha kohët dhe për të gjithë popujt e kombet: **“Ne duam t’i bëjmë mirësi të shtypurve në tokë, t’i bëjmë udhëheqës dhe t’i bëjmë ata trashëgues.”**.

Ky ajet përgëzon për triumfin e së vërtetës mbi të gabuarën dhe të besimit mbi mohimin.

Ajeti është përgëzues për të gjithë njerëzit e lirë, të cilët duan drejtësi, që e duan qeverinë e së drejtës dhe mposhtjen e padrejtësisë e të dhunës.

Qeveria e Beni Israilëve dhe asgjësimi i sundimit të faraonëve, nuk janë më shumë se një model për realizimin e këtij vullneti hyjnor, por shembulli më i plotësuar i këtij modeli është qeveria që krijoi Profeti i Islamit së bashku me shokët e tij të nderuar, natyrisht pas shfaqjes e forcimit të Islamit. Qeveria e Beni

Israilëve, për të cilën flet ajeti i nderuar, ishte qeveria e këmbëzbathurve, e të përbuzurve, e besimtarëve të dhunuar nga padrejtësitë e nga mizoritë e politeistëve; ajo ishte qeveria e atyre që urreheshin e shpërfilleshin me tallje prej faraonëve të kohës së tyre, ishte qeveria e atyre që rënkonin nën zgjedhën e mizorëve të krerëve mohues e adhures të idhujve.

Në fund, me duart e atyre të pafuqishmëve, All'llahu hapi portat e pallateve të mbretërve e të perandorëve, i zbriti ata nga froni i pushtetit dhe i fuqisë dhe e zhyti në llucë mendjemadhësinë e tyre.

Dhe shembulli më konkret dhe me kuptimin më të gjerë do të jetë sundimi i qeverisë së të drejtës dhe të së vërtetës mbi të gjithë sipërfaqen e globit tokësor, sundimi i asaj qeverie që do të ngrihet nën udhëheqjen e Mehdiut.

Ajetet që janë objekt studimi japin përgëzimin më të qartë për shfaqjen e kësaj qeverie. Në transmetimet e ardhura me rrugët e Ehli Bejtit në lidhje me interpretimin e këtij ajeti, lexojmë shenja që tregojnë shfaqjen e kësaj dukurie madhështore.

Edhe në “Nehxhul Belaga” lexojmë fjalën e Imam Aliut, i cili ka thënë: *“Pa dyshim që kjo botë do ta tregojë dashurinë e saj ndaj nesh, ashtu siç e shfaq egërsira dashurinë ndaj të voglit të saj”*, dhe pastaj ka lexuar ajetin: **“Ne duam t’i bëjmë mirësi të shtypurve në tokë.”**¹

Natyrisht që qeveria botërore e Mehdiut (*Paqja qoftë mbi të!*) do të formohet afër fundit të botës. Ajo nuk është pengesë për

¹ “Nehxhul Belaga”, fjalët e shkurtra, nr. 209.

ekzistencën e qeverive islame të përmasave të kufizuara, të ngritura prej të pafuqishmëve në luftën e tyre kundër mendjemëdhenjve. Kur të plotësohen kushtet për të tilla qeveri islame, atëherë premtimi i All'llahut dhe vullneti I Tij do të bëhen realitet në lidhje me atë qeveri të drejtësisë botërore dhe me fitoren e saj.

2- Kush janë të pafuqishmit dhe kush janë mendjemëdhenjtë?

Fjala *"el mustad'afu"* rrjedh prej rrënjës së saj *"da'fun"* – **"pafuqi"** por meqenëse në këtë ajet ka ardhur në formën e foljes që tregon gjendjen, ajo përdoret për njeriun që nuk ka me se ta shuajë urinë, çka e bën atë të pafuqishëm.

Me fjalë të tjera, në këtë ajet, *"i pafuqishëm"* nuk është njeriu që e ka humbur fuqinë fizike. Jo, këtu fjala *"i pafuqishëm"* ka fuqi e forcë fizike, por gjendet nën shtypjen e mizorëve dhe të tiranëve. Megjithatë, ky *"i pafuqishëm"*, ndonëse i ka duart e këmbët të prangosura, ai as nuk hesht e as nuk dorëzohet, por punon për të thyer prangat dhe për të fituar lirinë; ai i sfidon tiranët e mendjemëdhenjtë dhe e ndihmon drejtësinë e të vërtetën.

All'llahu u ka premtuar njerëzve të tillë mirësi dhe mundësi që të ndërtojnë qeverinë e tyre në këtë tokë, por këtë mundësi Ai nuk ua jep frikacakëve, të cilët nuk guxojnë të bëjnë as kundërshtimin më të vogël ndaj mizorisë së tiranëve. Vallë, si do të reagojnë frikacakët, kur prej tyre të kërkohet të luftojnë, apo kur të vijë çasti i sakrificës dhe i martirizimit?!

Beni Israilët mundën të marrin në dorë sundimin. Ata i zhveshën faraonët nga pushteti dhe u bënë trashëgimtarë të atij pushteti. Kjo ndodhi vetëm atëherë kur ata u bashkuan rreth Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) dhe i mobilizuan fuqitë e forcat e veta, duke formuar një radhë kompakte. Gjithashtu, kjo u bë realitet vetëm atëherë kur ata punuan për ta plotësuar atë besim që u kishte mbetur prej besimit të trashëguar nga gjyshi i tyre i parë, Ibrahim, miku i All'llahut, si dhe kur hoqën dorë nga mitet e nga mendimet e tyre të gabuara e u ngritën të luftojnë së bashku me Musain (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*).

“Të pafuqishmit” janë disa llojesh: të pafuqishëm nga ana mendore, kulturore, ekonomike, politike ose nga ana morale, por Kur’ani e vë theksin më shumë mbi “pafuqinë” politike dhe morale. Mendjemëdhenjtë tiranë kanë punuar gjithmonë për t’i tërhequr konkurentët e tyre drejt pafuqisë ideore e kulturore, çka ua bën më të lehtë t’i çojnë ata drejt pafuqisë ekonomike. Kështu, konkurrentëve të tyre nuk do t’u mbetet më as fuqi e as mundësi, madje as do të mendojnë për të ngritur krye dhe për të marrë në dorë pushtetin.

Në Kur’anin Famëlartë, fjala “të pafuqishëm” ka ardhur në pesë vende dhe në përgjithësi tregon besimtarët që rënkojnë nën shtypjen e tiranëve.

Në ajetin 75 të sures “En Nisa”, Kur’ani u bën thirrje “të pafuqishmëve” për të luftuar në rrugën e All'llahut: **“Përse nuk luftoni në rrugën e All'llahut (që të shpëtoni) të pafuqishmit, burra, gra e fëmijë, të cilët lutën: o Zoti ynë, na nxirr prej këtij vendi (Mekës), banorët e të cilit janë mizorë dhe na jep nga ana Jote një kujdestar dhe ndihmues.”**

Kurse në ajetin 97 të së njëjtës sure, pra të sures “En Nisà”, flitet për ata që ndihmuan mohuesit dhe kështu i bënë padrejtësi vetes së tyre; ndërkaq ata pretendojnë se janë të pafuqishëm, por nuk e lanë vendin e të emigrojnë në rrugën e All’llahut. Për këtë, Kur’ani ua mohon atyre këtë “pafuqi” dhe thotë: **“Atyre që u marrin shpirtin engjëjt duke qenë të padrejtë ndaj vetvetes, u thanë: si ishte puna juaj? Ata thanë: ishim të pafuqishëm në atë tokë; ata (melekët) thanë: a nuk ishte e gjerë toka e All’llahut që ju të emigronit në të? Vendi i tyre është Xhehennemi dhe sa vend i keq është ai!”**.

Gjithsesi, kudo ku përmenden “*të pafuqishmit*”, Kur’ani Famëlartë i mbron dhe i përmend ata për të mirë. Në Kur’an thuhet se “*të pafuqishmit*” janë besimtarët që rënkojnë nën shtypjen e mendjemëdhenjve, janë ata që luftojnë në rrugën e All’llahut dhe ata që punojnë me seriozitet. Prandaj ata ndodhen nën kujdesin, butësinë dhe dashamirësinë e All’llahut të Lartësuar.

3- Rruga që kanë ndjekur mendjemëdhenjtë përgjatë historisë

Nuk është vetëm Faraoni që i masakroi fëmijët meshkuj të Beni Israilëve dhe i la të jetonin fëmijët e tyre femra. Me këtë masakër, ai kishte për qëllim t’i dobësonte e t’i poshtëronte Beni Israilët. Gjatë gjithë historisë flitet se tiranët kanë ndjekur të njëjtën rrugë dhe e kanë ushtruar dhunën në të njëjtën formë. Ata kanë punuar me ngulm për të hequr mundësitë e fuqitë e njerëzve me çdo mjet. Kur nuk kanë pasur mundësi të vrisnin burrat, ata kanë tentuar të vrasin “burrërinë” dhe ta shuajnë shpirtin e vendosmërisë nëpërmjet përhapjes së korrupsionit, drogave,

prostitucionit, punëve të ulëta, perversitetit seksual, shtimin e pijeve dehëse dhe të kumarit, me qëllim që të kishin mundësi të vazhdonin sundimin dhe shtypjen e njerëzve.

Profetët e All'llahut, dhe në mënyrë të veçantë Profeti i Islamit, punuan për të zgjuar forcat e fjetura dhe për ta mbushur rininë me mësimet e tyre. Ata i çliruan “të pafuqishmit” prej robërisë e poshtërimit; ata i kushtuan një vëmendje të veçantë edhe grave, të cilat dhanë shembuj trimërie, vendosmërie e zgjuarsie dhe qëndruan në një radhë me burrat kundër mendjemëdhenjve.

Ajetet: 7 - 9

وَأَوْحَيْنَا إِلَىٰ أُمِّ مُوسَىٰ أَنْ أَرْضِعِيهِ ۖ فَإِذَا خِفَتْ عَلَيْهِ فَأَلْقَاهُ فِي الْقَيْمِ وَلَا تَخَافِ
وَلَا تَحْزَنِي ۚ إِنَّا رَادُّوهُ إِلَيْكَ وَجَاعِلُوهُ مِنَ الْمُرْسَلِينَ ﴿٧﴾ فَالْتَقَطَهُ ءَالُ فِرْعَوْنَ
لِيَكُونَ لَهُمْ عَدُوًّا وَحَزَنًا ۖ إِنَّ فِرْعَوْنَ وَهَمَانَ وَجُنُودَهُمَا كَانُوا خَاطِئِينَ ﴿٨﴾
وَقَالَتِ امْرَأَتُ فِرْعَوْنَ قُرْتُ عَيْنِي لِي وَلَكَ ۖ لَا تَقْتُلُوهُ عَسَىٰ أَنْ يَنْفَعَنَا أَوْ
نَتَّخِذَهُ وَلَدًا وَهُمْ لَا يَشْعُرُونَ ﴿٩﴾

“Ne e inspiruam nënën e Mûsàit: mëkoje atë me qumështin e gjirit dhe kur të kesh frikë për atë, atëherë hidhe në ujë dhe as mos u frikëso e as mos u dëshpëro, Ne do ta kthejmë atë për ty dhe do ta bëjmë atë prej të Dërguarve.”

“Atë (Mûsàin) e gjeti familja e Faraonit që të ishte për ata armik e dëshpërim; në të vërtetë, Faraoni, Hamàni dhe ushtria e atyre të dyve gabuan rëndë.”

“Gruaja e Faraonit tha: gëzim i madh për mua dhe për ty, mos e vrisni atë, mbase na sjell dobi, ose e adaptojmë për fëmijë; por ata nuk e kuptojnë.”

Komentimi

Në pallatin e Faraonit

Me qëllim që të japë një panoramë të gjallë për fitoren e të pafuqishmëve mbi mendjemëdhenjtë, Kur'ani Famëlartë e shtjellon tregimin e Musait e të Faraonit dhe flet për kohën kur Musai ishte fizikisht i pafuqishëm, kurse Faraoni ishte në kulmin e fuqisë. Por All'llahu kishte vendosur që të zbatohej vullneti i Tij kundër tiranëve në mënyrën më të bukur.

Për këtë fazë të jetës së Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), Kur'ani njofton: **“Ne e inspiruam nënën e Musait: mëkoje atë me qumështin e gjirit dhe kur të kesh frikë për atë, atëherë hidhe në ujë dhe as mos u frikëso e as mos u dëshpëro; Ne do ta kthejmë atë për ty dhe do ta bëjmë atë prej të Dërguarve.”**.

Ky ajet me kaq pak fjalë pëmbledh dy urdhra për veprim, dy ndalesa dhe dy përgëzime.

Pushteti i Faraonit dhe qeveria e tij mizore kishin planifikuar kryerjen e masakrës së padëgjuar më parë. Plani i tyre për therjen e foshnjeve të sapolindura të Beni Israilëve ishte i studiuar mirë. Sipas këtij plani, nuk duhej të mbetej gjallë asnjë fëmijë mashkull i Beni Israilëve, prandaj edhe mamitë që do të asistonin në lindjen e grave të tyre, caktoheshin prej familjes së Faraonit.

Por ndodhi që njëra prej atyre mamive të kishte marrëdhënie të mira me nënën e Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi*

të!). Barra e nënës së Musait ishte e fshehur, aq sa ajo nuk dukej se ishte shtatzënë. Kur e ndjeu se ishte në pragun e lindjes, ajo e njoftoi mikeshën e saj, maminë. Kur lindi Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), sytë e tij rrezatonin dritë. Mamia kopte u trondit prej asaj drite dhe në zemrën e saj u vulos dashuria për atë fëmijë. Ajo u kthye nga nëna e Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) dhe i tha: “Duhet të lajmëroj njerëzit e Faraonit për këtë fëmijë që lindi dhe ata do të vijnë ta vrasin. Por unë nuk mund ta bëj këtë, sepse e dua shumë dhe nuk do të lejoj që t'i preket asnjë fije floku. Bëj kujdes dhe ruaje këtë fëmijë! Mendoj se në fund, ky do të jetë armiku ynë i parashikuar.”.

Pastaj mamia doli nga shtëpia e nënës së Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), por e panë disa policë të Faraonit, të cilët folën ndërmjet tyre për të hyrë në atë shtëpi. Por motra e Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) i njohu policët dhe e dëgjoi bisedën që ata bënë me njëri-tjetrin. Ajo nxitoi për tek e ëma dhe e njoftoi që të përgatitej për këtë punë. Nëna u hutua dhe nuk dinte si të vepronte. Ashtu siç ishte, e mbështolli foshnjen e saj, Musain (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) me pelena dhe e flaku në furrë. Ndërkaq aty arritën spiunët dhe policët, të cilët filluan të kontrollonin, por nuk gjetën asgjë tjetër përveç furrës së ndezur. Pastaj ata e pyetën nënën e Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) për shkakun që kishte hyrë mamia në shtëpinë e saj. Ajo iu përgjigj se mamia ishte shoqja e saj dhe se kishte ardhur aty për vizitë. Kështu, policët e spiunët dolën jashtë të zhgënjyer.

Më pas, nëna e Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) erdhi në vete dhe pyeti të bijën për vëllain e saj, por ajo i tha se nuk dinte gjë për të. Në këto fjalë e sipër u dëgjua e qara e foshnjes brenda furrës. Nëna shkoi me vrap te furra dhe pa se Musai ishte shëndoshë e mirë. All'llahu e kishte ftohur zjarrin e furrës. Furrën

e ndezur e të nxehtë, Ai e kishte bërë vend sigurie për Musain (*Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!*). Atë e shpëtoi All'Ilahu, e shpëtoi Ai që kishte shpëtuar Ibrahimin, mikun e All'Ilahut, prej zjarrit të Nemrudit. Nëna e nxorri menjëherë të voglin e saj prej furrës së ndezur shëndoshë e mirë.

Por nëna e Musait (*Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!*) nuk ishte e qetë, sepse spiunët shkonin lart e poshtë dhe kontrollonin të gjitha shtëpitë me imtësinë më të madhe. Në këtë gjendje, ishte e pashmangshme që ata të mos i dëgjonin të qarat e foshnjes së porsalindur.

Ndonëse ishte një situatë e rrezikshme, e ëma e Musait ndjente siguri. Kjo siguri i erdhi asaj prej All'Ilahut, kështu që do të bëhej patjetër realitet. Nëna e mbështolli foshnjen me një rrobë pune të veten dhe vendosi që të voglin e saj ta hidhte në ujërat e lumit Nil.

Ajo shkoi te një zdrukthëtar egjiptian dhe e porositi që t'i punonte një arkë të vogël. Zdrukthëtari e pyeti se për çfarë i duhej dhe ajo ngaqë nuk e kishte zakon të gënjente, i tha atij të vërtetën. Me ta mësuar këtë lajm, zdrukthëtari kopt vendosi të njoftonte policët dhe u nis menjëherë drejt tyre. Por papritmas atë e kapi një frikë e madhe. Fjalët i ngatërroheshin në gjuhë dhe sa herë që mundohej t'u thoshte atyre diçka, e kishte të pamundur të fliste. Atëherë, ai filloi t'ua bënte atyre me shenja, por policët menduan se ai po tallej me ta, prandaj e përzunë duke e rrahur. Sapo hyri në dyqanin e tij, zdrukthëtari u kthye në gjendjen normale dhe kështu shkoi te policët për herë të dytë që t'i lajmëronte ata. Por edhe kësaj here i ndodhi si herën e parë. Ai nuk fliste dot, nuk mund të nxirrte nga goja asnjë fjalë. Më në fund, zdrukthëtari e

kuptoi se kjo ishte një punë hyjnore dhe një sekret i fshehtë. Ai e punoi arkën dhe nëna e Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) u largua me të ndër duar. Në kohën kur njerëzit ishin ende në gjumë, ajo doli nga shtëpia, duke mbajtur në duar arkën, në të cilën ajo kishte fshehur djalin e saj, Musain (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*). Ajo shkoi në breg të lumit Nil, ku i dha të pinte foshnjes derisa u ngop. Pastaj, ajo e lëshoi arkën në ujë. Valët e lumit e morën arkën e vogël dhe e larguan prej bregut. Nëna e Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) e shihte se si largohej arka e vogël dhe, për një çast ajo ndjeu se zemra iu nda prej trupit dhe u bashkua me valët e ujit të lumit. Mëshira e butësia e All'llahut bënë që ajo ta mblidhte veten dhe ta forconte zemrën; përndryshe, ajo do të kishte vënë kujën dhe kështu do të zbulohet e fshehta e saj.

Askush nuk mund ta përfytyrojë se ç'ndjente zemra e saj në ato çaste!

Askush nuk mund ta përfytyrojë se sa e tronditur dhe e frikësuar ishte kur ajo e hodhi foshnjen e saj në ujërat e lumit Nil!

Në lidhje me këtë ndodhi, poetesha Pervin I'tisàmij ka shkruar shumë vargje mallëngjyese, që e përshkruajnë me afërsi gjendjen e asaj nëne që rrinte në këmbë në bregun e lumit, duke e vështruar arkën në mesin e vorbullave të ujit:

Nëna e Musait, kur hodhi fëmijën e saj,

sipas frymëzimit që i erdhi prej Zotit të qiellit

Ajo shikon Nilin që rrjedh me shpejtësi

Ah, sikur ta dish me të vërtetë gjendjen e saj!

*Në zhurmën e valëve ka një britmë,
valëzimet e dallgëve lëvizin bimët ujore.*

* * *

*Ajo i flet atij në heshtje: "Djali im,
qysh të merr ty kjo varkë pa timonier".
Nëse beson në Atë, Zotëruesin e butësisë,
kush tjetër mëshiron përveç Atij?*

*Asaj i erdhi frymëzimi: "Prit dhe lëre
mendimin e gabuar e iluzionin e rremë.
Musai po shkon në shtëpi.
Kije frikë All'llahun dhe mos u nxito!
Ne e takuam Atë që takove ti.
Me një dorë Ai kujdeset dhe mos u bëj injorante
Shushurima e ujit është bërë djepi i tij
Në një madhështi njerëzore nëse më lutesh Mua.*

* * *

*Vala e ngritur e ujit është dashuri për atë
Më shumë sa mund të jetë nëna e babai,
asnjë lumë nuk rrjedh kot,*

shkaku është urdhri i All'llahut.

* * *

*Ai urdhëron detin dhe ai bëhet i egërsuar,
për Atë, i bindur shfryn tufani,
bota e ekzistencës është prej shenjave të Tij,
të gjitha sendet vetëm Atë madhërojnë.*

* * *

Ku shkon? Lëre atë!

Për të ka një Zot më të mirë, që e ushqen dhe e furnizon.

Por çfarë ndodhi në pallatin e Faraonit?

Në transmetime thuhet se Faraoni kishte një vajzë të sëmurë dhe nuk kishte fëmijë tjetër përveç saj. Kjo vajzë vuante nga disa sëmundje të rënda dhe ilaçet nuk i bënë asnjë dobi. Faraoni kishte kërkuar ndihmën e falltarëve, të cilët i kishin thënë se jargët që do të dilnin prej gojës së njeriut që do të vinte nga uji, do të ishin shërim për vajzën e tij. Faraoni dhe gruaja e tij, Asija, rrinin në pritje që kjo ngjarje të ndodhte një ditë prej ditësh. Rastësisht, ata panë me sytë e tyre një arkë që e përplasin dallgët e ujit të Nilit. Faraoni i urdhëroi njerëzit e tij që t'ia sillnin arkën për të parë se çfarë kishte brenda saj.

Arkën e panjohur e të fshehtë e vunë para Faraonit, por askush nuk mundi ta hapte atë.

Do të ishte vetë Faraoni, ai që do ta hapte atë arkë. Musai (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) do të shpëtohej me dorën e vetë Faraonit! Sapo sytë e Asijes panë djalin, prej tij rrezatoi një dritë që ia ndriçoi asaj zemrën. Dashuria për atë fëmijë hyri në zemrat e të gjithëve, sidomos në zemrën e gruas së Faraonit. Kur vajza e Faraonit u shërua prej jargëve të gojës së atij fëmije, dashuria për të u shtua edhe më shumë.¹

Në lidhje me këtë çështje, në Kur'an thuhet: **“Atë (Mùsàinë) e gjeti familja e Faraonit që të ishte për ata armik e dëshpërim.”**.

Fjala e ajetit *“iltekata”* është marrë prej rrënjës *“iltikàt”* që në origjinën e saj do të thotë: arritja te një send pa mundim e pa bërë rrugë. Pikërisht për këtë shkak, sendet e gjetura në gjuhën arabe quhen: *“luktah”* në kuptimin e një sendi të gjetur rastësisht.

Është interesant fakti se familja e Faraonit nuk e mori arkën me foshnjen që kishte sjellë uji, që më pas të ishte një armik i madh për ta, por ashtu siç tha gruaja e Faraonit, e morën që të ishte shpresë e gëzim për ta.

Por dihet se si ishte rezultati përfundimtar. Madje për frazën e ajetit **“Atë (Mùsàinë) e gjeti familja e Faraonit që të ishte”**, gjuhëtarët dhe letrarët kanë thënë se germa *“l”* në fjalën *“iltekata”* nuk është për të treguar dënim dhe nuk është shkakësor. Por është shumë domethënës fakti që brendia e kësaj shprehjeje tregon se i Gjithëfuqishmi e kishte për qëllim të shpaloste fuqinë e Tij dhe të tregonte se si grupi i faraonëve i shfrytëzoi të gjitha

¹ Kjo pjesë e këtij transmetimi është përcjellë prej Ibni Ab'bàsit dhe gjendet në Tefsiri “Kebijr”, vëll. 24, f. 227. Ka edhe transmetime të tjera që flasin për këtë ndodhi. Transmetimi i mësipërm gjendet edhe në tefsiret “Rùhul Meànij” dhe “Mexhmaul Bejan”.

mundësitë për të vrarë vetëm njërin prej fëmijëve meshkuj, duke urdhëruar për këtë vrasjen e të gjithë fëmijëve të Beni Israilëve. Por ja që fëmija që ata donin të vrisnin, do të rritej në gjirin e familjes së Faraonit, si biri i tyre më i dashur.

Gjithashtu, nga brendia e ajetit kuptohet se “kapësi” i arkës nuk ishte një njeri i vetëm, por disa anëtarë të familjes së Faraonit. Ky fakt tregon në vetvete se ata ishin në pritje të kësaj ndodhie.

Më pas, ajeti mbyllet me thënien: **“në të vërtetë, Faraoni, Hamani dhe ushtria e atyre të dyve gabuan rëndë”**.

Ata gabuan në të gjitha drejtimet. A mund të kishte gabim më të madh sesa shmangia e tyre nga rruga e drejtësisë dhe e së vërtetës, qysh kur ndërtuan bazat e sundimit të tyre mbi mizorinë e mbi idhujtarinë?!

A mund të kishte gabim më të madh sesa therja e mijëra foshnjeve të Beni Israilëve, vetëm që të vrisnin Musain (*Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!*)? Porse All'Ilahu, i Gjithëfuqishmi e la atë foshnje në duart e tyre dhe u tha: *Merreni armikun tuaj dhe kujdesuni që ai të rritet te ju!*.¹

Nga ajeti i dytë mësojmë se pati një grindje midis Faraonit dhe gruas së tij. Madje ka mundësi që gjatë kohës kur ata po shkëmbenin fjalë me njëri-tjetrin, disa prej pasuesve të Faraonit

¹ Ràgibi në fjalorin e tij “Mufredàtu el Fàdhil Kur’ànì”, shpjegon dallimin midis fjalëve “*el khàtiu*” dhe “*el mukhtiu*”. Të dyja këto tregojnë njeriun që ka gabuar, por ashtu siç shpjegon Ràgibi, fjala “*el khàtiu*” tregon personin që ndërmerr një punë dhe nuk del prej fjalës së dhënë, por vazhdon me dashje në gabimin që bën; kurse fjala “*el mukhtiu*” përdoret për atë person që vendos ta bëjë një punë, por ai del prej fjalës së dhënë kur e sheh se po gabon; ai heq dorë menjëherë dhe nëse ka mundësi, e ndreq punën e keqe.

kishin qëndruar mbi kokën e foshnjes për ta vrarë. Në lidhje me këtë çast, Kur'ani Famëlartë njofton: **“Gruaja e Faraonit tha: gëzim i madh për mua dhe për ty, mos e vrisni atë, mbase na sjell dobi, ose e adaptojmë për fëmijë.”.**

Faraoni u gjend në mes përfytyrimesh të shumta rreth kësaj foshnjeje, duke shtuar edhe shenja të tjera që kishin lidhje me të, siç qe futja e tij brenda në arkë dhe hedhja e arkës në mesin e valëve të lumit Nil. Fëmija ishte prej Beni Israilëve. Faraoni ishte i frikësuar nga mendimi se pushteti i tij do të asgjësohej prej këtij fëmije. Zemrën e tij e kishte mbërthyer një makth i fortë dhe ishte aq i brengosur, saqë në shpirtin e tij ra një errësirë. Ai donte që edhe mbi këtë foshnje të zbatohej ligji i tij kriminal.

Në këtë mendim, Faraonin e mbështetën edhe ndjekësit e tij servilë. Ata i sugjeruan Faraonit që edhe ky fëmijë duhej të therej. Sipas tyre, nuk kishte asnjë argument që ky ligj të mos zbatohej kundër tij.

Por gruaja e Faraonit, e cila nuk kishte lindur fëmijë mashkull dhe zemra e saj nuk ishte e njëjtë me ato të nëpunësve të pallatit, i doli përpara Faraonit e mbështetësve të tij dhe i ndaloi që ta vrisnin foshnjen.

Shërimi i vajzës së Faraonit me jargët që dilnin prej gojës së Musait, është një argument më shumë që shpjegon triumfin e Asijes në këtë krizë.

Kur'ani Famëlartë e mbyll këtë ajet me një fjali autoritare dhe kuptimplotë: **“por ata nuk e kuptojnë”.** Ata nuk e kuptojnë se urdhri i All'llahut zbatohet dhe vullneti i Tij nuk mund të mposhtet. All'llahu kishte vendosur që ky fëmijë të rritej në

vendin më të rrezikshëm dhe vullnetin e Tij nuk mund ta kundërshtojë e ta mposhtë askush.

Hulumtime

Plani i mahnitshëm i All'llahut

Shfaqje e fuqisë nuk do të thotë se kur All'llahu vendos të shkatërrojë një popull tiran dërgon kundër tij ushtritë e qiellit e të tokës, që të mbysin e të shkatërrojnë tiranët mizorë.

Shfaqje e fuqisë do të thotë që vetë tiranët e mendjemëdhenjtë ta shkatërrojnë veten me duart e tyre. Për këtë, All'llahu i frymëzon ata në zemër që ta hedhin veten në gropën që kanë hapur për të tjerët; Ai i frymëzon që të ndërtojnë një burg me duart e tyre e të vdesin vetë në të; Ai i frymëzon që të ngrejne trekëmbëshat e të ekzekutohen vetë në to. Kështu i ndodhi Faraonit dhe tiranëve të tjerë. Rritja e shpëtimi i Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) në të gjitha fazat e jetës së tij u bë me duart e tyre.

- Mamia që asistoi në lindjen e Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) ishte kopte.

- Zdrukthëtari që punoi arkën, në të cilën e ëma fshehu Musain (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), ishte kopt.

- Ata që e kapën arkën në ujë ishin prej familjes së Faraonit.

- Edhe kapakun e arkës e hapi me duart e tij vetë Faraoni, ose gruaja e tij.

- Vendi i sigurtë dhe i qetë, ku u rrit Musai (*Paqja e All'lahut qoftë mbi të!*), ishte pallati i Faraonit.

Në këtë formë shfaqet fuqia e All'lahut të Lartësuar.

Ajetet: 10 - 13

وَأَصْبَحَ فُؤَادُ أُمِّ مُوسَىٰ فَرِغًا ۖ إِن كَادَتْ لَتُبْدِي بِهِ ۚ لَوْلَا أَن رَّبَطْنَا عَلَىٰ قَلْبِهَا
لِتَكُونَ مِنَ الْمُؤْمِنِينَ ﴿١٠﴾ وَقَالَتْ لِأُخْتِهِ ۖ فُصِّيه ۖ فَبَصُرَتْ بِهِ ۚ عَن جُنُبٍ وَهُمْ
لَا يَشْعُرُونَ ﴿١١﴾ ۖ وَحَرَّمْنَا عَلَيْهِ الْمَرَاضِعَ مِن قَبْلُ فَقَالَتْ هَلْ أَدُلُّكُمْ عَلَىٰ
أَهْلِ بَيْتٍ يَكْفُلُونَهُ ۖ لَكُمْ وَهُمْ لَهُ ۖ نَصِْحُونَ ﴿١٢﴾ فَرَدَدْنَاهُ إِلَىٰ أُمِّهِ ۚ كَىٰ تَقَرَّ
عَيْنُهَا وَلَا تَحْزَنَ ۚ وَلِتَعْلَمَ أَنَّ وَعْدَ اللَّهِ حَقٌّ وَلَكِنَّ أَكْثَرَهُمْ لَا يَعْلَمُونَ ﴿١٣﴾

“Zemra e nënës së Mùsait mbeti e zbrazur (nuk mendonte asgjë tjetër përveç fëmijës) dhe gati sa nuk e zbuloi atë, sikur Ne të mos ia forconim asaj zemrën që të ishte prej besimtarëve.”

“Ajo (nëna) i tha motrës së tij: vëzhgoje, ajo e ndiqte nga larg dhe ata nuk e kuptonin (që ajo ishte motra e fëmijës).”

“Ne ia ndaluan atij të pinte tek mëndeshat dhe ajo (motra e Mùsait) tha: a doni t’u tregoj një familje që do të kujdeset për atë dhe që do të jenë të sigurtë ndaj tij?”

“Dhe Ne e kthyem atë te nëna e tij që asaj t’i kënaqej syri e të mos dëshpërohej dhe që të kuptojë se premtimi i All’llahut është i sigurtë, por shumica e atyre (njerëzve) nuk e dinë.”

Komentimi

Kthimi i Musait në prehërin e nënës së tij

Në këto ajete shpaloset një pamje e re. Pasi hodhi fëmijën e saj në ujërat e lumit Nil, dëshpërimi i nënës së Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) ishte aq i madh, saqë i dukej sikur po i dilte zemra nga vendi për shkak të ndarjes prej të voglit të saj. Ajo zemër, që më parë ishte e mbushur me dashurinë e nënës për fëmijën, tani mbeti e zbrazur.

Ajo ishte gati të thërriste me të madhe nga thellësia e shpirtit dhe të tregonte të gjitha të fshehtat e veta, por All'llahu me dashamirësinë e me butësinë e Tij ishte pranë saj, ashtu siç njofton Kur'anî Famëlartë: **“Zemra e nënës së Mûsait mbeti e zbrazur (nuk mendonte asgjë tjetër përveç fëmijës) dhe gati sa nuk e zbuloi atë, sikur Ne të mos ia forconim asaj zemrën që të ishte prej besimtarëve.”**.

Fjala e ajetit *“fârigan”* do të thotë: **e zbrazur**. Qëllimi i saj në këtë ajet është që të tregohet se në zemrën e nënës së Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) s'kishte mbetur gjë tjetër përveç kujtimit të të birit. Disa interpretues të Kur'anit mendojnë se kjo fjalë tregon se zemra e nënës së Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) mbeti e zbrazur për shkak të dëshpërimit e brengës së madhe, ose për shkak të frymëzimit dhe të përgëzimeve që kishte marrë më parë ajo. Por nëse do të shohim me hollësi, do të arrijmë në përfundimin se ky interpretim nuk është i saktë.

Është e natyrshme për një nënë, e cila ndahet me fëmijën e saj në këtë mënyrë, të harrojë çdo gjë tjetër e ta pushtojë një gjendje hutimi, kur mendon për rrezikun e madh që e pret fëmijën e saj. Prandaj, nga dëshpërimi i madh, ajo donte të thërriste me zë të lartë, por nga britmat e saj do të merrej vesh puna e saj e fshehtë.

Porse All'llahu, Ai që ia kishte hedhur nënës së Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) këtë barrë të rëndë, ia forcoi zemrën. Ai bëri që ajo të besonte në premtimin e All'llahut dhe të kuptonte se fëmija i saj ishte nën kujdesin e Tij dhe se Ai do t'ia kthente asaj fëmijën, që më vonë do të bëhej Profet.

Fjala e ajetit "*rebatnà*" në rrënjën e saj "*rebeta*" do të thotë: e lidhi shtrënguar kafshën; e lidhi atë mirë dhe në një vend ku kafsha ose diçka tjetër e ngjashme është e sigurtë. Më pas, fjala "*lidhje*" ka marrë edhe kuptimin: ruajtje, forcim dhe përforcim. Në këtë ajet, qëllimi me shprehjen "*lidhje e zemrës*" është forcimi i zemrës së nënës së Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), që ajo të besonte në premtimin e All'llahut dhe ta përballonte këtë ngjarje kaq të rëndë për një nënë.

Nën ndikimin e dashamirësisë së All'llahut, nëna e Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) ndjeu siguri. Megjithatë, ajo donte të dinte për të ardhmen e fëmijës së vet, prandaj e urdhëroi të motrën e fëmijës që të ndiqte gjurmët që e çonin tek ai dhe të mësonte ndonjë lajm rreth tij. Për këtë, ajeti njofton: **"Ajo (nëna) i tha motrës së tij: vëzhgoje"**.

Fjala e ajetit "*kus'sijhi*" në rrënjën e saj "*kas'sa*" do të thotë: ndjek gjurmët e një sendi. Kjo fjalë është përdorur këtu për shkak

se ka kuptimin e lajmeve e të njoftimeve të ndryshme që vijnë njëri pas tjetrit.

Motra e Musait (*Paqja e All'lahut qoftë mbi të!*) ndoqi gjurmët e vëllait të saj me kujdes, që të mos ngjallte dyshim dhe, më në fund, ajo pa nga larg që njerëzit e Faraonit e nxorrën arkën e vogël prej ujit. Në lidhje me këtë ngjarje, Kur'anit njofton: **“dhe ajo e ndiqte nga larg”**. Natyrisht që ata nuk e kuptuan se motra e fëmijës po e vëzhgonte atë, ashtu siç njofton ajeti i nderuar: **“dhe ata nuk e kuptonin”**.

Disa interpretues të Kur'anit kanë shpjeguar se shërbyesit e Faraonit e morën fëmijën dhe dolën prej pallatit në kërkim të një taje dhe ata i pa motra e Musait (*Paqja e All'lahut qoftë mbi të!*).

Duket se interpretimi i parë është më konkret dhe, duke u bazuar mbi të, rezulton se nëna e Musait (*Paqja e All'lahut qoftë mbi të!*), kur u kthye në shtëpi e dërgoi menjëherë motrën e fëmijës që të sillte ndonjë lajm prej tij. Për frazën e ajetit **“dhe ata nuk e kuptonin”** ka edhe interpretime të tjera.

Dijetari poliedrik “Et Tabresij” nuk e përjashton mundësinë që kjo frazë të jetë përsëritur në këtë ajet dhe në ajetet vijuese për të treguar se Faraoni ishte injorant deri në atë shkallë sa pretendoi të ishte zot. Si është e mundur që ai të luftonte vullnetin e pamposhtur të All'lahut?!

Sidoqoftë, vullneti i All'lahut deshi që ai fëmijë të kthehej pranë nënës së tij sa më shpejt, me qëllim që zemra e saj të qetësohej. Për këtë ngjarje, në Kur'an thuhet: **“Ne ia ndaluam atij të pinte tek mëndeshat.”**

Zakonisht, foshnja e gjirit pas disa orësh ndjen uri dhe fillon të qajë, për shkak se nuk e përballon urinë. Gjetja e një taje për fëmijën ishte bërë domosdoshmëri, duke shtuar këtu edhe faktin se zemra e mbretëreshës së Egjiptit, gruas së Faraonit, ishte shumë e lidhur me këtë fëmijë.

Punonjësit e pallatit vraponin nga njëra shtëpi në tjetrën, në kërkim të një taje, por ishte e habitshme se foshnja nuk pranonte gjirin e asnjërës prej tajave.

Mbase kjo i vinte atij nga egërsia që shprehej në fytyrat e tajave, ose ngaqë e kishte shijuar qumështin e atyre grave, por ai i dukej i hidhur. Prandaj foshnja e largonte kokën me vrull prej gjoksit të tajave. Ky ishte ndalimi gjenetik prej All'llahut, që ai fëmijë të mos pinte qumështin e asnjë gruaje tjetër.

Sa më shumë kohë kalonte, aq më i uritur dukej fëmija e aq më shumë qante. Pallati i Faraonit u mbush me të qara e me zhurmë. Teksa punonjësit ishin në kërkim të një taje, rastësisht atyre iu afrua një vajzë, e cila iu tha se nuk e njihje këtë fëmijë, por i pyeti: **“(motra e Mūsait) tha: a doni t’u tregoj një familje që do të kujdeset për atë dhe që do të jenë të sinqertë ndaj tij?”**.

Vajza u tha atyre: *“Unë njoh një grua prej Beni Israilëve, që ka plot qumësht; ajo është grua zemërmirë dhe shumë e dashur; ajo e ka humbur fëmijën e saj dhe është e gatshme të kujdeset për këtë foshnje.”*.

Kjo i gëzoi shumë punonjësit e pallatit dhe pa humbur kohë, ata e shoqëruan nënën e Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) për në pallat. Kur fëmija nuhati erën e gjirit të nënës së tij, filloi të pinte me shumë dëshirë dhe të dy sytë i shndritën prej gëzimit. U gëzuan edhe punonjësit e pallatit, të cilët ishin lodhur duke

kërkuar një tajë për foshnjen, por edhe mbretëresha u gëzua shumë që u gjet ajo.

Në disa transmetime thuhet se kur Musai (*Paqja e All'lahut qoftë mbi të!*) e pranoi gjirin e nënës së tij, Hamani, ministri i Faraonit i tha nënës së Musait: “Mbase ti je nëna e tij e vërtetë; përndryshe, si të pranoi ty, kur ai nuk ka pranuar të pijë prej shumë grave të tjera?” Nëna e Musait tha: “O mbret, unë jam një grua me erë të mirë dhe qumështi im është i ëmbël. Asnjë fëmijë që më kanë sjellë për ta ushqyer me qumësht, nuk më ka refuzuar.”. Të pranishmit i besuan gruas dhe i dhanë asaj shumë dhurata të shtrenjta.¹

Në një transmetim të ardhur në lidhje me këtë çështje lexojmë se transmetuesi tregon: “E pyeta Imam Bàkirin: Sa ditë qëndroi Musai (*Paqja e All'lahut qoftë mbi të!*) larg nënës së tij, derisa atë e ktheu All'llahu tek ajo? Ai m'u përgjigj: “Tre ditë”.²

Ky ndalim nga ana e All'lahut, siç e thamë më lart, ishte një ndalim gjenetik (*tahrijmun tekvijni*), sepse vullneti i Tij ishte që Musai (*Paqja e All'lahut qoftë mbi të!*) të mos mëkohej me qumështin e ndotur të grave të ushqyera me pasuri të ndaluar, të vjedhur, ose të ardhur nga krimet ekonomike, si ryshfeti, apo cënimi i të drejtave të njerëzve të tjerë. All'llahu i Lartësuar kishte shfaqur vullnetin e Tij që Musai (*Paqja e All'lahut qoftë mbi të!*) të ushqehet me qumësht të pastër, siç ishte qumështi i nënës së tij, pasi vetëm kështu ai do të kishte mundësi të ngrihej kundër punëve të ndyra dhe të luftonte mëkatarët.

¹ Tefsiri “Kebijr”, vëll. 24, f. 231.

² Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 4, f. 116.

Të gjitha punët u plotësuan me urdhrin e All'llahut: **“Dhe Ne e kthyem atë te nëna e tij që asaj t'i kënaqej syri e të mos dëshpërohej dhe që të kuptojë se premtimi i All'llahut është i sigurtë, por shumica e atyre (njerëzve) nuk e dinë.”**¹

Këtu lind pyetja: A e la familja e Faraonit foshnjen te nëna e vet, që ajo ta ushqente me gji dhe ta sillte atë në pallatin e Faraonit në çdo kohë, për ta parë Faraoni dhe e shoqja? Apo e mbajtën Musain (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) në pallat dhe i kërkuan tajës, nënës së tij, që të shkonte atje për ta ushqyer me gji fëmijën në kohën e caktuar?

Nuk ka argument për asnjërën prej këtyre dy mundësive, por mundësia e parë duket se është më afër asaj që duhet të ketë ndodhur, pra ata e lanë foshnjen tek e ëma dhe ajo e sillte atë në pallat çdo ditë.

Sërish lind pyetja: A u kthye Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) në pallatin e Faraonit pas përfundimit të periudhës së gjidhënies, apo vazhdoi të qëndronte te familja e tij? Apo shkonte e vinte nga pallati në shtëpinë e tij?

Disa interpretues të Kur'anit kanë thënë se pas periudhës së ushqimit me gji, Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) u kthye te Faraoni dhe te gruaja e tij. Ai u rrit dhe u edukua në praninë e atyre të dyve. Për Musain (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) dhe Faraonin ka tregime të shumta, por fjala që Faraoni i tha Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) pas ngarkimit të tij me detyrën e Profetësisë: **“a nuk të rritëm ty si fëmijë në mesin tonë, ku**

¹ Për rrënjën gjuhësore të frazës së ajetit “*tekarr'rre ajnuhà*” - “**asaj t'i kënaqej syri**” kemi dhënë shpjegime në fundin e ajetit 74 të sures “El Furkàn”.

kalove disa vjet të jetës tënde?”¹, - tregon qartë se Musai (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) ka jetuar në pallatin e Faraonit shumë vite të jetës së tij.

Prej tefsirit të Ali bin Ibrahimit mësojmë se Musai (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) ka qëndruar në pallatin e Faraonit, ku ka gëzuar respekt të plotë derisa arriti moshën madhore, ndonëse fjalët e tij për Njësimin e All’llahut e shqetësonin shumë Faraonin, madje aq shumë sa kishte vendosur ta vriste. Në një gjendje të tillë, Musai (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) e la pallatin dhe shkoi në qytet, ku gjeti dy burra që po rriheshin me njëri-tjetrin. Njëri prej tyre ishte kopt, kurse tjetri ishte prej Beni Israilëve. Musai (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) u afrua t’i ndante. Hollësitë në lidhje me këtë ngjarje do t’i shpjegojmë gjatë komentimit të ajeteve të ardhshme.²

¹ Sure “Esh Shu’arà”, ajeti 18.

² Shih në tefsirin e Ali bin Ibrahimit, vëll. 2, f. 137, i cituar në përputhje të plotë me atë që thuhet në tefsirin “Nuruth Thekalejn”, vëll. 4, f. 117.

Ajetet: 14 - 17

وَلَمَّا بَلَغَ أَشُدَّهُ ۖ وَاسْتَوَىٰ ءَاتَيْنَاهُ حُكْمًا وَعِلْمًا ۚ وَكَذَٰلِكَ نَجْزِي الْمُحْسِنِينَ ﴿١٤﴾
 وَدَخَلَ الْمَدِينَةَ عَلَىٰ حِينٍ غَفْلَةٍ مِّنْ أَهْلِهَا فَوَجَدَ فِيهَا رَجُلَيْنِ يَقْتَتِلَانِ
 هَٰذَا مِنْ شِيعَتِهِ ۖ وَهَٰذَا مِنْ عَدُوِّهِ ۖ فَلَسَّتْ عَلَيْهِ ٱلَّذِي مِّنْ شِيعَتِهِ ۖ عَلَى ٱلَّذِي
 مِّنْ عَدُوِّهِ ۖ فَكَرَهُهُ مُوسَىٰ فَقَضَىٰ عَلَيْهِ ۖ قَالَ هَٰذَا مِنْ عَمَلِ ٱلشَّيْطَانِ إِنَّهُ ۖ
 عَدُوٌّ مُّضِلٌّ مُّبِينٌ ﴿١٥﴾ قَالَ رَبِّ إِنِّي ظَلَمْتُ نَفْسِي فَاغْفِرْ لِي فَغَفَرَ لَهُ ۚ إِنَّهُ ۖ
 هُوَ ٱلْغَفُورُ ٱلرَّحِيمُ ﴿١٦﴾ قَالَ رَبِّ بِمَا أَنْعَمْتَ عَلَيَّ فَلَن أَكُونَ ظَهِيرًا
 لِّلْمُجْرِمِينَ ﴿١٧﴾

“Dhe kur ai (Mùsà) arriti moshën madhore dhe pjekurinë (mendore) Ne i dhamë atij urtësi e dituri; kështu i shpërblejmë Ne punëmirët.”

“Ai hyri në qytet pa u vënë re prej banorëve të qytetit, aty gjeti dy burra që po përlesheshin; njëri ishte prej anës së tij (Beni Israilëve) dhe tjetri ishte prej armiqve të tij; ai i anës së tij i kërkoi ndihmë kundër armikut të tij. Mùsà e goditi atë me grusht dhe ai vdiq; Mùsà tha: kjo është prej punëve të djallit; me të vërtetë ai (djalli) është armik i hapur që çon në rrugën e humbjes.”

“Ai (Mùsài) tha: o Zoti im, unë i bëra padrejtësi vetes, më fal mua dhe Ai e fali; me të vërtetë, Ai është Gjithëfalësi, Mëshirëploti.”

“Ai (Mùsài) tha: o Zoti im, për mirësitë që Ti më ke dhënë, unë kurrë nuk do të vihem në ndihmë të mohuesve.”

Komentimi

Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) dhe mbrojtja e të shtypurve

Në këto ajete shpaloset etapa e tretë e tregimit të Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*). Këtu flitet për ngjarjet që ndodhën midis tij dhe Faraonit. Gjithashtu, në këto ajete trajtohen disa çështje që kanë të bëjnë me moshën e pjekurisë së tij trupore e mendore si dhe disa ngjarje që lidhen me Musain (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) gjatë kohës që ai ishte në Egjipt, para se të nisej në drejtim të Medjenit. Nga këto ajete do të mësojmë edhe shkaqet që e detyruan atë të emigrojë në Medjen.

Ajeti i parë i këtij grupi ajetesh, njofton: **“Dhe kur ai (Mùsài) arriti moshën madhore dhe pjekurinë (mendore), Ne i dhamë atij urtësi e dituri; kështu i shpërblejmë Ne punëmirët.”**

Fjala e ajetit *“eshud’dehù”* është nxjerrë prej rrënjës së saj *“esh’shid’detu”*, që do të thotë **“fuqi”**.

Ndërsa fjala tjetër e ajetit *“istevà”*, në rrënjën e saj *“el istivàu”* do të thotë *“plotësimi i rritjes fizike dhe arritja e pjekurisë mendore”*.

Në mesin e interpretuesve të Kur'anit ka shumë mendime për ndryshimin midis kuptimeve të këtyre dy fjalëve.

Disa prej interpretuesve të Kur'anit kanë thënë se qëllimi me fjalën *“eshud’dehù”* është njeriu që ka arritur plotësimin nga ana trupore, që në shumicën e rasteve arrihet në moshën tetëmbëdhjetë vjeçare; kurse me fjalën *“el istivàu”*, qëllimi është stabiliteti e pjekuria në punët e jetës, që zakonisht arrihet pas plotësimit të njeriut nga ana trupore.

Disa kanë thënë se qëllimi me arritjen e fuqisë trupore është plotësismi i rritjes trupore, kurse me qëndrueshmërinë dhe pjekurinë, qëllimi është forcimi i mendjes dhe pjekuria në mendime.

Në një transmetim të ardhur prej Imam Sadikut në librin *“Kitàbu Meànil Akhbàr”*, lexojmë se në lidhje me frazën e ajetit **“Dhe kur ai (Mùsài) arriti moshën madhore dhe pjekurinë”**, interpretuesit e Kur'anit kanë thënë se mosha madhore arrihet kur njeriu mbush tetëmbëdhjetë vjeç, kurse qëndrueshmëria e pjekuria arrihen kur mashkullit fillon t’i rritet mjekra.¹

Midis dy shprehjeve nuk ka ndonjë dallim të madh. Duke marrë parasysh edhe kuptimin gjuhësor të dy fjalëve *“esh’shid’detu”* dhe *“el istivàu”*, mësohet se të dyja ato tregojnë plotësimin e fuqive trupore, mendore dhe shpirtërore.

¹ Tefsiri *“Nuruth Thekalejn”*, vëll. 4, f. 117.

Kurse ndryshimi midis fjalëve “*el hukmu*” - “*urtësi*” dhe “*el ilmu*” - “*dituri*” qëndron në faktin se e para ka për qëllim mendjen, të kuptuarit dhe fuqinë për të gjykuar saktë, kurse fjala e dytë “*dituri*” ka për qëllim njohjen, dijen.

Shprehja “**kështu i shpërblejmë Ne punëmiret**”, tregon se Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) e meritonte pozitën e urtësisë dhe të diturisë, sepse ishte shumë i devotshëm dhe i pastër e bënte punë të mira. Kur ajeti njofton se All'llahu e shpërbleu atë me dituri e urtësi, është e qartë se me to nuk është qëllimi as Profetësia, as Shpallja e as ndonjë dhunti tjetër e ngjashme, sepse në kohën për të cilën flasin ajetet, Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) nuk ishte ngarkuar akoma me detyrën e Profetësisë. Dihet se ai e mori këtë detyrë shumë kohë pas ngjarjeve, për të cilat flitet në këto ajete.

Në këtë ajet, qëllimi me fjalët “*urtësi*” e “*dituri*” është njohja e mirë, shikimi me mprehtësi i çështjeve dhe aftësia e fuqia për të gjykuar saktë dhe për punë të tjera të ngjashme. Ashtu siç u tha më lart, All'llahu i Lartësuar ia kishte dhënë Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) të gjitha këto mirësi për shkak të pastërtisë, singleritetit dhe punëve të tij të mira.

Prej kësaj shprehjeje kuptohet se Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) nuk u ndikua prej mjedisit të pallatit të Faraonit, ku ai jetonte. Ai punoi për të sjellë drejtësi dhe fliste për të vërtetën me aq sa kishte mundësi. Megjithatë, shumë pjesë prej jetës së tij gjatë atyre viteve nuk janë të qarta.

Për këto gjendje të Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), ajeti njofton: **“Ai hyri në qytet pa u vënë re prej banorëve të qytetit.”**

Cili është qyteti i përmendur në këtë ajet? Ne nuk e dimë të vërtetën e kësaj pyetjeje, por ka gjasa që në këto ajete të bëhet fjalë për kryeqytetin e Egjiptit. Disa interpretues të Kur'anit kanë thënë se grindjet me Faraonin dhe kundërshtimi i Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) ndaj pushtetit të tij shtoheshin ditë pas dite derisa Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) vendosi të largohej nga kryeqyteti. Pavarësisht vendimit të marrë, Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) iu dha një mundësi e veçantë. Kur njerëzit ishin të shkujdesur ndaj tij, ai u kthye dhe hyri në atë qytet.

Gjithashtu, ka mundësi që qëllimi me shprehjen **“hyri në qytet”** të jetë për hyrjen nga ana e pallatit të Faraonit, sepse në atë kohë pallatet ndërtoheshin anëve të qytetit, me qëllim që të dihej se kush hynte e kush dilte prej aty.

Kurse qëllimi me frazën e ajetit **“pa u vënë re prej banorëve të qytetit”** është për kohën kur njerëzit kanë lënë punët e tyre dhe po pushojnë. Zakonisht, në këtë kohë, qyteti nuk mbahej nën kontroll të rreptë. Por, për ç'kohë bëhet fjalë konkretisht?

Disa prej interpretuesve të Kur'anit kanë thënë se është çasti i fillimit të natës, kur njerëzit lënë punët dhe mbyllin dyqanet e punishtet, është koha kur disa shkojnë të flenë e disa të tjerë shëtisin. Në disa transmetime islame, kjo kohë njihet me emrin **“koha e shkujdesjes”**.

Në një hadith, Profeti Muhammed (*Paqja e bekimi i All'lahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: *“Falni namaz vullnetar në kohën e shkujdesjes, qoftë edhe dy rekate të shkurtra.”*.

Në fundin e këtij hadithi thuhet: *“Koha e shkujdesjes është midis përfundimit të diellit dhe namazit të Jacisë.”*¹

Gjatë **“kohës së shkujdesjes”** ndodhin shumica e krimeve penale, prostitucioni dhe devijimet morale; pra në kohën kur njerëzit nuk janë as të zënë me punë, por nuk janë as në gjumë.

Disa të tjerë janë shprehur se **“koha e shkujdesjes”** është koha pas mesit të ditës, kur njerëzit pushojnë dhe qetësohen përkohësisht. Pavarësisht nga këto thënie, interpretimi i parë duket se është më i sakti.

Musai (*Paqja e All'lahut qoftë mbi të!*) hyri në qytet në **“kohën e shkujdesjes”** dhe aty pa dy burra që po rriheshin me njëri- tjetrin. Ai u afrua pranë tyre, ashtu siç njofton edhe ajeti: **“aty gjeti dy burra që po përlesheshin; njëri ishte prej anës së tij (Beni Israilëve) dhe tjetri ishte prej armiqve të tij”**.

Shprehja e ajetit *“shij’atili”* – **“i anës së tij”** tregon se Musai (*Paqja e All'lahut qoftë mbi të!*) kishte ndjekësit e tij prej Beni Israilëve edhe para se të ngarkohej me detyrën e Profetësisë; madje ka mundësi që ai tashmë të kishte zgjedhur njerëzit që do t’i bashkoheshin atij në përballjen me Faraonin dhe me parinë e tij.

¹ “Uesàilu Shij’ah”, vëll. 8, f. 120, kapitulli “Falja e namazit nafile është mustehab, qoftë edhe dy rekate në orën e shkujdesjes”.

Kur izraeliti e pa Musain (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), i kërkoi atij ndihmë: **“ai i anës së tij i kërkoi ndihmë kundër armikut të tij”**.

Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) shkoi ta ndihmonte dhe ta shpëtonte atë prej armikut të tij mizor, për të cilin thuhej se ishte kuzhinier në pallatin e Faraonit dhe po i kërkonte izraelitit që të mbarte drutë deri në pallat. Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) e goditi këtë armik me grushtin e tij të fuqishëm në gjoks dhe ai pas goditjes u shtri menjëherë për tokë. Për këtë ngjarje, ajeti thotë: **“Mūsài e goditi atë me grusht dhe ai vdiq.”**.

S'ka dyshim se Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) nuk kishte për qëllim që ta vriste koptin, çka bëhet e qartë nga ajetet vijuese, por kjo nuk do të thotë se kopti nuk e meritonte vrasjen, krahas problemeve dhe pasojave që mund të binin mbi Musain (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) dhe mbi grupin e tij.

Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) u hidhërua shumë për atë që ndodhi. Në lidhje me këtë, ajeti njofton: **“Mūsài tha: kjo është prej punëve të djallit; me të vërtetë ai (djalli) është armik i hapur që çon në rrugën e humbjes.”**.

Me fjalë të tjera, Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) kishte qëllim vetëm që ta largonte koptin prej izraelitit, edhe pse koptët meritonin më shumë se kaq. Më poshtë do të shohim se kjo ngjarje e detyroi Musain (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) që të dilte jashtë tokës së Egjiptit dhe të shkonte në Medjen, pasi qëndrimi tij i mëtejshëm në atë vend u bë i pamundur.

Në vijim, Kur'ani Famëlartë flet për gjendjen e Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) dhe thotë: **“Ai (Mūsài) tha: o Zoti**

im, unë i bëra padrejtësi vetes, më fal mua dhe Ai e fali; me të vërtetë, Ai është Gjithëfalësi, Mëshirëploti.”.

Është pranuar plotësisht se Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) ishte krejtësisht i pafajshëm në këtë ngjarje, ndonëse do të kishte qenë shumë më mirë sikur të mos e qëllonte koptin; ai duhej të ishte treguar i matur e të mos hynte në probleme të tilla. Pikërisht për këtë, ai i lutet All'llahut që t'ia falë “mëkatin” dhe i kërkon ndihmë. Kështu, atë e përfshiu butësia e All'llahut, të Gjithëdijshtit.

Kur shpëtoi prej kësaj rruge pa krye në saje të butësisë së All'llahut ndaj tij, Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) tha: **“Ai (Mūsai) tha: o Zoti im, për mirësitë që Ti më ke dhënë”**- që më fale dhe që më shpëtove prej dorës së armiqve, si dhe për të gjitha mirësitë që më ke dhënë qysh në fillim të jetës time e deri tani: **“unë kurrë nuk do të vihem në ndihmë të mohuesve”**, por do të ndihmoj besimtarët e dhunuar nga padrejtësia. Me këto fjalë, Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) donte të thoshte se nuk do të ishte kurrë në krah të Faraonit e të pasuesve të tij, por do t'u vinte vazhdimisht në ndihmë Beni Israilëve të shtypur.

Disa interpretues të Kur'anit janë shprehur se qëllimi me fjalën “*el muxhrimijne*” është për atë izraelitin që ndihmoi Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), por duke u nisur nga kuptimi që shprehin fjalët e ajetit, kjo mundësi është larg nga e vërteta.

Dy hulumtime

1- A nuk ishte kjo vepër e Musait në kundërshtim me pamëkatshmërinë (*ismetium*)?

Interpretuesit e Kur'anit e kanë trajtuar gjatë grindjen që ndodhi midis koptit e izraelitit si dhe vrasjen e koptit prej Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*).

Në thelb, kjo çështje nuk ka ndonjë rëndësi të madhe, sepse koptët mizorë dhe pasuesit shkatërrimtarë të Faraonit vranë me mijëra fëmijë të Beni Israilëve dhe nuk u ndalën para asnjë krimi tjetër kundër tyre.

Për interpretuesit e Kur'anit kanë rëndësi shprehjet e Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), prej të cilave kanë lindur paqartësi në mesin e tyre.

Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) herë thotë: **“kjo është prej punëve të djallit”**.

Herë tjetër thotë: **“O Zoti im, unë i bëra padrejtësi vetes, më fal mua”**.

Si mundet që shprehje të tilla të përputhen me statusin e Profetëve si njerëz pa mëkate, edhe para se ata të ngarkoheshin me detyrën e Profetësisë?

Duke u bazuar në komentin e ajetit të mësipërm, të gjitha këto paqartësi bien. Situata në të cilën u ndodh Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) lidhet me lënien e punës me përparësi. Ne e

shpjeguam se Musai (*Paqja e All'lahut qoftë mbi të!*) duhej të ishte treguar më i rezervuar para se ta qëllonte koptin me grusht, por ai nuk e bëri këtë. Për rrjedhojë, ai e futi veten në probleme dytësore, për faktin se vrasja e koptit nuk ishte ngjarje e thjeshtë. Përkundrazi, ajo ishte një ngjarje që nuk mund të falej prej faraonëve.

Ne dimë se lënia e punës me përparësi, nuk do të thotë se puna e bërë është e ndaluar. Këtu, heqja dorë prej punës me përparësi është shumë më e rëndësishme dhe shumë më e mirë.

Një shprehje e ngjashme ka ardhur edhe në tregimet e Profetëve, duke përfshirë edhe tregimin në lidhje me Ademin, babain e njerëzimit, ngjarjen e të cilit e kemi parë në komentin e ajetit 19 të sures “El A’ràf”.

Në një transmetim të ardhur prej Imam Ali bin Mùsà Er Rridà, lexojmë se në lidhje me interpretimin e frazës së ajetit: “**Ai** (Mùsài) **tha: kjo është prej punëve të djallit**”, - ai ka thënë se përleshja që ndodhi në mes atij burrit dhe veprimi i Musait (*Paqja e All'lahut qoftë mbi të!*), që shkaktoi vdekjen e koptit, ishte prej punëve të djallit dhe se djalli “**është armik i hapur që çon në rrugën e humbjes**” - kurse me frazën e ajetit “**O Zoti im, unë i bëra padrejtësi vetes, më fal mua**”, Musai (*Paqja e All'lahut qoftë mbi të!*) dëshiron të thotë: Unë e vura veten jo aty ku duhej të isha kur hyra në këtë qytet, prandaj “**më fal mua**”, pra më fshih prej armiqve të mi dhe bëj që ata të mos më zbulojnë se përndryshe do të më vrasin...”¹⁽¹⁾.

¹ “Ujùnu Akhbàru Rridà”, vëll. 1, f. 198, e cituar sipas tefsirit “Nuruth Thekalejn”, vëll. 4, f. 119.

2- Mbështetja dhe ndihma e dhënë e mizorëve është gjynahu më i madh

Në jurisprudencën islame ka një kapitull të veçantë me titull: “Mbështetja e mëkatit dhe bashkëpunimi me mizorët”. Ky kapitull është argumentuar me hadithe të shumta, të cilat tregojnë se mëkati më i madh është ndihma për të padrejtët dhe kriminelët. Hadithet shpjegojnë se ndihma e dhënë ndaj mohuesve e mizorëve është shkak që edhe ndihmuesi të ketë të njëjtin përfundim të keq si ata.

Në origjinë, mizorët dhe kriminelët në shoqëri janë të ngjashëm me Faraonin, qofshin edhe vetëm disa individë. Kur shoqëria nuk i ndihmon e nuk i mbështet individë të tillë, ata nuk mund të bëhen kurrë si Faraoni. Në të vërtetë, këtë pakicë të ngjashme me Faraonin e mbështesin njerëzit e pafuqishëm, oportunistët dhe adhuruesit e kësaj bote, të cilët grumbullohen rreth mizorëve e kriminelëve dhe i mbështesin ata, ose më e pakta ua shtojnë krahët e fuqisë djallëzore.

Shumë ajete të Kur'anit Famëlartë e vënë theksin mbi këtë bazë islame. Në ajetin e dytë të sures “El Maida” thuhet: **“Bashkëpunoni për punë të mira e devotshmëri dhe mos bashkëpunoni me mëkate e me aggression.”**.

Gjithashtu, në disa ajete, Kur'ani e shpall me zë të lartë mosdhënien e ndihmës për mizorët, si për shembull në ajetin 113 të sures “Hud”: **“Dhe mos anoni kah mizorët, ndryshe do të futeni në zjarr.”**.

Fjala e ajetit “*lâ terkenû*”, në rrënjën e saj “*err’rrukûn*” do të thotë “**anim**”. Animi është njëlloj qoftë kur është vetëm me zemër, qoftë kur është me dhënien e ndihmës konkrete, qoftë me miratim e dashamirësi ndaj mizorëve, ose duke u uruar të mirën atyre. Të gjitha këto kuptime i kanë përmendur interpretuesit e Kur’anit në lidhje me fjalën “*err’rrukûn*” - “**anim**” dhe të gjitha shprehin mbështetjen e dhënien e ndihmës për mizorët dhe vartësinë prej tyre. Ky kuptim vërteton komentin që bëmë për ajetin që është objekt studimi.

Në lidhje me këtë çështje, në një transmetim të ardhur prej Imam Ali bin Hysejini, lexojmë bisedën e tij me Muham’med bin Muslim Ez Zehrij, i cili ishte dijetar, por kishte simpati për *emevitët* dhe bashkëpunonte me ta, sidomos me kalifin Hish’shâm bin Abdul Melik. Në këtë bisedë, Imami e paralajmëroi dijetarin se ishte duke ndihmuar mizorët dhe se po prirej drejt tyre. Ai i thotë: “*Sapo ata të ftuan, ti iu përgjigje ftesës. Ata të bënë të parin e tyre, në mënyrë që me ty të rrotullojnë mekanizmin e padrejtësive që bëjnë; ata të kanë bërë urë, që të kalojnë sipër teje për të shkuar në punët e tyre të liga; të kanë bërë shkallë për t’u ngjitur te hijet e tyre, të kanë bërë sy për veten e tyre, që ti të ecësh në rrugën e tyre. Me ty, ata kanë futur dyshimin në zemrat e dijetarëve; me ty, ata drejtojnë zemrat e injorantëve që t’i ndjekin ata. Sa pak të kanë dhënë, në krahasim me atë që kanë marrë prej teje! Sa pak kanë ndërtuar për ty, në krahasim me atë që kanë shembur me ndihmën tënde! Shikoje veten tënde, sepse askush tjetër nuk sheh në ty përveç teje! Kërkoji llogari vetes, ashtu siç kërkon llogari njeriu që mban përgjegjësi.*”¹

¹ “Tuhful Ukûli”, f. 275.

Në të vërtetë, kjo logjikë e mprehtë e shumë ndikuese e Imamit, i drejtohet çdo dijetari dhe këshilltari të mbretërve; u drejtohet atyre, që duke anuar nga mbreti mizor, bëjnë padrejtësi. Në saje të kësaj logjike, dijetari ka mundësi të parashikojë të ardhmen e tij fatale dhe përfundimin e turpshëm.

Ibni Ab'bàsi ka thënë se ajeti: **“O Zoti im, për mirësitë që Ti më ke dhënë, unë kurrë nuk do të vihem në ndihmë të mohuesve”**, është njëri prej ajeteve që theksojnë se simpatia ndaj kriminelëve është faj shumë i rëndë; gjithashtu, si kundërpeshë, ajeti thekson bindje të plotë ndaj urdhrave të All'llahut, të Gjithëfuqishmit.

Një dijetari iu tha se filani është bërë shkruar për filan mizor dhe se shkruan vetëm të ardhurat e shpenzimet. Jeta e tij dhe e familjes së tij është peng i asaj rroge që ai merr për punën që bën; përndryshe ai vetë, së bashku me familjen e tij, shumë shpejt do të bien në varfëri.

Përgjigjja e këtij dijetari ishte: A nuk e keni dëgjuar fjalën e rob-it të mirë, Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*): **“O Zoti im, për mirësitë që Ti me ke dhënë, unë kurrë nuk do të vihem në ndihmë të mohuesve.”**¹.

¹ Në fundin e ajetit 2 të sures “El Mâide” dhe në fundin e ajetit 113 të sures “Hüd” kemi vënë dy studime në lidhje me ndihmën që u jepet mohuesve e mizorëve.

Ajetet: 18 - 22

فَأَصْبَحَ فِي الْمَدِينَةِ خَائِفًا يَتَرَقَّبُ فَإِذَا الَّذِي اُسْتَنْصَرُهُ بِالإِمْسِ يَسْتَصْرِخُهُ
 قَالَ لَهُ مُوسَى إِنَّكَ لَغَوِيٌّ مُبِينٌ ﴿١٨﴾ فَلَمَّا أَنْ أَرَادَ أَنْ يَبْطِشَ بِلُذِي هُوَ عَدُوٌّ
 لَهُمَا قَالَ يَمُوسَى أَتُرِيدُ أَنْ تَقْتُلَنِي كَمَا قَتَلْتَ نَفْسًا بِالإِمْسِ إِنْ تُرِيدُ إِلَّا
 أَنْ تَكُونَ جَبَّارًا فِي الْأَرْضِ وَمَا تُرِيدُ أَنْ تَكُونَ مِنَ الْمُصْلِحِينَ ﴿١٩﴾ وَجَاءَ
 رَجُلٌ مِّنْ أَقْصَا الْمَدِينَةِ يَسْعَى قَالَ يَمُوسَى إِنَّ أُمْلَأَ يَأْتَمِرُونَ بِكَ لِيَقْتُلُوكَ
 فْلَخُرْجِ إِنِّي لَكَ مِنَ النَّاصِحِينَ ﴿٢٠﴾ فَخَرَجَ مِنْهَا خَائِفًا يَتَرَقَّبُ قَالَ رَبِّ نَجِّنِي
 مِنَ الْقَوْمِ الظَّالِمِينَ ﴿٢١﴾ وَلَمَّا تَوَجَّهَ تِلْقَاءَ مَدْيَنَ قَالَ عَسَى رَبِّي أَنْ يَهْدِيَنِي
 سَوَاءَ السَّبِيلِ ﴿٢٢﴾

“Ai (Mùsài) në qytet u gdhi i frikësuar duke vëzhguar (se ç’do t’i ndodhte për shkak të vrasjes) dhe ja personi që i kishte kërkuar ndihmë dje, i kërkoj përsëri që ta ndihmonte, por Mùsài i tha: ti me të vërtetë qenke ngatërrestar i njohur.”

“Dhe kur ai deshi të vërë dorë mbi atë që ishte armik i të dyve, ai (kopti) tha: a do të më vrasësh edhe mua siç vrave dje një njeri? Ti nuk dashke gjë tjetër veçse të jesh keqbërës në tokë dhe nuk paske dëshirë të jesh prej përmirësuesve.”

“Një burrë erdhi me nxitim nga ana e largët e qytetit dhe i tha: o Mùsà, paria po bisedojnë për të të vrarë, prandaj dil (prej qytetit), unë për ty jam prej këshilluesve.”

“Dhe ai (Mùsà) doli prej qytetit i frikësuar duke hetuar dhe tha: o Zoti im, më shpëto prej njerëzve mizorë.”

“Kur ai (Mùsà) u drejtua kah Medjeni, tha: All’llahu patjetër do të më orientojë të ndjek rrugën e duhur.”

Komentimi

Musai (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) drejtohet për në Medjen fshehurazi

Në ajetet që janë objekt studimi shohim pjesën e katërt të këtij tregimi me përmbajtje të rëndësishme.

Lajmi për vrasjen e koptit u përhap me shpejtësi në Egjipt. Gjithashtu, faktet e shumta tregonin se vrasësi ishte prej Beni Israilëve. Mbase emri i Musait (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) përmendej ndër Beni Israilët dhe dyshohej se vrasësi ishte ndër ata.

Natyrisht që kjo vrasje nuk mund të ishte prej vrasjeve të zakonshme, por konsiderohej si shkëndijë që lajmëronte shpërthimin e revolucionit të ardhshëm. Aparati qeveritar nuk mund ta kalonte këtë situatë me lehtësi. Me këtë vrasje u bë fakt se

tani koptët mund të vriteshin prej sklevërve të tyre, Beni Israilëve.

Për të gjitha këto, Kur'ani Famëlartë qysh në ajetin e parë të këtij grupi ajetesh, njofton: **“Ai (Mūsà) në qytet u gdhi i frikësuar duke vëzhguar (se ç’do t’i ndodhte për shkak të vrasjes).”**.

Gjendja e krijuar e detyronte të bënte kujdes e të vëzhgonte se si do zhvilloheshin ngjarjet pas vrasjes së koptit. Por të nesërmen, ai u befasua prej izraelitit, të cilin Musai e kishte ndihmuar një ditë më parë në grindjen e tij me koptin, sepse ai i kërkoi përsëri që ta ndihmonte. Për këtë, ajeti njofton: **“dhe ja personi që i kishte kërkuar ndihmë dje, i kërkoi përsëri që ta ndihmonte”**.

Por Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) u çudit me të dhe e dënoi punën e atij njeriu, ashtu siç njofton vijimi i ajetit: **“por Mūsà i tha: ti me të vërtetë qenke ngatërrestar i njohur”**; ti çdo ditë grindesh me të tjerët, çdo ditë krijon probleme që nuk duhet të nxirren tani; ne parashikojmë të kemi pasoja nga ndodhia e djeshme, kurse ti kërkon prej meje të të ndihmoj edhe një herë tjetër!

Sidoqoftë, burri prej Beni Israilëve ishte i dhunuar dhe gjendej në dorën e mizorëve, prandaj ai e meritonte të ndihmohej. Sërish, ishte detyra e Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) që të mos e linte izraelitin vetëm në sheshin e përlleshjes. Kur Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) deshi ta godiste atë, që ishte armik i të dyve, ai thirri me zë të lartë: **“Ai tha: a do të më vrasësh edhe mua siç vrave dje një njeri?”**; nga puna jote duket se nuk qenke

njeri i matur: **“Ti nuk dashke gjë tjetër veçse të jesh keqbërës në tokë dhe nuk paske dëshirë të jesh prej përmirësuesve.”**¹

Këto shprehje kur'anore tregojnë qartë se Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) kishte gjithmonë për qëllim përmirësimin, si në pallatin e Faraonit, ashtu edhe jashtë tij. Në disa transmetime islame lexojmë se ai kishte shkëmbyer fjalë të ashpra me Faraonin për punë të drejtësisë, prandaj edhe kopti i thotë Musait: *Ti dëshiron çdo ditë të vrasësh një njeri. Çfarë përmirësimi është ky që do ti?* Sikur Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) ta kishte vrarë edhe këtë kopt, do të kishte hedhur një hap tjetër përpara në rrugën e përmirësimit. Sido që të ketë qenë gjendja, Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) e kuptoi se lajmi i vrasjes së një dite më parë ishte përhapur dhe, me qëllim që të mos shtoheshin problemet për të, u frenua që të mos e vriste koptin ditën e dytë.

Nga ana tjetër, lajmet arritën në pallatin e Faraonit. Ai, së bashku me parinë e tij, e kuptuan se përsëritja e ngjarjeve të tilla paralajmëronte rrezik, prandaj Faraoni thirri një seancë këshillimore me ministrat e tij. Në këtë seancë u thur komploti për të vrarë Musain (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), por në pallat ishte edhe një burrë që kishte marrëdhënie të mira me Musain, i cili e njoftoi atë në lidhje me komplotin. Për këtë, Kur'ani Famëlartë njofton: **“Një burrë erdhi me nxitim nga ana e largët e qytetit dhe i tha: o Mùsà, paria po bisedojnë për të të vrarë, prandaj dil (prej qytetit), unë për ty jam prej këshilluesve.”**

¹ Disa interpretues të Kur'anit mendojnë se këto fjalë izraeliti ia tha Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), sepse mendoi që ai donte ta vriste, por shembujt krahasues të Kur'anit e hedhin poshtë këtë mundësi.

Duket se ky njeri ishte besimtar prej familjes së Faraonit, por që e fshihte besimin e tij. Ai quhej Hazekijl, ishte prej familjes së Faraonit dhe kishte marrëdhënie të ngushta me të, përderisa merrte pjesë në seanca të tilla.

Ky burrë i përjetonte me dhimbje krimet e Faraonit dhe qëndronte në pritje të realizimit të një revolucioni “hyjnor”, ku të merrte pjesë edhe ai vetë.

Duket qartë se ai shpresonte shumë te Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*). Ai shihte në fytyrën e tij shenja të një njeriu hyjnor, të një burri punëmirë e revolucionar, prandaj sapo mësoi për rrezikun e madh që i kanosej atij, shkoi personalisht që ta shpëtonte prej kthetrave të rrezikut. Më poshtë do të shohim se ky njeri besimtar nuk ishte mbështetës i Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) vetëm në këtë rast, por kishte qenë vëzhgues në favor të Beni Israilëve në pallatin e Faraonit në shumë raste e në shumë ngjarje.

Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) e priti me seriozitet lajmin e këtij burri dhe e pranoi këshillën e porosinë e tij për t'u larguar nga qyteti. Për këtë ngjarje, ajeti njofton: **“Dhe ai (Mùsà) doli prej qytetit i frikësuar duke hetuar.”**.

Ai ishte i nënshtruar ndaj All'llahut singërisht dhe me zemër të pastër i lutet Atij që ta shpëtonte prej të keqes së njerëzve mizorë. Për këtë gjendje të tij, në ajet thuhet: **“...dhe tha: o Zoti im, më shpëto prej njerëzve mizorë”**. O Zoti im, unë e di se mizorët nuk e njohin mëshirën; unë jam ngritur kundër tyre në mbrojtje të të privuarve nga të gjitha të drejtat, ua kam përplasur mizorëve në fytyrë e nuk kam reshtur së punuari për të larguar të ligat e dëmet prej njerëzve

të mirë. Prandaj o Zoti im, o i Madhërishëm, të lutem largoji prej meje fyerjet e të këqijat e tyre!

Në këtë gjendje, Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) vendosi të udhëtonte në drejtim të Medjenit, që ndodhej në jug të Shamit e në veri të Hixhazit. Medjeni ishte larg sundimit të Egjiptit dhe të faraonëve. Ai ishte një i ri, i rritur në mirëqenie e në mesin e të mirave, por ja që tani duhej të ndërmerte një udhëtim që nuk e kishte bërë më parë në jetën e tij. U nis për udhëtim pa furnizim, pa sendet e nevojshme, pa një mik e pa një shok, pa kafshë dhe pa udhërrëfyes. Veç kësaj, ai ishte vazhdimisht i shqetësuar se njerëzit e Faraonit mund ta kapnin përpara se të arrinte në Medjen, ku ishte objektivi i tij. Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) kishte frikë se mos e zinin rob dhe pastaj e vrisnin. Nuk është për t'u çuditur që ai ishte kaq i trazuar.

Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) duhej të kapërcente një fazë shumë të vështirë. Ai duhej të shpëtonte prej grackës që kishin ngritur kundër tij Faraoni me ndjekësit e vet; ai duhej ta kapërcente patjetër këtë fazë, që pastaj të stabilizohej pranë të shtypurve, ku do të përjetonte jo vetëm dhimbjet e tyre, por edhe ndjenjat dhe dashurinë e tyre. Njëkohësisht, aty do të përgatitej për ngritjen "hyjnore" për të mirën e të shtypurve dhe kundër mendjemëdhenjve. Në këtë rrugë që ai ndërmori, përveç ndjenjave që i vlonin në zemër, kishte edhe një kapital të madh: besimin në All'llahun dhe mbështetjen vetëm në Të. Për këtë, ai nuk shqetësohej për asgjë dhe vazhdonte udhëtimin e tij duke thënë: **"Kur ai (Mùsài) u drejtua kah Medjeni, tha: All'llahu patjetër do të më orientojë të ndjek rrugën e duhur."**

Ajetet: 23 - 25

وَلَمَّا وَرَدَ مَاءَ مَدْيَنَ وَجَدَ عَلَيْهِ أُمَّةً مِّنَ النَّاسِ يَسْقُونَ وَوَجَدَ مِنْ دُونِهِمْ
 امْرَأَتَيْنِ تَذُودَانِ قَالَ مَا خَطْبُكُمَا قَالَتَا لَا نَسْقِي حَتَّى يُصْدِرَ الرِّعَاءُ وَأَبُونَا
 شَيْخٌ كَبِيرٌ ﴿٢٣﴾ فَسَقَى لَهُمَا ثُمَّ تَوَلَّى إِلَى الظِّلِّ فَقَالَ رَبِّ إِنِّي لِمَا أَنْزَلْتَ إِلَيَّ مِنْ
 خَيْرٍ فَقِيرٌ ﴿٢٤﴾ فَجَاءَتْهُ إِحْدَاهُمَا تَمْشِي عَلَى اسْتِحْيَاءٍ قَالَتْ إِنَّ أَبِي يَدْعُوكَ
 لِيَجْزِيَكَ أَجْرَ مَا سَقَيْتَ لَنَا فَلَمَّا جَاءَهُ وَقَصَّ عَلَيْهِ الْقَصَصَ قَالَ لَا تَخَفْ
 نَجَوْتَ مِنَ الْقَوْمِ الظَّالِمِينَ ﴿٢٥﴾

“Kur ai (Mùsà) arriti te pusi i Medjenit, gjeti pranë pusit një grumbull njerëzish që u jepnin ujë (bagëtime); përveç atyre gjeti edhe dy gra, të cilat qëndronin larg atyre dhe i ndalonin dhentë (që të përziheshin me dhentë e të tjerëve); i pyeti si e keni punën ju të dyja? Ato të dyja i thanë: ne nuk u japim të pinë (bagëtime tona) derisa barinjtë të largohen me dhentë e tyre, babai ynë është shumë i vjetër.”

“Ai u dha të pinin ujë (bagëtime të dy vajzave), pastaj u largua nën një hije dhe tha: o Zoti im, unë kam nevojë për çdo të mirë që Ti do të më japësh.”

“Njëra prej atyre të dyjave erdhi tek ai duke ecur e turpshme dhe i tha: Baba im të thërret që të paguajë shpërblimin për ujin

që nxorre për bagëtitë tona dhe, kur ai (Mùsà) erdhi tek ai e i tregoi atij ngjarjen, ai i tha: Mos u frikëso, paske shpëtuar prej njerëzve mizorë.”

Komentimi

Një punë e mirë hap portat e mirësive për Musain

Ajetet që janë objekt studimi shpalosin pjesën e pestë të tregimit të Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*). Në këtë pjesë flitet për arritjen e tij në qytetin e Medjenit. Ky djalë i ri e i pastër, që nuk kishte mashtruar askënd, kishte ditë që udhëtonte në një rrugë që nuk e kishte bërë kurrë më parë. Disa interpretues të Kur'anit kanë thënë se Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) u detyrua të udhëtonte zbathur. Gjithashtu, thuhet se këtë rrugë ai e përshkoi për tetë ditë dhe u lodh aq shumë, sa edhe këmbët iu bënë me plagë nga ecja e gjatë.

Gjatë kësaj rruge, për të shuar urinë ai hëngri bimë që gjente në tokë dhe gjethe pemësh; por as problemet e as lodhja e madhe nuk kishin rëndësi për të, sepse zemra e tij ishte e mbushur me dashamirësinë e All'llahut, që e shpëtoi atë prej kthetrave të Faraonit.

Shenjat e Medjenit ai filloi t'i shihte qysh nga larg njërën pas tjetrës. Kështu, zemra e tij u qetësua për shkak se po i afrohej qytetit. Por kur u afrua, ai e kuptoi se ata ishin barinj me bagëtinë

e tyre të grumbulluar rreth pusit, ku do të pinin ujë vetë dhe do t'u jepnin edhe bagëtime të tyre.

Në lidhje me këtë ngjarje, Kur'ani njofton: **“Kur ai (Mūsai) arriti te pusi i Medjenit, gjeti pranë pusit një grumbull njerëzish që u jepnin ujë (bagëtime); përveç atyre gjeti edhe dy gra, të cilat qëndronin larg atyre dhe i ndalonin dhentë (që të përziheshin me dhentë e të tjerëve).”**¹

Kjo situatë e vuri në lëvizje Musain (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*). Aty ishin disa barinj, djem të rinj trupmëdhenj që po mbushnin ujë për bagëtitë e veta dhe nuk i hapnin vend askujt derisa të mbaronin punë e të largoheshin. Por larg tyre, në një qoshe, ishin ulur edhe dy gra, në të cilat dalloheshin qartë shenjat e nderit dhe të fisnikërisë. Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) u afrua tek ato të dyja për t'i pyetur për shkakun e qëndrimit në atë vend: **“...i pyeti si e keni punën ju të dyja?”**² Përse nuk afroheni te pusi për t'u dhënë ujë bagëtime tuaja?

Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) nuk e duronte dot padrejtësinë. Ai kishte qëllim të hynte në qytetin e Medjenit, por tani që po e shihte këtë padrejtësi, nuk e mbajti veten, sepse ishte mbrojtës i të gjithë atyre që ishin të privuar nga të drejtat. Madje për të mbrojtur të privuarit, ai la pallatin e Faraonit, hodhi prapa krahëve të gjitha mirësitë që gëzonte dhe la pas edhe atdheun e tij. Ai nuk mund të hiqte dorë nga rruga e të heshtte para despotëve, të cilët nuk duan t'ia dinë për të dhunuarin nga padrejtësitë.

¹ Fjala e ajetit “*tedhūdāni*” në rrënjën e saj “dhūd” do të thotë: ndalim; të dyja vajzat i ndalonin dhentë e veta që të mos përziheshin me dhentë e të tjerëve.

² Fraza e ajetit “*mā khatbukumā*” do të thotë: Si e keni punën? Çfarë bëni ju të dyja këtu?

Vajzat i thanë se prisnin derisa të tjerët t'u jepnin ujë bagëtime të tyre dhe të largoheshin. Në Kur'an thuhet: **“Ato të dyja i thanë: ne nuk u japim të pinë (bagëtime tona) derisa barinjtë të largohen me dhentë e tyre.”**¹

Dhe që Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) të mos i pyeste nëse e kishin apo jo të atin, vajzat shtuan: **“Babai ynë është shumë i vjetër”**; ai s'ka mundësi të nxjerrë ujë që të pijnë bagëtia; ne nuk kemi as vëlla që ta kryejë këtë punë, kështu që punën e bariut na mbetet ta kryejmë ne të dyja.

Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) u prek shumë nga fjalët e dy vajzave dhe po thoshte me vete: **“Ç'njerëz qenkan këta, që nuk e shikojnë me drejtësi atë që i bëhet padrejtësi?!”** Ai bëri përpara, mori kovën që ishte pranë pusit dhe e lëshoi në ujë. Thuhet se për ta nxjerrë këtë kovë të mbushur plot me ujë duheshin disa burra, por Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) e nxorri atë pa ndihmën e askujt, ashtu siç njofton ajeti: **“Ai u dha të pinin ujë (bagëtime të dy vajzave).”**

Thuhet se kur Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) u afrua pranë pusit, i qortoi barinjtë me këto fjalë: **“Ç'njerëz qenkeni?! Ju interesoheni vetëm për veten tuaj, ndërkohë që këto dy vajza qëndrojnë ndenjur?!”** Barinjtë i hapën vend dhe i thanë: **“Eja dhe mbushe kovën!”**. Ata e dinin se kur kova mbushej plot, duheshin dhjetë vetë për ta nxjerrë prej pusit.

Por Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), ndonëse ishte i pangrënë dhe i lodhur nga rruga e gjatë, e mbushi kovën, e tërhoqi lart pa ndihmën e askujt dhe u dha të pinin të gjitha

¹ Fjala e ajetit *“jusdire”* në rrënjën e saj *“sadere”* do të thotë: dalje prej ujit; kurse fjala tjetër *“err'rruâu”* është shumësi i fjalës *“rain”*, që do të thotë: roja i dhenve, bariu.

dhenve të vajzave. Ajeti vijues njofton për veprimin e tij: **“Pastaj u largua nën një hije dhe tha: ‘O Zoti im, unë kam nevojë për çdo të mirë që Ti do të më japësh.’”**.

Musai (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) ishte i lodhur dhe i uritur. Atë nuk e njihte askush në këtë qytet. Ai ishte i huaj dhe, në të njëjtën kohë ishte shumë i edukuar, sepse në lutjen që i drejtoi All’llahut nuk tha: “O Zoti im, unë dua këtë e atë, por tha: **“O Zoti im, unë kam nevojë për çdo të mirë që Ti do të më japësh”**; me këto fjalë, ai tregon vetëm nevojën e tij, ndërsa gjërat e tjera i lë në mëshirën e të Gjithëfuqishmit.

Puna e mirë, sa ndikim të lavdëruar ka, po aq begati të çuditshme sjell. Një punë e vogël për të arritur kënaqësinë e All’llahut, siç qe mbushja e kovës për të ndihmuar vajzat e privuara nga e drejta, hapi për Musain një kapitull të ri dhe shpalosi për të një botë të çuditshme me begati materiale dhe morale. Ai gjeti atë të fshehtë që e kërkonte prej shumë vitesh.

Ky kapitull i ri në jetën e Musait (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) fillon qysh kur erdhi tek ai njëra prej atyre vajzave me një hap të matur, që tregonte se ajo ishte me të vërtetë nga ato vajza që kanë turp të flasin me një djalë të ri të panjohur. Për më tepër, ajo u kthye tek ai shumë shpejt dhe i njoftoi lajmin që kishte për t’i dhënë. Për këtë, Kur’ani njofton: **“Njëra prej atyre të dyjave erdhi tek ai duke ecur e turpshme dhe i tha: Babai im të thërret që të paguajë shpërblimin për ujin që nxorre për bagëtitë tona.”**

Në zemrën e Musait (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) lindi një rreze shprese. Ai e ndjeu se e priste një ngjarje e madhe dhe se një burrë i rëndësishëm do të ishte përballë tij; një burrë që e njihte të drejtën e tjetrit e se nuk mund të linte pa i paguar shpërblimin

edhe për mbushjen e një kove me ujë. Ky burrë patjetër që ishte një njeri model dhe hyjnor. Ky njeri i madh ishte vetë Shuajbi, Profeti që u bënte thirrje njerëzve për vite me radhë që t'i drejtoheshin All'llahut. Ai jo vetëm që e njohte të drejtën, por edhe e kërkonte atë. Kur dy vajzat e tij u kthyen aq shpejt, ai pyeti për shkakun dhe pasi mësoi se si qëndronte puna, vendosi që të plotësonte detyrimin ndaj atij të riu.

Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) u nis dhe arriti në shtëpinë e Shuajbit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*). Sipas disa transmetimeve, vajza ecte para Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) që t'i tregonte atij rrugën, por era ia ngrinte lart rrobat dhe mbase i ka zbuluar edhe kërcijtë e këmbëve. Prandaj Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), si njeri i ndershëm e i turpshëm që ishte, i kërkoi vajzës të dilte mbrapa dhe vetë ecte para saj.¹

Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) hyri në shtëpinë e Shuajbit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*). Ajo shtëpi shndriste prej dritës së Profetësisë; në çdo cep të saj rrezatonte hyjnorja. Ai pa një plak të moshuar ulur në një qoshe të asaj shtëpie, i cili e përshëndeti Musain (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) dhe e pyeti se nga vinte, pse kishte ardhur në qytet dhe pse ishte vetëm. I bëri edhe pyetje të tjera të kësaj natyre.

Në lidhje me këtë pjesë të këtij tregimi, Kur'ani Famëlartë njofton: **"...kur ai (Mūsà) erdhi tek ai dhe i tregoi atij ngjarjen, ai i tha: mos u frikëso, paske shpëtuar prej njerëzve mizorë."** Vendi ynë është larg sundimit të tyre, prandaj mos u frikëso dhe hiqe mendjen prej egërsisë së tyre. Tani je në një vend të sigurtë dhe mos

¹ Shih në tefsirin "Nùruth Thekalejn", fundi i ajetit që është objekt studimi.

mendo se je në kurbet. Me mirësinë e All'llahut, të gjitha punët për ty do të jenë shumë të lehta.

Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) e kuptoi se kishte gjetur një mësues të madh, prej të cilit buronin krojet e diturisë së thellë. Prej këtij burri të moshuar, ai kishte mundësi të shuante etjen e madhe që kishte për dituri.

Por edhe Shuaibi (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) e ndjeu se gjendej përballë një nxënësi të denjë, me vlera të larta; në të ai pa gatishmërinë për të marrë dituri dhe për t'i transmetuar atij përvojën e jetës.

Dy hulumtime

1- Ku ndodhej Medjeni?

Medjen quhej qyteti ku banonte Shuaibi (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) me fisin e tij. Ky qytet ndodhej në lindje të gjirit të Akabes [në veri të Hixhazit dhe në jug të tokave të Shamit]. Banorët e tij ishin prej pasardhësve të Ismailit, djalit të Ibrahimit, mikut të All'llahut. Ata bënë tregti me Egjiptin, Palestinën dhe Libanin.

Në ditët e sotme, emri *Medjen* përputhet me emrin *Meàn*.

Disa interpretues të Kur'anit besojnë se *Medjen* ishte emri i një fisi që jetonte në zonën ndërmjet gjirit të Akabes dhe malit

Sijnà, i njohur me emrin *Tùri Sijnà*. Në Teurat, ky emër është përmendur edhe si *Medjàn*.¹

Disa interpretues të tjerë të Kur'anit mendojnë se emri *Medjen* i këtij qyteti lidhet me njërin prej bijve të mikut të All'llahut, Ibrahimit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), i cili quhej *Medjen* dhe ka jetuar në këtë qytet.²

Në hartat gjeografike të Jordanisë së sotme, duket se veçoritë e qytetit *Meàn*, që ndodhet në juglindje të saj, përputhen me qytetin *Medjen*.

2- Mësime të shumta që frymëzojnë përvojë

Në këtë pjesë të tregimit të Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) gjenden mësime të shumta që frymëzojnë përvojë.

a) Profetët e All'llahut kanë qenë gjithmonë mbrojtës të të dhunuarve nga padrejtësitë. Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), si kur ishte në Egjipt, ashtu edhe kur erdhi në *Medjen*, i vinte keq kur shihte të bëheshin padrejtësi dhe kur shkeleshin të drejtat e njerëzve. Ai u vinte atyre në ndihmë. E përse të mos vepronte kështu, kur një prej qëllimeve të dërgimit të Profetëve është ndihma për të dhunuarit nga padrejtësisë?!

b) Kryerja e një pune të vogël për hir të All'llahut ka begati të shumta.

Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) bëri një punë krejt të thjeshtë, kur u mbushi kovën e ujit dhe u dha të pinin bagëtive të dy vajzave, por me këtë gjë, ai nuk kishte qëllim tjetër përveçse të arrinte kënaqësinë e All'llahut, të Gjithëfuqishmit, Atij që nuk i mungon asgjë e nuk ka asnjë nevojë.

¹ Lexo në "A'làmul Kur'àn", f. 573.

² Lexo tefsirin "Rùhul Meànij", vëll. 20, f. 51.

Por, prej asaj pune të vogël erdhën shumë të mira e begati. Ajo u bë shkak që ai të shkonte në shtëpinë e Profetit të All'Ilahut, Shuajbit (*Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!*), të shpëtonte prej kurbetit, të gjente një strehë ku të ndihej i sigurtë dhe ku kishte ushqim të përshtatshëm, veshje dhe një grua të mirë. Por më i rëndësishëm nga të gjitha këto qe takimi i tij me Shuajbin (*Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!*). Ai u takua me atë burrë të moshuar, por që kishte një ndërgjegje të gjallë dhe pasonte një fe qiellore. Musai (*Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!*) jetoi me të njëzet vjet dhe aty u përgatit për të udhëhequr popullin e asaj kohe.

c) Robtë e All'Ilahut nuk lënë të shkojë kot asnjë punë, veçanërisht ato që bëjnë njerëzit e sinqertë. Ky ishte shkaku që, sapo u njoftua për punën që kishte bërë Musai (*Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!*), Profeti i All'Ilahut nuk gjente qetësi derisa dërgoi dhe e thirri që t'i jepte shpërblimin për të.

d) Në këtë çështje të tërheq vëmendjen fakti se Musai (*Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!*) e përmendte gjithmonë All'Ilahun, kërkonte ndihmë vetëm prej Tij dhe për të gjitha problemet mbështetej vetëm tek Ai.

Kur vrau koptin dhe kuptoi se kishte lënë pa bërë punën me më shumë përparësi, i kërkoi menjëherë All'Ilahut faljen e gabimit, ashtu siç e lexuam në ajetin e mësipërm: **“Ai (Mùsà) tha: ‘O Zoti im, unë i bëra padrejtësi vetes, më fal mua.’”**.

Kur Musai (*Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!*) doli jashtë Egjiptit, i kërkoi All'Ilahut që ta shpëtonte, ashtu siç njofton ajeti: **“...tha: ‘O Zoti im, më shpëto prej njerëzve mizorë.’”**.

Edhe kur u nis për në tokën e Medjenit, ai tha: **“...tha: All'Ilahu patjetër do të më orientojë të ndjek rrugën e duhur.”**.

Edhe kur u dha të pinin ujë dhenve të Shuajbit (*Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!*), ai u largua nën një hije dhe iu lut vetëm

Zotit të tij: **“...dhe tha: ‘O Zoti im, unë kam nevojë për çdo të mirë që Ti do të më japësh.’”**.

Kjo lutje e fundit bëhej në një kohë kur ai gjendej në një rrugë pa krye dhe kur kishte nevojë më shumë se kurrë. Megjithatë, edukata e tij ishte e lartë dhe falë saj, ai nuk i kërkoj All'llahut t'ia plotësonte nevojat që kishte, por me shumë modesti i kërkoj edhe më shumë: **“...dhe tha: ‘O Zoti im, unë kam nevojë për çdo të mirë që Ti do të më japësh.’”**.

e) Nuk duhet të mendojmë se Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) e përmendte All'llahun vetëm kur gjendej para vështirësive të mëdha. Jo! Ai nuk harronte ta përmendte Atë as atëherë kur jetonte në mesin e të mirave e në mirëqenie të plotë në pallatin e Faraonit. Në lidhje me këtë çështje, në transmetimet islame lexojmë: “Në vegjëlinë e tij, një ditë teksa ndodhej pranë Faraonit, Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) teshtiu dhe tha: **“...falënderimi e lavdërimi janë vetëm për Zotin e botëve.”** Faraoni e kundërshtoi ashpër këtë fjalë dhe e goditi me shpullë në fytyrë. Pastaj e pyeti: **“Ç’është kjo fjalë që thua?”**

Ndërkaq, fëmija e kapi Faraonin për mjekre dhe gati sa nuk ia shkuli. Faraoni ndjeu një dhimbje të fortë dhe vendosi ta vriste, por gruaja e tij i tha: **“Ky është fëmijë dhe nuk e di se ç’thotë, por ti e godite me shpullë aq fort, saqë i mbeti shenja në fytyrë. Kjo është mjaft për atë dhe për ty!”**.¹

¹ Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 4, f. 117.

Ajetet: 26 - 28

قَالَتْ إِحْدَاهُمَا يَا أَبَتِ اسْتَجِرْهُ إِنَّ خَيْرَ مَنِ اسْتَجَرْتَ الْقَوِيُّ الْأَمِينُ ﴿٢٦﴾
 قَالَ إِنِّي أُرِيدُ أَنْ أُنكِحَكَ إِحْدَى ابْنَتَيَّ هَاتَيْنِ عَلَى أَنْ تَأْجُرَنِي ثَمَنِي حَبِجٍ
 فَإِنْ أَتَمَمْتَ عَشْرًا فَمِنْ عِنْدِكَ وَمَا أُرِيدُ أَنْ أَشُقَّ عَلَيْكَ سَتَجِدُنِي إِنْ شَاءَ
 اللَّهُ مِنَ الصَّالِحِينَ ﴿٢٧﴾ قَالَ ذَلِكَ بَيْنِي وَبَيْنَكَ أَيَّمَا الْأَجَلَيْنِ قَضَيْتُ فَلَا
 عُدْوَانَ عَلَيَّ وَاللَّهُ عَلَى مَا نَقُولُ وَكِيلٌ ﴿٢٨﴾

“Njëra prej atyre të dyjave tha: O baba, merre këtë në shërbim me pagesë. Në të vërtetë, më i miri që do të marrësh në shërbim me pagesë, është i fuqishmi, besniku.”

“Ai (Shuajbi) tha: Unë dëshiroj të martoj ty me njërën prej këtyre dy vajzave të mia, me kusht që të shërbesh tek unë tetë vjet dhe, nëse plotëson dhjetë, kjo është me dëshirën tënde; unë nuk dua të rëndoq dhe, në dashtë All’llahu, do të gjesh se unë jam prej atyre që e mbajnë fjalën.”

“Ai (Mùsà) tha: kjo le të jetë në mes ne të dyve; cilin prej dy afateve të plotësoj, mbi mua nuk do të ketë asnjë pretendim (për më shumë kohë shërbimi) dhe për këto që po themi në mes nesh, garant kemi All’llahun.”

Komentimi

Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) në shtëpinë e Shuajbit

Kjo është pjesa e shtatë e tregimit prej jetës së Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*). Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) erdhi në shtëpinë e Shuajbit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), e cila ishte një shtëpi fshati e thjeshtë dhe e pastër. Pasi i tregoi mikpritësit se si e kishte punën, njëra prej vajzave të Shuajbit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) filloi të fliste dhe me një fjali të shkurtër i sugjeroi të atit që ta merrte Musain (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) në shërbim me pagesë, për të ruajtur dhentë. Për këtë, ajeti njofton: **“Njëra prej atyre të dyjave tha: O baba, merre këtë në shërbim me pagesë. Në të vërtetë, më i miri që do të marrësh në shërbim me pagesë, është i fuqishmi, besniku.”**

Kjo vajzë e rritur dhe e edukuar pranë këtij Profeti të madh, sigurisht që nuk mund të thoshte fjalë të tjera përveç kësaj fraze të shkurtër dhe t'i vlerësonte cilësitë e Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) me kaq pak fjalë.

Vallë, nga e kuptoi ajo vajzë se ky djalë ishte i fuqishëm dhe besnik? Ajo e pa atë për herë të parë te pusi dhe nuk e dinte të kaluarën e jetës së tij.

Përgjigjja për këtë pyetje është shumë e qartë: ajo e pa fuqinë e tij kur ai mënjanoi barinjtë prej pusit; e pa se si e mbushi kovën e rëndë dhe si e nxorri atë prej pusit pa ndihmën e askujt; e pa se si e kërkonte të drejtën e të dhunuarit nga padrejtësia.

Gjithashtu, edhe besnikëria e sinqeriteti i tij u dukën qartë qysh kur ajo filloi të ecte para tij për ta çuar në shtëpinë e të atit dhe i kërkoi asaj që të ecte mbrapa tij, me qëllim që të mos ia shihte këmbët kur ia ngrinte era rrobat.

Fuqia e tij u shpalos edhe gjatë bisedës me Shuajbin (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), kur i tregoi se si kishte ndërhyrë për të ndarë koptin nga izraeliti dhe se si e kishte vrrarë atë vetëm me një goditje me grusht. Ndërsa besnikëria e sinqeriteti i tij dalloheshin nga brendia e fjalëve dhe nga sa tregoi, kuptohej qartë se ai nuk bënte pazar me tiranët.

Shuajbi (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) e miratoi propozimin e vajzës së tij dhe iu drejtua Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) me fjalët që i lexojmë në ajetin vijues: **“Ai (Shuajbi) tha: Unë dëshiroj të martoj ty me njëren prej këtyre dy vajzave të mia, me kusht që të shërbesh tek unë tetë vjet”,** pastaj menjëherë shtoi: **“...dhe, nëse plotëson dhjetë, kjo është me dëshirën tënde.”**¹

Shuajbi (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) i tha këtij të riu që nuk donte ta rëndonte, ashtu siç përmendet edhe në ajetin e mëposhtëm: **“Unë nuk dua të rëndoj dhe, në dashtë All'llahu, do të gjesh se unë jam prej atyre që e mbajnë fjalën”;** *Unë i qëndroj fjalës së dhënë dhe marrëveshjes që bëme, nuk do të të shtrëngoј në punë dhe, në dashtë All'llahu, nga unë do të trajtohesh vetëm me mirësi.*

¹ E njëjta përmbajtje është cituar në tefsirin e Ali bin Ibrahimit, vëll. 2, f. 138, ku tregohet se Shuajbi (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) i tha vajzës së tij: *“Fuqinë e tij e kuptove kur ai nxorri kovën prej pusi pa ndihmën e askujt, por nga e kuptove se ai është njeri besnik?”*. Vajza u përgjigj: *“Kur ai më tha të ecja mbrapa tij dhe më kërkoi t'i tregoja rrugën, duke shtuar se i përkiste një populli që nuk i shihnin vithet e grave. Aty e kuptova besnikërinë e tij.”*.

Këtu lindin pyetje të shumta rreth martesës së Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) me vajzën e Shuajbit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*). Hollësitë në lidhje me shumën e kurorës (*mehrin*) dhe me të gjitha veçantitë që kanë të bëjnë me këtë çështje, do t'i trajtojmë në paragrafin "Hulumtime".

Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) e pranoi marrëveshjen e ofruar nga Shuajbi (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) dhe i tha: "**Ai** (Mùsài) **tha: kjo le të jetë në mes ne të dyve.**".

Pastaj shtoi: "**Cilin prej dy afateve të plotësoj, mbi mua nuk do të ketë asnjë pretendim** (për më shumë kohë shërbimi)", pra si plotësova dhjetë, si plotësova tetë vjet, për mua do të jetë njëlloj dhe nuk do të ketë asnjë pretendim për afatin.

Me qëllim që marrëveshja midis tyre të ishte sa më e përsosur, Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) bëri garant All'llahun dhe tha: "**...dhe për këto që po themi në mes nesh, garant kemi All'llahun**". Ja, kaq thjeshtë, Musai u martua me vajzën e Shuajbit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) dhe u bë dhëndër i tij.

Hulumtime

1- Dy kushte themelore për një administrim të mirë

Në ajetin e mësipërm u përmend se dy cilësitë më të rëndësishme që kishte vënë re vajza e Shuajbit (*Paqja e All'llahut*

qoftë mbi të!) te Musai (*Paqja e All'lahut qoftë mbi të!*) ishin fuqia dhe besnikëria.

Është shumë domethënës fakti se me fjalën “fuqi”, që u përmend në ajetin e mësipërm, nuk është si qëllim vetëm fuqia trupore, por edhe fuqia për të mbajtur përgjegjësinë.

Mjek i fuqishëm dhe besnik, është ai që ka dituri të mjaftueshme dhe që e zotëron mirë profesionin e vet. Drejtor i mirë është ai që i njeh bazat e administrimit si dhe objektivat e kërkuara; ai e ka nën administrim të plotë gjendjen e planeve dhe të programeve, ka njohuri për teknologjitë e reja dhe është i aftë në organizimin e punëve. Në këtë këndvështrim, fjala “fuqi” do të thotë: fuqia për të ndjekur rrugën që të çon drejt arritjes së objektivit.

Në të njëjtën kohë, një drejtor i tillë është i mëshirshëm, këshillon për të mirë dhe është besnik dhe i sinqertë në punën që i është besuar.

Njerëzit që hiqen se e kuptojnë përgjegjësinë që u është besuar dhe se janë besnikë e të pastër, gabojnë në atë masë sa edhe ai që mbështetet vetëm në dijen.

Specialistët dhe shkencëtarët që janë shmangur nga e vërteta, i sjellin shembujt e tyre, ashtu siç i sjellin edhe njerëzit e sinqertë, prandaj duken se kanë dije dhe se e bëjnë punën me mjeshtëri.

Kur një shtet ka për qëllim të shkatërrojë një shtet tjetër, ai mbështetet në njërën prej këtyre dy kategorive të njerëzve: në drejtuesit që tradhtojnë “emanetin”, pra që tradhtojnë detyrën që

u është besuar, si dhe në të sinqertët, që duket se kanë vetëm dituri. Sigurisht, rezultati i mbështetjes në çdonjërin prej këtyre dy kategorive do të jetë vetëm një.

Logjika e Islamit është që puna t'i besohet një njeriu të fuqishëm, besnik dhe me aftësitë e duhura për ta çuar sistemin shoqëror drejt plotësismit. Nëse do të kërkojmë shkakun e asgjësimit të qeverive përgjatë historisë, do të shohim se faktori kryesor është lënia e punës drejtuese në dorën e njëres prej dy kategorive që u përmendën më lart.

Në Islam kërkohet që në të gjitha punët, dituria e devotshmëria (frika ndaj All'llahut) të jenë të ndërthurura me njëra-tjetrën.

Ai që vihet në krye të punëve, duhet të jetë punëtor dhe i drejtë. Edhe gjykatësi e komandanti duhet të jenë punëtorë dhe të drejtë. Për drejtuesit kërkohet plotësimi i shumë kushteve të tjera, por bazë e të gjithave janë: dituria, devotshmëria dhe drejtësia.

2- Pyetje rreth martesës së Musait (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) me vajzën e Shuajbit (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)

Më lart u tha se ajetet që janë objekt studimi shtrojnë pyetje të shumta në brendinë e tyre.

a) Bazuar në ligjin fetar, a lejohet që gruaja të mos ketë dijeni për martesën e saj, meqenëse në formulimin e akt-martësës, Shuajbi (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) thotë: **“të martoj ty me njërin prej këtyre dy vajzave?”**.

Përgjigje: Frazja e ajetit: **“të martoj ty me njërën prej këtyre dy vajzave të mia”** është thënë gjatë formulimit të akt-martësës. Duket qartë se janë zhvilluar bisedime paraprake dhe vetëm pas miratimit nga ana e Musait (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) u bë formulimi i aktit të martësës, ashtu siç thuhet në ajetin e mësipërm.

b) A ka mundësi që *mehri* (shuma e kurorës) të mos dihet, ose të mendohet që është më shumë, ose më pak?

Përgjigje: Prej fjalëve të ajetit kuptohet se shuma e kurorës ishte tetë vjet shërbim, kurse dy vitet e tjera janë lënë në vullnetin e Musait (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*); nëse ka dëshirë, ai i plotëson ato dy vjet ose jo.

c) A lejohet që shuma e kurorës (*mehri*) të jetë shërbimi, ose puna?¹

Si mund të merret gruaja bazuar mbi këtë shumë kurore dhe si mund të jetosh me të si bashkëshorte, në një kohë kur shuma e kurorës nuk është plotësuar dhe kur nuk është e mundur që ajo të plotësohet në një vend të vetëm?

Përgjigje: Në të vërtetë, nuk ka ndonjë argument që e bën të pavlefshme këtë shumë kurore. Nga ana tjetër, ka argumente të

¹ Vërtetuesi i haditheve El Hil’lij, në librin “Esh Sheràiu”, ka thënë: “Akt-martesa është e vlefshme edhe kur lidhet me kushtin që shuma e kurorës të jetë në formën e një dobie, si mësimi i një mjeshtërie, ose i një sureje të Kur’anit dhe të çdo pune të lejuar, siç mund të jetë marrja e burrit në shërbim kundrejt pagesës për një kohë të caktuar. Juristi i madh i ligjit të fesë islame, shejhu Muham’med Hasan, autori i librit “El Xheuàhir”, pasi e ka përmendur këtë shprehje, ka thënë: “Me miratimin e juristëve më të dëgjuar të fesë”, “Xheuàhirul Kelàm”, vëll. 31, f. 4.

shumta, sipas të cilave në shumën e kurorës përfshihet çdo gjë që ka një vlerë.

Gjithashtu, nuk është kusht që shuma e kurorës të shlyhet në një vend të caktuar, por është e mjaftueshme që ajo të jetë nën ruajtjen e burrit dhe gruaja të jetë zotëruese e saj.

Rregulli i sigurisë dhe i shoqërimit kërkojnë që ky burrë të jetojë për një kohë, gjatë së cilës ka mundësi të shlyejë këtë shumë kurore.

d) Si është e mundur që shërbimi ndaj babait, të konsiderohet si shumë kurore për vajzën e tij? A është shuma e kurorës, një mall që shitet kundrejt shërbimit?

Përgjigje: S'ka dyshim se Shuajbi (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) u kujdes për të ruajtur të drejtën e vajzës dhe për të marrë miratimin e saj. Në këtë rast, zotëruesi i shumës së kurorës është nën mbrojtjen e Musait (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) është vetë gruaja e tij, vajza e Shuajbit (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!).

Por meqenëse ata jetonin bashkërisht në të njëjtën shtëpi dhe ndërmjet tyre nuk kishte dallim e ndarje, edhe çështja e shlyerjes së borxhit nuk mund të ishte objekt bisedimi për mënyrën se si do mbahej besa për të paguar shumën e kurorës.

Këtu është i rëndësishëm fakti se zotëruesja e shumës së kurorës ishte vetë vajza dhe jo babai; edhe vetë shërbimet që kreu Musai (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) u bënë bazuar në këtë fakt.

dh) Shuma e kurorës për vajzën e Shuajbit (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) ishte mjaft e rëndë. Nëse do të llogarisim pagën e punëtorit të zakonshëm gjatë një muaji, pastaj gjatë një viti dhe

pagën e një viti ta shumëzohjmë me tetë vjet, do të rezultojë një shumë mjaft e madhe.

Përgjigje: Në radhë të parë duhet thënë se ajo martesë nuk ishte një martesë e thjeshtë. Në të vërtetë, ajo qe si një parathënie për qëndrimin e Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) pranë Shuajbit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), që ai të mësonte në atë shtëpi mënyrën e sjelljes dhe rrugën e këtij Profeti të madh. Ajo ishte një periudhë paraprake, gjatë së cilës Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) studioi në një “universitet” të madh për një kohë të gjatë. Vetëm All'llahu e di më mirë se sa gjëra mësoi Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) prej “plakut të Medjenit”.

Pas këtyre që u përmendën, sikur ne të themi se gjatë kohës që Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) kaloi në shërbim të Shuajbit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) ky i fundit e kishte detyrim të përballonte edhe shpenzimet për atë e për gruan e tij dhe, sikur të marrim me mend shpenzimet që ai ka bërë për Musain prej pagës që i jepte atij, shuma e kurorës nuk rezulton të jetë aq e lartë; madje pas heqjes së shpenzimeve të domosdoshme, ajo shumë kurore mbetet gati simbolike.

3- Emrat e dy vajzave të Shuajbit

Interpretuesit e Kur'anit i kanë përmendur emrat e dy vajzave të Shuajbit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) dhe kanë thënë se njëra quhej *Safûrâ* dhe ishte gruaja e Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), kurse vajza tjetër quhej *Lijâ*.¹

¹ Tefsiri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 7, f. 249.

Ajetet: 29 - 35

﴿ فَلَمَّا قَضَىٰ مُوسَى الْأَجَلَ وَسَارَ بِأَهْلِهِ ۚ آنَسَ مِنْ جَانِبِ الطُّورِ نَارًا ۚ قَالَ لِأَهْلِهِ امْكُثُوا إِنِّي آنَسْتُ نَارًا لَّعَلِّي آتِيكُم مِّنْهَا بِخَبَرٍ أَوْ جَذْوَةٍ مِّنَ النَّارِ لَعَلَّكُمْ تَصْطَلُونَ ﴾ ﴿٢٩﴾ فَلَمَّا أَتَاهَا نُودِيَ مِنْ شَاطِئِ الْوَادِ الْأَيْمَنِ فِي الْبُقْعَةِ الْمُبَارَكَةِ مِنَ الشَّجَرَةِ أَنْ يَمُوسَىٰ إِنِّي أَنَا اللَّهُ رَبُّ الْعَالَمِينَ ﴿٣٠﴾ وَأَنْ أَلْقِ عَصَاكَ فَلَمَّا رَآهَا تَهْتَزُّ كَأَنَّهَا جَانٌّ وَلَّى مُدْبِرًا وَلَمْ يُعَقِّبْ يَمُوسَى أَقْبَلَ وَلَا تَخَفْ ۚ إِنَّكَ مِنَ الْآمِنِينَ ﴿٣١﴾ أَسْلُكَ يَدَكَ فِي جَيْبِكَ تَخْرُجُ بَيْضَاءَ مِنْ غَيْرِ سَوْءٍ وَأَضْمُمُ إِلَيْكَ جَنَاحَكَ مِنَ الرَّهْبِ ۚ فَذَلِكَ بَرْهَنَانِ مِنْ رَبِّكَ إِلَىٰ فِرْعَوْنَ وَمَلَئِهِ ۚ إِنَّهُمْ كَانُوا قَوْمًا فَٰلسِقِينَ ﴿٣٢﴾ قَالَ رَبِّ إِنِّي قَتَلْتُ مِنْهُمْ نَفْسًا فَأَخَافُ أَنْ يَقْتُلُونِ ﴿٣٣﴾ وَأَخِي هَارُونُ هُوَ أَفْصَحُ مِنِّي لِسَانًا فَأَرْسَلْهُ مَعِيَ رِدْءًا يُصَدِّقُنِي ۚ إِنِّي أَخَافُ أَنْ يُكَذِّبُونِ ﴿٣٤﴾ قَالَ سَنَشُدُّ عَضُدَكَ بِأَخِيكَ وَنَجْعَلُ لَكُمَا سُلْطٰنًا فَاذْهَبَا إِلَىٰ فِرْعَوْنَ ۖ إِنَّهُ طٰغِي ۖ ۭ يَتَّبِعُ كُومًا مَّا لِي غٰلِبُونَ ﴿٣٥﴾

“Kur Mùsài e plotësoi afatin, udhëtoi me familjen e vet; ai pa nga larg kah ana e Tùrit një zjarr dhe i tha familjes së tij: qëndroni këtu, unë pashë një zjarr, mbase u sjell prej zjarrit ndonjë lajm, ose ndonjë urë zjarri të ndezur që të ngroheni.”

“Dhe kur ai arriti te zjarri, nga e djathta e luginës së atij vendi të bekuar me pemë, u thirr: o Mùsà, pa dyshim unë jam All’llahu, Zoti i botëve.”

“Hidhe shkopin tënd; kur ai (Mùsà) pa shkopin të lëvizë si të ishte gjarpër, u kthye të largohet pa shikuar nga prapa; o Mùsà kthehu dhe mos u frikëso; pa dyshim ti je prej të siguruarve.”

“Fute dorën tënde në xhep, ajo do të dalë e bardhë pa pësuar ndonjë të keqe dhe shtrëngoje krahun tënd pas vetes kur të frikësohesh (nga bardhësia e dorës); këto janë dy argumente nga Zoti yt për te Faraoni dhe paria e tij; me të vërtetë, ata janë njerëz shkatërrues.”

“Ai (Mùsà) tha: O Zoti im, unë kam vrarë një njeri prej tyre dhe kam frikë se do të më vrasin.”

“Vëllai im është më orator se unë, dërgoje edhe atë me mua si ndihmës që të vërtetojë fjalët e mia; kam frikë se ata do të më përgënjeshtrojnë.”

“Ai (All’llahu) tha: do të forcojmë krahun me vëllain tënd dhe për ju të dy do të bëjmë të keni pushtet dhe me argumentet Tona, ata nuk do të arrijnë te ju të dy, ju të dy dhe pasuesit tuaj jeni triumfues.”

Komentimi

Shkëndija e parë e Shpalljes hyjnore

Askush nuk e di me hollësi se çfarë i ndodhi Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) gjatë dhjetë vjetëve që ai bashkëjetoj me Shuajbin (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*)¹ (1), por pa dyshim që ato ishin vitet më të mira të jetës së tij, vitet që e përgatitën atë për përgjegjësinë më të madhe.

Ishte e domosdoshme që Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) të kalonte një periudhë dhjetëvjeçare të jetës së tij në kurbet pranë Profetit të madh, Shuajbit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*). Gjithashtu, ishte e domosdoshme që ai të bëhej bari' i dhenve të këtij të fundit, për të pastruar shpirtin e tij nga ato gjëra që i ishin bërë zakon në jetën e tij të mëparshme. Veç kësaj, ai duhej të pastrohej edhe nga gjurmët që i kishin mbetur nga koha që kishte kaluar në pallatin e Faraonit.

Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) duhej të jetonte një periudhë kohe pranë banorëve të kasolleve, që të njëhej me hallet e me dhimbjet e tyre dhe që të përgatitej për t'iu kundërvënë banorëve të pallateve.

Nga ana tjetër, Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) kishte nevojë që të meditonte për një kohë të gjatë rreth sekreteve të krijimit, sekreteve të botës së gjallë, në mënyrë që të ndërtonte

¹ Prej transmetimeve islame mësohet se Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) punoi te Shuajbi (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) për dhjetë vjet. Kjo çështje është trajtuar në librin "Uesàilu Shijah", vëll. 15, f. 34; (libri "Kurora e martesës", kapitulli "Shuma e kurorës – mehri", paragrafi 22, vëll. 4).

edhe personalitetin e tij. A mund të kishte vend më të mirë për meditim sesa shkretëtira e Medjenit dhe shtëpi më të mirë sesa ajo e Shuajbit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*)?

Përgjegjësia e një Profeti, të cilësuar në Kur'an prej Profetëve "*të vendosur*" - "*ulul azmi*", sigurisht që nuk ishte e vogël dhe atë s'mund ta mbante çdokush. Përkundrazi, mund të thuhet se pas përgjegjësisë së Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), përgjegjësia e Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) ishte më e rënda dhe më e rëndësishmja, duke marrë parasysh detyrat e tij të shumta, si përballja me tiranët e asaj toke, shpëtimi i kombit të tij prej skllavërisë dhe pastrimi i mendjes së tyre prej ndikimeve kulturore të skllavërisë.

Në Teurat dhe në disa transmetime islame lexojmë se Shuajbi (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), për të nderuar Musain (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) për punën që bënte për të, kishte vendosur t'i dhuronte atij të gjithë qingjat që do të lindnin me shenja të veçanta. Në vitin që Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) i la lamtumirën Shuajbit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) rastisi që të gjithë dhentë, ose shumica e tyre, i lindën qingjat me shenja të veçanta dhe Shuajbi (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) ia dhuroi me gjithë zemër atij.¹

Natyrisht që Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) nuk mund ta kalonte gjithë jetën e tij duke ruajtur dhentë, edhe pse për atë, prania e Shuajbit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) konsiderohej prej mirësive më të mëdha.

¹ Lexo "A'âmul Kur'an", f. 409

Detyra e Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) ishte që të shkonte në ndihmë të kombit të vet dhe t'i shpëtonte ata jo vetëm prej prangave të skllavërisë, por edhe prej injorancës.

Detyra e tij ishte që t'u jepte fund mizorëve dhe sundimtarëve tiranë në Egjipt, të shkatërronte idhujt dhe të fuqizonte të dhunuarit nga padrejtësitë. Kjo ndjenjë e shtynte Musain (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) që të merrte rrugën e të gjendej sa më shpejt në mesin e kombit të vet.

Më në fund, ai bëri përgatitjet për udhëtim. Mblodhi orenditë, sendet e nevojshme dhe dhentë e tij.

Nga kuptimi që shpreh fjala “ehl” – “**familje**” që në Kur'an ka ardhur në shumë ajete, mësohet se në këtë udhëtim, përveç gruas së tij, Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) kishte me vete edhe një fëmijë, ose disa. Ky kuptim i fjalës “familje” theksohet jo vetëm në transmetimet islame, por për të është folur qartë edhe në Teurat, në kapitullin “Dalja”. Gjithashtu, duhet shtuar se gruaja e tij ishte shtatzanë.

Gjatë rrugës së kthimit për në atdheun e vet prej Medjenit, me qëllim që të mos binte rob në duart e banditëve prej banorëve të Shamit, ai udhëtoi në një rrugë të pashkelur dhe kështu e humbi drejtimin.

Gjithsesi, në ajetin e parë të grupit të ajeteve që janë objekt studimi, Kur'ani thotë: **“Kur Mùsài e plotësoi afatin, udhëtoi me familjen e vet; ai pa nga larg kah ana e Tùrit një zjarr”,** pastaj i tha familjes së tij: **“...dhe i tha familjes së tij: qëndroni këtu, unë pashë një zjarr, mbase u sjell prej zjarrit ndonjë lajm, ose ndonjë urë zjarri të ndezur që të ngrohëni.”**

Fjala e ajetit “*ànestu*” në rrënjën e saj “*ijnàs*” do të thotë: shikim i shoqëruar me qetësi e kënaqësi.

Fjala e ajetit “*xhedhuetin*” do të thotë: një pjesë zjarri. Disa interpretues kanë thënë se kjo fjalë ka kuptimin: pjesë e madhe e një druri të ndezur.

Prej frazës së ajetit “**mbase u sjell prej zjarrit ndonjë lajm**”, mësohet se ai kishte humbur rrugën. Gjithashtu, prej frazës tjetër: “**që të ngroheni**”, mësohet se ishte natë dhe bënte ftohtë.

Në ajet nuk bëhet fjalë për gruan e Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), por sipas thënieve më në zë, të ardhura në librat e tefsirit dhe në transmetimet islame, mësohet se ajo ishte shtatzanë dhe se në ato çaste filloi të ndjente dhimbjet e lindjes, prandaj Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) ishte i shqetësuar edhe për gjendjen e saj. “**Dhe kur ai arriti te zjarri**”, që e kishte parë nga larg, e kuptoi se ai nuk ishte një zjarr i zakonshëm; ai zjarr as nuk ngrohte e as nuk digjte, por ishte si një copë drite e pastër; Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) u çudit nga kjo gjë, ndërkohë që: “**...nga e djathta e luginës së atij vendi të bekuar me pemë, u thirr: o Mùsà, pa dyshim Unë jam All'llahu, Zoti i botëve.**”.

Fjala e ajetit “*shàti'i*” do të thotë: breg deti.

Fjala “*el vâdij*” do të thotë: rrugë kalimi midis dy maleve, ose rrjedhë përrenjsh.

Fjala “*el ejmen*” është nxjerrë prej rrënjës së saj “*el jemijn*” – “*djathtas*” e kundërta e së majtës, që është cilësi për luginën.

Fjala e ajetit “*el buk'ati*” ka kuptimin: një parcelë me anë të njohura.

S'ka dyshim se i Gjithëfuqishmi, All'llahu i Lartësuar, mund të krijojë valë zanore në çdo send. Në atë luginë, Ai bëri një pemë që t'i fliste Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), i cili ishte njeri me trup e me veshë, prandaj patjetër që e ka dëgjuar fjalën në saje të valëve zanore. Zakonisht, të gjithë Profetëve, shpallja herë u vinte në formën e frymëzimit të brendshëm, herë kur ishin në gjumë dhe herë tjetër me rrugën e dëgjimit të valëve zanore.

Sido që mund të ketë zbritur Shpallja, nuk ka vend të pandehim se All'llahu mori formën e një trupi konkret.

Në disa transmetime thuhet se kur u afrua, Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) i hapi sytë mirë dhe pa se zjarri dilte prej një dege të gjelbër; ky zjarr herë pas here shtoej dhe dukej më i bukur. Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) u përkul mbi zjarrin me një degë të thatë në dorë, që ta ndizte aty, por kur pa se zjarri vinte drejt tij prej një dege të gjelbër, u frikësua dhe u spraps; pastaj u rikthye që të merrte një urë të ndezur prej atij zjarri. Herë afrohej ai te zjarri e herë afrohej zjarri tek ai. Ndërkaq, ai dëgjoi thirrjen dhe përgëzimin për Shpalljen që i vinte atij prej All'llahut, të Gjithëfuqishmit, prej Atij që s'ka nevojë për asnjë send dhe të Cilit nuk i mungon asgjë.

Duke parë edhe shembujt krahasues në ajete të ndryshme të Kur'anit që flasin për Musain (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), ai e kuptoi qartë se thirrja që dëgjoi nuk mund të ishte tjetër veçse një thirrje prej All'llahut.

Meqenëse ai do të mbante një përgjegjësi të madhe, patjetër duhej që prej All'llahut ai të ishte i pajisur me mrekulli të mëdha, të përshtatshme për pozitën e tij Profetike. Ajetet që janë objekt

studimi tregojnë vetëm për dy nga mrekullitë e shumta, me të cilat ai shkoi te Faraoni dhe te Beni Israilët.

Mrekullia e parë njoftohet me fjalën e All'llahut, të Lartit: **“Hidhe shkopin tënd; kur ai (Mùsà) pa shkopin të lëvizë si të ishte gjarpër, u kthye të largohet pa shikuar nga prapa.”**.

Ditën që Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) zgjodhi këtë shkop që të mbështetej mbi të dhe të ruante dhentë e tij me të, nuk mund ta besonte se në brendi të tij, All'llahu i Lartësuar kishte mbledhur një fuqi kaq të madhe. Por ky shkop i thjeshtë do të trondiste pallatet e mizorëve.

Ti mund të mendosh se sendet që gjenden në këtë botë janë të pavlefshme, por në to All'llahu ka mbledhur fuqi të mëdha, të cilat shfaqen vetëm me urdhër të Tij dhe vetëm kur do Ai.

Në këtë gjendje, Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) e dëgjoji përsëri thirrjen që vinte prej pemës: **“O Mùsà, kthehu dhe mos u frikëso; pa dyshim ti je prej të siguruarve.”**.

Në rrënjën e saj, fjala e ajetit “*el xhàn'n*” tregon një qenie që nuk shihet me sy, por ajo përdoret edhe në kuptimin e gjarprit, për shkak se gjarpërinjtë zvarriten nëpër barishte e nëpër gurë në mënyrë të padukshme. Gjithashtu, në dy sure të Kur'anit, ky shkop cilësohet me shprehjen: “*thu' bânun mubijn*” (sure “El A'râf”, ajeti 107 dhe sure “Esh Shuarâ”, ajeti 32).

Më sipër kemi thënë se ky ndryshim në shprehje, mbase është bërë për të shpjeguar qartë gjendjet e ndryshme të atij “gjarpri”, i cili në fillim u shfaq si gjarpër i vogël dhe pastaj u

shndërrua në një gjarpër të madh. Gjithashtu, ka mundësi që Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) ta ketë parë shkopin në luginë në formën e një gjarpri të vogël, kurse herë të tjera shkopi shfaqej në një formë të frikshme, në atë të një gjarpri të madh.

Sido që të jetë, Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) duhej ta njihte patjetër të vërtetën dhe nuk duhej të kishte frikë para pranisë hyjnore, sepse siguria absolute është sunduese; aty ku ai ndodhej, nuk ishte vend për t'u frikësuar.

Mrekullia e parë ishte një argument “frikësues”. Pastaj ai urdhërohet që të shpalosë mrekullinë tjetër, që është dritë dhe shpresë. Të dyja mrekullitë do të ishin “paralajmërim” dhe “përgëzim”: **“Fute dorën tënde në xhep dhe ajo do të dalë e bardhë pa pësuar ndonjë të keqe!”**.

E bardha që shndriti në dorën e tij për ta parë njerëzit, nuk ishte e bardhë sëmundjeje, si ajo e lebrozës etj, por ishte një dritë e re hyjnore.

Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) u trondit shumë kur i pa këto gjëra të jashtëzakonshme në errësirën e natës, në mes të shkretëtirës, ku s'pipëtinte asgjë. Për ta qetësuar shpirtin e tij nga frika që e zuri, All'llahu i Lartësuar e urdhëroi të vendoste dorën në gjoks, ashtu siç njofton ajeti: **“...dhe shtrëngoje krahun tënd pas vetes kur të frikësohesh** (nga dora e bardhë)“.

Disa kanë thënë se fraza: **“...dhe shtrëngoje krahun tënd pas vetes kur të frikësohesh** (nga bardhësia e dorës)” është alegori që tregon domosdoshmëri të formës së prerë për një vendosmëri të palëkundur në mbajtjen e përgjegjësisë, sepse duke pasur parasysh mesazhin që do të kumtonte, ai nuk duhej të kishte frikë prej asgjëje, prej asnjë njeriu dhe asnjë fuqie. Mbase

kjo gjendje frike i ngjason asaj të shpendit kur vetëmbrohet, në kohën kur gjendet para armikut të tij sulmues; por kur ai armik largohet, shpendi kthehet në gjendjen e tij normale.

Menjëherë pas thirrjes që dëgjoi Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), atij i erdhi Shpallja: **“Këto janë dy argumente nga Zoti yt për te Faraoni dhe paria e tij; me të vërtetë ata janë njerëz shkatërrues.”**.

Ata njerëz si grup kishin dalë jashtë bindjes së All'llahut dhe tirania tek ata kishte arritur në shkallën më të lartë. Prandaj o Musa, misionin tënd do ta kryesh duke i këshilluar ata.

Këtu Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) iu kujtua një ngjarje shumë e rëndësishme, që i kishte ndodhur gjatë kohës kur ishte në Egjipt. Atij iu kujtua vrasja e koptit dhe ndjekja që i bënë njerëzit e Faraonit për ta kapur dhe për ta vrarë.

Ndonëse në atë ngjarje, Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) kishte qëllim vetëm ta shpëtonte të dhunuarin prej mizorit, në logjikën e Faraonit dhe të popullit të tij, e vërteta e ngjarjes nuk kishte kuptim. Ata ishin të vendosur për ta vrarë Musain (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) nëse do ta gjenin, prandaj ai, duke i kujtuar të gjitha këto, shpjegoi: **“Ai (Mūsà) tha: O Zoti im, unë kam vrarë një njeri prej tyre dhe kam frikë se do të më vrasin.”**.

Më pas, Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) tha: **“Unë jam vetëm dhe gjuha ime nuk flet rrjedhshëm”: “Vëllai im është më orator se unë, dërgoje edhe atë me mua si ndihmës, që të vërtetojë fjalët e mia; kam frikë se ata do të më përgënjeshtrojnë.”**.

Në rrënjën e saj, fjala e ajetit “*efsahu*” do të thotë: sendi është i pastër. Gjithashtu, kjo fjalë përdoret edhe kur thuhet: fjalë e singertë, në rast se në të s’ka asgjë të kotë.

Kurse fjala tjetër e ajetit “*rid’en*” do të thotë: ndihmës.

Kjo ishte një përgjegjësi shumë e madhe për Musain (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*). Që të mos dështonte, ai i kërkoi Zotit të tij që së bashku me atë, të dërgonte edhe vëllain e tij Harunin.

All’llahu i Lartësuar iu përgjigj lutjes së tij dhe e siguroi se kërkesa do t’i plotësohet: **“Ai (All’llahu) tha: do të forcojmë krahun me vëllain tënd dhe për ju të dy do të bëjmë të keni pushtet”** - ju të dy do të keni pushtet dhe fitore në të gjitha etapat e misionit tuaj.

All’llahu i përgëzoi të dy me ndihmë e me fitore dhe i siguroi, duke u thënë se e keqja e armiqve nuk do të arrinte kurrë tek ata, ashtu siç njoftohet në ajet: **“...me argumentet Tona, ata nuk do të arrijnë te ju të dy”**; me këto argumente e mrekulli, ata nuk kanë mundësi as t’ju vrasin e as t’ju dëmtojnë. Ajeti mbyllet me frazën: **“...ju të dy dhe pasuesit tuaj jeni triumfues”**.

Shpallja që All’llahu i zbreti Musait (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) ishte një shpresë shumë e madhe. Ajo ishte edhe një përgëzim i madh. Me këto dy “dhurata”, zemra e Musait (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) u siguraa; atij iu shtua vendosmëria dhe gjurmët e frikës iu larguan.

Hollësi të mëtejshme rreth kësaj historie do t’i shohim në faqet vijuese, kur të trajtojmë aspekte të tjera të tregimit të Musait (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*).¹

¹ Në lidhje me këtë çështje kemi vënë studime në suret: “El A’râf”, “Tà Hà”, “Esh Shuarà” dhe në disa sure të tjera.

Ajetet: 36 - 37

فَلَمَّا جَاءَهُمْ مُوسَى بِآيَاتِنَا بَيِّنَاتٍ قَالُوا مَا هَذَا إِلَّا سِحْرٌ مُّفْتَرًى وَمَا سَمِعْنَا
بِهَذَا فِي آبَائِنَا الْأَوَّلِينَ ﴿٣٦﴾ وَقَالَ مُوسَى رَبِّي أَعْلَمُ بِمَنِ جَاءَ بِالْهُدَى مِنْ
عِنْدِهِ ۖ وَمَنْ تَكُونُ لَهُ عَقِيبَةُ الدَّارِ إِنَّهُ لَا يُفْلِحُ الظَّالِمُونَ ﴿٣٧﴾

“Dhe kur Mùsài ua solli atyre argumentet Tona të qarta, ata thanë: kjo nuk është gjë tjetër veçse magji e trilluar; këto (që thoni ju) nuk i kemi dëgjuar ndër prindërit tanë të mëparshëm.”

“Mùsài tha: Zoti im e di më mirë atë që u erdhi me udhëzim prej Tij dhe se kush do të ketë përfundim të mirë; ata që bëjnë padrejtësi, me të vërtetë nuk do të shpëtojnë.”

Komentimi

Musai (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) përballë Faraonit

Në pjesën e tetë të këtij tregimi, Musai (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!), pikërisht në këtë natë të errët e në këtë tokë të shenjtë, mori urdhër prej Zotit të tij, që të shpallte me zë të lartë se

ishte Profet dhe mbajtës i mesazhit hyjnor. Ai arriti në Egjipt dhe njoftoi vëllain e vet për misionin me të cilin ishin ngarkuar. Të dy së bashku, ata shkuan të kumtonin mesazhin e All'llahut. Pas një kujdesi të veçantë, ata të dy mundën të hynin te Faraoni, të cilin e gjetën të rrethuar prej parisë dhe prej njerëzve të zgjedhur të tij. Ata të dy i bënë thirrje që të besonte në All'llahun, Zotin Një e të Vetëm.

Tani le të shohim se si rrodhën ngjarjet në pallatin e Faraonit.

Qysh në ajetin e parë të këtij grupi ajetesh, Kur'ani Famëlartë njofton: **“Dhe kur Mūsà i ua solli atyre argumentet Tona të qarta, ata thanë: kjo nuk është gjë tjetër veçse magji e trilluar.”**:

Ata refuzuan të dëgjonin fjalë të tilla dhe thanë: **“...këto (që thoni ju) nuk i kemi dëgjuar ndër prindërit tanë të mëparshëm”**.

Ata u përballën me Musain (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) me “armën” që kanë përdorur tiranët dhe të devijuarit nga rruga e vërtetë gjatë gjithë historisë, kur shihnin mrekullitë e Profetëve të tyre; ata i akuzuan si magjistarë, megjithëse Profetët u vinin atyre me punë të jashtëzakonshme. Por mizorët mohues, edhe magjinë e quanin punë të jashtëzakonshme, ndonëse dallimi midis mrekullisë e magjisë është i qartë.

Magjistarët janë prej atyre që kanë devijuar nga rruga e vërtetë, janë banorë të kësaj bote dhe skllëvër të saj. Edhe puna e tyre është ndërtuar mbi shtrembërimin e të vërtetave.

Në të kundërt, thirrja e Profetëve dhe përmbajtja e saj dëshmon për vërtetësinë e mrekullive të tyre.

Veç kësaj, magjistarët mbështeten në fuqinë njerëzore. Për rrjedhojë, edhe puna e tyre është e kufizuar. Kurse Profetët mbështeten në fuqinë hyjnore, prandaj mrekullitë me të cilat ata erdhën, janë të mëdha e të pakufizuara.

Shprehja e ajetit “*ajàtin bej’jinàtin*” – “**argumente të qarta**” tregon se mrekullitë e Musait (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) ishin të qarta. Për më tepër, fjala “mrekulli” ka ardhur në numrin shumë, çka tregon se përveç dy mrekullive që u përmendën më lart, ai kishte edhe mrekulli të tjera, ose çdonjëra prej atyre të dyjave përbëhej prej disa mrekullive.

Shndërrimi i shkopit në një gjarpër të madh është një mrekulli. Gjithashtu, një mrekulli tjetër është edhe shndërrimi i gjarpërit në shkop. Fjala tjetër e ajetit “*mufteren*” në rrënjën e saj “*ferij’jetun*” do të thotë “akuzë” dhe “gënjeshtër”, sepse ata me këtë akuzë kishin për qëllim të thonin se Musai (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) sajonte gënjeshtër për All’llahun. “**Këto** (që thoni ju) **nuk i kemi dëgjuar ndër prindërit tanë të mëparshëm**” - këto fjalë të mohuesve tregojnë se Profetët e mëparshëm si Nuhu, Ibrahim i dhe Jusufi, që kanë ardhur në këtë tokë para Musait (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*), kanë bërë thirrje për të adhuruar vetëm All’llahun, të Gjithëfuqishmin. Baza e kësaj thirrjeje ka qenë e njëjtë gjatë gjithë kohës, para dhe pas tyre; ose me këtë frazë, ata kanë dashur të thonë se as prindërit e tyre nuk i janë nënshtruar thirrjes së Profetëve.

Por Musai (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) iu përgjigj atyre me një gjuhë kërcënuese, ashtu siç e zbulon Kur’ani dialogun midis tyre: “**Mùsàì tha: Zoti im e di më mirë atë që u erdhi me udhëzim prej Tij dhe se kush do të ketë përfundim të mire.**”.

Me këto fjalë, ai u thotë atyre: *Patjetër që All'llahu ka dijeni të plotë për gjendjen time. Ai di gjithçka për mua, pavarësisht se ju më akuzoni për gënjeshtar. A mund të më japë mua All'llahu fuqi, që unë të bëj këto punë të jashtëzakonshme për të çuar robtë e Tij në rrugën e humbjes?!*

Veç kësaj, gënjeshtari mund të ketë kaluar një kohë në mesin e njerëzve, duke gënjyer e duke mashtruar, por shumë shpejt puna e tij do të diskreditohet. Prandaj edhe ju prisni, sepse shumë shpejt do të shikoni se për cilin do të jetë përfundimi i mirë e fitorja dhe për cilin do të jetë turpërimi e tatëpjeta.

Sikur fjalët e mia të jenë gënjeshtër, atëherë unë jam një njeri i padrejtë, por: **“Ata që bëjnë padrejtësi me të vërtetë nuk do të shpëtojnë.”**

Kjo shprehje është e ngjashme me atë që ka ardhur në ajetin 69 të sures “Tà Hà”: **“dhe magjistari nuk do të shpëtojë kudo qoftë”**.

Brendia e kësaj fraze tregon se ai u thotë faraonëve mizorë e mendjemëdhenj: Pa dyshim që ju jeni të bindur se mrekullitë dhe thirrja ime janë të vërteta, por ju më kundërshtoni me të padrejtë. Duhet ta dini se jo gjithmonë do të jeni triumfues dhe se përfundimi i mirë do të jetë vetëm për mua.

Shprehja e ajetit “àkibetud dâri” – **“përfundimi i mirë”**, tregon përfundimin e mirë në këtë botë, ose në Botën Tjetër, ose në të dyja ato. Natyrisht që kuptimi i tretë, sipas kuptimit të jashtëm të fjalëve të ajetit, është më përgjithësues dhe më i saktë.

Me logjikën e kësaj edukate i kërcënoi Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) Faraonin dhe popullin e tij, duke ua bërë të qartë se ata i pret disfata në këtë botë dhe në Botën Tjetër.

Ajetet: 38 - 42

وَقَالَ فِرْعَوْنُ يَأْتِيهَا الْمَلَأُ مَا عَلِمْتُ لَكُم مِّنْ إِلَهِ غَيْرِي فَأَوْقَدَ لِي يَلْهَمَنُ
عَلَى الطِّينِ فَلْجَعَلَ لِي صَرَخًا لَعَلِّي أُطْلِعُ إِلَى إِلَهِ مُوسَى وَإِنِّي لَأَظُنُّهُ ۖ وَمِنَ
الْكَذِبِينَ ﴿٣٨﴾ وَأَسْتَكْبَرَهُ هُوَ وَجُنُودُهُ ۖ فِي الْأَرْضِ بِغَيْرِ الْحَقِّ وَظَنُّوا أَنَّهُم إِلَيْنَا
لَا يُرْجَعُونَ ﴿٣٩﴾ فَأَخَذْنَاهُ وَجُنُودَهُ فَنَبَذْنَاهُمْ فِي الْيَمِّ فَلَنظَرُ كَيْفَ كَانَ عَقِبُهُ
الظَّالِمِينَ ﴿٤٠﴾ وَجَعَلْنَاهُمْ أَيْمَةً يَدْعُونَ إِلَى التَّارِ وَيَوْمَ الْقِيَمَةِ لَا يُنصَرُونَ ﴿٤١﴾
وَاتَّبَعْنَاهُمْ فِي هَذِهِ الدُّنْيَا لَعَنَةً ۖ وَيَوْمَ الْقِيَمَةِ هُمْ مِنَ الْمَقْبُوحِينَ ﴿٤٢﴾

“Faraoni tha: o pari, unë nuk di të ketë për ju zot tjetër përveç meje, prandaj o Hàmàn përgatit blloqet prej dheu dhe ndërto për mua një kullë të lartë se dua të informohem për Zotin e Musait; në të vërtetë unë mendoj se ai është prej gënjeshtarëve.”

“Ai (Faraoni) dhe ushtria e tij treguan mendjemadhësi në tokë pa të drejtë dhe menduan se nuk do të ktheheshin te Ne.”

“Prandaj atë (Faraonin) dhe ushtrinë e tij Ne e hodhëm (mbytëm) në ujë; shikoje si qe përfundimi i mizorëve!”

“Ne i bëmë ata prijës që ftojnë për në zjarr dhe Ditën e Kiametit ata nuk do të ndihmohen.”

“Në këtë botë, Ne i kemi përcjellë ata me mallkim dhe Ditën e Kiametit; ata janë prej të përbuzurve.”

Komentimi

Si qe fundi i mizorëve?

Tani jemi në pjesën e nëntë të këtij tregimi të mbushur me ngjarje dhe me mësim të rëndësishme të dala nga përvoja.

Në këto ajete trajtohet çështja e ndërtimit të kullës së lartë prej Faraonit, që ai të argumentonte se thirrja e Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) ishte trillim dhe iluzion.

Ne dimë se kur në punët e politikanëve të mëparshëm ndodhte ndonjë dështim i madh, që ishte në kundërshtim me dëshirat e me prirjet e tyre, ata e kishin si metodë që të kamuflonin punët dhe të krijonin te njerëzit një atmosferë të mirë, në mënyrë që ta hiqnin vëmendjen e tyre nga gjendja e vërtetë e punëve.

Duket se ndërtimi i “kullës” ka ndodhur pas ballafaqimit të Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) me magjistarët; kurse në suren “El Gàfir” thuhet se ndërtimi i kullës ka ndodhur kur Faraoni përgatiste vrasjen e Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), ndërkohë që një besimtar prej familjes së Faraonit e mbronte atë. Ne e dimë se para ballafaqimit të Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) me magjistarët, nuk bëhej fjalë për ndërtimin e kullës, pasi

për këtë nuk flitet në suret e mëparshme. Siç dihet, për ballafaqimin e Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) me magjistarët, Kur'ani Famëllartë flet në suret: "Tà Hà", "El A'ràf", "Junus" dhe "Esh Shuarà". Në të gjitha këto sure nuk përmendet çështja e ndërtimit të "kullës". Për këtë çështje flitet në suren "El Gàfir".

Ishte koha kur në Egjipt ishte përhapur lajmi i fitores së Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) mbi magjistarët. Veç kësaj, çështja merrte një rëndësi të madhe për faktin se magjistarët i kishin besuar Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) dhe kjo ngjarje e vinte qeverinë e faraonëve përballë një rreziku serioz.

Mund të ndodhte ndërgjegjësimi dhe zgjimi i masave që jetonin nën një skllavëri e poshtërim të tejskajshëm, prandaj ishte e domosdoshme të tërhiqej vëmendja e njerëzve me ndonjë mënyrë, pavarësisht nga çmimi, me qëllim që ata të përqendroheshin diku tjetër. Kështu, i gjithë aparati qeverisës u vu në lëvizje.

Kur'ani Famëllartë flet për këshillimin e Faraonit për të trajtuar qëndrimin që do të mbahej. Qysh në ajetin e parë të grupit të ajeteve që janë objekt studimi, thuhet: **"Faraoni tha: o pari, unë nuk di të ketë për ju zot tjetër përveç meje."**

Me këto fjalë, ai u thoshte atyre: Unë jam zoti juaj në tokë, kurse për zotin e qiellit s'ka asnjë argument që të vërtetojë ekzistencën e Tij, por unë do të hetoj mbi këtë çështje. Ndërkaq, ai i drejtohet ministrit të tij, Hāmānit, të cilin e urdhëron: **"prandaj, o Hāmān, përgatit blloqet prej dheu"** dhe pastaj do të urdhëroj ndërtimin e një kulle, ose të një pallati shumë të lartë që të ngjitem sipër tij dhe nga aty të kërkoj lajme për zotin e Musait (*Paqja e*

All'Ilahut qoftë mbi të!), ashtu siç njofton vijimi i ajetit: **“dhe ndërto për mua një kullë të lartë se dua të informohem për Zotin e Musait; në të vërtetë unë mendoj se ai është prej gënjeshtarëve.”**.

Përse Faraoni nuk e përmendi fjalën “tullë”, por u mjaftua duke thënë: **“o Hāmān, përgatit blloqet prej dheu?”**. Disa interpretues të Kur'anit kanë thënë se kjo shprehje e tij është një argument që vërteton se deri në atë kohë tullat nuk ishin vënë në qarkullim dhe se ato i shpiku vetë Faraoni më vonë. Të tjerë mendojnë se në këtë shprehje ka një lloj risie e shpikjeje, që është në përshtatje me rrugën e tiranëve.

Një grup i tretë prej interpretuesve të Kur'anit janë shprehur se fjala “tullë” - “àxher” nuk është prej fjalëve të arabishtes letrare. Për këtë shkak, ajo nuk është përmendur në Kur'an, por është përdorur shprehja e mësipërme që u tha me fjalët e Faraonit.

Një grup interpretuesish të Kur'anit, ndër të cilët Fakhru Rràzij dhe El Alùsij'ji, e kanë diskutuar faktin nëse Faraoni e ndërtoi vërtet kullën apo jo. Me sa duket, ata janë përqendruar në faktin se puna për ndërtimin e kullës së lartë nuk ishte diçka normale, sido që të llogaritej.

Vallë, a nuk janë ngjitur njerëzit më përpara në male dhe nga aty kanë parë qiellin, siç e shihnin në tokë?

A është më e lartë kulla që ndërtojnë njerëzit sesa mali?

Cili është ai i çmendur që pretendon se mund të arrihet në qiell me anën e një kulle të tillë?

Është e qartë se ata që kanë pasur mendime të tilla, kanë qenë krejtësisht të shkujdesur mbi këtë çështje. Në radhë të parë, Egjipti nuk është vend malor; pastaj ata harruan se masa e përgjithshme e popullsisë së Egjiptit ishin njerëz të thjeshtë, të cilët mund të mashtrohen me mjete nga më të ndryshmet.

Edhe në shekullin tonë, që quhet shekulli i shkencës dhe i dritës, gjen mashtrime e punë të ngjashme me ato të njerëzve të asaj kohe.

Sido që të ketë ndodhur, në disa histori thuhet tekstualisht: Hamani urdhëroi të caktohet një parcelë e madhe toke, ku do të ndërtohej kulla, ose pallati i lartë. Për këtë ndërtim qesharak, ai vuri të punojnë pesëdhjetë mijë vetë, punëtorë e inxhinierë, si dhe mijëra punëtorë të tjerë që punonin për përgatitjen e mjeteve të nevojshme. Për këtë punë u hapën portat e thesarit dhe u shpenzuan shuma të pallogaritshme. Në këtë ndërtim punuan aq shumë punëtorë, saqë nuk kishte vend ku të mos dëgjoheshin zërat dhe jehona e kësaj pune.

Sa më lart ngrihej ndërtesa, aq më shumë njerëz vinin për ta soditur dhe pyesnin: Ç' do të bëjë Faraoni me këtë ndërtesë, apo me këtë kullë?

Kur ndërtesa u përfundua plotësisht dhe punëtorët s'kishin mundësi ta ngrinin më lart, erdhi vetë Faraoni dhe u ngjit lart me ceremoni të veçanta. Nga lartësia e kullës, ai hodhi sytë në drejtim të qiellit dhe pa se qielli ishte i kthjellët, ashtu siç e kishte parë edhe poshtë në tokë. Asgjë nuk kishte ndryshuar dhe asgjë e re nuk kishte ndodhur në të.

Në thënien që qarkullon më shumë në lidhje me shigjetën që lëshoi Faraoni në drejtim të qiellit, tregohet se ajo ra në tokë e lyer me gjak. Mbase ajo mund të kishte goditur ndonjë shpend, ose ishte një dredhi që e kishte kurdisur Faraoni më përpara. Faraoni zbriti nga kulla dhe u tha njerëzve: *“Shikojeni shigjetën e përlyer me gjak me sytë tuaj, që të besoni se unë e vrava me të vërtetë zotin e Musait (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!).”*¹

Është plotësisht e kuptueshme se një grup njerëzish të thjeshtë, prej atyre që e ndiqnin qeverinë verbërisht, jo vetëm që i besuan fjalës së Faraonit, por e përhapën atë në të gjithë vendin. Faraoni e arriti qëllimin e tij. Njerëzit u morën me këtë lajm dhe nuk u kushtuan rëndësi të vërtetave. Thuhet se kulla nuk qëndroi gjatë. Ajo u shemb dhe nën gërmadhat e saj u vranë një grup njerëzish.

Këtu tërheq vëmendjen fakti se Faraoni me fjalën e tij **“...unë nuk di të ketë për ju zot tjetër përveç meje”** ka përdorur fjalën më të keqe dhe më djallëzore. Ai në të vërtetë mendonte se tanimë ishte pranuar se ai ishte zot. Me këtë frazë, Faraoni u thoshte atyre: A ka zot tjetër përveç meje?! Më pas, ai mohon në mënyrë të prerë ekzistencën e ndonjë zoti tjetër, për shkak se mendon që nuk ka ndonjë argument për ta vërtetuar këtë.

Në etapën e tretë dhe të fundit të mashtrimeve që trillonte Faraoni, me qëllim që të kishte një argument për mosekzistencën e ndonjë zoti tjetër përveç tij, ai urdhëroi ndërtimin e kullës.

Të gjitha këto thënie theksojnë qartë se Faraoni i njihte këto çështje, por me fjalët e tij, ai i çonte njerëzit në rrugën e humbjes

¹ Marrë prej tefsirit “Rûhul Xhinân”, fundi i ajetit që është objekt studimi, vëll. 8, f. 462.

dhe ua largonte mendimet e tyre nga e vërteta. Këtë ai e bënte për të ruajtur sundimin e tij.

Më pas, Kur'ani Famëllartë flet për mendjemadhësinë e Faraonit dhe të atyre që ishin së bashku me të. Në Kur'an thuhet se ata nuk u kushtonin vëmendje dy çështjeve: fillimit të jetës dhe ringjalljes pas vdekjes. Faraoni bënte krime e punë të tjera të këqija, sepse ai i mohonte këto dy parime bazë. Në lidhje me mendjemadhësinë e tiraninë e Faraonit, Kur'ani njofton: **“Ai (Faraoni) dhe ushtria e tij treguan mendjemadhësi në tokë pa të drejtë dhe menduan se nuk do të ktheheshin te Ne.”**.

Njeriu është aq i pafuqishëm, saqë nuk mund të largojë prej vetes as një mushkonjë që e bezdis e mbase atë mund ta vrasë edhe një mikrob që nuk shihet me sy. Atëherë, si mundet që ai të kërkojë për veten e tij madhërinë hyjnore?!

Në një hadithi kudsij, All'llahu, i Gjithëfuqishmi thotë: *“Lavdia është rroba Ime e sipërme, dhe madhështia është rroba Ime e poshtme. Ai që më kundërvihet në njërën prej këtyre të dyjave, do të flaket në zjarr.”*¹

Vetëkuptohet që All'llahu s'ka nevojë për të tilla cilësi, por është fakt se pushteti e pasuria e shumë bëhen aq zotëruese mbi njeriun, sa ai e harron vetveten dhe mendimet e tij ia mbushin mendjemadhësia e mashtrimi. Por, le të shohim se deri ku arriti ky mendjemadh e mashtrues së bashku me ushtrinë e tij. Për këtë çështje, Kur'ani Famëllartë shpjegon: **“Prandaj atë (Faraonin) dhe ushtrinë e tij Ne e hodhëm (mbytëm) në ujë.”**. E sheh? Ne bëmë që

¹ Tefsiri “Rùhul Meànj; tefsiri “Kebijr”, vëll. 24, f. 253; tefsiri “El Mijzàn”, vëll. 16, f. 40 dhe tefsire të tjerë në komentimin e ajetit që është objekt studimi.

ata të vdesin në ujë, në atë që është baza e jetës së tyre; Ne e bëmë lumin Nil varrezë për ta, ndonëse ai për ta ishte simboli i madhështisë e i fuqisë.

Është kuptimplotë fakti se në lidhje me mbytjen e tyre në ujë, Kur'ani Famëlartë ka përdorur foljen *"nebdhnàhum"*, që në rrënjën e saj *"nebedhe"* do të thotë: hedhja e një sendi pa vlerë dhe flakja e tij larg. Vallë, a mund të kishte vlera ai njeri mendjemadh, egoist e kriminel?

Zoti i flaku ata njerëz që s'kishin asnjë vlerë në shoqërinë njerëzore dhe duke i flakur ata, Ai e pastroi tokën nga ndotja që vinte prej tyre.

Në mbyllje të ajetit që është objekt studimi, fjala i drejtohet Profetit (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): **"...shikoje si qe përfundimi i mizorëve"**. Kjo nuk mund të realizohet me shikimin me sy, por me aftësinë për të kuptuar me anë të vëzhgimit e të mendimit. Natyrisht që shprehja e ajetit **"përfundimi i mizorëve"** nuk ka të bëjë vetëm me njoftimin rreth mizorëve të kohës së kaluar dhe faraonëve që jetuan para kohës së re, por tregon se për tiranët nuk mund të ketë përfundim tjetër përveç atij përfundimi të rëndë.

Në vijim, Kur'ani në lidhje me mizorët njofton: **"Ne i bëmë ata prijësa që ftojnë për në zjarr dhe Ditën e Kiametit ata nuk do të ndihmohen."**

Kjo shprehje kur'anore ka ngritur një problem te disa interpretues të Kur'anit, të cilët shtrojnë pyetjen: Si është e mundur që All'llahu t'i bëjë njerëzit prijës në të gabuarën?!

Në të vërtetë, ky problem nuk është aspak i ndërlikuar. Në radhë të parë duhet theksuar se ata janë në krye të grupit të

banorëve të zjarrit dhe kur do të lëvizin, ata do t'u prijnë të tjerëve për në zjarr. Ashtu siç i prinin në këtë botë në rrugën e humbjes, ata do të jenë prijës të tyre edhe në Botën e Ardhshme.

E dyta, statusi i tyre si prijës që bëjnë thirrje në rrugën e humbjes, vjen për shkak të punëve që ata kanë bërë me duart e veta. Por ne dimë se ndikimi i çdo gjëje bëhet vetëm me urdhrin e All'Ilahut. Ata zgjodhën rrugën e humbjes, prandaj prijës të tillë patjetër që i çojnë pasuesit e tyre në atë rrugë. Kjo do të jetë gjendja e tyre në Ditën e Kiametit.

Për të theksuar edhe më shumë gjendjen e tyre, Kur'ani Famëlartë përshkruan figurën e tyre në këtë botë dhe në Botën e Ardhshme: **“Në këtë botë Ne i kemi përcjellë ata me mallkim dhe Ditën e Kiametit ata janë prej të përbuzurve.”**¹

“Mallkimi i All'Ilahut” do të thotë: përzënia e tyre prej mëshirës së All'Ilahut, kurse “mallkimi i engjëjve dhe i besimtarëve”, do të thotë: lutja e tyre për ta mëngjes e mbrëmje dhe në çdo kohë. Disa herë ata i përfshin mallkimi i përgjithshëm; për disa prej tyre vjen një mallkim i veçantë në atë mënyrë, që cilido që e shfleton historinë e tyre, i mallkon ata dhe largohet me neveri prej punëve të tyre.

Sido që të jetë, nga të këqijat e bëra në këtë botë, ata do të kenë fytyra të këqija në Botën Tjetër, pra në Ditën e Gjykimit, në Ditën kur të gjitha punët do të shihen në të vërtetën e tyre.

¹ Fjala e ajetit “*el makhbūh*” në rrënjën e saj “*el kubhu*” do të thotë: **e keqe**; ndërsa interpretuesit e Kur'anit kanë shpjeguar se fjala “i përbuzur”, ka kuptimin: **i përzënë**, ose **i diskredituar**, ose ai që ka merituar zemërimin e All'Ilahut, ose ka kuptime të tjera të ngjashme me këto.

Hulumtim

Prijësit e “dritës” dhe prijësit e “zjarrit”

Në logjikën e Kur'anit Famëlartë janë dy kategori prijësish:

- Prijësit e atyre që i frikësohen All'llahut; këta u bëjnë thirrje njerëzve për punë të mira, ashtu siç thuhet në ajetin 73 të sures “El Enbijà”: **“Ne ata i bëmë prijës që udhëzonin me urdhrin Tonë; Ne i orientuam ata në punë të mira, në faljen e namazit, në dhënien e zekatit dhe adhurimin e kushtonin vetëm për Ne.”**.

Këta janë prijës me programe të qarta, bëjnë thirrje me sinqeritet për Njësimin e All'llahut, u bëjnë thirrje njerëzve që të besojnë se All'llahu është Zoti Një e i Vetëm; ata bëjnë thirrje për punë të mira, për të vërtetën e për drejtësi. Të gjitha këto përbëjnë tekstin pa koment të programeve të tyre, prandaj ata janë prijësit e dritës. Vija e tyre lidhet me vargun e Profetëve, deri te vula e të gjithë Profetëve, Muhammedi (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

- Nga ana tjetër qëndrojnë prijësit e rrugës së humbjes. Për ta, në ajetet që po studiojmë, thuhet se janë: **“prijës që ftojnë për në zjarr”**.

Në një transmetim të ardhur prej Imam Sadikut, përshkruhen karakteristikat e prijësve të dy grupeve:

“Në librin e All'llahut, prijësit janë të dy kategorive: All'llahu i Lartësuar thotë: ‘Ne i bëmë ata prijës që ftojnë me urdhrin Tonë’ dhe jo me urdhrin e njerëzve; ata e vënë urdhrin e All'llahut para urdhrin

*të tyre, sundimin e vendimin e All'lahut para sundimit e vendimit të tyre. Kurse për grupin e dytë të prijësve, Kur'ani Famëlartë thotë: **'Ne i bëmë ata prijës që ftojnë për në zjarr'**; ata e vënë urdhrin e sundimin e tyre para urdhrit e sundimit të All'lahut dhe vendosin sipas dëshirave të tyre e në kundërshtim me Librin e All'lahut."*¹

Me këtë kriter bëhet e qartë njohja e këtyre dy grupe prijësish. Ditën e Kiametit, në Ditën kur do të dallohen radhët dhe njerëzit do të ndahen në grupe, çdo grup do të shkojë pas prijësit të vet. Ata që janë për në zjarr, shkojnë atje me në krye prijësin e tyre, dhe ata që janë për në Xhennet, shkojnë atje me në krye prijësit e tyre. Për këtë, Kur'ani Famëlartë, në ajetin 71 të sures "El Isrà" njofton: **"...Ditën kur do të thërrasim çdo njeri me prijësin e tyre"**.

Shpesh kemi thënë se Dita e Kiametit është një konkretizim i madh i kësaj bote të vogël. Ata që në këtë botë ishin të lidhur me prijësin e tyre dhe e kanë ndjekur atë në çdo hap, patjetër që edhe në Botën Tjetër do të shkojnë pas tij.

Bishr bin Gàlib citon prej Imamit Ebù Abdullah El Hysejn se ai e ka pyetur në lidhje me interpretimin e ajetit të mësipërm: **"...Ditën kur do të thërrasim çdo njeri me prijësin e tyre"** dhe Imami ka thënë: "...Një prijës që bën thirrje për në rrugën e drejtë dhe ata që i janë përgjigjur thirrjes së tij dhe një prijës që bën thirrje për në rrugën e humbjes dhe ata që i janë përgjigjur thirrjes së tij; të parët janë në Xhennet, të dytët në zjarr. Ky është kuptimi i

¹ Tefsiri "Es Sâfij", fundi i ajetit që është objekt studimi.

fjalës së All'lahut, të Lartit, në ajetin 98 të sures "Hùd": **"...njëri grup në Xhennet dhe grupi tjetër në zjarr."**¹⁽¹⁾

Është shumë domethënës fakti se Faraoni i priu popullit të tij në këtë botë dhe me mendjemadhësinë e tij, ai i mbyti ata në ujërat e lumit Nil. Faraoni do të jetë në krye të popullit të vet edhe në Ditën e Gjykimit; atë Ditë, ai do të jetë në krye të tyre dhe me mendjemadhësinë e me tiraninë e tij do t'i turpërojë, duke hyrë së bashku me ta në zjarrin e Xhehennemit. Në lidhje me këtë çështje, në ajetin 98 të sures "Hùd", Kur'ani Famëllartë thotë: **"Ditën e Kiametit ai (Faraoni) i prin popullit të vet dhe i fut në zjarr; sa vend i keq është vendi ku ai i fut ata!"**.

Këtë studim e mbyllim me një transmetim të ardhur prej Imam Aliut, që flet për hipokritët dhe thotë: *"Pastaj do të qëndrojnë pas tij dhe do të afrohen te prijësit që bënin thirrje për në rrugën e humbjes. Prijësit e tyre bënin thirrje për në zjarr me mashtrime e me shpifje; prijësit e rrugës së humbjes bënin thirrje për në rrugën e humbjes me fjalët e me punët e tyre, e megjithatë, pasuesit i bënë ata sundimtarë mbi qafat e njerëzve."*²

¹ "Amàlij Sadùk", f. 153; ashtu siç ka ardhur në tefsirin "Nuruth Thekalejn", vëll. 2. f. 192.

² Lexo "Nehxhul Belaga", hutbeja nr. 210.

Ajetet: 43 - 46

وَلَقَدْ ءَاتَيْنَا مُوسَى الْكِتَابَ مِنْ بَعْدِ مَا أَهْلَكْنَا الْقُرُونَ الْأُولَىٰ بَصَائِرَ
لِلنَّاسِ وَهَدَىٰ وَرَحْمَةً لَّعَلَّهُمْ يَتَذَكَّرُونَ ﴿٤٣﴾ وَمَا كُنْتَ بِجَانِبِ الْغَرْبِيِّ إِذْ قَضَيْنَا
إِلَىٰ مُوسَى الْأَمْرَ وَمَا كُنْتَ مِنَ الشَّاهِدِينَ ﴿٤٤﴾ وَلَكِنَّا أَنْشَأْنَا قُرُونًا فَتَطَاوَلَ
عَلَيْهِمُ الْعُمُرُ وَمَا كُنْتَ ثَاوِيًا فِي أَهْلِ مَدْيَنَ تَتْلُو عَلَيْهِمْ ءَايَاتِنَا وَلَكِنَّا كُنَّا
مُرْسِلِينَ ﴿٤٥﴾ وَمَا كُنْتَ بِجَانِبِ الطُّورِ إِذْ نَادَيْنَا وَلَكِنْ رَحْمَةً مِّن رَّبِّكَ لِتُنذِرَ
قَوْمًا مَّا أَتَتْهُمْ مِّن نَّذِيرٍ مِّن قَبْلِكَ لَعَلَّهُمْ يَتَذَكَّرُونَ ﴿٤٦﴾

“Pasi i shkatërruam popujt e mëparshëm, Ne i dhamë Mùsàit librin, që është për njerëzit dritë, udhëzim dhe mëshirë që ata të marrin mësim.”

“Ti nuk ishe në anën përëndimore kur ne i shpallëm Mùsàit urdhrin, ti nuk ishe aty pranë.”

“Por Ne krijuam popuj që jetuan gjatë; ti nuk banove në mesin e popullit të Medjenit që t’i lexosh këtyre argumentet Tona, porse Ne të dërguam.”

“Ti nuk ishe pranë Tùrit kur ne e thirrëm (Mùsàin), por është mëshirë prej Zotit tënd që ti të paralajmërosh një popull te të cilët nuk ka ardhur paralajmërues para teje, mbase ata do të marrin mësim.”

Komentimi

Njoftimet e fshehta vijnë vetëm prej All'Ilahut

Me këtë grup ajetesh arritëm në pjesën e dhjetë dhe të fundit të ajeteve të kësaj sureje, që trajtojnë tregimin e Musait (*Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!*) si dhe kuptimet e thella që ndodhen në të.

Ajetet që janë objekt studimi flasin për zbritjen e dispozitave dhe të Teuratit, për mbarimin e ndikimit negativ të “djallit” dhe për fillimin e një epoke të re e pozitive.

Ajeti i parë i grupit të ajeteve që janë objekt studimi njofton: **“Pasi i shkatërruam popujt e mëparshëm, Ne i dhamë Mûsàit librin, që është për njerëzit dritë, udhëzim dhe mëshirë që ata të marrin mësim.”.**

Nga shprehja e këtij ajeti: **“popujt e mëparshëm”**, nuk mësohet se cilët ishin popujt që u shkatërruan.

Disa prej interpretuesve të Kur'anit kanë thënë se ata ishin mohuesit prej popullit të Nuhut, adët, themudët dhe të tjerë të ngjashëm. Me kalimin e kohës, gjurmët e mësimave të Profetëve të mëparshëm u shuan, prandaj ishte e domosdoshme që në duart e njerëzisë të vinte një libër i ri qiellor.

Të tjerë interpretues të Kur'anit kanë thënë se kjo shprehje tregon shkatërrimin e popullit të Faraonit, të cilët ishin mbetje prej popujve të mëparshëm dhe, pas shkatërrimit të tyre, All'Ilahu i

Gjithëfuqishmi, i dha Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) Teuratin.

Por, përse të mos përfshihen në shprehjen **“popujt e mëparshëm”** të këtij ajeti, të gjithë ata popuj që u asgjësuan?

Fjala e ajetit *“besàire”* është shumësi i fjalës *“besijreh”* që do të thotë: shikim me sy. Qëllimi me këtë fjalë këtu është shikimi i shenjave dhe i argumenteve që ndriçojnë zemrat e besimtarëve. Kurse dy fjalët e tjera të ajetit: *“huden”* – *“udhëzim”* dhe *“rahmeten”* - *“mëshirë”* janë prej domosdoshmërive të *“shikimit”*, pasi prej ndikimit të udhëzimit dhe mëshirës, zemrat e njerëzve zgjohen.

Në vijim, Kur’ani Famëlartë e shpjegon këtë të vërtetë, duke iu drejtuar Profetit të Islamit dhe i thotë: Ajo që Ne kemi përmendur, o i Dërguar i All'llahut në lidhje me Musain (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) dhe Faraonin dhe ngjarjet që ndodhën në mes tyre me të gjitha hollësitë, në të vërtetë është një argument që dëshmon të vërtetën e Kur’anit; sepse ti nuk ishe i pranishëm në ato vende ku Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) u përball me Faraonin e me popullin e tij. Ti nuk i ke parë ato ngjarje me sytë e tu, por kjo është prej mirësive që All'llahu i Lartësuar të ka dhënë ty, duke të zbritur këto ajete që ti të udhëzosh njerëzit në rrugën e vërtetë me fjalën e Kur’anit: **“Ti nuk ishe në anën perëndimore kur ne i shpallëm Mùsàit urdhrin”**, domethënë urdhrin e ngarkimit në detyrën e Profetësisë; **“dhe ti nuk ishe aty pranë”**.

Në tregimin e Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) tërheq vëmendjen fakti se kur ai u nis nga Medjeni për në Egjipt, mori rrugën në drejtim të gadishullit Sijnà, pra ai ndoqi drejtimin nga lindja drejt perëndimit.

E kundërta e drejtimit të këtij udhëtimi është rrugëtimi i Beni Israilëve kur lanë Egjiptin për të shkuar në zonën e Shamit. Në këtë rrugëtim, Beni Israilët kaluan nëpër rrugën e gadishullit Sijnà, domethënë ata ndoqën drejtimin nga perëndimi për në lindje. Për këtë shkak, disa interpretues të Kur'anit mendojnë se ajeti 60 i sures "Esh Shuarà" thotë: **"...ata (ushtria e Faraonit) i arritën (Beni Israilët) në kohën e lindjes së diellit"**, që flet për ndjekjen e Beni Israilëve prej Faraonit dhe popullit të tij, tregon pikërisht këtë kuptim.

Në vijim, Kur'ani Famëllartë shton: **"Por Ne krijuam popuj që jetuan gjatë"**; pra kaloi një kohë aq e gjatë, sa që u zhdukën shenjat e udhëzimit të Profetëve në zemrat e njerëzve, prandaj ne të zbritëm ty Kur'anin dhe të shpjegoam qartë në të tregimet e të mëparshmëve, në mënyrë që ky libër të jetë dritë e udhëzim për njerëzit.

Më pas, Kur'ani Famëllartë, gjithnjë duke iu drejtuar Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), thotë: **"...ti nuk banove në mesin e popullit të Medjenit që t'u lexosh këtyre argumentet Tona"**, pra t'ua lexosh banorëve të Mekës, **"porse Ne të dërguam"**, domethënë: Ne t'i sollëm ty me Shpallje këto njoftime të hollësishme që flasin për ngjarje të ndodhura mijëra vjet më parë, për të qenë përvojë për njerëzit dhe këshillë për të devotshmit, për ata që i frikësohen dënimit të All'llahut.¹

¹ Koha ndërmjet Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) dhe ardhjes së Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) duhet të jetë në kufijtë e dy mijë vjetëve.

Për të theksuar këto që u thanë, Kur'ani Famëlartë vazhdon t'i drejtohet Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe i thotë: **"Ti nuk ishe pranë Tùrit kur Ne e thirrëm (Mùsàin)"** - kur Ne i komunikuam Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) urdhrin e Profetësisë; këto njoftime Ne i zbritëm për ty si mëshirë prej All'llahut. Ajeti vijon: **"...por është mëshirë prej Zotit tënd që të paralajmërosh një popull te të cilët nuk ka ardhur paralajmërues para teje, mbase ata do të marrin mësim."**¹⁽¹⁾

Me pak fjalë, pjesa e fundit e këtij ajeti thotë: All'llahu i Lartësuar të njofton ty o Muhammed, me ndodhi' që kanë ngjarë në popujt e mëparshëm, në të cilat gjendet zgjim e paralajmërim, ndonëse ti nuk ishe i pranishëm që t'i shikoje. Ne t'i sjellim këto njoftime, që ti t'ua lexosh popullit tënd, të cilët janë në rrugën e humbjes, por që mund të udhëzohen në rrugën e drejtë dhe të nxjerrin mësim nga pësimet e popujve të kaluar.

Lind pyetja: Si thotë Kur'ani: **"...që ti të paralajmërosh një popull te të cilët nuk ka ardhur paralajmërues para teje"**, domethënë arabët bashkëkohës të Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), kur dihet se toka nuk ka qenë kurrë pa

¹ Disa interpretues të Kur'anit kanë thënë se ka mundësi që me fjalën "*nàdejnà*" - **"Ne e thirrëm"**, këtu të jetë qëllimi për thirrjen e dytë, kur Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) erdhi në Tùr me shtatëdhjetë burra të popullit të tij dhe aty u erdhi thirrja prej All'llahut; por kjo mundësi është shumë larg prej asaj që shprehin fjalët e ajetit, sepse këto ajete theksojnë ngjarjet për të cilat njoftohet Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ndonëse ai nuk ishte i pranishëm atje që t'i shikonte me sytë e tij ato. Gjithashtu, ne dimë se këto ajete flasin për udhëtimin e Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) prej Medjenit për në Egjipt si edhe për zërin që ai dëgjoji për herë të parë nga ana e All'llahut në luginën e malit Tùr.

argumente që dëshmojnë ekzistencën dhe fuqinë e All'llahut? Gjithashtu, dimë se në mesin e arabëve të asaj kohe ka pasur prej atyre që u kanë folur njerëzve për mësimet e Profetëve, siç ishin për shembull nxënësit e Profetit Isa (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*).

Në përgjigje të kësaj pyetjeje themi se qëllimi me fjalën **“dërguam”** është sjellja e një Profeti që i vjen popullit të tij me një libër të qartë qiellor, sepse qysh nga koha e Isait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) dhe deri kur erdhi Profeti i Islamit, kishin kaluar disa shekuj dhe tek ata nuk kishte ardhur ndonjë Profet prej atyre që në Kur'an cilësohen si *“ulil azmi”* – **“të vendosur”**; prandaj kjo kohë e gjatë është përdorur si pretekst prej jobesimtarëve, shkatërruesve dhe ngatërrestarëve.

Në lidhje me këtë çështje, Imam Aliu ka thënë: *“All'llahu e dërgoi Muhammedin (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), kur asnjëri prej arabëve nuk kishte lexuar libër dhe kur askush nuk e kishte pretenduar Profetësinë. Ai i orientoi njerëzit në rrugën e drejtë dhe u kumtoi se ku ishte shpëtimi për ta.”*¹

¹ “Nehxhul Belaga”, hutbeja nr. 33.

Ajetet: 47 - 50

وَلَوْلَا أَن تُصِيبَهُمْ مُّصِيبَةٌ بِمَا قَدَّمَتْ أَيْدِيهِمْ فَيَقُولُوا رَبَّنَا لَوْلَا أَرْسَلْتَ إِلَيْنَا رَسُولًا فَنَتَّبِعَ آيَاتِكَ وَنَكُونَ مِنَ الْمُؤْمِنِينَ ﴿٤٧﴾ فَلَمَّا جَاءَهُمُ الْحَقُّ مِنْ عِنْدِنَا قَالُوا لَوْلَا أُوتِيَ مِثْلَ مَا أُوتِيَ مُوسَىٰ أَوْ لَمَّا يَكْفُرُوا بِمَا أُوتِيَ مُوسَىٰ مِنْ قَبْلُ قَالُوا سِحْرَانِ تَظَاهَرَا وَقَالُوا إِنَّا بِكُلِّ كَافِرُونَ ﴿٤٨﴾ قُلْ فَأْتُوا بِكِتَابٍ مِّنْ عِنْدِ اللَّهِ هُوَ أَهْدَىٰ مِنْهُمَا أَتَّبِعُهُ إِن كُنْتُمْ صَادِقِينَ ﴿٤٩﴾ فَإِنْ لَّمْ يَسْتَجِيبُوا لَكَ فَلَعَلَّكُمْ أَنْتُمْ يَتَّبِعُونَ أَهْوَاءَهُمْ وَمَنْ أَضَلُّ مِمَّنِ اتَّبَعَ هَوَاهُ بِغَيْرِ هُدًى مِّنَ اللَّهِ إِنَّ اللَّهَ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الظَّالِمِينَ ﴿٥٠﴾

“Dhe kur ata goditen nga ndonjë e keqe që e kanë përgatitur me duart e veta, të mos thonë: Zoti ynë, sikur të na dërgoje një Profet që ne të ndiqnim argumentet Tuaja dhe të ishim prej besimtarëve.”

“Por, kur atyre u erdhi e vërteta nga ana Jonë, ata thanë: përse nuk iu dha atij (Muhammedit) nga ato që iu dhanë Mûsàit? A nuk e mohuan ata atë që iu dha Mûsàit më parë, por thanë: dy magji që plotësojnë njëra-tjetrën dhe thanë: ne i mohojmë të gjithë.”

“Thuaj: nëse ju thoni të vërtetën, atëherë sillni një libër prej All’llahut që është më udhëzues se ato të dy dhe unë do të ndjek atë (që do të sillni ju).”

“Nëse ata nuk të përgjigjen, atëherë dije se ata ndjekin dëshirat e veta; por, a mund të ketë më të humbur se ai që ndjek dëshirat e veta pa pasur udhëzim prej All’llahut? Me të vërtetë, All’llahu nuk i udhëzon njerëzit mizorë.”

Komentimi

Pretekst për t’iu shmangur të vërtetës

Ajetet e mësipërme flisnin për dërgimin e Profetit (*Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që me ato ajete ai të paralajmëronte popullin e vet; kurse me ajete që janë objekt studimi, Kur’ani shpjegon kënaqësinë e All’llahut që Profeti është në mesin e popullit të tij dhe thotë: Ne edhe më parë kemi dërguar Profetë kur vendosnim të lëshonim dënimin mbi ata për shkak të mizorive dhe punëve të këqija që bënin. Kur ata e panë veten ngushtë, thanë: Përse o Zot, nuk dërgon te ne një Profet, që të na shpjegojë dispozitat Tuaja dhe ne t’i besojmë atij?

Për këtë, ajeti njofton: **“Dhe kur ata goditen nga ndonjë e keqe që e kanë përgatitur me duart e veta, të mos thonë: Zoti ynë, sikur**

të na dërgoje një Profet që ne të ndiqnim argumentet Tuaja dhe të ishim prej besimtarëve.”.¹

Ky ajet e vë theksin mbi një temë shumë të rëndësishme dhe shpjegon se rruga e vërtetë është e qartë dhe e dukshme dhe se çdo “mendje” e gjykon pavlefshmërinë e vënies shok All’llahut në adhurim (shirk), si dhe pavlefshmërinë e adhurimit të idhujve. Gjithashtu, ajeti shpjegon se të këqijat, siç janë padrejtësitë dhe punë të tjera të ngjashme, që bien mbi jobesimtarët, janë rezultat i vënies shok All’llahut në adhurim si dhe të adhurimit të idhujve. Ndonëse këto gjëra janë prej punëve që i gjykon mendja në mënyrë të pavarur edhe pa qenë e nevojshme të dërgohen Profetë, përsëri dënimi për të tilla punë është plotësisht i mundshëm.

Por edhe pse gjykimi i mendjes është i qartë për të tilla çështje, i Gjithëfuqishmi, All’llahu i Lartësuar, Ai që nuk asnjë të metë dhe që nuk ka nevojë për asnjë send, ka dërguar Profetë me libra qiellorë dhe me mrekulli konkrete, me qëllim që të jenë argument për njerëzit e ata të mos thonë se patën një shkak, që askush të mos thotë se e keqja e tij ishte për shkak se nuk kishte argument, apo të thotë se do të ishte udhëzuar dhe do të kishte qenë në grupin e të shpëtuarve nëse ndër ta do të gjendej një udhëheqës nga ana e All’llahut.

¹ Shumica e interpretuesve të Kur’anit thonë se përgjigjja për fjalën e ajetit “leulâ” – “**sikur**” është hequr dhe vlerësimi i kuptimit të kësaj fjale mbetet: “Kur Ne dërguam Profet”, ose “kur dërgimi i Profetit u bë i domosdoshëm”. Kuptohet se shprehja e dytë është shumë e përpiktë dhe shumë më e qartë. Sido që të jetë kuptimi i vërtetë i kësaj fjale, ajo ka lidhje me dispozita që i kap edhe mendja; përndryshe, dërgimi i Profetëve bëhet domosdoshmëri, në mënyrë që ata të vinin me argumente të tjera. Gjithashtu, njëra prej dobive të ardhjes së Profetëve është edhe vërtetimi i dispozitave logjike, siç janë pavlefshmëria e vënies shok All’llahut në adhurim (shirk), apo e keqja e mizorisë, e padrejtësisë, e shkatërrimit dhe e ngatërresave.

Gjithsesi, ky ajet është prej atyre ku vërtetohet dashamirësia e butësia e All'llahut, që shfaqet nëpërmjet rrugës së dërgimit të Profetëve. Gjithashtu, ajeti tregon se rruga e All'llahut është që të mos dënojë asnjë popull para se të dërgojë tek ai një Profet. Në lidhje me këtë çështje, në ajetin 165 të sures "En Nisà", lexojmë: **"Të dërguar përgëzues e paralajmërues që njerëzit pas dërgimit të Profetëve të mos kenë argument (për justifikim) para All'llahut; Ai është i Gjithëfuqishmi, Mëshirëploti."**

Më pas, ajetet flasin për pretekstet që nxirrnin mohuesit dhe theksojnë se idhujtarët edhe pas dërgimit të Profetëve, nuk hoqën dorë nga mashtrimet e nga pretekstet të mbështetura mbi argumente që nuk mund të jenë të tilla; ata vazhduan në rrugën e devijimit dhe, për këtë, ajeti njofton: **"Por, kur atyre u erdhi e vërteta nga ana Jonë thanë: përse nuk iu dha atij (Muhammedit) nga ato që iu dhanë Mùsait?"**.

Përse në dorën e tij (Muhammedit) nuk është shkopi i Musait? Përse dora e tij nuk është e bardhë si dora e Musait? Përse ai nuk e çan detin me shkop, ashtu siç e çau Musai?

Lista e preteksteve të tyre ishte e gjatë.

Kur'ani Famëlartë u përgjigjet këtyre preteksteve dhe u thotë: **"...a nuk e mohuan ata atë që iu dha Mùsàit më parë, por thanë: dy magji që plotësojnë njëra-tjetrën"**, domethënë: Musai dhe Haruni bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, që të na nxjerrin nga rruga jonë, por **"ne i mohojmë të gjithë (Profetët dhe dy librat)"**.

Shprehja e Kur'anit *"sihràni"* - **"dy magji"** ka ardhur në vend të fjalës *"sàhiràni"* - **"dy magjistarë"** me qëllim theksimi, pasi arabët kur duan të theksojnë cilësinë e një personi të drejtë,

thonë: ai është vetë drejtësia, ose për magjistarin thonë: ai është vetë magjia, etj.

Gjithashtu, ka mundësi që me fjalën “**dy magji**”, ata të kenë pasur për qëllim dy mrekullitë e mëdha të Musait (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*), që ishin shkopi dhe dora e bardhë.

Lind pyetja: Ç’lidhje ka ky mohim me politeistët e Mekës, kur këto çështje kanë të bëjnë me Faraonin e me popullin e tij, që janë prej popujve të mëparshëm?

Përgjigjja për këtë pyetje është e qartë: Nxjerrja e preteksteve me argumente mjerane, nuk është punë e mirë dhe tregon se politeistët e Mekës dhe politeistët e mëparshëm janë prej të njëjtit brumë; prandaj edhe fjala e tyre është e njëjtë, ashtu siç është edhe rruga e praktika që ata ndjekin.

Komenti i qartë i këtij ajeti është ai që bëmë më lart, por ka edhe disa të tjerë që e kanë komentuar ndryshe dhe kanë thënë se qëllimi me fjalën e All’llahut, të Lartit: “**dy magji që plotësojnë njëra-tjetrën**”, është Profeti Musa (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) dhe Profeti i madh i Islamit, Muhammedi (*Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Po kështu thonin edhe idhujtarët Mekës: të dy janë magjistarë, prandaj ne i mohojmë që të dy.

Në lidhje me këtë çështje, interpretuesit e Kur’anit kanë cituar një ngjarje historike, në të cilën tregohet se idhujtarët e Mekës dërguan një delegacion te jehuditë për të marrë pjesë në disa festime që ata organizonin. Aty, ata i pyetën jehuditë nëse kishin njoftime për Profetin e Islamit, Muhammedin (*Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe nëse

Profetësia e tij ishte e vërtetë. Jehuditë u përgjigjën se në Teurat përshkruhen cilësitë e tij. Delegatët idhujtarë u kthyen tek idhujtarët e Mekës dhe ua komunikuan atyre bisedën që kishin bërë me jehuditë: **“...dy magji që plotësojnë njëra-tjetrën dhe thanë: ne i mohojmë të gjithë”**.

Nëse do të shohim me kujdes në këto dy pika, rezulton se ky interpretim është larg asaj që shprehin fjalët e ajetit për arsyet e mëposhtme:

E para: në histori dhe në transmetimet e përcjella vërehet se janë të paktë ata idhujtarë arabë që e akuzojnë Musain (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) si magjistar.

E dyta: si është e mundur që dikush të pretendojë se Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) dhe Muhammedi (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) janë dy magjistarë dhe qëndrojnë përballë njëri-tjetrit, kur ndërmjet tyre ka një ndarje kohore, që siç e kemi thënë më lart, vlerësohet në kufijtë e dy mijë vjetëve?!

Vallë, a është e mundur që një magjistar, i cili ka jetuar para mijëra vjetësh, të dijë se ç' do të ndodhë në të ardhmen dhe se ç' do të thonë njerëzit në atë kohë?!

Sido që të jetë, idhujtarët armiqësorë të Mekës, këmbëngulnin në pyetjen e tyre: Përse Muhammedi (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk ka ardhur me mrekulli të ngjashme me ato të Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*)? Nga ana tjetër, ata nuk dinin se cilën prej shenjave e prej cilësive të tij të gjenin në Teurat. Për më tepër, ata nuk i besonin Kur'anit Famëlartë dhe argumenteve të tij të qarta. Për të gjitha

këto, Kur'ani i flet Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në vetën e dytë dhe e urdhëron që t'i sfidojë idhujtarët, duke u thënë që të sjellin një libër më të lartë se Kur'ani: **“Thuaj: nëse ju thoni të vërtetën, atëherë sillni një libër prej All'llahut që është më udhëzues se ato të dy (Teurati e Kur'ani) dhe unë do të ndjek atë (që do të sillni ju).”**.

Me fjalë të tjera, idhujtarët e Mekës kërkonin të gjenin një libër tjetër udhëzues dhe një mrekulli tjetër.

Cili libër dhe cila mrekulli mund të jetë më madhështore se Kur'ani? Edhe sikur Profeti (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) – të mos kishte mrekulli tjetër përveç Kur'anit, do të ishte plotësisht e mjaftueshme që të dëshmohej se thirrja e tij është e vërtetë. Por ata nuk ishin prej atyre që kërkonin të vërtetën. Ata thjesht nxirrnin pretekste të mbështetura mbi argumente mjerane.

Në vijim të ajeteve, Kur'ani shton: **“Nëse ata nuk të përgjigjen, atëherë dije se ata ndjekin dëshirat e veta”**; kur njeriu nuk ndjek dëshirat e veta, shumë shpejt do ta dëgjojë këtë propozim sfidë, por meqenëse ata nuk ishin në rrugën e drejtë, për çdo propozim që refuzonin, nxirrnin një pretekst të ri.

Në të vërtetë, a mund të kishte njerëz më të humbur se ata?

Ajeti njofton: **“...por a mund të ketë më të humbur se ai që ndjek dëshirat e veta, pa pasur udhëzim prej All'llahut? Me të vërtetë, All'llahu nuk i udhëzon njerëzit mizorë.”**.

Sikur ata të kërkonin të vërtetën duke qenë në rrugën e humbjes, patjetër që do t'i përfshinte dashamirësia e butësia e

All'llahut, ashtu siç njoftohet në ajetin 69 të sures “El Ankebût”: **“dhe ata që luftuan për hirin Tonë, pajetër do t’i udhëzojmë në rrugët Tona”**, por ata janë mizorë ndaj vetes dhe ndaj shoqërisë ku jetojnë; ata nuk kanë qëllim tjetër, përveçse të shprehin mllefin me kokëfortësi. Si mund t’i udhëzojë e t’i ndihmojë All’llahu ata?!

Hulumtime

Ndjekësit e dëshirave bëjnë thirrje për në rrugën e humbjes

Në ajetet që janë objekt studimi, u shpjegua qartë lidhja ndërmjet dëshirave dhe shkarjes në rrugën e humbjes. Në lidhje me ndjekësit e dëshirave, Kur’ani shprehet se ata janë njerëzit që kanë rënë në rrugën e humbjes më shumë se të tjerët dhe se nuk janë të përfshirë në udhëzimin e All’llahut.

Ndjekja e dëshirave është një perde e trashë para syve të mendjes.

Ndjekja e dëshirave e lidh njeriun pas një sendi, deri në ata gradë sa ai e humb fuqinë për të kuptuar të vërtetat. Dhe për t’i kuptuar të vërtetat, njeriu duhet të dorëzohet pa kushte ndaj realiteteve, duhet të heqë dorë nga varësia prej sendit dhe të nxitojë për të vepruar me urtësi. Dorëzimi pa kushte ndaj realitetit të jashtëm, qoftë ky realitet i hidhur, qoftë i ëmbël, qoftë në përputhje me dëshirat, qoftë kundër dëshirave personale, qoftë

kur përputhet me interesat e me dobitë personale, qoftë kur nuk përputhet.

Në lidhje me këtë çështje kemi vënë një studim të zgjeruar në fundin e komentit të ajetit 43 të sures “El Furkàn”.

Është shumë domethënës fakti se edhe transmetimet e ardhura që komentojnë këtë ajet, shpjegojnë se këtu qëllimi është për atë që lë Imamin e udhëheqësin e tij hyjnor dhe ndjek dëshirat e veta.¹

Këto transmetime janë të cituara prej Imam Bakirit, Imam Sadikut e prej disa Imamëve të tjerë. Në to shpjegohet qartë se njeriu ka gjithmonë nevojë për udhëzim, i cili herë pasqyrohet në Librin e All’llahut, herë në të Dërguarin e All’llahut, herë në rrugën tij, herë në Imamët e prijësit e herë në logjikën e mendimit. E rëndësishme është që njeriu të jetë gjithmonë në linjën e udhëzimit hyjnor dhe të mos ndjekë dëshirat e veta, sepse vetëm kështu ka mundësi që të ndriçohet me këto drita.

¹ Këto transmetime gjenden në librat: “Usûlul Kâfij”, vëll. 1, f. 374 dhe “Besàiru Derexhât”, f. 13, tekstualisht siç janë në tefsirin “Nuruth Thekalejn”, vëll. 4, f. 132.

Ajetet: 51 - 55

﴿وَلَقَدْ وَصَّلْنَا لَهُمُ الْقَوْلَ لَعَلَّهُمْ يَتَذَكَّرُونَ﴾ ٥١ الَّذِينَ ءَاتَيْنَاهُمْ الْكِتَابَ مِنْ
 قَبْلِهِ هُمْ بِهِ يُؤْمِنُونَ ﴿٥٢﴾ وَإِذَا يُتْلَىٰ عَلَيْهِمْ قَالُوا ءَامَنَّا بِهِ ؕ إِنَّهُ الْحَقُّ مِنْ رَبِّنَا
 إِنَّا كُنَّا مِنَ الْقَبْلَةِ مُسْلِمِينَ ﴿٥٣﴾ أُولَٰئِكَ يُؤْتَوْنَ أَجْرُهُمْ مَرَّتَيْنِ بِمَا صَبَرُوا
 وَيَدْرَءُونَ بِالْحَسَنَةِ السَّيِّئَةَ وَمِمَّا رَزَقْنَاهُمْ يُنفِقُونَ ﴿٥٤﴾ وَإِذَا سَمِعُوا اللَّغْوَ
 أَعْرَضُوا عَنْهُ وَقَالُوا لَنَا أَعْمَلُنَا وَلَكُمْ أَعْمَلُكُمْ سَلَامٌ عَلَيْكُمْ لَا نَبْتَغِي
 الْجَاهِلِينَ ﴿٥٥﴾

“Ne e çuam fjalën (Kur'anin) te ata pa ndërprerë që ata të këshillohen.”

“Atyre që Ne i dhamë librin para atij, disa prej tyre i besojnë atij (Kur'anit).”

“Dhe kur atyre ai (Kur'ani) u lexohet, ata thonë: ne besuam në atë, ai është e vërteta prej Zotit tonë; ne edhe para tij ishim myslimanë.”

“Shpërblimi atyre u jepet, edhe të keqen ata e largojnë me të mirë dhe shpenzojnë nga furnizimi që Ne u kemi dhënë.”

“Kur ata dëgjojnë fjalë të padenja, u largohen atyre fjalëve dhe thonë: ne kemi punët tona dhe ju keni punët tuaja. Paqja qoftë mbi ju, ne nuk na interesojnë injorantët.”

Shkakun e zbritjes

Interpretuesit e Kur'anit dhe përcjellësit e njoftimeve kanë cituar transmetime të shumta dhe të ndryshme në lidhje me shkaku të zbritjes së ajeteve që janë objekt studimi. Ajo që i bashkon të gjitha këto thënie, është fakti se grupe dijetarësh jehudinj, kristianë dhe individë me zemër të pastër besuan në Kur'anin dhe në Profetin e Islamit.

Prej Sejid bin Xhubejrit transmetohet se këto ajete kanë zbritur në lidhje me shtatëdhjetë priftërinj kristianë, të cilët i kishte dërguar në Mekë Nexh'xhàshiu, mbreti i Abisinisë, që të merrnin informacion për fenë e Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimi i All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Kur Profeti i Islamit u lexoi suren “Jàsin”, sytë e tyre u mbushën me lot nga dëshira e zjarhtë që kishin për të vërtetën dhe ata e pranuan Islamin.¹

Të tjerë kanë thënë se këto ajete kanë zbritur në lidhje me kristianët e Nexhrànit, qytet që ndodhet në veri të Jemenit, të cilët

¹ Tefsiri “Fi Dhilâlil Kur'an”, vëll. 6, f. 357-358.

erdhën te Profeti (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe pasi dëgjuan ajetet e Kur'anit, i besuan atij.¹

Disa të tjerë kanë thënë se këto ajete kanë zbritur në lidhje me Nexh'xhàshiun dhe popullin e tij.²

Një mendim tjetër është se këto ajete kanë zbritur në lidhje me Selmàn Fàrisiun dhe me një grup prej dijetarëve jehudinj, si Abdu'll'llàh bin Selàm, Temijmud Dàrij, Xhàrùd El Abdij dhe të tjerë si këta.³

Të tjerë mendojnë se këto ajete kanë zbritur në lidhje me ata dyzet dijetarët kristianë, që kishin një ndërgjegje të gjallë e të ndritur. Ata ishin tridhjetë e dy vetë që erdhën sëbashku me Xhafer bin Ebù Tàlibin nga Abisinia, kurse tetë të tjerët erdhën nga Shami, ndër të cilët ishte edhe murgu Behijrà. Të gjithë u paraqitën para Profetit (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe në prani të tij, ata pranuan Islamin.⁴

Tre transmetimet e para janë në përputhje me mendimin se këto ajete janë zbritur në Mekë. Gjithashtu, ky fakt mbështet edhe fjalën e atyre që mendojnë se të gjitha ajetet e kësaj sureje kanë zbritur në Mekë. Transmetimi i katërt dhe i pestë tregojnë se këto ajete kanë zbritur në Medine, domethënë vërtetojnë mendimin e atyre që kanë thënë se këto ajete kanë zbritur në Medine.

Sido që të jetë, këto ajete janë një dëshmi e rëndësishme, që tregojnë se një grup dijetarësh prej ithtarëve të librave të mëparshëm – kristianë dhe jehudinj, kur dëgjuan ajetet e Kur'anit,

¹ Burimi i mësipërm.

² Burimi i mësipërm.

³ Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 7, f. 258.

⁴ Burimi i mësipërm.

shpallën pranimin e Islamit. Mendimin se këto ajete janë zbritur në Medine, ata e mbështesin në faktin se Profeti i Islamit nuk kishte mundësi të priste delegacion në Mekë, kur asnjëri prej ithtarëve të librave të mëparshëm (kristianë e jehudinj) akoma nuk kishte besuar. Veç kësaj, idhujtarët do të ngriheshin menjëherë dhe do të krijonin trazira, në mënyrë që të përgënjeshtrojnë Profetin (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Komentimi

Kërkuesit e së vërtetës prej ithtarëve të librave të mëparshëm besuan në Kur'an

Ajetet e mësipërme flasin për gjoja argumentet e idhujtarëve para të vërtetave që sillte Kur'ani Famëlartë, ndërsa ajetet që janë objekt studimi flasin për zemrat e përgatitura për të pranuar fjalën e All'llahut, të Vërtetit, fjalën që udhëzon në rrugën e Islamit. Prandaj, të gjithë ata që e pranojnë Islamin, mbeten të kapur fuqishëm pas tij dhe i qëndrojnë besnikë, kurse zemrat e injorantëve mendjemëdhenj e mizorë, nuk ndikohen kurrë prej dritës së Kur'anit.

Në lidhje me këtë çështje, All'llahu i Lartësuar me fjalën e Tij, Kur'anin Famëlartë njofton: **“Ne e çuam fjalën (Kur'anin) tek ata pa ndërprerë, që ata të këshillohen.”**.

Këto ajete zbrisnin mbi ata si një shi i pandërprerë dhe argumentet e Kur'anit erdhën te ta në format e në mënyrat nga më të ndryshmet. Brendia e ajeteve të Kur'anit herë premtan shpërblim dhe herë tjetër përmban kërcënimin me zjarrin e Xhehennemit; herë tjetër ajetet e Kur'anit vijnë në formë këshille e mësimi; herë tjetër paralajmërojnë dhe kërcënojnë, disa herë përmbajnë konkluzione logjike, herë tjetër sjellin tregimet e të mëparshmëve dhe historitë e tyre të mbushura me mësim të dala nga përvoja, duke dhënë një përmbledhje të plotë të ngjarjeve më të spikatura, në të cilat beson çdo zemër që ka qoftë edhe gatishmërinë më të vogël për të besuar; sepse ato janë ngjarje që i tërheqin zemrat, me përjashtim të atyre që i kanë zemrat të verbuara, të cilët nuk u nënshtrohen këtyre argumenteve, madje nuk duan as të dëgjojnë për to.

Me përjashtim të atyre jehudive e kristianëve, të cilëve: **“Atyre që Ne i dhamë librin para atij, disa prej tyre i besojnë atij (Kur'anit)”**; ata u besonin ajeteve të Kur'anit sepse e shihnin se në to ka harmoni të plotë me shenjat e me argumentet që njoftoheshin në librat e tyre qiellorë.

Këtu është e rëndësishme të theksohet se ata ishin një grup prej ithtarëve të librave të mëparshëm, për të cilët ajetet që janë objekt studimi flasin pa asnjë kusht, pa dalluar disa dhe pa asnjë preferencë, por ka mundësi që ato të shprehin edhe kuptimin se ata me të vërtetë ishin besimtarë të librave të mëparshëm, kurse të tjerët prej tyre, nuk besonin në to.

Në vijim, Kur'ani Famëllartë duke përshkruar cilësitë e atyre ithtarëve të librave të mëparshëm thotë: **“Dhe kur atyre ai**

(Kur'ani) u lexohet, ata thonë: **ne besuam në atë, ai është e vërteta prej Zotit tone.**"

Për ata ishte e mjaftueshme që vetëm nga leximi i ajeteve të Kur'anit, të thonin **"ne besuam"**. Kur'ani njofton për fjalët që ata thanë: në të vërtetë, ne jemi myslimanë jo vetëm për këtë ditë, por: **"ne edhe para tij ishim myslimanë"**. Ata thanë: Ne i kemi gjetur shenjat e Profetit të Islamit në librat tanë qiellorë, prandaj zemrat tona janë të lidhura me të; ne kemi pritur me durim të madh dhe, në rastin më të parë kur ne gjetëm atë që na kishte humbur, ne u kapëm pas tij dhe e pranuan atë me zemrat e me shpirtrat tanë.

Më pas, Kur'ani Famëlartë, duke njoftuar për atë grup prej ithtarëve të librave të mëparshëm, të cilët i besuan Profetit (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) jo duke e imituar symbyllur, por ashtu siç është ai në të vërtetë, njofton: **"Shpërblim atyre u jepet dyfish për durimin që treguan."**

Një herë ata u shpërblyen për shkak se besuan në librin e tyre qiellor dhe ishin të singërtë e besnikë në besimin e tyre; herën tjetër shpërblehen për besimin që patën në Profetin e madh të Islamit; ata besuan në Profetin e premtuar dhe të përmendur në librat e tyre qiellorë.

Gjithashtu, nga këto ajete mësohet se shpërblimi atyre do t'u jepet dy herë edhe për shkak se ata besuan në Profetin e Islamit para shfaqjes së tij, edhe sepse nuk e mohuan, por i besuan atij kur u shfaq si Profet.

Ata punuan dhe duruan për një kohë të gjatë që të kryenin detyrën dhe përgjegjësinë që u takonte, megjithëse me punën e tyre nuk ishin dakort jehudët dhe kristianët që kishin devijuar nga

rruga e së vërtetës dhe nuk i lejuan ata të ndiqnin të mëparshmit, madje as mjedisi shoqëror nuk i lejonte ata të linin fenë e tyre e të pranonin fenë islame. Por ata qëndruan me durim, kapërcyen dëshirat materiale të kësaj bote dhe nuk panë interesat personale. Me qëndrimin e me durimin e tyre, ata e arritën dy herë shpërblimin e All'Ilahut.

Në vijim, Kur'ani Famëlartë thekson disa prej cilësive të mira që ata kishin, si për shembull ata e sprapsin të keqen me të mirën dhe shpenzojnë për punë të mira nga furnizimi që u ka dhënë All'Ilahu. Gjithashtu, ata qëndrojnë larg fjalëve të padenja dhe dërdëllitjeve të injorantëve. Në saje të durimit e të qëndrimeve të drejta që mbajtën, në Kur'anin Famëlartë ata karakterizohen me katër cilësi të mira.

Cilësitë e tyre të lavdëruara, Kur'ani Famëlartë i ka sjellë me fjali të qarta. Në lidhje me njërën prej tyre, Kur'ani thotë: **“...edhe të keqen ata e largojnë me të mirë”**.

Fjalën e keqe ata e sprapsin me fjalën e mirë; ata urdhërojnë për punë të mira dhe ndalojnë punët e urryera. Me butësi, ata sprapsin injorancën dhe injorantët. Me dashuri, ata sprapsin armiqësinë e urrejtjen. Ata i mbajnë lidhjet me farefisin, madje edhe me atë që i ka ndërprerë lidhjet me ta. Me pak fjalë, në vend që t'i përgjigjen të keqes me të keqe, ata bëjnë të kundërtën, ashtu siç njofton ajeti: **“...edhe të keqen ata e largojnë me të mirë”**.

Cilësi tjetër e këtyre të lavdëruarve në Kur'an është: **“...dhe shpenzojnë nga furnizimi që Ne u kemi dhënë”**.

Këtu nuk është fjala vetëm për shpenzim material, por për çdo dhunti që atyre u ka dhënë All'Ilahu, si: dituri, fuqi mendore

dhe trupore, autoritet në shoqëri etj. Ata e dinë se të gjitha këto dhunti i kanë prej All'llahut dhe prej furnizimit të Tij, prandaj i përdorin ato në rrugën e Tij.

Cilësinë tjetër të lavdëruar të tyre, Kur'ani Famëlartë e shpjegon qartë me frazën: **“Kur ata dëgjojnë fjalë të padenja, u largohen atyre fjalëve.”**.

Ata nuk i përgjigjen injorancës me injorancë, nuk i përgjigjen fjalës së padenjës me të njëjtën monedhë, por: **“...dhe thonë: ne kemi punët tona dhe ju keni punët tuaja”**.

Ju nuk do përgjigjeni për mëkatet e punëve tona, as ne nuk do të përgjigjemi për krimet që ju bëni dhe për mëkatet e punëve tuaja, por shumë shpejt, secili prej nesh do të gjejë rezultatin e punës së tij.

Në vijim, Kur'ani shton në lidhje me besimtarët dhe njofton se kur ballafaqohen me injorantët, të cilët punojnë për t'i shmangur nga rruga e besimit, ata u përgjigjen atyre me edukatë, duke u thënë: **“Paqa qoftë mbi ju, ne nuk na interesojnë injorantët.”**.

Ne nuk jemi prej atyre që thonë fjalë të padenja, nuk jemi as injorantë e as ngatërrestarë. Ne nuk interesohemi për të tilla punë; neve na interesojnë vetëm dijetarët, njerëzit me ndërgjegje të gjallë dhe punëtorët besimtarë e të sinqertë.

Në vend që të konsumojnë energjitë e veta duke u përballur me injorantët, gojëndyrët dhe me ata që i kanë zemrat e verbuara, ata kalojnë pranë tyre të respektuar, që të arrijnë të realizojnë objektivat dhe programet e tyre kryesore.

Vlen të përmendet se kur kanë përballë injorantët, nuk i përshëndesin ata me selam, me përshëndetjen dashamirëse islame, por vetëm me një “tungjatjeta” e u japin lamtumirën.

Hulumtime

Zemrat e gatshme për të besuar

Ajetet që janë objekt studimi i përshkruajnë në mënyrën më të bukur zemrat e përgatitura për të besuar.

Kuptohet se ata që janë të gatshëm për të besuar, nuk janë njerëz oportunistë që i kanë zemrat të mbushura me fanatizëm, me injorancë, me fjalë të ulëta, me kopraci, me urrejtje e me të tjera gjëra të urryera.

Ata janë njerëz të mëdhenj, burra e gra, të cilët para çdo gjëje shkallmuan prangat që u kishte imponuar ndjekja e traditës në mënyrë të verbër; pastaj, ata dëgjuan thirrjen për Njësimin e All'llahut (Teuhid) dhe kur gjetën argumentet e vërteta, iu përgjigjën asaj thirrjeje.

Ata morën përsipër të paguanin një çmim shumë të lartë; ata dolën jashtë rrethit të traditës së verbër dhe i thyen prangat e saj; ata u çliruan prej mjedisit të tyre të devijuar nga rruga e vërtetë. Për rrugën që zgjodhën të ndjekin, ata u detyruan të mbajnë mbi vete shumë probleme e vështirësi të mëdha. Në rrugën e arritjes së qëllimit të tyre madhor si dhe në përballjen me vështirësitë, ata i ndihmonte durimi dhe qëndrimet e drejta.

Ata nuk urrenin, nuk i përgjigjeshin të keqes me të keqe; ata nuk ishin as kopracë të ulët, që të mbanin të gjitha dhuntitë hyjnore vetëm për veten e tyre.

Ata ishin njerëz të mëdhenj dhe nuk gënjenin; ata merreshin vetëm me gjëra të vërteta.

Gjuha e tyre ishte e mirë, por zemrat e tyre ishin edhe më të mira. Ata nuk i konsumonin energjitë e tyre për t'iu përgjigjur injorantëve. Në shumicën e rasteve preferonin heshtjen në vend të fjalëve për t'iu përgjigjur injorantëve.

Ata mendonin seriozisht rreth punëve e përgjegjësive të veta dhe për ta shuar këtë "etje", ata ecnin në rrugën e së vërtetës siç ecën i eturi drejt burimit të ujit; ata kishin etje për dituri dhe kishin shumë dëshirë të merrnin pjesë në kuvendet e dijetarëve dhe të juristëve të ligjit të fesë.

Ata njerëz të mëdhenj e përvetësuan mesazhin e besimit në shpirtrat e tyre dhe për këtë, ata e marrin shpërblimin jo vetëm një herë, por All'Ilahu i shpërblen dy herë për durimin e tyre ndaj të gjitha vështirësive.

Të tillë ishin Selman Farisiu, Nexh'xhashiu, murgu Behijra. Të gjithë këta janë në të njëjtën linjë dhe në të njëjtin front. Ata u munduan shumë dhe u rezistuan llojeve të shumta e të ndryshme të vështirësive, me qëllim që të arrinin deri në kuptimin e besimit (imanit).

Ëshë shumë kuptimplotë ajo që lexojmë në një transmetim të ardhur prej Imam Sadikut në lidhje me çështjen e durimit: "Ne

ishim durimtarë, por ndjekësit tanë janë më durimtarë sesa ne. Ne duruam për atë që dinim, kurse ata durojnë për atë që nuk e dine.”.¹

Përfytyroni dy besimtarë që janë drejtuar për në sheshin e luftës në rrugën e All'llahut. Njëri prej atyre të dyve e di përfundimin e kësaj pune. Ai e di gjithashtu, se lufta e tij në rrugën e All'llahut është fitore, kurse tjetri nuk e di. A nuk është durimi i të dytit më shumë se durimi i të parit?!

Ose le të themi se shembujt krahasues tregojnë se ata të dy do të pijnë nga kupa e rënies dëshmor në rrugën e All'llahut. Njëri prej atyre të dyve e di se çfarë sekretesh e të fshehtash ka rënia e tij dëshmor në rrugën e All'llahut, ashtu siç e di se për njerëzit e lirë, ai do të jetë shembulli më i mirë dhe model për t'u ndjekur; kurse i dyti nuk di asgjë nga këto, prandaj në këtë drejtim, i dyti është më i durueshëm sesa i pari.

Në një transmetim tjetër të ardhur në tefsirin e Ali bin Ibrahimit, lexojmë: fjala *“el lagvu”* do të thotë: gjepura, dërdëllitje, fjalë të ndyra; kurse fjala *“el lehvu”* do të thotë: këngë, qejf e zbavitje. Ata që u largohen gjepurave janë: *“mut'tekijn”* – **“njerëzit e devotshëm”**.²

Të dy transmetimet janë një kriter për dallimin e së vërtetës, por kuptimi i fjalës *“el lagvu”* – **“gjepura”** është shumë më i gjerë dhe përfshin të gjithë besimtarët e vërtetë që u largohen fjalëve boshe e dërdëllitjeve, edhe pse Imamët e nderuar qëndrojnë në pararojë të tyre.

¹ “Bihàrul Enuàr”, vëll. 24, f. 216 dhe vëll. 68, f. 84; tefsiri i Ali bin Ibrahimit, vëll. 2, f. 141.

² Tefsiri i Ali bin Ibrahimit, cituar prej tefsirit “Nuruth Thekalejn”, vëll. 4, f. 133.

Ajetet: 56 - 57

إِنَّكَ لَا تَهْدِي مَنْ أَحْبَبْتَ وَلَكِنَّ اللَّهَ يَهْدِي مَنْ يَشَاءُ وَهُوَ أَعْلَمُ
بِلِلْمُهْتَدِينَ ﴿٥٦﴾ وَقَالُوا إِنْ تَتَّبِعِ الْهُدَىٰ مَعَكَ نُتَخَطَّفُ مِنْ أَرْضِنَا أَوَلَمْ
نُمْكِّنْ لَهُمْ حَرَمًا ءَامِنًا يُجِبَىٰ إِلَيْهِ ثَمَرَاتُ كُلِّ شَيْءٍ رِّزْقًا مِّن لَّدُنَّا
وَلَكِنَّ أَكْثَرَهُمْ لَا يَعْلَمُونَ ﴿٥٧﴾

“Pa dyshim që ti nuk mund të udhëzosh atë që do, porse All’l-lahu udhëzon cilin të dojë dhe vetëm Ai e di më mirë se cilët janë të udhëzuarit.”

“Ata thanë: ‘nëse do të ndjekim udhëzimin (për në rrugën e drejtë) bashkë me ty’, shumë shpejt do të dëbohem i prej vendit tonë; a nuk bëmë Ne për ata një vend të shenjtë të sigurtë dhe ku për ata nga ana Jonë sillen frutat e çdo send, si furnizim nga ana Jonë, por shumica e tyre nuk e dinë.”

Komentimi

Udhëzimi vjen vetëm prej All'Ilahut!

Në lidhje me shkakun e zbritjes së ajetit të parë të dy ajeteve që janë objekt studimi, kanë ardhur transmetime të shumta. Megjithatë, për një çështje të tillë kanë ardhur edhe transmetime që nuk mund të merren në konsideratë, kështu që këtë ajet do ta komentojmë me vetë Kur'anin dhe pastaj do të trajtojmë transmetimet e dyshimta ose të vëna.

Ajetet e mësipërme flisnin për dy grupe: grupin e idhujtarëve të Mekës, për të cilët i Dërguari i All'Ilahut këmbëngulte në udhëzimin e tyre, por që ata nuk u udhëzuan dhe nuk iu nënshtruan dritës së besimit; dhe grupi tjetër, që ishin prej ithtarëve të librave të mëparshëm dhe individë që jetonin larg Mekës, por që udhëzimin e All'Ilahut e pritën me zemër të hapur, dhe me dashuri, madje ranë dëshmorë në rrugën e Islamit; ata nuk u kushtuan rëndësi njerëzve të tyre injorantë e egoistë, nuk u frikësuan nga presionet, izolimi dhe kërcënimet e hapura.

Duke iu rikthyer ajeteve në fjalë, konstatojmë se ajeti i parë zbulon perden që e mbulonte këtë të vërtetë dhe, duke iu drejtuar personalisht Profetit, thotë: **“Pa dyshim që ti nuk mund të udhëzosh atë që do, porse All'Ilahu udhëzon cilin të dojë dhe vetëm Ai e di më mirë si janë të udhëzuarit”**.

All'Ilahu e di se cilët janë ata që e meritojnë të jenë besimtarë; Ai e di se cilat zemra e kërkojnë të vërtetën. All'Ilahu e di se kush janë ata që kanë dashuri për Të; Ai i njeh ata dhe ua bën atyre mbarë që të shkojnë në drejtim të besimit (*imanit*).

Kurse atyre që u janë errësuar zemrat, ata që kanë zgjedhur rrugën e keqe dhe janë armiqësorë ndaj së vërtetës, ata e luftuan me urrejtje të Dërguarin e All'llahut, sepse zemrat e tyre ishin të ndotura gjatë gjithë jetës me ndyrësinë e idhujtarisë deri në atë gradë, sa nuk mund të ishin të denjë të besonin në All'llahun e Lartësuar. Prandaj, për ata nuk do të ndriçonte kurrë feneri i besimit.

Duke u bazuar mbi këto që u thanë, qëllimi me udhëzimin nuk është që atyre t'u thuhej të "shihnin rrugën", sepse kjo është prej detyrave të Profetit (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe kjo detyrë përfshin të gjithë njerëzit pa përjashtim. Qëllimi me udhëzimin këtu është "arritja e të kërkuarit dhe e objektivit"; mirëpo kjo arritje është vetëm në dorën e All'llahut dhe është vetëm All'llahu, Ai që e "mbjell" besimin në zemra. All'llahu i Lartësuar sheh në zemrat e përgatitura që t'u dhurojë atyre dritën e qiellit.

Ky ajet e forcon zemrën e Profetit (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), në mënyrë që ai të jetë i sigurtë për këtë të vërtetë; pra, as këmbëngulja e as armiqësia e idhujtarëve, qofshin edhe prej banorëve të Mekës, as besimi i banorëve të Abisinisë, apo të Nexhranit, si Selman Farisiut, apo i murgut Behjërà, nuk ndodhën pa argument e pa shkak. Prandaj, ai nuk duhej të shqetësohej ngaqë grupi i parë nuk besonte, sepse All'llahu i Lartësuar e hedh dritën e Tij vetëm në zemrat e përgatitura për ta marrë atë dritë.

Në ajetet e Kur'anit gjejmë shembuj të ngjashëm me përmbajtjen e ajetit që është objekt studimi; për shembull, në ajetin 272 të sures "El Bekare" lexojmë: **"Nuk është detyrim për ty që t'i**

udhëzosh ata (në rrugën e drejtë), **por All'llahu udhëzon atë që Ai do."**

Edhe në ajetin 37 të sures "En Nahl" lexojmë: **"Edhe nëse ti** (o Muhammed) **bën shumë kujdes që t'i udhëzosh ata, All'llahu nuk e udhëzon atë që është në rrugën e humbjes."**

Gjithashtu, në ajetin 43 të sures "Jünus", lexojmë: **"...a ti do të udhëzosh të verbërit nëse ata nuk shikojnë..."**.

Ndërsa në ajetin 4 të sures "Ibràhim" lexojmë fjalën e All'llahut, të Lartit, që është ligj i përgjithshëm: **"All'llahu e lë në rrugën e humbjes atë që do dhe e udhëzon** (në rrugën e drejtë) **atë që do. Ai është i Gjithëfuqishmi, i Urti."**

Ajeti i dytë i ajeteve që janë objekt studimi tregon qartë se dëshira hyjnore në lidhje me këto dy grupe, pra me grupin e udhëzuar në rrugën e drejtë dhe grupin e devijuar, nuk është pa llogari. Përkundrazi, ajo është në përputhje të plotë me meritën e individit për t'u udhëzuar si dhe me vetë punën e tij. Në këtë ajet, Kur'ani Famëllartë flet për një grup që e kanë pohuar Islamin në jetën e tyre, pra zemrat e tyre janë ndërgjegjësuar për këtë fe, përndryshe ata nuk do ta shfaqnin kurrë besimin për shkak se do t'i ndalonin interesat personale. Për këtë grup njerëzish, ajeti njofton: **"Ata thanë: nëse do të ndjekim udhëzimin** (për në rrugën e drejtë) **bashkë me ty, shumë shpejt do të dëbohem i prej vendit tone."**

Në librat e tefsirit thuhet se personi që e tha frazën **"nëse do të ndjekim udhëzimin** (për në rrugën e drejtë) **bashkë me ty"** ishte Hàrith bin Nüfel. Ai iu drejtua Profetit (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) me këto fjalë: *"Ne e*

dimë se ajo që ti thua është e vërtetë, por kemi frikë të të ndjekim e të të besojmë sepse i druhami sulmit të banorëve të shkretëtirës, të cilët do të na nxjerrin jashtë trojeve tona dhe ne nuk kemi fuqi t'i sprapsim ata.”¹

Këto fjalë mund të dalin vetëm prej atij që e konsideron të vogël fuqinë e All'llahut dhe që mendon se fuqia e një grupi të vogël arabësh politeistë e injorantë është e madhe; këto fjalë dalin vetëm prej asaj zemre që nuk e njeh kujdesin e All'llahut dhe mbrojtjen e Tij; ato dalin vetëm prej atij që nuk ka dijeni se si i ndihmon All'llahu miqtë dhe se si i poshtëron armiqtë e Tij. Në përgjigje të këtyre pretendimeve false, Kur'ani Famëlartë njofton: **“...a nuk bëmë Ne për ata një vend të shenjtë e të sigurtë dhe ku për ata nga ana Jonë sillen frutat e çdo send, si furnizim nga ana Jonë, por shumica e tyre nuk e dine.”**

All'llahu e bëri këtë tokë të kripur e të mbuluar me shkëmbinj, pa bimësi e pa lumenj. Ai e bëri atë vend të shenjtë, drejt të cilit orientohen zemrat; Ai bëri që aty të vijnë fruta prej të gjitha vendeve të botës.

Kush tjetër përveç All'llahut, e ka këtë fuqi për të vendosur sigurinë dhe për të sjellë mirësitë në këtë vend?! Këtë gjendje, ju o idhujtarë, e shihni me sytë tuaj. Si mund të mendoni se Ai nuk qenka i fuqishëm që t'ju ruajë prej sulmit të një grushti injorantësh që adhurojnë idhujt?

Në kohën kur ju ishit mohues u mbuluat prej dy mirësive të mëdha të All'llahut: siguria dhe mjetet e jetesës. Pra, si mund t'ju privojë All'llahu nga këto mirësi pasi e pranuat Islamin?!

¹ Tefsiri “Mexhmaul Bejan”, fundi i ajetit që është objekt studimi.

Forcojini zemrat dhe besoni në atë që u është zbritur, sepse Zoti i Qabes, Zoti i Mekës, është me ju.

Por, nga historia është vërtetuar se “shenjtëria” e Mekës jo gjithmonë ka qenë siguri për myslimanët. A nuk janë torturuar një grup prej tyre në këtë qytet? A nuk e gjuajtën Profetin (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) me gurë shumë herë në Mekë? A nuk u vranë disa myslimanë aty? A nuk emigruan një grup myslimanësh për në Abisini, me në krye Xhafer bin Ebù Tàlibin? Më në fund, a nuk u detyrua Profeti (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) të largohej nga Meka së bashku me një grup tjetër myslimanësh, për shkak se aty s'kishte siguri?

Në përgjigje të këtyre pyetjeve, themi:

E para: krahas të gjitha ngjarjeve që u përmendën, Meka vazhdonte të ishte shumë më e sigurtë sesa vendet e tjera. Arabët vazhdonin ta respektonin e ta shenjtëronin atë, pavarësisht se vetë ata bënë krime të shumta në vende të tjera.

Në përgjithësi, Meka vazhdonte të ruante një siguri relative, për shkak se banorët e shkretëtirës që jetonin jashtë saj, kujdeseshin për sigurinë dhe shenjtërinë e këtij qyteti.

E dyta: është e vërtetë se Meka, të cilën All'llahu e bëri vend të shenjtë dhe të sigurtë, për një kohë të shkurtër, kur ajo ra në duart e një grupi, u bë vend jo i sigurtë, por shumë shpejt ajo u shndërrua në një qendër të madhe sigurie e me mirësi të shumta.

Sido që të jetë, është e vërtetë se shumica e atyre që shqetësoheshin për përfitimet personale, si Hàrith bin Nùfeli, nuk hynin në rrugën e udhëzimit e të besimit, në një kohë kur besimi

në All'llahun dhe dorëzimi ndaj urdhrit të Tij, nuk siguronte për ta vetëm përfitime morale, por edhe mjedisin e shëndoshë ekonomik dhe dobitë e ligjshme materiale.

Ndër mirësitë e mëdha që All'llahu i lartësuar i ka dhënë Mekës, është pikërisht siguria. Përveç saj, mirësi tjetër është ajo e ardhjes së frutave e të furnizimeve prej të gjitha anëve. Ka mundësi që kjo shprehje të shpjegojë pikërisht faktin se, përderisa siguria mbizotëron në një vend, atëherë ekonomia e tij është e mirë. (Këtë çështje e kemi trajtuar në studimin që kemi vënë në lidhje me komentimin e ajetit 35 të sures "Ibràhim").

Gjithashtu, vlen të theksohet se fjala e këtij ajeti "*juxhbà*" – "**sillen**", edhe pse ka ardhur në formën e foljes në kohën e tashme, tregon se sjellja e mirësive në Mekë do të jetë e vazhdueshme si në të tashmen, ashtu edhe në të ardhmen. Sot, edhe pasi kanë kaluar më shumë se katërmbëdhjetë shekuj, ne e shohim të vërtetën e kësaj fjale, e shohim se ardhja e llojeve të shumta të mirësive në këtë vend të bekuar është e vazhdueshme. Ata që shkojnë në Mekë për të kryer *haxhin* dhe që vizitojnë "shtëpinë" e All'llahut, Qabenë, e shohin me sytë e tyre se sa shumë të mira ka në këtë tokë të zhveshur, të nxehtë e pa bimësi.

Hulumtime

Besimi i Ebu Talibit dhe diskutimi rreth tij

Kjo temë duket kaq e çuditshme për studiuesit e për lexuesit, të cilët pyesin: Si ka mundësi që një grup prej përcjellësve të transmetimeve, këmbëngulin në pretendimin e tyre se Ebu Talibi, xhaxhai i Profetit (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ka qenë idhujtar dhe se ka vdekur si mohues, ndërkohë që sipas mendimit të përbashkët të myslimanëve, ai ka bërë sakrifica të shumta e të pashembullta për të mbrojtur e për të ruajtur Profetin e Islamit?!

Përse nuk shihet një këmbëngulje e ngjashme në etiketimin e idhujtarëve të tjerë, që nuk kanë ndonjë rol në historinë e Islamit?

Ne e dimë se këtu nuk kemi të bëjmë me një çështje të zakonshme. Po ta shohim më hollësisht, do të vëmë re se pas këtyre studimeve dhe transmetimeve, qëndron një lojë politike shumë e rrezikshme, e kurdisur prej kundërshtarëve të Imam Aliut, të cilët kanë punuar me këmbëngulje për ta zhveshur atë prej çdo virtyti, deri edhe të atin e tij, i cili u bë theror dhe e deshi Profetin e All'llahut më shumë se veten e tij; e megjithatë, sipas pretendimit të tyre, ky njeri vdiq si mohues!

Është e sigurtë se *emevitë* (benij Umej'jeh) dhe mbështetësit e tyre bashkëkohës, edhe para se ata të merrnin në dorë frerët e qeverisjes, punuan shumë për të vërtetuar pretendimet e tyre për

pushtet dhe për të mbledhur dëshmues të rremë e “argumente”, që vetëm të tilla nuk mund të quhen.

Në pikëpamjen tonë, këto valë politike të pashembullta dhe të devijuara duhet të studiohen nga këndvështrime të ndryshme; por këtë studim do ta bëjmë në mënyrë të përmbledhur, ashtu siç e kërkon edhe karakteri i këtij libri. Këtu do të bëhet e qartë se prapa kësaj “zhurme” s’ka asnjë argument që mund të merret në konsideratë. Përkundrazi, ka dëshmi konkrete kundër vetë çështjes që ata kanë ngritur, gjë që do ta shohim në pikat në vijim:

1- Ajeti që është objekt studimi “Pa dyshim që ti nuk mund të udhëzosh atë që do” - s’ka asnjë lidhje me Ebu Talibin, pasi ashtu siç e kemi shpjeguar më lart, këto ajete kanë të bëjnë me grupin e besimtarëve prej ithtarëve të librave të mëparshëm kundrejt idhujtarëve të Mekës.

Ràziu (interpretues i njohur dhe autori i tefsirit “*Et Tefsiijrul Kebijr*”) pretendon se sipas mendimit të përbashkët të myslimanëve, ky ajet ka zbritur në lidhje me Ebu Talibin, por ai deklaron hapur se në të s’ka asnjë argument që të vërtetojë se Ebu Talibi ishte mohues.¹

Meqë qenka kështu, atëherë pse këmbëngulet kaq shumë për të vërtetuar se Ebu Talibi ishte idhujtar? Kjo gjë është me të vërtetë e habitshme.

2- Argumenti më i rëndësishëm që ata kanë në lidhje me këtë çështje, është se pretendimi që Ebu Talibi ishte idhujtar, pranohet nga e gjithë bashkësia e myslimanëve, në një kohë kur

¹ Tefsiri “Kebijr”, vëll. 25, f. 3.

fjala “bashkësi e myslimanëve” nuk mbështetet në asnjë bazë dhe në të nuk ka asnjë të vërtetë.

Interpretuesi i njohur i Kur'anit Famëlartë, El Alūsij'ji, që është prej dijetarëve të Ehli Syneetit, ka deklaruar në tefsirin e tij “*Rùhul Meànij*” se kjo nuk është prej çështjeve që kanë fjalën e përbashkët të “bashkësisë së myslimanëve” dhe se mendimi që qarkullon në masën e myslimanëve dhe në mesin e interpretuesve të Kur'anit, se ajeti që është objekt studimi ka zbritur për Ebu Talibin, duket jo i vërtetë, sepse shumica e interpretuesve besojnë se ai ishte mysliman. Gjithashtu, këtë mendim e kanë mbështetur të gjithë Imamët e Ehli Bejtit. Këtu duhet shtuar se edhe të gjitha mendimet që qarkullojnë për Ebu Talibin, dëshmojnë besimin e tij.¹

3- Studimet e hollësishme kanë vërtetuar se kjo “bashkësi e myslimanëve” e pretenduar, është prej njoftimeve të mbështetura vetëm në transmetime që nuk mund të merren në konsideratë, sepse përballë tyre qëndrojnë transmetime të tjera, të vërtetuara për saktësinë e tyre, të cilat i hedhin poshtë të parat. Sipas këtyre transmetimeve të sakta, mendimet që pretendojnë se Ebu Talibi ishte idhujtar, janë të përcjella prej individëve, që në shkencën e verifikimit të saktësisë së transmetimeve, janë quajtur përcjellës të dyshimtë.

Prej transmetimeve që sjellin mbështetësit e pretendimit se Ebu Talibi ishte idhujtar, është edhe ai i cituar prej Ibni Merdevij'jeh me përcjellës të drejtpërdrejtë Ibn Ab'bàsin, i cili në lidhje me ajetin “**Pa dyshim që ti nuk mund të udhëzosh atë që do**”, ka thënë: “*Thuhet se ky ajet ka zbritur në lidhje me Ebu Talibin*

¹ Tefsiri “*Rùhul Meànij*”, vëll. 20, f. 84; fundi i ajetit që është objekt studimi.

dhe se Profeti (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) këmbënguli shumë tek ai që të besonte, por ai nuk besoi kurrë.".¹

Është vërtetuar se ndër përcjellësit e këtij transmetimi është edhe i quajtur Ebu Sehl Es'serij. Për të, dijetarët që janë marrë me përcjellësit e transmetimeve, kanë thënë se është prej gënjeshtarëve që kanë vënë fjalët e tyre dhe, nga kjo pikëpamje, janë prej vjedhësve të haditheve. Gjithashtu, në vargun e përcjellësve të transmetimit në fjalë është edhe Abdul Kudûs Ebû Seïjd Ed Dimeshkij, i cili gjithashtu është cilësuar ndër përcjellësit gënjeshtarë.²

Fjalët e transmetimit të lartpërmendur tregojnë se Ibni Ab'bàsi e ka përcjellë këtë transmetim pa ndërmjetës. Nga fjalët e transmetimit kuptohet se ka qenë vetë i pranishëm në atë ngjarje, por dihet se Ibni Ab'bàsi ka lindur tre vjet para "Hixhretit" (emigrimit të Profetit nga Meka në Medine), që do të thotë se kur vdiq Ebu Talibi, ai ishte ende foshnje që ushqehet me gjë. Nga ky fakt, arrijmë në konkluzionin se transmetuesit ishin prej atyre që stisin.

Ekziston edhe një transmetim tjetër i ardhur prej Ebu Hurejres, në të cilin ai tregon: "Kur Ebu Talibi ishte në pragun e vdekjes, Profeti (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) i tha: "O xhaxha, thuaj: 'Là ilàhe il'lell'llàh' - s'ka zot tjetër përveç All'llahut - që në Ditën e Gjykimit unë të dëshmoj për ty, në prani të All'llahut se ti je besimtar". Por Ebu Talibi tha: "Sikur kurejshët të mos thonin se Ebu Talibi e deklaroi besimin në çastet e

¹ Tefsiri "Ed Durr'rrul Menthûr", vëll. 5, f. 133.

² "El Gadijr", vëll. 8, f. 20.

vdekjes nga frika, unë do të dëshmoja Njësimin e All'llahut këtu para teje.". Ndërkaq zbriti fjala e All'llahut, të Lartit: **"Pa dyshim që ti nuk mund të udhëzosh atë që do."**¹

Nga fjalët e këtij transmetimi del se Ebu Hurejre ishte i pranishëm në atë ngjarje, në një kohë kur ne e dimë se ai e ka pranuar Islamin pas çlirimit të Hajberit, pra është bërë mysliman në vitin e shtatë të hixhretit. Atëherë, si mundet që ai të ketë qenë i pranishëm në vdekjen e Ebu Talibit, e cila ka ndodhur para Hixhretit?!

Nëse do thuhej se Ibni Ab'basi dhe Ebu Hurejre, vërtetë nuk ishin të pranishëm në ngjarje, por ata e kanë dëgjuar këtë çështje prej ndonjë personi tjetër, atëherë ne pyesim: Kush është ky person që ua ka cituar këtë transmetim këtyre dy burrave? Rezulton se ai "person" është i panjohur. Transmetime të tilla në shkencën e hadithit klasifikohen nën titullin "*mursel*", por të gjithë e dinë se hadithi i shkallës "*mursel*", nuk mund të merret në konsideratë.

Është për të ardhur keq kur sheh se një grup përcjellësish të transmetimeve dhe interpretuesish të Kur'anit i kanë cituar këto transmetime në librat e tyre prej njëri-tjetrit, pa ndonjë verifikim të hollësishëm. Kështu, pak e nga pak u krijua mendimi se këto transmetime gëzojnë fjalën e përbashkët të "bashkësisë së myslimanëve". Por ç'bashkësi është kjo, apo i çfarë grade është klasifikuar një transmetim i tillë, që të merret në konsideratë?!

4- Megjithatë, vetë fjalët e këtyre transmetimeve, tregojnë se Ebu Talibi besonte në të vërtetën e Profetit (*Paqja dhe bekimi i*

¹ Tefsiri "Ed Durr'rrul Menthùr", vëll. 5, f. 133.

All'Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Qëllimi në këtë çështje është se ai nuk e shqiptoi fjalën e Njëshmërisë me gojën e tij. Gjithsesi, ne e dimë se besimi është me zemër, kurse fjala është rruga e zemrës. Në disa transmetime islame, Ebu Talibi përshkruhet se ngjason me “djemtë e shpellës” (*as'habul kehfi*), të cilët ishin besimtarë, por nuk patën mundësi ta deklaronin besimin me gojën e tyre.¹

Në ditët e sotme ruhen shumë poezi të Ebu Talibit, të cilat e shpjegojnë qartë besimin e tij në Islamin dhe në mesazhin e Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimi i All'Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Këto poezi i kanë cituar një grup dijetarësh të nderuar në librat e tyre. Edhe ne kemi cituar prej këtyre poezive të marra nga burime të njohura të Ehli Syneetit në fundin e ajetit 26 të sures “El En'âm”.

5- Pavarësisht nga sa u tha më lart, historia e jetës së Ebu Talibit dhe sakrificat e tij të mëdha për Profetin (*Paqja dhe bekimi i All'Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), tregojnë se lidhjet e tij me myslimanët ishin aq të forta sa që vitin e vdekjes së tij, Profeti (*Paqja dhe bekimi i All'Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e quajti “viti i hidhërimit”. Kjo tregon se sa shumë dashuri kishte ai njeri për Islamin. Veç kësaj, mbrojtja që Ebu Talibi i jepte Profetit të Islamit, nuk ishte si ajo që mund të jepet për një të afërm. Jo, mbrojtja e Ebu Talibit, ishte mbrojtja e një besimtari të sinqertë, e një besimtari të pastër në dashurinë e tij ndaj Islamit; ajo ishte mbrojtja që jep ushtari i bindur ndaj komandantit dhe prijësit të tij. Edhe pse të gjitha këto janë të qarta, përsëri injoranca,

¹ Për këtë çështje, lexo në tefsiret “Es Sâfi” dhe “El Burhân”; fundi i ajetit që është objekt studimi.

shkujdesja, padrejtësia dhe mungesa e falënderimit, bëjnë që një pjesë e interpretuesve të Kur'anit të këmbëngulin në mendimin e tyre se ky njeri i madh dhe besimtar i sinqertë në Njësimin e All'llahut, ka vdekur si idhujtar.¹

¹ Në lidhje me këtë çështje kemi vënë një studim gjatë komentit të ajetit 36 të sures "El En'am".

Ajetet: 58 - 60

وَكَمْ أَهْلَكْنَا مِنْ قَرْيَةٍ بَطَرَتْ مَعِيشَتَهَا فَتِلْكَ مَسَكِنُهُمْ لَمْ تُسْكَنْ مِنْ
 بَعْدِهِمْ إِلَّا قَلِيلًا وَكُنَّا نَحْنُ الْوَارِثِينَ ﴿٥٨﴾ وَمَا كَانَ رَبُّكَ مُهْلِكَ الْقُرَى حَتَّى
 يَبْعَثَ فِي أُمَمٍ رُسُلًا يَتْلُوا عَلَيْهِمْ آيَاتِنَا وَمَا كُنَّا مُهْلِكِي الْقُرَى إِلَّا وَأَهْلُهَا
 ظَالِمُونَ ﴿٥٩﴾ وَمَا أُوتِيتُمْ مِنْ شَيْءٍ فَمَتَّلِعُوا الْحَيَاةَ الدُّنْيَا وَزِينَتُهَا وَمَا عِنْدَ اللَّهِ
 خَيْرٌ وَأَبْقَى أَفَلَا تَعْقِلُونَ ﴿٦٠﴾

“Sa vendbanime kemi shkatërruar ngaqë ata (banorët) ishin mosmirënjohës për jetën që bënin; ja dhe shtëpitë e tyre, në të cilat pas tyre s’kanë banuar në ato përveçse një pakicë dhe Ne ishim trashëgimtarët e tyre.”

“Zoti yt nuk i ka shkatërruar vendbanimet pa dërguar më parë në kryeqendrat e tyre një Profet që t’u lexojë atyre argumentet Tona dhe Ne i shkatërruam vendbanimet vetëm kur banorët bëjnë padrejtësi.”

“Çdo gjë që u është dhënë, ajo është kënaqësi dhe shije e kësaj bote; kurse ajo që është tek All’llahu (shpërblimi i All’llahut), është shumë më e mirë dhe e përhershme; a nuk mendoni?”

Komentimi

Të mos ju mashtrojnë gjërat që ju lidhin me këtë botë

Në ajetet e mësipërme bëhej fjalë për pretendimet e banorëve të Mekës dhe në mënyrë të veçantë për fjalët e tyre: “Nëse do të ndjekim udhëzimin së bashku me ty, neve do të na nxjerrin arabët prej trojeve tona, kështu që do të na shkojë dëm jeta dhe do të na përkeqësohet gjendja ekonomike.”.

Këto ajete u dhanë një përgjigje shumë të goditur të gjitha këtyre pretendimeve të kota.

Edhe në ajetet që janë objekt studimi jepen dy përgjigje të tjera ndaj fjalëve të banorëve të Mekës:

E para: le të supozojmë se ju kurrë nuk do të besoni; do të vazhdoni në idhujtarinë tuaj e do të kaloni një jetë të mirë nga ana materiale, por mos harroni të nxirrni mësim prej jetës së atyre që jetuan para jush.

Për këtë, ajeti njofton: **“Sa vendbanime kemi shkatërruar ngaqë ata (banorët) ishin mosmirënjohës për jetën që bënë.”.**

Mendjemadhësia e mosmirënjohja bënë që ata të mos falënderojnë për të mirat që gëzonin, ndërkohë që mosmirënjohja e pakënaqësia ndaj mirësive janë baza e padrejtësisë. Prandaj, padrejtësia e tërhoqi zvarrë jetën e tyre drejt zjarrit. Për përfundimin e tyre, në ajet thuhet: **“...ja dhe shtëpitë e tyre në të cilat pas tyre pak vetë kanë banuar në ato”.**

Shtëpitë e tyre mbetën të shkreta, u shkatërruan, u bënë gërmadha të errëta. Në to nuk banoi askush përveç një kohe të shkurtër. Ajeti njofton: “...dhe Ne ishim trashëgimtarët e tyre”.

Me fjalë të tjera, në ajet thuhet: “O idhujtarë të Mekës! A doni ta kaloni jetën duke qenë të pakënaqur dhe duke mohuar, ashtu siç bënë popujt e mëparshëm? Por dijeni se fundi juaj do të jetë si fundi i tyre. Pra, çfarë dobie ka në këtë?!

Fjala e ajetit “*betiret*” në rrënjën e saj “*betire*” do të thotë tirani e mendjemadhësi nga ana e njerëzve kur jetojnë në mesin e të mirave.

Kurse fjala tjetër e ajetit “*tilke*” tregon largësi dhe në shumicën e rasteve përdoret për të treguar objekte që mund të shihen nga larg me sy. Me këtë shprehje, qëllimi mund të jetë për vendbanimet e popujve: Àd, Themùd dhe të popullit të Lutit. Këto vende nuk janë shumë larg banorëve të Mekës, pasi ato shtrihen në zonën Ahkâf ndërmjet Jemenit e Shamit, ose në Vâdil-kurà, ose në zonën e Sodomës. Të gjitha këto vende shtriheshin në rrugën që përshkonin karvanet e tregtarëve arabë nga Meka për në Sham. Gjatë udhëtimit, ata e shihnin me sytë e tyre se si këto shtëpi kishin mbetur pa njeri, ose në to banonin fare pak veta.

Në shprehjen e ajetit “**përveçse një pakicë**” që ka ardhur në formë përjashtuese, ka tre mundësi:

Mundësia e parë: nuk ka banorë.

Mundësia e dytë: nuk ka shtëpi.

Mundësia e tretë: në ato shtëpi nuk mund të banohet.

Nga mundësia e parë kuptohet se në ato shtëpi banonte vetëm një grup i vogël njerëzish.

Nga mundësia e dytë kuptohet se ato shtëpi janë përdorur për banim vetëm për një periudhë të shkurtër kohe, sepse faqja e jetës së banorëve të tyre është palosur shumë shpejt.

Të tre kuptimet e tekstit të lartpërmendur janë të vlefshëm, edhe pse kuptimi i parë është më i qartë.

Disa interpretues të Kur'anit kanë thënë se qëllimi me këtë ajet janë banesat provizore të udhëtarëve që shkonin e vinin me karvane; ato banesa shërbenin që njerëzit e karvaneve të pushonin për pak kohë. Interpretues të tjerë kanë thënë se qëllimi me fjalën "shtëpi" në këtë ajet janë strolçat e kafshëve të egra.

Sipas asaj që është pranuar nga të gjithë, mësohet se ato shtëpi ishin të ndotura nga mëkati dhe nga idhujtaria, prandaj u bënë të papërshtashme për banim.

Fraza e ajetit: **"dhe Ne ishim trashëgimtarët e tyre"** tregon se ato shtëpi mbetën pa njerëz dhe se pronari i vërtetë i tyre është All'llahu, i Gjithëfuqishmi, Pronari i çdo sendi. Kur Ai i jep dikujt një pronë që mund të merret në konsideratë, ajo nuk mund të vazhdojë gjatë në duart e pronarit, pasi shumë shpejt trashëgimtari i saj do të jetë përsëri All'llahu.

Në të vërtetë, ajeti vijues është një përgjigje për pyetjen e mundshme: Meqë qenka kështu, atëherë përse nuk u shkatërruan banorët idhujtarë të Mekës e të Hixhazit, tirania e mizoria e të cilëve kishte arritur në kufinj shumë të largët? Ata nuk lanë mëkat pa bërë dhe injoranca e tyre dukej qartë në të gjitha punët.

Atëherë, përse All'llahu nuk i ndëshkoi ata me dënimin e dhimbshëm?

Në përgjigje të kësaj pyetjeje, Kur'ani thotë: **“Zoti yt nuk i ka shkatërruar vendbanimet pa dërguar më parë në kryeqendrat e tyre një Profet që t’u lexojë atyre argumentet Tona.”**.

All'llahu nuk dënon asnjë popull derisa mbi ta të plotësohet argumenti i Tij kundër tyre dhe derisa Ai të dërgojë tek ata një Profet. Gjithashtu, All'llahu nuk i dënon derisa ata të mos kenë bërë një mëkat të madh, që e bën detyrim dënimin e tyre. All'llahu e kontrollon punën e tyre, ashtu siç njofton ajeti: **“Ne i shkatërroam vendbanimet vetëm kur banorët bënë padrejtësi.”**.

Fraza e ajetit **“Zoti yt nuk...”** ose fraza tjetër e tij **“dhe Ne i...”** janë argument që vërteton se rruga e përhershme e All'llahut ka qenë e do të vazhdojë të jetë për të mos dënuar askënd pa u plotësuar argumentet kundër tij në mënyrë të mjaftueshme.

Fraza tjetër e ajetit: **“pa dërguar më parë në kryeqendrat e tyre një Profet”**, tregon se nuk është e domosdoshme të dërgohet Profet për çdo qytet, por është e mjaftueshme që All'llahu e dërgon Profetin në kryeqendër, nga e cila përhapen lajmet e dituria. Profeti i dërguar u kumton njerëzve misionin me të cilin është ngarkuar të shpallë. Është e mjaftueshme që Profeti të dërgohet në një kryeqendër, me të cilën banorët e atyre zonave kanë marrëdhënie të vazhdueshme dhe janë të detyruar të shkojnë e të vijnë vazhdimisht për të plotësuar nevojat e tyre të domosdoshme. Prandaj, lajmi për një ngjarje që ndodh në kryeqendër përhapet me shpejtësi deri në skajet më të largëta të zonës, ashtu siç u përhap jehona e ardhjes së Profetit Muhammed

(*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Nga Meka, lajmi për këtë ngjarje madhore u përhap në të gjitha anët e Gadishullit Arabik, sepse ajo ishte kryeqendër e zonës Vàdil-kurà dhe qendër shpirtërore për të gjithë banorët e gadishullit. Njëkohësisht, Meka ishte edhe qendër tregtare, kështu që brenda një kohe shumë të shkurtër, lajmet rreth Profetit të Islamit arritën në të gjitha qendrat e rëndësishme të asaj kohe.

Duke u bazuar mbi këtë shpjegim, ajeti që është objekt studimi shpjegon një dispozitë të përgjithshme në lidhje me pretendimin e interpretuesve të Kur'anit, se qëllimi me shprehjen e ajetit **“në kryeqendrat e tyre”**, është Meka, por që është thënë me një shprehje përgjithësuese. Vetë fjala *“um'mun”* ka kuptimin *“qendër origjinë”* dhe nuk mund të jetë e posaçme vetëm për Mekën.¹

Ajeti i fundit i grupit të ajeteve që janë objekt studimi ka në brendinë e vet përgjigjen e tretë ndaj atyre që iu drejtuan Profetit (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) me këto fjalë: **“nëse do të ndjekim udhëzimin** (për në rrugën e drejtë) **bashkë me ty', shumë shpejt do të dëbohem** prej vendit **tonë”**, arabët do të na largojnë prej shtëpive tona. Por All'llahu, me fjalën e Tij, u thotë atyre: **“Çdo gjë që u është dhënë, ajo është kënaqësi dhe shije e kësaj bote; kurse ajo që është tek All'llahu** (shpërblimi i All'llahut), **është shumë më e mirë dhe e përhershme”**; mirësitë që ju keni do të zhduken, pasi mirësitë e kësaj bote preken nga shumë dëme e probleme të ndryshme.

¹ Në lidhje me faktin nëse ajeti i përfshin, apo jo nocionet logjike të pavarura (*mustakil aklî*), flitet në studimin që kemi vënë në fundin e ajetit 15 të sures “El Isrà”.

Kurse të mirat që janë tek All'llahu, janë të përhershme dhe nuk mund të maten e të krahasohen me të mirat kalimtare të kësaj bote. Mirësitë e All'llahut jo vetëm që janë më të mira, por janë edhe të përhershme.

Edhe me një paralelizim të thjeshtë, çdo njeri i mençur e kupton se ai nuk duhet të sakrifikojë mirësitë e Botës së Ardhshme për mirësitë e kësaj bote. Për këtë, ajeti mbyllet me fjalën e All'llahut, të Lartit: **“A nuk mendoni?”**.

Fahrud-din Raziu ka cituar prej një juristi të ligjit të fesë, i cili ka thënë: “Nëse dikush porosit që një të tretën e pasurisë t’ia japë njeriut më të mençur, unë do ta këshilloja që t’ia jepte këtë pasuri atij që i bindet urdhrit të All'llahut, sepse njeriu më i mençur është ai që jep nga pasuria e tij pak për të marrë shumë, për të marrë atë që është më e mirë dhe e përhershme; por këtë e beson vetëm ai që i bindet All'llahut.”.

Më pas, Fahrud-din Raziu shton: “Duket se këtë gjykim, juristi e ka nxjerrë prej ajetit që është objekt studimi.”.

Ajetet: 61 - 64

أَفَمَنْ وَعَدْنَاهُ وَعْدًا حَسَنًا فَهُوَ لَاقِيهِ كَمَنْ مَتَّعْنَاهُ مَتَاعَ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا ثُمَّ هُوَ يَوْمَ الْقِيَامَةِ مِنَ الْمُحْضَرِينَ ﴿٦١﴾ وَيَوْمَ يُنَادِيهِمْ فَيَقُولُ أَيْنَ شُرَكَاءِ الَّذِينَ كُنْتُمْ تَزْعُمُونَ ﴿٦٢﴾ قَالَ الَّذِينَ حَقَّ عَلَيْهِمُ الْقَوْلُ رَبَّنَا هَؤُلَاءِ الَّذِينَ أَغْوَيْنَا أَغْوَيْنَاهُمْ كَمَا غَوَيْنَا تَبَرَّأْنَا إِلَيْكَ مَا كَانُوا إِيَّانَا يَعْبُدُونَ ﴿٦٣﴾ وَقِيلَ ادْعُوا شُرَكَاءَكُمْ فَدَعَوْهُمْ فَلَمْ يَسْتَجِيبُوا لَهُمْ وَرَأَوُا الْعَذَابَ لَوْ أَنَّهُمْ كَانُوا يَهْتَدُونَ ﴿٦٤﴾

“A është ai që e arrin atë premtim të mirë që Ne i kemi bërë, si ai të cilit i kemi dhënë kënaqësi në jetën e kësaj bote, pastaj ai Ditën e Kiametit do të jetë prej të dënuarve.”

“Ditën kur Ai do t’i thërrasë ata, do t’u thotë: ku janë ato që ju i bëtë shokë për Mua dhe që ju i pandehnit për zota?”

“Ata që e merituan fjalën (dënimin) thanë: këta janë ata që ne i çuam në rrugën e humbjes, ashtu siç hymë edhe vetë në rrugën e humbjes; ne shfajësohemi te Ti se ata nuk na kanë adhuruar.”

“Dhe u thuhet: thirrini zotat tuaj; ata i thërrasin, por ato nuk u përgjigjen dhe ata e shohin me sy dënimin (vendin e dënimit) atëherë (do të thonë) sikur të ishin udhëzuar në rrugën e drejtë.”

Komentimi

Ata janë adhurues të dëshirave

Në ajetet e mësipërme flitej për ata që preferuan mohimin mbi besimin për shkak të përfitimeve personale. Gjithashtu, ata preferuan t'i bënin shok All'llahut në adhurim (*shirk*) dhe e lanë Njësimin e All'llahut (*Teuhidin*), e lanë adhurimin kushtuar vetëm Atij.

Kurse në grupin e ajeteve që janë objekt studimi, Kur'ani Famëlartë shpjegon për gjendjen e grupit të parë në Ditën e Kiametit kundrejt gjendjes së besimtarëve të singërtë.

Në fillimin e ajetit të parë të ajeteve në fjalë, shtrohet një pyetje dhe bëhet krahasimi midis besimtarëve dhe mohuesve. Në të vërtetë, kjo pyetje e ngacmon ndërgjegjen dhe e bën atë gjykatëse, ashtu siç e lexojmë në tekstin e ajetit: **“A është ai që e arrin atë premtim të mirë që Ne i kemi bërë, si ai të cilit i kemi dhënë kënaqësi në jetën e kësaj bote, pastaj ai Ditën e Kiametit do të jetë prej të dënuarve.”**.

S'ka dyshim se një ndërgjegje e zgjuar anon nga premtimi i All'llahut, nga dhuntitë e Tij të mëdha dhe jo nga të mirat e kësaj bote, të cilat nuk vazhdojnë më shumë se disa ditë dhe më pas do të vijnë dhimbje e vuajtje të përhershme.

Fraza e ajetit **“ai që e arrin atë”** thekson se premtimi i All'llahut nuk do të vonojë kurrë dhe patjetër duhet të jetë kështu, sepse vonimi i premtimit vjen ose prej mungesës së dijenisë, ose

prej pamundësisë; por si mungesa e dijenisë, ashtu edhe e pamundësisë nuk mund të thuhet për All'llahun e Lartësuar.

Kurse fraza e fundit e ajetit: **“...ai Ditën e Kiametit do të jetë prej të dënuarve”**, tregon sjelljen e njerëzve në Ditën e Kiametit në praninë e All'llahut gjatë dhënies së llogarisë. Këtë frazë disa e kanë interpretuar me sjelljen në zjarrin e Xhehennemit. Gjithsesi, duket se komentimi i parë përputhet më shumë me fjalët e ajetit. Sido që të jetë, kjo frazë tregon se jobesimtarët do të çohen pa dëshirën e tyre në vendin e frikshëm të dhënies së llogarisë dhe kështu do të jetë patjetër, sepse llogaridhënia, gjykimi dhe pamjet e asaj Dite janë aq të tmerrshme, saqë e errësojnë krejtësisht qenien e jobesimtarëve.

Shprehja e ajetit **“jeta e kësaj bote”**, që përsëritet në ajete të sureve të ndryshme të Kur'anit, tregon përcëimin për këtë botë ndaj Jetës së Përhershme në Botën e Ardhshme, që kurrë nuk do të asgjësohet; vetë fjala *“dun'jâ”* - **“kjo botë”** në rrënjën e saj *“dunu'vun”* do të thotë: afrim në hapësirë (në vendin përkatës), në kohë dhe në pozitë. Më pas, ky kuptim është përdoruar për të treguar qeniet që zotërohen kundrejt qenieve të mëdha, por mund të përdoret edhe për sende pa vlerë kundrejt sendeve me vlerë; kurse fjala *“pranë”* këtu mund të jetë përdorur edhe në kuptimin e largësisë së vogël në kohë, duke pasur parasysh kuptimin se jeta e kësaj bote është shumë e vogël kundrejt jetës së ardhshme; jeta e kësaj bote është pa vlerë, por është edhe afër Jetës së Përhershme. Nga ky këndvështrim, emërtimi **“jeta e kësaj bote”** është më i përshtatshmi nga ana gjuhësore.

Më pas flitet për grumbullimin e të gjitha qenieve në Ditën e Gjykimit, për pamjet e asaj Dite, të cilat do të jenë konkrete për

jobesimtarët. Nga dukuritë e asaj Dite, njeriut i rrënoqethet trupi edhe kur i përfytyron, ashtu siç e lexojmë në njoftimin që bën Kur'ani për këtë gjendje: **“Ditën Kur Ai do t’i thërrasë ata, do t’u thotë: ku janë ato që ju i bëtë shokë për Mua dhe që ju i pandehnit për zota?”**.

Natyrisht që këtu kemi të bëjmë me një pyetje qortuese dhe poshtëruese, sepse Dita e Kiametit është Dita e heqjes së perdeve dhe e mbulesave. Në atë Ditë nuk ka kuptim të flitet as për idhujtarinë e as për idhujtarët; në atë Ditë, të gjithë do të jenë ose me besimin që kishin në këtë botë, ose me idhujtarinë e tyre.

Në të vërtetë, kjo pyetje është njëra prej llojeve të poshtërimeve, qortimeve dhe formave të dënimit.

Por në vend që ata që i vënë shok All’llahut në adhurim (*mushrikët*) të përgjigjen vetë, do të jenë “të adhuruarit” e tyre, ata që do të përgjigjen; të adhuruarit do të shfaqësohen dhe do të shfaqin neverinë ndaj adhurimit që politeistët kanë bërë për ta.

Ne dimë se zotat që adhuronin politeistët ishin tre llojesh: ose ishin idhuj prej guri ose prej druri të gdhendur prej vetë njerëzve; ose krijesa të “shenjta” engjëj, ose Mesihu, ose ishin prej djajve xhindë. Janë pikërisht këta të adhuruar që i përgjigjen pyetjes, ashtu siç tregon Kur’ani: **“Ata që e merituan fjalën (dënimin) thanë: këta janë ata që ne i çuam në rrugën e humbjes, ashtu siç hymë edhe vetë në rrugën e humbjes; ne shfaqësohemi te Ti se ata nuk na kanë adhuruar.”**.

Bazuar mbi këtë shpjegim, ajeti në fjalë është i ngjashëm me ajetin 28 të sures “Jûnus”: **“të adhuruarit e tyre thonë: ju nuk na adhuruat ne”**.

Ja kështu do të përgjigjen të adhuruarit mashtrues në vend të adhuruesve të tyre, por ata shfajësohen dhe ua hedhin barrën e fajit adhuruesve, ashtu siç u shfajësua Faraoni, Nemrùdi, djalli dhe xhindët prej adhuruesve të tyre e popullit të tyre. Të adhuruarit largohen me vrap nga neveria që kanë ndaj adhuruesve dhe mbrojnë veten e tyre; madje, edhe për rrugën e gabuar që ndiqnin adhuruesit e tyre, ata përsëri ua hedhin fajin adhuruesve dhe thonë: "...ata na ndoqën me vullnetin e tyre...", etj.

Por në Ditën e Gjykimit, ky mohim s'ka asnjë ndikim, as shfajësimi nuk u sjell ndonjë dobi. Atë Ditë, adhuruesi dhe i adhuruari do të jenë së bashku në Zjarr.¹

Këtu tërheq vëmendjen fakti se atë Ditë, çdonjëri prej të devijuarve nga rruga e vërtetë do të mundohet të shfajësohet prej të tjerëve dhe ta hedhë fajin mbi shokun e tij.

Situata e asaj Dite ngjason plotësisht me atë që shohim në këtë botë. Kur disa njerëz që bashkëpunojnë në një punë që është në kundërshtim me ligjin kapen dhe vihen para drejtësisë, çdonjëri nga të implikuarit i lan duart prej tjetrit; madje disa edhe krimin ia hedhin bashkëpunëtorit. Edhe në botën e ardhshme, e tillë do të jetë gjendja e atyre që devijuan nga rruga e vërtetë në këtë botë.

¹ Në ajetin që është objekt studimi, ka mundësi që ata që i përgjigjen pyetjes të jenë krerët e idhujtarëve, domethënë një grup prej adhuruesve të idhujve. Këta, me qëllim që të mos i përgjigjen pyetjes, fillojnë të flasin për ndjekësit e tyre dhe thonë: "O Zoti ynë, ne u mashtruam dhe ramë në idhujtari, por këta na kanë ndjekur me dëshirën e vet dhe ne i mashtruam, por ata nuk na bindën.". Fjala e ajetit "*el ibâdetu*" - "*adhurim*", në ajetin në fjalë ka kuptimin "bindje me dëshirë dhe me respekt". Nga ky këndvështrim rezulton se ata u janë bindur krerëve të tyre me vullnetin e vet.

Një shembull të ngjashëm e lexojmë edhe në ajetin 22 të sures “Ibrahim”: **“Pasi mbaron gjykimi, djalli tha: me të vërtetë All’llahu u bëri premtimin e vërtetë; edhe unë u premtova, por unë nuk e mbajta premtimin ndaj jush; unë nuk kisha asnjë pushtet mbi ju, unë u bëra thirrje dhe ju iu përgjigjët thirrjes time, prandaj mos më qortoni mua, por qortoni veten tuaj.”**

Në lidhje me grindjen midis idhujtarëve dhe ndjekësve të tyre në Ditën e Kiametit, lexojmë edhe në ajetin 30 të sures “Es Saffât”: **“...nuk kishin ndonjë pushtet mbi ju por ju vetë ishit në rrugën e humbjes”**.

Gjithsesi, pas pyetjes për zotat e tyre dhe pamundësisë së idhujtarëve për t’u përgjigjur, u kërkohet t’i thërrasin ata për t’u ardhur në ndihmë: **“Dhe u thuhet: thirrini zotat tuaj!”**.¹

Kur idhujtarët mësojnë se thirrja e tyre nuk sjell asnjë dobi dhe se të adhuruarit e tyre, që ata ia bënin shok All’llahut në adhurim, nuk mund të bëjnë asgjë, nga tmerri i asaj Dite, apo në përgjigje të urdhrat të All’llahut, i Cili ka shfaqur vullnetin e Tij të diskreditojë idhujtarët dhe zotat që ata adhuronin para syve të njerëzisë, është pikërisht ky çasti kur idhujtarët do t’u drejtohen për ndihmë zotave të tyre, zotave që ata i bënin shok All’llahut në adhurim. Për këtë, Kur’ani njofton se: **“ata i thërrasin”**.

Është e qartë se për këtë thirrje apo kërkesë të idhujtarëve s’ka asnjë përgjigje; atyre nuk u thotë askush “erdhëm”: **“por ato nuk i përgjigjen”**, atyre nuk u sjell asgjë dobi, sepse tani ata: **“dhe ata e shohin me sy dënimin** (vendin e dënimit)”.**”**

Në këtë gjendje, idhujtarët shpresojnë: **“atëherë** (do të thonë) **sikur të ishin udhëzuar”**.¹

¹ Shprehja e ajetit “shurekâekum” - **“zotat tuaj”**, të cilët ju i bëtë shokë për Mua, tregon o politeistë, se ato ishin idhujt tuaj dhe se kanë lidhje vetëm me ju, por jo me All’llahun.

Kjo është e ngjashme me frazën e ajetit 6 të sures “Et Tekâthur”: **“Patjetër do ta shihni Xhehennemin.”**.

Disa të tjerë mendojnë se kuptimi i frazës së lartpërmendur është: “sikur ata të ishin udhëzuar në rrugën e drejtë në këtë botë, nuk do ta shihnin dënimin në Botën Tjetër”.

Disa të tjerë pretendojnë se dënimi nuk është ashtu siç u tha dhe, për këtë, ata janë zgjatur në studime të shumta.

Disa të tjerë mendojnë se kushti i përgjigjes për dënimin në bazën e saj, nuk është hequr; gjithashtu edhe fraza **“dhe ata e shohin me sy dënimin** (vendin e dënimit)” është përgjigjja e mësipërme dhe ajo që vjen pas kësaj fraze, është kusht. Sipas këtij shpjegimi, kuptimi i frazës është: “sikur ata të mendonin dhe të udhëzoheshin, patjetër që nuk do të shihnin dënimin, porse ata nuk u udhëzuan në rrugën e drejtë.”

Përveç këtyre, është edhe një kuptim tjetër që ne e kemi përmendur më lart gjatë shpjegimit të fjalës “leu” – **“sikur”** dhe kuptimin e fjalës “leu” ne e shpjeguam me foljen “temen’neu” – **“urojnë për vete”** prandaj s’ka asnjë problem nëse lexohen edhe libra gjuhësie apo letërsie, si libri “Mugnil Edijb”, etj.

¹ Në lidhje me frazën e ajetit **“atëherë (do të thonë) sikur të ishin udhëzuar në rrugën e drejtë”**, disa interpretues të Kur'anit kanë bërë studime të shumta. Shumë prej tyre kanë thënë se shprehja “leu”, këtu është në mënyrën kushtore. Gjithashtu, ata kanë bërë studime edhe në lidhje me dënimin dhe kanë thënë se prej frazës **“dhe ata e shohin me sy dënimin** (vendin e dënimit)”, mësohet se vlerësimi i kësaj fraze është: “edhe sikur ata të ishin udhëzuar në rrugën e drejtë, patjetër që dënimin do ta shihnin me sytë e vet qysh në këtë botë”.

Ajetet: 65 - 70

وَيَوْمَ يُنَادِيهِمْ فَيَقُولُ مَاذَا أَجَبْتُمُ الْمُرْسَلِينَ ﴿٦٥﴾ فَعَمِيَتْ عَلَيْهِمُ الْأَنْبَاءُ
يَوْمَئِذٍ فَهُمْ لَا يَتَسَاءَلُونَ ﴿٦٦﴾ فَأَمَّا مَنْ تَابَ وَآمَنَ وَعَمِلَ صَالِحًا فَعَسَىٰ أَن
يَكُونَ مِنَ الْمُفْلِحِينَ ﴿٦٧﴾ وَرَبُّكَ يَخْلُقُ مَا يَشَاءُ وَيَخْتَارُ ۚ مَا كَانَ لَهُمُ الْخِيَرَةُ
سُبْحَنَ اللَّهِ وَتَعَالَىٰ عَمَّا يُشْرِكُونَ ﴿٦٨﴾ وَرَبُّكَ يَعْلَمُ مَا تُكِنُّ صُدُورُهُمْ وَمَا
يُعْلِنُونَ ﴿٦٩﴾ وَهُوَ اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ لَهُ الْخَمْدُ فِي الْأُولَىٰ وَالْآخِرَةِ ۖ وَلَهُ الْحُكْمُ
وَالِإِيَّاهِ تُرْجَعُونَ ﴿٧٠﴾

**“Dhe Ditën kur Ai (All’Ilahu) i thërret ata dhe u thotë:
ç’përgjigje u dhatë të Dërguarve?”**

**“Atë Ditë atyre u humbin lajmet (që do t’i shpëtonin nga
përgjigjja) dhe as nuk pyesin njëri-tjetrin.”**

**“Kurse ai që është penduar, ka besuar dhe ka bërë punë të mira,
shpresohet që ai të jetë prej të shpëtuarve.”**

**“Zoti yt krijon atë çka dëshiron dhe Ai zgjedh, pasi zgjedhja
nuk i takon atyre; i dëlirë nga të metat dhe i lartë është All’Ilahu
prej atyre gjërave që ata ia vënë Atij për shok.”**

**“Zoti yt ka dijeni se ç’fshehin dhe çfarë shpallin hapur zemrat e
tyre.”**

“Ai është All’llahu, s’ka zot tjetër përveç Atij, vetëm Atij i takon falënderimi e lavdërimi në këtë botë dhe në Botën Tjetër, vetëm Atij i takon sundimi dhe tek Ai do të ktheheni.”

Komentimi

Ajetet që janë objekt studimi vijnë menjëherë pas ajeteve që flisnin për idhujtarët dhe pyetjet që u bëhen atyre në Ditën e Gjykimit.

Pasi pyeten për zotat që ata ia bënin shok All’llahut në adhurim, idhujtarët do të pyeten dhe për qëndrimet që kanë mbajtur ndaj Profetëve të tyre. Për këtë, ajeti njofton: **“Dhe Ditën kur Ai (All’llahu) i thërret ata dhe u thotë: ç’përgjigje u dhatë të dërguarve?”**.

Dihet se idhujtarët nuk kanë përgjigje për këtë pyetje, ashtu siç nuk kishin edhe për pyetjen e mëparshme.

A mendon se ata mund të thonë: “ne iu përgjigjëm Profetëve”?! Kjo është gënjeshtër e mirëfilltë. Atë Ditë, gënjeshtari është krejtësisht i humbur; apo do të thonë: “ne i përgënjeshtroam dhe i akuzuam të Dërguarit”; “ne u thamë atyre që janë të çmendur, luftuam kundër tyre dhe kundër atyre që i besonin ata”.

A ka mundësi të thonë kështu?! Çdo gjë që mund të thonë i diskrediton ata dhe tregon se sa të ligj janë. Atë Ditë, edhe Profetët e të Dërguarit do t’i përgjigjen Zotit të tyre kur të pyeten, ashtu siç

e lexojmë në ajetin 109 të sures “El Maide”: **“...ç’përgjigje u dhanë (popujt); ata (Profetët) thonë: ne nuk kemi dijeni, vetëm Ti ke dijeni të plotë për të fshehtat”**.

Por ç’do të thonë në atë Ditë e në atë vend idhujtarët me zemra të errësuar?

Duke shpjeguar gjendjen e tyre në atë Ditë, Kur’ani Famëlartë njofton: **“Atë Ditë atyre u humbin lajmet** (që do t’i shpëtonin nga përgjigja) **dhe as nuk pyesin njëri-tjetrin”**; ata nuk e pyesin njëri-tjetrin ngaqë nuk dinë si të përgjigjen.

Në këtë ajet tërheq vëmendjen fakti se shprehja **“u humbin”**, u adresohet lajmeve dhe jo idhujtarëve, pasi ajeti këtu nuk flet për verbërinë e idhujtarëve, por thotë: **“Atë Ditë atyre u humbin lajmet”**, sepse për shumë prej ngjarjeve që ndodhin aty, njeriu mund të mos ketë dijeni, por i mëson pasi ato të lakohen në gjuhët e të tjerëve; ashtu siç na ndodh të kemi dijeni për ngjarjet vetëm atëherë kur lajmet për to përhapen në mesin e shoqërisë. Por në Ditën e Gjykimit, as njerëzit nuk kanë dijeni dhe as lajmet nuk përhapen.

Kështu mbeten lajmet e fshehura dhe njerëzit nuk kanë me se t’i përgjigjen fjalës së All’liahut, të Lartit: **“ç’përgjigje u dhatë të Dërguarve”**; në ato çaste, ata i pushton një heshtje e plotë.

Metoda e thirrjes së Kur’anit është e atillë që i lë portat e pendimit gjithmonë të hapura, madje edhe për mohuesit e mëkatarët, me shpresë se ata do të pendohen dhe do të kthehen në rrugën e vërtetë, pavarësisht mëkateve të tyre. Në lidhje me këtë, në ajetin vijues thuhet: **“Kurse ai që është penduar, ka besuar**

dhe ka bërë punë të mira, shpresohet që ai të jetë prej të shpëtuarve.”.

Ashtu siç e shpjegon Kur'ani, rruga e shpëtimit është përmbledhur me tri fjali: kthimi tek All'llahu dhe pendimi para Tij, besimi e puna e mirë dhe përfundim do të jetë patjetër shpëtimi.

Shprehja e ajetit “*asà*” është prej foljeve vetvetore që tregon “shpresë”, megjithëse ai që beson dhe bën punë të mira, patjetër që është prej të shpëtuarve. Kjo fjalë mund të ketë ardhur në ajet për shkak se besimi dhe puna e mirë janë të kushtëzuara me vijimësinë; pra, njeriu duhet të besojë e të bëjë punë të mira në mënyrë të vazhdueshme. Por dihet se edhe ata që pendohen, jo të gjithë i përmbahen pendimit (*teubes*). Ndodh që disa prej të penduarve të rikthehen në punët e mëparshme, prandaj edhe Kur'ani është shprehur me fjalën “*asà*” - “**shpresohet**”.

Ajeti në vazhdim është argument që hedh poshtë idhujtarinë dhe shpjegon se sa të gabuar janë idhujtarët: **“Zoti yt krijon atë çka dëshiron dhe Ai zgjedh, pasi zgjedhja nuk u takon atyre.”**¹

Krijimi është në “dorën” e Tij, edhe mendimi e zgjedhja gjithashtu. Askush përveç Atij nuk mund të bëjë atë që dëshiron; pa mendo se ç'mund të bëjnë idhujt?!

Zgjedhja e njerëzve është në “dorën” e Tij; në “dorën” e Tij është ndërmjetësimi dhe dërgimi i Profetëve. Në mënyrë të

¹ Fjala “*mà*” në frazën e ajetit “**zgjedhja nuk u takon atyre**” është frazë mohuese. Disa interpretues të Kur'anit mendojnë se ajo është frazë e lidhëse ose cilësor për një kundrinor të hequr të fjalës “**zgjedh**”, por kjo mundësi është shumë larg së vërtetës.

përmbledhur, zgjedhja e të gjitha sendeve është e varur prej dëshirës dhe prej Vullnetit të Tij të shenjtë. Duke u bazuar mbi këtë, idhujt s'kanë fuqi të bëjnë asgjë; madje as engjëjt e as Profetët s'kanë fuqi të bëjnë diçka me dëshirën e me vullnetin e vet, përveçse me urdhrin e All'llahut dhe vetëm për atë që Ai do dhe është i kënaqur me punën që bëhet.

Sido që të jetë, vetë zgjedhja pa kushte është argument që vërteton se zgjedhja është e përgjithshme, në kuptimin që vetëm All'llahu, të Cilit nuk i mungon asgjë dhe s'ka nevojë për asgjë, është "Autori" i zgjedhjes në punët e krijimit dhe të dispozitave ligjore; pra, të gjitha punët janë të varura vetëm tek All'llahu.

Meqë gjendja është e tillë, atëherë si është e mundur që ata të shkojnë në rrugën e vënies shok All'llahut në adhurim dhe të kërkojnë ndihmë e t'i luten dikujt tjetër dhe të mos i drejtohen për ndihmë Atij? Për të gjitha këto, ajeti e dëlir All'llahun nga ortakët që i vënë idhujtarët dhe thotë: **"...i Dëlirë nga të metat dhe i Lartë është All'llahu prej atyre gjërave që ata ia vënë Atij për shok."**

Në transmetimet e ardhura prej Ehli Bejt, ajeti që është objekt studimi është interpretuar me zgjedhjen e Imamëve të ruajtur prej mëkateve nga ana e All'llahut të Lartësuar. Sipas këtyre transmetimeve, fraza **"zgjedhja nuk u takon atyre"** tregon se çështja e ruajtjes së fesë dhe zgjedhja e një udhëheqësi të ruajtur prej mëkateve, nuk mund të jetë veçse nga ana e All'llahut të Lartësuar.¹

¹ "Usûlul Kâfij, vëll. 1, f. 201; tefsiri i Ali bin Ibrahim, vëll. 2, f.142 dhe tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 4, f. 136.

Ajeti vijues flet për diturinë e madhe të All'llahut dhe është në të vërtetë një argument, që tregon sesa e gjerë është zgjedhja e Tij. Për këtë, ajeti në fjalë njofton: **“Zoti yt ka dijeni se ç’fshehin dhe çfarë shpallin hapur zemrat e tyre.”**.

Fakti që All'llahu ka dijeni për të gjitha gjërat e sendet, është edhe një kërcënim për idhujtarët që ata të mos mendojnë se All'llahu nuk ka dijeni për sekretet, për qëllimet dhe për komplotet e tyre.

Ajeti i fundit i grupit të ajeteve që janë objekt studimi, është një rezyme e gjyimit dhe një shpjegim për ajetet para tij në lidhje me hedhjen poshtë të idhujtarisë. Në këtë ajet, kjo shpjegohet me katër prej cilësive të All'llahut, që në të vërtetë janë degë të fuqisë së Tij krijuese dhe zgjedhjes së Tij:

E para: “Ai është All'llahu, s’ka zot tjetër përveç Atij.”

Si është e mundur të ketë një të adhurar tjetër përveç All'llahut?! Vetëm Ai është Krijuesi dhe të gjitha zgjedhjet janë me urdhrin e me Vullnetin e Tij. Prandaj, kush mendon të ndërmjetësojë për veten e tij tek All'llahu me anë të idhujve, ai është në rrugën e humbjes dhe është prej atyre që gabojnë rëndë.

E dyta: të gjitha mirësitë e kësaj bote dhe të Botës Tjetër, janë vetëm prej All'llahut, pasi kjo është prej kërkesave të fuqisë absolute të Tij për të krijuar. Në lidhje me këtë çështje, Kur’ani njofton: “vetëm Atij i takon falënderimi e lavdërimi në këtë botë dhe në Botën Tjetër.”.

E treta: “vetëm Atij i takon sundimi”; vetëm Ai është Sunduesi në këtë botë dhe në Botën Tjetër.

E katërta: “dhe te Ai do të ktheheni” për të dhënë llogari dhe për të marrë shpërblimin ose dënimin.

All’Ilahu është Krijuesi, Ai është i Mirëinformuari, është Sunduesi në Ditën e Gjykimit. Në “dorën” e Tij janë llogaria, shpërblimi dhe dënimi.

Ajetet: 71 - 75

قُلْ أَرَأَيْتُمْ إِنْ جَعَلَ اللَّهُ عَلَيْكُمُ اللَّيْلَ سَرْمَدًا إِلَى يَوْمِ الْقِيَمَةِ مَنْ إِلَهٌ غَيْرُ اللَّهِ يَأْتِيكُمْ بَضِيَاءٌ أَفَلَا تَسْمَعُونَ ﴿٧١﴾ قُلْ أَرَأَيْتُمْ إِنْ جَعَلَ اللَّهُ عَلَيْكُمُ النَّهَارَ سَرْمَدًا إِلَى يَوْمِ الْقِيَمَةِ مَنْ إِلَهٌ غَيْرُ اللَّهِ يَأْتِيكُمْ بَلِيلٌ تَسْكُنُونَ فِيهِ أَفَلَا تُبْصِرُونَ ﴿٧٢﴾ وَمِنْ رَحْمَتِهِ ۚ جَعَلَ لَكُمُ اللَّيْلَ وَالنَّهَارَ لِتَسْكُنُوا فِيهِ وَلِتَبْتَغُوا مِنْ فَضْلِهِ ۚ وَلَعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ ﴿٧٣﴾ وَيَوْمَ يُنَادِيهِمْ فَيَقُولُ أَيْنَ شُرَكَائِيَ الَّذِينَ كُنْتُمْ تَزْعُمُونَ ﴿٧٤﴾ وَنَزَعْنَا مِنْ كُلِّ أُمَّةٍ شَهِيدًا فَقُلْنَا هَاتُوا بُرْهَانَكُمْ فَعَلِمُوا أَنَّ الْحَقَّ لِلَّهِ وَضَلَّ عَنْهُمْ مَا كَانُوا يَفْتَرُونَ ﴿٧٥﴾

“Thuaj: si mendoni nëse All’Ilahu do ta bënte natën për ju të përhershme deri Ditën e Kiametit, cili zot tjetër përveç All’Ilahut do të sillte dritë për ju; a nuk dëgjoni?”

“Thuaj: si mendoni nëse All’Ilahu do ta bënte ditën për ju të përhershme deri Ditën e Kiametit, cili zot tjetër përveç All’Ilahut do të sillte natë që ju të pushoni gjatë saj; a nuk e shikoni?”

“Dhe nga mëshira e Tij, Ai bëri për ju natën dhe ditën, që ju të pushoni dhe të përfitoni prej mirësive të Tij dhe që ju të falënderoni.”

“Dhe Ditën kur do t’i thirrë ata, do t’u thotë: ku janë ata shokët e Mi që ju pretendonit.”

“Ne prej çdo populli do të nxjerrim dëshmitar dhe do të themi: silleni argumentin tuaj; atëherë ata (idhujtarët) do të mësojnë se e drejta (për të qenë i adhuruar) i takon vetëm All’llahut dhe i humbin prej syve ato që ata kishin trilluar.”

Komentimi

Nata dhe dita, dy mirësitë e mëdha

Ajetet që janë objekt studimi flasin për një pjesë të madhe të dhuntive të All’llahut të Lartësuar. Nga njëra anë, këto dhunti vërtetojnë Njëshmërinë e All’llahut dhe nga ana tjetër plotësojnë studimin e mëparshëm dhe u kujtojnë njerëzve mirësitë, për të cilat është detyrim të falënderohet e të lavdërohet vetëm Dhuruesi i tyre. Në të njëjtën kohë, këto ajete janë edhe një dëshmi që vërteton se zgjedhja dhe rregullimi në sistemin e krijimit i takon vetëm All’llahut.

Në ajetin e parë të këtij grupi ajetesh flitet për mirësinë e natës e të ditës, që janë bazë për çdo lëvizje. Për këtë, ajeti thotë: **“Thuaj: si mendoni nëse All’llahu do ta bënte natën për ju të**

përhershme deri Ditën e Kiametit, cili zot tjetër përveç All'Ilahut do të sillte dritë për ju; a nuk dëgjoni?".¹

Në këtë ajet, dita është shprehur me fjalën "dritë", për shkak se qëllimi kryesor me të është zbardhja e agimit dhe drita, nga e cila varet jeta e të gjitha qenieve të gjalla. Sikur të mos ishte drita e diellit, nuk do të mbinte asnjë lule, nuk do të rritej asnjë pemë, nuk do të fluturonte asnjë shpend, nuk do të kishte mbetur asnjë njeri dhe nuk do të binte asnjë pikë shiu.

Fjala e ajetit "*sermeden*" ka kuptimin: i përhershëm, i vazhdueshëm. Disa kanë thënë se kjo fjalë ka kuptimin: i përhershëm, i njëpasnjëshëm; disa të tjerë mendojnë se rrënja e kësaj fjale "*serdun*" do të thotë: shpon, përsërit, vazhdon etj. Disa të tjerë mendojnë se germa "*m*" në fjalën "*sermeden*" është e shtuar, por në të vërtetë kjo është fjalë e pavarur dhe shpreh kuptimin e përhershmërisë e të vijueshmërisë.²

Ajeti vijues flet për mirësinë e errësirës dhe thotë: **"Thuaj: si mendoni nëse All'Ilahu do ta bënte ditën për ju të përhershme deri Ditën e Kiametit, cili zot tjetër përveç All'Ilahut do të sillte natë që ju të pushoni gjatë saj; a nuk e shikoni?".**

Kurse ajeti i tretë i këtij grupi ajetesh tregon rezultatin e dy ajeteve të para dhe thotë: **"Dhe nga mëshira e Tij, Ai bëri për ju**

¹ Shprehja e ajetit "*ere'ejtum*" ka ardhur në kuptimin: "Më thoni, më njoftoni"; por ashtu siç e kemi thënë më lart, herë të tjera kjo shprehje ka ardhur edhe në kuptimin: "A e mësuat? A e morët vesh?"

² Gjuhëtarët kanë thënë se fjala "*sermedij'jun*" thuhet për diçka që s'ka as fillim e as mbarim; kurse fjala "*el ezelij*" thuhet për diçka që s'ka fillim, ndërsa fjala "*el ebedij*" thuhet për diçka që s'ka mbarim.

natën dhe ditën që ju të pushoni dhe të përfitoni prej mirësive të Tij dhe që ju të falënderoni.”.

Padiskutim që mëshira e madhe e All’llahut përmban të gjitha elementët e jetës tuaj, por ju keni nevojë të punoni e të lëvizni dhe për shkak të lodhjes keni nevojë për natën që të pushoni.

Në ditët e sotme është vërtetuar praktikisht se të gjitha organet e trupit të njeriut janë aktive kur ka dritë. Në saje të dritës aktivizohet sistemi i qarkullimit të gjakut, aparati i frymëmarrjes, ritmi i pulsimit të zemrës dhe të gjitha organet e tjera. Por kur drita vazhdon më shumë se zakonisht, qelizat e trupit lodhen dhe aktiviteti kthehet në plogështi.

E kundërta ndodh natën: qelizat qetësohen dhe bien në një pushim të thellë që rikthen aktivitetin dhe fuqinë. Këtë kuptim e kemi shpjeguar në vëllimin e gjashtë në fundin e ajetit 67 të sures “Jùnus” dhe në ajetin 12 të sures “El Isrà”.

Është shumë domethënës fakti se kur ajeti u flet njerëzve për përhershshmërinë e natës, u drejtohet në vetën e dytë dhe u thotë: **“a nuk dëgjoni?”** dhe kur u flet për përhershshmërinë e ditës, u thotë: **“a nuk e shikoni?”**. Ka mundësi që kjo mënyrë shprehjeje të jetë për shkak se shqisa e të dëgjuarit është e përshtatshme për natën, ndërsa shqisa e të shikuarit është e përshtatshme për ditën. Ky mund të jetë edhe shkak se pse kjo çështje kaq e rëndësishme është trajtuar në Kur’anin Famëlartë me kaq hollësi.

Gjithashtu, në këtë ajet duhet t’i kushtohet vëmendje faktit se pasi është përmendur dëgjimi dhe shikimi, ose nata dhe dita, fraza përmbyllëse është: **“...që ju të falënderoni”**; falënderim për

sistemin e llogaritur dritë-errësirë, falënderim që e çon njeriun drejt njohjes së Dhuruesit të mirësive, falënderim që është motiv për besimin si dhe falënderim për studimet që lidhen me çështjet e besimit.

Pasi janë përmendur disa argumente që vërtetojnë Njëshmërinë e All'llahut dhe hedhin poshtë idhujtarinë, Kur'ani Famëlartë rikthehet në pyetjen që u shtrua në ajetet e mësipërme dhe thotë: **“Dhe Ditën kur do t'i thirrë ata, do t'u thotë: ku janë ata shokët e Mi që ju pretendonit?”**.

Ky ajet është përsëritur tekstualisht edhe në ajetin 62 të kësaj sureje, por kjo përsëritje mbase ka ardhur për shkak të pyetjes drejtuar çdo individ në lidhje me Ditën e Kiametit; është përsëritur me qëllim që njerëzit t'i kthehen ndërgjegjes së tyre dhe të kenë turp prej vetes. Pyetja herë është e përgjithshme në lidhje me Ditën e grumbullimit të të gjithë njerëzve për të dhënë llogari para All'llahut, ashtu siç tregohet në ajetin vijues, që njerëzit të turpërohen edhe në prani të njëri-tjetrit në atë grumbullim të madh.

Për të shpjeguar ato që u thanë më lart, ajeti vijues njofton: **“Ne prej çdo populli do të nxjerrim dëshmitar dhe do të themi: silleni argumentin tuaj”**, silleni argumentin ju o idhujtarë, që keni marrë rrugën e humbjes.¹

Dhe kur të zbulohen të gjitha çështjet e kur të dalin në dritë të gjitha punët, nuk do të mbetet asgjë e fshehtë: **“...atëherë ata (idhujtarët) do të mësojnë se e drejta** (për të qenë i adhuruar) **i**

¹ Fjala “neza'nà” e këtij ajeti do të thotë: tërheqja e një sendi prej vendit të vet. Kjo fjalë tregon sjelljen e dëshmitarëve prej mesit të çdo grupi e prej mesit të çdo populli.

takon vetëm All'llahut dhe i humbin prej syve ato që ata kishin trilluar."

Duke bërë krahasimin me ajetet e tjera të Kur'anit, dëshmitarët që do të nxirren janë Profetët. Çdonjëri prej Profetëve është dëshmitar për popullin e tij, kurse Profeti i Islamit, që është vula e të gjithë Profetëve, do të jetë dëshmitar për të gjithë Profetët dhe për të gjithë popujt, ashtu siç e lexojmë në ajetin 41 të sures "En Nisà": **"Si do të jetë gjendja e atyre (jobesimtarëve) kur Ne të sjellim dëshmitarë prej çdo populli dhe ty do të sjellim dëshmitar mbi ata (jobesimtarët)."**

Bazuar mbi këtë ajet, në Ditën e Kiametit do të mbledhet kuvendi i madh, ku të pranishëm janë edhe Profetët dhe ku idhujtarët zemërverbuar do të mësojnë dhimbjen e rëndë të idhujtarisë, do të mësojnë të vërtetën e All'llahut dhe do të kuptojnë se sa rrugë e gabuar është adhurimi i idhujve.

Është shumë kuptimplotë fakti që ajeti shprehet me frazën: **"...dhe i humbin prej syve ato që ata kishin trilluar"**, domethënë iluzionet e besimet që ata kishin për idhujt, do të shuhen në Ditën e Kiametit, sepse Fusha e Madhe e Gjykimit është e vërteta dhe aty s'ka vend për të gabuarën; prandaj, e gabuara do të fshihet dhe nuk do të ekzistojë më.

Kur e gabuara në këtë botë ia kishte mbuluar sytë idhujtarit dhe bënte që ai të mos e shihte të vërtetën, ajo e mashtronte për një farë kohe atë, por këtu në "sheshin" e gjykimit perdet hiqen dhe nuk do të mbetet asgjë përveç së vërtetës.

Në lidhje me interpretimin e frazës së ajetit **“Ne prej çdo populli do të nxjerrim dëshmitar”**, Imam Bakiri ka thënë: *“...dhe prej këtij ymeti, Imamin e tij.”*.¹

Kjo fjalë është një shenjë që tregon se në çdo shekull e në çdo kohë, do të ketë patjetër një dëshmitar të ruajtur prej mëkateve. Ky transmetim është kriter për vërtetimin e këtij kuptimi kur'anor.

¹ Tefsiri “El Mijzan”, vëll. 16, f. 200.

Ajetet: 76 - 78

وَإِنَّ قُرُونًا كَانَ مِنْ قَوْمِ مُوسَى فَبَغَى عَلَيْهِمْ وَآتَيْنَاهُ مِنَ الْكُنُوزِ مَا إِنَّ مَفَاتِحَهُ لَتَنُوءُ بِالْعُصْبَةِ أُولَى الْقُوَّةِ إِذْ قَالَ لَهُ قَوْمُهُ لَا تَفْرَحْ إِنَّ اللَّهَ لَا يُحِبُّ الْفَرِحِينَ ﴿٧٦﴾ وَابْتَغَ فِيمَا آتَاكَ اللَّهُ الدَّارَ الْآخِرَةَ وَلَا تَنْسَ نَصِيبَكَ مِنَ الدُّنْيَا وَأَحْسِنَ كَمَا أَحْسَنَ اللَّهُ إِلَيْكَ وَلَا تَبْغِ الْفَسَادَ فِي الْأَرْضِ إِنَّ اللَّهَ لَا يُحِبُّ الْمُفْسِدِينَ ﴿٧٧﴾ قَالَ إِنَّمَا أُوتِيْتُهُ عَلَى عِلْمٍ عِنْدِي أَوَلَمْ يَعْلَم أَنَّ اللَّهَ قَدْ أَهْلَكَ مِنْ قَبْلِهِ مِنَ الْقُرُونِ مَنْ هُوَ أَشَدُّ قُوَّةً وَأَكْثَرُ جَمْعًا وَلَا يُسْأَلُ عَنْ ذُنُوبِهِمُ الْمُجْرِمُونَ ﴿٧٨﴾

“Kàrùni ishte prej popullit të Mùsàsë, por ai i shtypte ata; Ne i patëm dhënë atij prej pasurive aq sa duhej një grup i fuqishëm të mbarte çelësat e pasurisë së tij dhe, kur populli i tij i tha atij mos u krekos kaq shumë, sepse All’Ilahu nuk i do ata që krekosen.”

“Dhe mos harro që me atë (pasurinë) që të ka dhënë All’Ilahu, kërko (të fitosh) Botën Tjetër, prandaj mos e lër mangët atë që të takon të bësh në këtë botë dhe bëj mirë ashtu siç të ka bërë mirë All’Ilahu edhe ty; mos bëj ngatërresa në tokë, All’Ilahu nuk i do ngatërrestarët.”

“Ai (Kàrùni) tha: ajo (pasuria) më është dhënë në saje të diturisë që kam; a nuk e di ai se All’llahu ka shkatërruar para tij prej popujve të mëparshëm nga ata që ishin më të fuqishëm dhe kishin më shumë pasuri se ai; por kriminelët nuk do të pyeten për fajet e tyre.”

Komentimi

I pasuri izraelit koprac

Në tregimin e bukur të Musait (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) kemi parë se pjesa më e madhe e konfrontimeve dhe e qëndrimeve të tij ndaj Faraonit janë trajtuar në ajetet e mëparshme të kësaj sureje, rreth të cilave kemi folur mjaftueshëm.

Në ajetet që janë objekt studimi flitet për konfrontimin e Beni Israilëve me një të pasur prej tyre që quhej Karun.

Karuni ishte tipiku i pasanikut mendjemadh, mashtrues dhe mizor.

Në të vërtetë, gjatë gjithë jetës së tij, Musai (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) është konfrontuar me tre persona të fuqishëm, mendjemëdhenj e tiranë:

1- Faraoni, i cili ishte prototipi i forcës dhe i fuqisë së mveshur me pushtet.

2- Karuni, i cili ishte prototipi i pasanikut dhe i pronarit të madh arrogant e mashtrues.

3- Samirij'ji, i cili ishte prototipi i hipokritit si dhe mjeshtër i dalluar në punët artizanale.

Pavarësisht se konfrontimi kryesor i Musait (*Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!*) ishte ai me Faraonin dhe me qeverinë e tij, edhe dy konfrontimet e tjera kanë rëndësi të madhe.

Dihet se Karuni ishte farefis me Musain (*Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!*); ai ishte prej të afërmeve të tij, djali i xhaxhait ose djali i tezes. Ai e njihte Teuratin dhe në fillim ishte me besimtarët, por mendjemadhësia dhe pasuria e madhe që zotëronte, e çuan atë drejt mohimit dhe e bënë që t'i kundërvihej Musait (*Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!*). Edhe vdekja e Karunit është këshillë e mësim për të gjithë. Shpjegimet rreth kësaj ngjarjeje do t'i shohim në ajetet vijuese.

Në fillim të ajetit të parë të këtij grupi ajetesh, Kur'ani Famëlartë në lidhje me Karunin, njofton: **“Kàrùni ishte prej popullit të Mùsàsë, por ai i shtypte ata.”**. Shkaku i padrejtësisë dhe i shtypjes që ai ushtronte mbi njerëzit e tij ishte pasuria e madhe. Në fakt, Karuni ishte njeri me besim të dobët dhe me personalitet të paqëndrueshëm. Shumë shpejt u mashtrua nga kjo pasuri e madhe dhe përfundimisht rrëshqiti në rrugën e devijimeve, çka bëri që atë ta kaplonte mendjemadhësia.

Duke përshkruar pasurinë e tij të madhe, Kur'ani Famëlartë njofton: **“Ne i patëm dhënë atij prej pasurive aq sa duhej një grup i fuqishëm të mbarte çelësat e pasurisë së tij.”**.

Ajeti shpjegon se Karuni zotëronte aq shumë pasuri në flori e në argjend, saqë për të mbartur arkat ku i kishte vënë ato, duheshin disa burra të fuqishëm. Këta të fundit, ajeti që është objekt studimi i cilëson me termin: *“ulil kuw’veti”* – **“burra të fuqishëm”**.

Duke marrë në konsideratë faktin se në rrënjën e saj, fjala e ajetit *“usbetun”* do të thotë “një grup burrash të zënë dorë për dorë për të kryer një punë të rëndësishme”, bëhet e qartë se sa vëllim të madh kishin metalet e çmuara që kishte Karuni. Disa interpretues të Kur'anit kanë thënë se fjala *“usbetun”* tregon një grup prej dhjetë deri në dyzet burra.

Kurse fjala tjetër e ajetit *“tenûu”* do të thotë: kryerja e një pune të rëndë e të vështirë. Zakonisht, kjo fjalë përdoret për të treguar vështirësinë e mbartjes së mallrave e të sendeve me peshë të rëndë, aq sa nga ajo peshë njeriu do të anohet nga njëra anë e tij.

Në lidhje me kuptimin e fjalës *“mefâtih”* – **“çelësa”** një grup interpretuesish të Kur'anit kanë thënë se pasuria e Karunit ishte aq e madhe saqë edhe për të mbartur vetëm çelësat e arkave, apo kasafortave të pasurisë tij, duheshin një grup burrash të fuqishëm.

Ata që e kanë bërë këtë interpretim, janë munduar shumë, por nuk kanë shtruar pyetjen: Si është e mundur të përfytyrohet një numër kaq i madh çelësash, që i mbartin me kaq mundim edhe një grup burrash të fuqishëm?! Prandaj, interpretimi i parë mbetet më afër realitetit dhe si shpjegim është shumë më i qartë. Mirëpo për fjalën *“miftâh”* – **“çelës”**, gjuhëtarët janë shprehur se përdoret edhe në kuptimin *“khazàneh”* – **“arkë, kasafortë”**. Pavarësisht nga kuptimi që ka kjo fjalë, interpretimi i parë është më afër të vërtetës, prandaj nuk duhet ngatërruar kuptimi i fjalës

"mefâtihahu" – **"çelësat e saj"** që këtu ka ardhur në kuptimin e kasafortave, ose arkave, - me fjalën *"çelës"*, me të cilën kuptohet mjeti që përdoret për hapjen e sendeve të mbyllura.

Le ta lëmë mënjanë këtë çështje dhe të shohim se çfarë i thanë Beni Israilët Karunit. Për këtë, Kur'ani njofton: **"...kur populli i tha atij mos u krekos kaq shumë, sepse All'Ilahu nuk i do ata që krekosen."**¹

Më pas, ata i japin atij katër këshilla shumë të vlefshme për të ardhmen e njeriut dhe, së bashku me këshillën *"mos u krekos"*, bëhen pesë të tilla.

Këshilla e parë është: **"Dhe mos harro që me atë (pasurinë) që të ka dhënë All'Ilahu, kërko (të fitosh) Botën Tjetër."** Kjo fjalë e tyre tregon se pasuria dhe prona nuk janë të këqija, siç mund të pandehin disa që kanë iluzione. E rëndësishme është që të dihet se ku duhet përdorur pasuria si dhe të mbahet gjithmonë parasysh se shpenzimi më i mirë i saj është për të fituar Botën Tjetër. Por nuk ka si bëhet më keq kur pasuria shpenzohet për lojëra, për plotësimin e dëshirave të ulëta, kur me anë të saj bëhet padrejtësi dhe kur ushtrohet despotizëm mbi njerëzit.

Në këtë kuptim ka ardhur edhe fjala e prijësit të besimtarëve, Imam Aliut: *"Ai që më sheh Mua me atë, Unë e shoh atë dhe kush sheh tek ajo, Unë e verboj atë."*²

¹ Fjala e ajetit *"ferihijne"* është shumësi i fjalës *"ferihun"* dhe përdoret për njeriun që krekoset për sendin që ka në dorë dhe me të tregohet mendjemadh e nuk i ndihmon të tjerët.

² *"Nehxhul Belaga"*, hutbeja 82.

Me pasurinë e madhe që zotëronte, Karuni kishte mundësi të bënte shumë punë të dobishme. Por ç'dobi mund të kishte ai prej asaj pasurie, kur ishte verbuar nga mendjemadhësia dhe nuk i shihte të vërtetat?

Këshilla e dytë ishte: **“...dhe mos e lër mangët atë që të takon të bësh në këtë botë.”**. Ajeti e vë theksin mbi faktin se çdonjëri prej nesh ka pjesën e tij në këtë botë. Pasuritë që mund të shpenzojë njeriu për trupin dhe për veshjen e tij, që të duket me një pamje sa më të përshtatshme, janë të kufizuara. Prandaj, njeriu nuk duhet ta harrojë këtë të vërtetë.

Sa ushqim mund të hajë njeriu? Sa rroba mund të veshë ai? Sa shtëpi e sa makina do të ketë? Dhe kur të vdesë, sa palë qefina ka mundësi të marrë me vete?!

Njeriu mund të shpenzojë nga pasuria e tij, por ajo që mbetet prej saj, do apo nuk do ai, bëhet e të tjerëve.

Sa e bukur është edhe fjala e Imam Aliut në lidhje me këtë kuptim: *“O bir i Ademit, pasurinë që ke fituar më shumë se fuqia jote, ti e ruan për të tjerët.”*¹

Në transmetimet islame dhe në thëniet e interpretuesve të Kur'anit ka edhe një koment tjetër për këtë frazë të ajetit. Ky koment mund të bashkohet me komentin e mësipërm sipas rregullit që e lejon përdorimin e fjalës në më shumë se një kuptim.

Në një transmetim të ardhur prej Imam Aliut në lidhje me komentin e frazës së ajetit **“...dhe mos e lër mangët atë që të takon të bësh në këtë botë”**, lexojmë: *“Mos lër gjë mangët me*

¹ “Nehxhul Belaga”, fjalët e shkurtra: fjalë nr. 192.

shëndetin tënd, me fuqinë tënde, me pushimin tënd, me rininë tënde dhe me aktivitetin tënd, në mënyrë që me to të kërkossh Botën Tjetër.”¹

Sipas këtij interpretimi, fraza e mësipërme është për të tërhequr vëmendjen e të gjithë njerëzve, që të mos e humbin kohën dhe rastet që kanë me punë të kota, sepse koha kalon më shpejt se retë në qiell.

Këshilla e tretë që ata i dhanë Karunit, është: **“Dhe bëj mirë ashtu siç të ka bërë mirë All’Ilahu edhe ty.”**.

E vërteta e kësaj këshille është se njeriu shpreson gjithmonë prej All’Ilahut të mira dhe dashamirësinë e butësinë e Tij. Nëse për vete i shpreson këto të gjitha, si mund të tregohet i shkujdesur ndaj kërkesave që kanë të tjerët, ose ndaj fjalës së tyre dhe gjendjes në të cilën janë? Si është e mundur të mos u kushtosh vëmendje kërkesave e nevojave të të tjerëve?

Me fjalë të tjera, ashtu siç të ka bërë mirë All’Ilahu ty, edhe ti bëju mirë njerëzve.

Një fjalë të ngjashme me kuptimin e këtij ajeti e gjejmë edhe në ajetin 22 të sures “En Nûr”, ku flitet për tolerancën dhe faljen: **“Le të falin dhe të jenë tolerues, a nuk doni që edhe All’Ilahu t’ju falë juve?”**.

Kjo frazë e këtij ajeti mund të interpretohet edhe kështu: All’Ilahu i dhuron njeriut dhunti të shumta; Ai i ka dhuruar atij mendje dhe fuqi jo vetëm për të drejtuar punët e një njeriu të vetëm, por për të drejtuar edhe punët e një vendi. All’Ilahu i ka

¹ “Meânîl Akhbâr”, tekstualisht sipas tefsirit “Nuruth Thekalejn”, vëll. 4, f. 139.

dhuruar njeriut dituri, nga e cila nuk përfiton vetëm një njeri, por prej saj gëzon mirësi e dobi e gjithë shoqëria.

All'Ilahu i ka dhënë njeriut pasuri e prona, që ai të zbatojë programet shoqërore.

Këto dhunti hyjnore, në kuptimin e tyre të brendshëm nuk kanë lidhje vetëm me njeriun si një individ i vetëm, por nëpërmjet tyre, ai duhet të udhëzojë të tjerët.

Këshilla e katërt dhe e fundit është: Ty nuk duhet të të mashtrojnë këto pasuri dhe këto mundësi materiale. Këto pasuri të shumta nuk duhet të të tërheqin në drejtim të shkatërrimit. Ajeti njofton: **"...mos bëj ngatërresa në tokë, All'Ilahu nuk i do ngatërrestarët."**

Në këtë frazë të ajetit shohim edhe një të vërtetë tjetër konkrete: shumë të pasur jepen pas çmendurisë së shtimit të pasurisë, të shtyrë nga mania e madhe për të qenë mbi të tjerët. Në rrugën e plotësimit të dëshirave të tyre me anë të pasurisë që kanë, ata arrijnë deri aty sa bëjnë shumë veprime të paligjshme dhe aspak njerëzore. Me veprimet e tyre, ata i varfërojnë të tjerët nëpërmjet rrugëve të pamoralshme, siç është për shembull vënia e monopolit mbi mallrat e nevojës së parë etj. Veç kësaj, nga mendjemadhësia, ata arrijnë deri aty sa të mendojnë se të gjithë njerëzit janë skllevër e bujkrobër të tyre. Si pasojë, kundërshtarët e tyre i pret vdekja. Nëse një gjë e tillë nuk është e mundur, atëherë ata i izolojnë kundërshtarët me mjetet e me rrugët e tyre të veçanta.

Si përfundim, njerëz të tillë e tërheqin shoqërinë drejt degjenerimit dhe devijimit.

Me një fjalë të shkurtër përgjithësuese arrijmë në përfundimin se këta këshillues, në radhë të parë u munduan ta frenonin krekosjen e Karunit.

Në fillim, ata u munduan t'ia tërheqin vëmendjen, duke i thënë se kjo botë është mjet. Në fazën e dytë, ata i thonë se kjo botë nuk është objektiv.

Në fazën e tretë, ata ia tërheqin vëmendjen dhe e këshillojnë, duke i thënë se ai do të përfitojë vetëm nga një pjesë fare e vogël e pasurisë së tij, kurse pjesa tjetër do t'u mbetet të tjerëve.

Në fazën e katërt, ata i bëjnë thirrje të kuptojë të vërtetën dhe të mos harrojë se pasuria e madhe që zotëron, është dhuratë prej All'llahut. Prandaj, ai e ka detyrim t'u bëjë mirë të tjerëve; përndryshe, All'llahu do ta zhveshë atë nga të gjitha dhuratat që i ka dhënë.

Në fazën e pestë, ata e paralajmërojnë Karunin dhe i thonë se ngatërresat e shkatërrimet në tokë ndodhin si rezultat i harrimit të katër gjërave të lartpërmendura.

Nuk dihet me siguri se cilët ishin këta që e këshilluan Karunin në atë kohë, por është pranuar përfundimisht se ata ishin prej dijetarëve të devotshëm; ata ishin burra të zgjuar, tek të cilët është e dallueshme madhështia e personalitetit. Këta burra kishin dijeni rreth çështjeve të hollësishme, të cilat për të tjerët mund të ishin jo të qarta.

Mendimi se këshilluesi i Karunit ishte vetë Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), nuk është i vërtetë, sepse fjala në lidhje me

këshilluesit në tekstin e Kur'anit ka ardhur në numrin shumë, ashtu siç e lexojmë në frazën e ajetit: **“kur populli i tij i tha atij”**.

Por cila ishte përgjigja e këtij izraeliti të pasur, shtypës e të padrejtë, ndaj grupit që e këshilluan atë?

Karuni u përgjigj me arrogancën e me mendjemadhësinë që i vinte prej pasurisë së madhe, ashtu siç e lexojmë në tekstin e ajetit: **“Ai (Kàrùn) tha: ajo (pasuria) më është dhënë në saje të diturisë që kam”**.

Me këto fjalë, ai nënkupton: Kjo nuk varet prej jush dhe ju s'keni të drejtë të më mësoni mua se si të veprojmë me pasurinë time. Atë pasuri unë e kam vënë me diturinë që kam. Veç kësaj, All'llahu e di gjendjen time. Ai e di se unë e meritoj pasurinë që më ka dhënë mua, kurse dituria ime ka të bëjë me mënyrën si e menaxhoj unë atë pasuri. Prandaj, ndërhyrja juaj është krejtësisht e panevojshme. Jam lodhur dhe kam punuar shumë për ta mbledhur atë pasuri. Nëse të tjerët duan të kenë pasuri, përse nuk punojnë derisa të lodhen? Unë nuk i kam vënë ata në gjendje të vështirë. Nëse nuk meritojnë të kenë pasuri, atëherë më e mira për ta, është që të vuajnë nga uria derisa të vdesin.

Kjo logjikë e mangët lakohet shpesh nga të pasurit që nuk kanë aspak besim ndaj atyre që i këshillojnë.

Fjalët e Karunit duhet të shihen me kujdes. Kur'ani nuk është shprehur me qartësi për diturinë që kishte Karuni dhe nuk e ka treguar llojin e saj. Aty nuk përmendet se çfarë diturie ishte ajo që i dha mundësi Karunit që të mbledhte një pasuri kaq të madhe. A bëhet fjalë për shkencën e kimisë, siç e kanë interpretuar disa? Apo ishte i ditur në menaxhimin e tregtisë, në inxhinieri apo

agronomi? Mos kishte ndonjë dituri të veçantë, që i mundësonte atij të mblidhte këtë pasuri të madhe? Apo i zotëronte të gjitha dituritë e përmendura?

Nuk përjashtohet mundësia që kuptimi i ajetit t'i përfshijë të gjitha llojet e diturive të mësipërme, pavarësisht nga fjala që thuhet në lidhje me shkencën e kimisë se kjo shkencë mundëson shndërrimin e bakrit dhe të metaleve të ngjashme në flori, është mit apo është e vërtetë reale?

Këtu Kur'ani u përgjigjet fjalëve të Karunit dhe të mendjemëdhenjve të ngjashëm me të, që shkojnë në rrugën e humbjes: **"A nuk e di ai që All'Ilahu ka shkatërruar para tij prej popujve të përparshëm nga ata që ishin më të fuqishëm dhe kishin më shumë pasuri se ai?"**.

Ti pretendon se: **"Ajo (pasuria) më është dhënë në saje të diturisë që kam"**, por harron se para teje ka pasur njerëz shumë më të ditur, shumë më të fortë dhe që kishin pasuri më shumë se ti. Vallë, a patën mundësi të shpëtojnë dhe t'i largohen dënimit hyjnor ata?!

Dijetarët me ndërgjegje të gjallë ndaj pasurisë, i përgjigjen Karunit me fjalën e tyre: **"atë që të ka dhënë All'Ilahu"**, por ai njeri i shkujdesur, u përgjigjet atyre pa edukatë dhe u mburret se e kishte vënë pasurinë në saje të diturisë së tij.

All'Ilahu i Lartësuar e shpreh neverinë për fuqinë e për mundësinë e Karunit kundrejt Vullnetit e dëshirës së Tij të Shenjtëruar e Absolute me frazën e mësipërme.

Në fundin e ajetit bëhet edhe një paralajmërim i madh për Karunin. Këtë paralajmërim, Kur'ani Famëlartë e përmend me një frazë të shkurtër: **“por kriminelët nuk do të pyeten për fajet e tyre”**.

Ditën e Kiametit s'ka vend as për pyetje e as për përgjigje. Atë Ditë dënimi është fakt dhe nuk mund të jetë ndryshe. Dënimi është para tyre tmerrues dhe i dhimbshëm; ky është dënimi i ashpër dhe i vazhdueshëm.

Me fjalë të tjera, dijetarët e Beni Israilëve e këshilluan Karunin ditën kur ai kishte mundësi të përgjigjej, sepse pas plotësimit të argumentit dhe zbritjes së dënimit hyjnor, s'ka më as kohë e as vend për t'u menduar dhe për t'u përgjigjur. Kur zbret dënimi hyjnor në vendin e caktuar, atëherë ka ardhur ora e shkatërrimit të pashmangshëm.

Në lidhje me frazën e ajetit: **“por kriminelët nuk do të pyeten për fajet e tyre”**, lind pyetja: Kriminelët nuk do të pyeten në këtë botë, apo në Botën Tjetër?

Disa interpretues të Kur'anit kanë thënë se mohuesit nuk do të pyeten në këtë botë; disa të tjerë kanë thënë se qëllimi i ajetit është që mohuesit nuk do të pyeten në Botën Tjetër. Megjithatë, ajeti mund të tregojë se mohuesit nuk do të pyeten as në këtë botë e as në Tjetrën; pra, ata nuk do të pyeten kur mbi ta të bjerë dënimi në këtë botë, në mënyrë që të mos kenë mundësi ta mbrojnë veten dhe të shfajësohen duke nxjerrë pretekste. Gjithashtu, ata nuk do të pyeten as në Ditën e Gjykimit, sepse atë Ditë nuk do të mbetet asgjë e fshehtë; të gjitha gjërat do të jenë të hapura e të qarta, ashtu siç shprehet Kur'ani në lidhje me këtë

gjendje të kriminelëve në ajetin 41 të sures “Err Rrahmàn”: **“kriminelët njihen me tiparet e tyre”**.

Ajeti që është objekt studimi njofton: **“por kriminelët nuk do të pyeten për fajet e tyre”**; kjo frazë është në përputhje të plotë edhe me ajetin 39 të sures “Er Rrahmàn”: **“...atë Ditë nuk do të pyetet për fajin e tij as njeriu e as xhindi.”**.

Edhe këtu lind pyetja: Si mund të jetë në përputhje ky ajet, me fjalën e All’Ilahut në ajetin 92 të sures “El Hixhr”: **“...betohem në Zotin tënd, patjetër të gjithë Ne do t’i pyesim ata.”**.

Kjo pyetje mund të ketë dy përgjigje:

E para: në Ditën e Kiametit ka shumë vendqëndrime; në disa prej tyre bëhen edhe pyetjet e jepen edhe përgjigjet, ndërsa në disa të tjera nuk është nevoja për pyetje, sepse perdet janë ngritur dhe të gjitha sendet janë të qarta.

E dyta: zakonisht pyetja është dy llojesh: pyetje vërtetuese dhe qartësuese. Në Ditën e Kiametit nuk bëhen pyetje hetuese, sepse atë Ditë janë të gjitha gjërat të qarta, pa asnjë lloj mbulese. Për kriminelët, kjo gjendje është njëra prej llojeve të dënimit.

Kjo gjendje është e njëjtë me pyetjen e supozuar, kur babai i thotë djalit të tij që s’ka edukatë: A nuk i kam bërë unë të gjitha këto shërbime për ty? Ky është shpërblimi për to? Ndërkohë, si babai ashtu edhe djali, e dinë se si qëndron e vërteta. Është e qartë se me këtë pyetje, babai kishte për qëllim të qortonte djalin e tij dhe jo ndonjë tjetër.

Ajetet: 79 - 82

فَخَرَجَ عَلَى قَوْمِهِ فِي زِينَتِهِ ۚ قَالَ الَّذِينَ يُرِيدُونَ الْحَيَاةَ الدُّنْيَا يَلِيتَ لَنَا مِثْلَ
 مَا أُوتِيَ قُرُونُ إِنَّهُ ۚ لَذُو حَظٍّ عَظِيمٍ ﴿٧٩﴾ وَقَالَ الَّذِينَ أُوتُوا الْعِلْمَ وَيَلَكُمْ
 ثَوَابُ اللَّهِ خَيْرٌ لِّمَن ءَامَنَ وَعَمِلَ صَالِحًا وَلَا يُلْقَاهَا إِلَّا الصَّابِرُونَ ﴿٨٠﴾
 فَخَسَفْنَا بِهِ ۚ وَبِدَارِهِ الْأَرْضَ فَمَا كَانَ لَهُ ۚ مِنْ فِئَةٍ يَنْصُرُونَهُ ۚ مِنْ دُونِ اللَّهِ
 وَمَا كَانَ مِنَ الْمُنتَصِرِينَ ﴿٨١﴾ وَأَصْبَحَ الَّذِينَ تَمَنَّوْا مَكَانَهُ ۚ بِلِلَّائِمِيسَ يَقُولُونَ
 وَيُكَأَنَّ اللَّهَ يَبْسُطُ الرِّزْقَ لِمَن يَشَاءُ مِنْ عِبَادِهِ ۚ وَيَقْدِرُ لَوْلَا أَن مَنَّ اللَّهُ
 عَلَيْنَا لَخَسَفَ بَنَّا وَيُكَأَنَّهُ ۚ لَا يُفْلِحُ الْكَافِرُونَ ﴿٨٢﴾

“Ai (Kàrùni) doli para popullit të tij me stolitë e veta dhe ata që kishin qëllim jetën e kësaj bote thanë: ah, sikur të kishim edhe ne aq sa i është dhënë Kàrùniti, me të vërtetë ai ka fat të madh.”

“Kurse atyre që u ishte dhënë dituri, thanë: të mjerët ju, shpërblimi i All’liahut është shumë më i mirë për atë që besoi dhe bëri punë të mira, por këtë nuk e arrin askush përveç të durueshmëve.”

“Atë (Kàrùnini) dhe shtëpinë e tij Ne e fundosëm në tokë dhe përveç All’liahut ai s’pati asnjë që ta ndihmonte, ai as veten nuk e ndihmoi dot.”

“Ata që dje lakmuan të ishin në vendin e tij, të nesërmen thanë: a nuk e shihni që All’llahu jep me shumicë, ose jep pak për atë që Ai do prej robve të Tij; sikur All’llahu të mos kishte shfaqur Mirësinë e Tij për ne, do të na kishte fundosur edhe ne në tokë; sa e çuditshme, jobesimtarët nuk do të gjejnë shpëtim.”

Komentimi

Çmenduria e pasurisë

Dihet se të pasurit sprovohen me disa lloje çmendurish, njëra prej të cilave është ekspozimi i pasurisë. Njerëz të tillë ndjejnë kënaqësi kur e ekspozojnë pasurinë e vet para të tjerëve; ose kur u flasin për një anije të shtrenjtë e komode, pastaj ecin duke përplasur këmbët për tokë, ç’ka bën që pluhuri të ngrihet lart dhe të bjerë mbi fytyrat e njerëzve, të cilët ai në të vërtetë i urren. Në këto çaste, këta pasanikë ndjejnë një qetësi shpirtërore; në fytyrat e tyre shihet gëzimi dhe zemrat e tyre rrahin më shpejt.

Shpesh, ekspozimi i pasurisë bëhet shkak që ekspozuesit të kalojnë nëpër sprova të mëdha, sepse ky veprim ngjall urrejtje në zemrën e atyre që i shohin. Kjo urrejtje mund të sjellë pasoja të dëmshme si për ekspozuesin, ashtu edhe për vetë pasurinë.

Ndër ne, sëmundja e ekspozimit të pasurisë mund të ndodhë kur duam të mashtrojmë mikun, ose kur kemi qëllim të bëjmë që të dorëzohen individët kundërshtarë. Kurse të pasurit,

në shumicën e rasteve, kur ekspozojnë pasurinë e tyre nuk nisen nga këto qëllime. Ekspozimi i pasurisë prej tyre nuk bëhet për ndonjë plan, ose për ndonjë program të caktuar, por për mendjemadhësi.

Gjithsesi, Karuni nuk bën përjashtim prej këtij rregulli, madje shërben si shembull i qartë i atyre që krekosen me pasurinë. Kur'ani Famëllartë flet për ekspozimin e pasurisë nga ana e Karunit me një frazë të shkurtër: **“Ai (Kàrùni) doli para popullit të tij me stolitë e veta”**, pra doli para popullit të tij, Beni Israilëve.

Shprehja e ajetit **“me stolitë e veta”** flet për këtë të vërtetë; pra, ai e shfaqti para të tjerëve të gjithë fuqinë e forcën e tij, me qëllim që ata të shihnin stolitë e shumta që kishte veshur. Ai kishte për qëllim që me ato stoli të tregonte se sa e madhe ishte pasuria e tij.

Në lidhje me këtë çështje, në histori janë cituar tregime të shumta, herë-herë të mveshuara edhe me legjenda. Në disa prej tyre shkruhet se në atë “paradë” madhështore, Karuni kishte nxjerrë katër mijë vetë hipur mbi katër mijë kuaj të kuq shumë të shtrenjtë, të mbuluar me kamosh të kuq. Të gjithë i kishte veshur me flori e me diamante. Në atë “paradë”, ai kaloi para Beni Israilëve dhe ishte e natyrshme që kjo pamje bëri efekt tek ata, kur panë katër mijë shërbëtorë të bardhë, të veshur me rroba të kuqe dhe të stolisura.

Disa kanë thënë se numri i atyre që Karuni nxorri në atë “paradë” ishte shtatë mijë vetë. Në lidhje me këtë çështje janë përmendur edhe njoftime të tjera.

Sikur të supozojmë se në këto tregime e lajme ka teprime, përsëri nuk mund të mohohet e vërteta se Karuni kishte aq shumë pasuri, saqë i ekspozoi ato i veshur edhe vetë me stolitë e tij.

Ky ekspozim i pasurisë i ndau njerëzit në dy grupe. Shumica ishin prej “adhuruesve të kësaj bote”, të cilët u ndikuan shumë nga ajo që panë. Zemrat e tyre u lëkundën dhe thanë: “ah të mjerët ne!”. Ata deshën të ishin në pozitën e Karunit, qoftë edhe vetëm për një ditë, ose edhe vetëm për një orë, madje edhe vetëm për një çast. Çfarë jete të ëmbël e të bukur dhurojnë kënaqësitë dhe aktiviteti! Për këtë kategori njerëzish, Kur’ani njofton: “... **ata që kishin qëllim jetën e kësaj bote thanë: ah, sikur të kishim edhe ne aq sa i është dhënë Kârûnit, me të vërtetë ai ka fat të madh.**”.

E uronin Karunin për pasurinë e tij të madhe. Sa i lartë e sa madhështi që kishte! Ata thonin: Nuk mendojmë se All’llahu i ka dhënë ndokujt pasuri sa i ka dhënë Karunit.

Pikërisht këtu vjen radha e provimit të madh; nga njëra anë qëndron Karuni, i cili do t’i nënshtrohet provimit ashtu siç ishte i krekosur, dhe nga ana tjetër qëndrojnë të ngazëllyerit nga madhështia e pasurisë që u shfaqti Karuni.

Dënimi i rëndë erdhi menjëherë pas këtij ekspozimi tundues. Nga maja e madhështisë, Karuni do të fundosej në thellësi të tokës, dhe kjo ndodhi brenda një çasti të shkurtër.

Përballë grupit të lartpërmendur, qëndron grupi tjetër i përbërë prej dijetarëve dhe prej njerëzve të devotshëm e të përkushtuar. Në horizontin e tyre, ata shihnin më larg, ndonëse ishin sëbashku me të tjerët në atë “paradë” që u kalonte para syve.

Ata burra nuk e ndërtonin personalitetin me flori e me forcë dhe as nuk ngazëlleshin nga të tilla pamje të rreme madhështie. Përkundrazi, ata talleshin me këtë ekspozim të pakuptimtë të pasurisë dhe kishin neveri nga të tilla punë që bënë kokëzbrazurit.

Edhe ata burra ishin aty, por qëndrimi i tyre ishte krejtësisht i ndryshëm nga qëllimi i Karunit. Për këta njerëz besimtarë e të devotshëm, Kur'ani Famëllartë thotë: **“Kurse atyre që u ishte dhënë dituri, thanë: të mjerët ju, shpërblimi i All'Ilahut është shumë më i mirë për atë që besoi dhe bëri punë të mira.”**.

Në vijim, Kur'ani thekson: **“por këtë nuk e arrin askush përveç të durueshmëve”**.

Ata ishin njerëz që nuk tronditeshin prej gjërave të bukura të kësaj bote, por mbanin qëndrim të drejtë dhe burrëror; ata nuk i tundnin kokat që të poshtëroheshin, por qëndronin të patundur para sprovës së pasurisë, pronave, frikës dhe goditjes nga pësimet. Për të gjitha këto, ata e meritonin plotësisht shpërblimin e All'Ilahut të Gjithëfuqishëm.

Është pranuar se qëllimi me frazën: **“atyre që u ishte dhënë dituri”** është për dijetarët e Beni Israilëve. Ndër ta ishte edhe Jushe'a, njëri prej burrave të tyre të mëdhenj.

Është shumë domethënës fakti se grupin e parë, pra ata që u tunduan nga madhështia e pasurisë së Karunit, Kur'ani Famëllartë e përshkruan me frazën: **“ata që kishin qëllim jetën e kësaj bote”**, ndërsa grupin e dytë nuk e përshkruan me të njëjtën frazë dhe të shprehet: **“ata që kishin qëllim jetën e Botës Tjetër”**,

por për ta thotë: **“atyre që u ishte dhënë dituri”**, sepse dituria është baza, është themeli i besimit, i qëndrimit të drejtë dhe i dashurisë së flaktë për të arritur shpërblimin e All’llahut dhe jetën e përhershme në Botën Tjetër.

Gjithashtu, fraza: **“ata që kishin qëllim jetën e kësaj bote”** është një përgjigje për Karunin sepse ai pretendonte se kishte dituri. Me këtë frazë, Kur’ani shpjegon se dijetarë të mirëfilltë janë ata që nuk kanë qëllim jetën e kësaj bote. Njëkohësisht, në Kur’an i thuhet Karunit: Kurse ti, o Karun, je mendjemadh e mburravec.

Këtu na jepet rasti të shohim edhe një herë se baza e begative dhe e të mirave, është dituria e vërtetë.

Me punët e tij, Karuni kishte arritur shkallën më të lartë të tiranisë e të padrejtësive. Në histori lexojmë një tregim të cituar në lidhje me Karunin. Prej tij mësojmë se Karuni ishte njeri i lig, që nuk e njihte turpin. Në tregim thuhet se Musai (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) i tha atij që All’llahu e kishte urdhëruar të merrte zekatin. Por Karuni jo vetëm që kundërshtoi ta jepte atë, por trilloi edhe një shpifje, duke thënëse Musai kishte qëllim të ushqej me pasuritë e njerëzve, se kishte ardhur tek ata që t’i urdhëronte të falnin namazin si dhe t’u jepte porosi të tjera, të cilat ata i kishin kryer. Njerëzit thanë: “Nuk do t’i zbatojmë më porositë e tij, por ti si mendon?” Karuni iu përgjigj: “Mendoj të dërgoj tek ai njërën prej lavireve të Beni Israilëve dhe ajo ta akuzojë Musain se e ka përdhunuar”. Kur Karuni e dërgoi laviren, i tha: “Të jap ç’të duash me kusht që të dëshmosh se Musai ka bërë imoralitet me ty”. Ajo pranoi ta bënte këtë gjë.

Karuni shkoi te Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) dhe i tha: "Mblidhi Beni Israilët dhe njoftoji ata për atë që të ka urdhëruar Zoti yt". Ai tha: "Po". Dhe kur i mblodhi, ata i thanë: "Me çfarë të ka urdhëruar Zoti yt?" Ai u tha: "Më ka urdhëruar që të adhuron vetëm Atë dhe të mos i bëni Atij shok e ortak në adhurim; më ka urdhëruar që ju të falni namazin...". Ai përmendi edhe obligimet e tjera të fesë. Ai tha se në lidhje me të pamoralshmin, Zoti e kishte urdhëruar që nëse ai është i martuar, të dënohet duke u gjuajtur me gurë. Të pranishmit e pyetën: "Edhe nëse je ti i pamoralshmi?". Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) iu përgjigj: "Po". Pas kësaj fjale, ata menjëherë i thanë: "Ti ke bërë imoralitet". I habitur, Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) tha: "Unë?".

Ata thirrën gruan dhe kur ajo erdhi, e pyetën: "Çfarë do të dëshmosh kundër Musait?". Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) i tha asaj: "Betohu në All'llahun se do të dëshmosh të vërtetën". Gruaja i tha: "Ti më kërkon të betohem në All'llahun, kurse ata më thirrën dhe më paguan të të akuzoj në nder. Por unë dëshmoj se ti je i pafajshëm, dëshmoj se ti je i Dërguar i All'llahut". Sapo dëgjoi këto fjalë, Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) ra në sexhde duke qarë. Në ato çaste, All'llahu i zbriti Shpalljen dhe e pyeti: "Pse qan? Ne e kemi vënë tokën nën pushtetin tënd. Urdhëroje atë dhe ajo do të të bindet".¹ Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) ngriti kokën dhe tha: "O tokë, kapi ata!" Dhe toka i kapi për fyti, ndërkaq ata filluan të thërrasin me të madhe: "O Musa, o Musa!". Por Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) përsëri tha: "O tokë, merri dhe largoji ata!". Ndërkaq, All'llahu i zbriti përsëri Shpallje

¹ Tefsiri "Ed Durr'rrul Menthûr", e cituar prej tefsirit "El Mijzân", vëll. 16, f. 84; tefsiri "Rûhul Me'ânij" dhe në tefsire të tjera, në fundin e ajetit që është objekt studimi.

dhe i tha: “O Musa! Robërit e Mi të thirrën të nënshtroar ndaj teje, por ti nuk iu përgjigje thirrjes së tyre. Beto hem në madhështinë Time, se po të më thërrisnin Mua, patjetër që do t’i përgjigjesha thirrjes së tyre”.

Në lidhje me këtë çështje, Kur’ani Famëlartë thotë: **“Ne atë (Kàrùnin) dhe shtëpinë e tij e fundosëm në tokë.”**.

Kur tirania, mendjemadhësia, mashtrimi dhe urrejtja ndaj besimtarëve të pafajshëm, duke përfshirë edhe komplotin kundër Profetit të All’llahut arrijnë kulmin, atëherë shfaqet fuqia e All’llahut të Lartësuar me tërë madhështinë e saj dhe e asgjëson jetën e tiranëve mashtrues e mendjemëdhenj. All’llahu i shkatërron ata plotësisht dhe pësimi i tyre mbetet mësim për të tjerët.

“Fundosje e tokës”, këtu ka kuptimin e çarjes së tokës dhe të përpirjes në brendësi të saj të çdo gjëje që gjendet mbi atë çarje. Ky fenomen ka ndodhur disa herë përgjatë historisë. Dihet që çarja e tokës ndodh në raste tërmetesh të fuqishme. Nga çarja, toka përpin në brendësi të saj edhe një qytet të tërë, ose disa banesa që ndodhen mbi vendin e çarë. Por fundosja e tokës që ngjau me Karunin është e ndryshme. Në rastin e fundosjes për të cilën flet ajeti, toka përpiu vetëm Karunin dhe thesaret e tij.

Është me të vërtetë e çuditshme. Faraoni mbytet në ujërat e lumit Nil, ndërsa Karuni fundoset në thellësi të tokës.

Uji, që është sekreti i jetës dhe bazë e saj, u urdhërua të asgjësonte Faraonin, ndërsa toka, që është vend i sigurisë, bëhet varr për Karunin dhe për pasuesit e tij. Është interesant fakti se Karuni nuk ishte i vetëm në atë shtëpi; së bashku me të ishin edhe

ata që e mbështesnin, duke përfshirë këtu edhe servilët që i rrinin përqark dhe që e ndihmonin në padrejtësitë e në tiraninë që ai ushtronte mbi të tjerët. Të gjithë ata u fundosën në thellësitë e tokës.

Në vijim, ajeti njofton: **“...dhe përveç All’llahut ai s’pati asnjë që ta ndihmonte, ai as veten nuk e ndihmoi dot.”**.

Karunin nuk e shpëtuan dot prej dënimit të All’llahut as miqtë, as shokët, as ata që mbartnin sendet e tij dhe as ndonjë tjetër. Karuni, pasuritë e tij si dhe ata që ishin sëbashku me të, përfunduan në thellësi të tokës.

Ajeti i fundit prej grupit të ajeteve që janë objekt studimi, tregon shndërrimin e shpejtë dhe të çuditshëm që u ndodhi atyre që dje ishin spektatorë të “paradës” së Karunit dhe që thonin: “Ah, sikur të kishim edhe ne aq sa i është dhënë Karunit, apo diçka të ngjashme!”. Ndërsa sot, ata thanë: “Mjerë ai! Me të vërtetë, furnizimi është në dorën e All’llahut!”. Për këtë shndërrim të shpejtë që ndodhi tek ata, ajeti i nderuar njofton: **“Ata që dje lakmuan të ishin në vendin e tij, të nesërmen thanë: a nuk e shihni që All’llahu jep me shumicë, ose jep pak për atë që Ai do prej robve të Tij.”**.

Në ditët e sotme është vërtetuar se askush nuk ka ndonjë send prej vetes së tij. Çdo gjë që ekziston, është prej All’llahut. Dhënia e begative nga All’llahu nuk është argument që tregon se njeriu të cilit Ai i jep me shumicë, ka kënaqësinë e Tij; as mosdhënia nuk është argument që tregon se njeriu të cilit All’llahu i ka dhënë pak, është i parëndësishëm për Të.

All'llahu i Lartësuar i provon robtë e Tij me pasurinë; me të, Ai provon ndërgjegjen dhe qëllimet e tyre.

Më pas, ata filluan të mendojnë dhe thanë me vete: “Sikur të ishte pranuar lutja jonë e djeshme, që të kishim si Karuni dhe sikur All'llahu të na kishte dhënë pasuri si atij, me siguri që edhe neve do të na përpinte toka, ashtu siç e përpiu Karunin”. Vetëm tani, ata e kuptuan se ajo pasuri nuk do t’u sillte asnjë dobi.

Prandaj, ata e falënderuan All'llahun për këtë mirësi të madhe dhe thanë: **“...sikur All'llahu të mos kishte shfaqur Mirësinë e Tij për ne, do të na kishte fundosur edhe ne në tokë; sa e çuditshme, jobesimtarët nuk do të gjejnë shpëtim.”**.

Ata thonin në vetvete: Tani po e shohim të vërtetën me sytë tanë, tani po e shohim përfundimin e mendjemadhësisë dhe të shkujdesjes, po shohim fundin e mohimit dhe të pasionit të sëmurë; ne sot u njohëm me shembujt e kësaj jete që i tundon zemrat me dukuritë e saj mashtruese. Sot ne pamë se sa të egra janë këto dukuri mashtruese dhe se ç’përfundim të keq që kanë!

Nga fjalja e fundit e këtij tregimi bëhet e qartë se Karuni mendjemadh vdiq si mohues, dhe jo si besimtar, ndonëse ai ishte ndër ata që e lexonin mirë Teuratin. Gjithashtu, ai njihej si njëri prej dijetarëve të Beni Israilëve dhe ishte prej të afërmve të Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*).

Hulumtime

1- Modele të Karunit dje dhe sot

Në Kur'anin Famëlartë, tregimi i Karunit, këtij të pasuri mendjemadh, përmendet në shtatë ajete, ku jepen shpjegime të qarta dhe zbulohen të vërteta të shumta në jetën e njerëzve.

Ky tregim e shpjegon qartë të vërtetën se mendjemadhësia, pasuria e tepërt, pasioni i sëmurë për të grumbulluar sa më shumë pasuri, ndonjëherë mund ta çojnë njeriun në lloje të shumta çmendurish, si: çmenduria për të ekspozuar pasurinë, me qëllim për të tërhequr vëmendjen e të tjerëve, deri edhe çmenduria e të kënaqurit nga urrejtja ndaj të varfërve dhe ndaj atyre që s'kanë as bukën e përditshme.

Gjithashtu, kjo mendjemadhësi, ky pasion dhe kjo dashuri e pakufishme për floririn dhe argjendin, ndodh që e çojnë njeriun të bëjë edhe mëkatet e fajet më të urryera, siç janë veprimet keqdashëse kundër Profetit, kundërshtimi i Zotit dhe i së vërtetës, akuzimi i individëve më të pastër për imoralitet, përdorimi dhe shpenzimi i pasurisë për punë të urryera etj.

Mendjemadhësia dhe pasioni që burojnë nga pasuria e madhe, nuk e lejojnë njeriun të dëgjojë këshillat e të tjerëve dhe as t'i përgjigjet atij që me të vërtetë uron vetëm të mirën për të.

Mendjemëdhenjtë e kësaj kategorie mendojnë se janë më të diturit; ata besojnë se pasuritë që kanë ndër duar, të cilat mbase i kanë përvetësuar nëpërmjet grabitjes, janë argument që vërteton

se janë të mençur, ashtu siç këmbëngulte edhe Karuni. Veç kësaj, mendjemëdhenj të tillë pandehin se të gjithë të tjerët janë injorantë e se vetëm ata janë dijetarë.

Të pasurit mendjemëdhenj mund të arrijnë deri aty, sa të ekspozojnë pasuritë e veta para njerëzve, me qëllim që të duken se vetëm ata janë të pavarur. Ata përhapin fjalë dhe kërkojnë t'ua mbushin mendjen të tjerëve se këtë pasuri të madhe e kanë arritur në saje të zgjuarsisë, të përgatitjes, të aftësive krijuese dhe të diturisë së tyre të pashoqe.

Ne e kemi parë se si qe fundi i këtij grupi mendjemëdhenjsh që kishin devijuar nga rruga e drejtë. E pamë se Karuni, pasuesit dhe pasuritë e tij të shumta, u fundosën në thellësi të tokës. Gjithashtu, historia ka treguar se mendjemëdhenj të tjerë janë asgjësuar në forma të tjera. Të pasurit mendjemëdhenj të kësaj kategorie arrijnë deri aty sa pasuritë e shumta u shndrijnë në pallate luksoze, në lulishte të bukura, ose blejnë toka të shumta dhe, prej këtyre nuk kanë asnjë dobi. Të prirur nga mania për të grumbulluar sa më shumë pasuri, ata blejnë deri edhe toka të vdekura dhe jopjellore, me shpresë që t'i ndajnë në parcela të vogla për ta shitur çdo pjesë me një çmim të lartë. Ja kështu i përpin toka pasuritë e tyre.

Njerëz të tillë, kur nuk gjejnë ndonjë rrugë për të shpenzuar pasuritë e tyre të mëdha, orientohen drejt vlerave të fantazuara. Ata shpenzojnë për të blerë enë balte ose porcelani të thyera, me pretendimin se ato përfaqësojnë trashëgiminë e vjetër, ose koleksionojnë pulla e monedha letre të viteve të kaluara dhe, të gjitha këto i ruajnë në një vend të sigurtë në shtëpitë e tyre, duke i konsideruar ato si sende të rralla me vlerë të madhe. Në fakt, nëse

do t'i shihnin ato sende me syrin e vlerësimit real, do të bindeshin se ato janë aq të pavlefshme sa duhen hedhur në koshin e mbeturinave.

Nën lëkundjet e fantazisë, kjo kategori të pasurish mendjemëdhenj bën një jetë të shkujdesur, ndonëse në qytetin, ose në zonën e tyre dhe shpesh edhe ndër fqinjët e tyre, u ndodh të shohin njerëz që i kalojnë netët të uritur. Është për t'u habitur se megjithëse e shohin gjendjen e të varfërve, këtyre pasanikëve nuk i bren aspak ndërgjegjja dhe zemra e tyre nuk ndikohet nga vuajtjet që shohin çdo ditë përreth. Nga ana tjetër, kafshët e tyre jetojnë në mirëqenie të plotë, madje kanë edhe kujdesin e mjekëve, ndërkohë që shumë njerëz janë të privuar krejtësisht nga kujdesi mjekësor dhe bëjnë një jetë shumë të vështirë. Spitalet janë të mbushura plot me njerëz të tillë, por askush nuk e ngren zërin për të kërkuar llogari për mungesën e ilaçeve për ta.

Këto studime ndonjëherë përkojnë me gjendjen e disa individëve në një shoqëri të caktuar, por mund të përkojnë edhe me gjendjen e një shteti në krahasim me shtetet e tjera. Kështu, në ditët e sotme ka shtete të ngjashme me atë të Karunit dhe shtete të tjera me ekonomi të dobët. Ky fakt shihet qartë në qëndrimet e superfuqive dhe të vendeve të zhvilluara ndaj vendeve të pafuqishme.

Shtetet e fuqishme kanë mundur të rregullojnë një jetë në mirëqenie në të gjitha format e saj në saje të shfrytëzimit të bijve të vendeve të ashtuquajtura "vende të botës së tretë", të vendeve të varfra dhe të izoluara. Në vendet e zhvilluara, tepricat e ushqimeve flaken në koshin e mbeturinave, ndërkohë që po të

menaxhohej situata në mënyrën e duhur, këto teprica mund të mblidheshin dhe me to do të ushqeheshin miliona të uritur.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për disa shtete të varfra, të cilat në të vërtetë nuk janë të tilla, por të mirat e tyre materiale vidhen nga të mëdhenjtë. Nëntoka e këtyre vendeve “të varfra” mban në gjirin e saj lloje të ndryshme mineralesh të çmuara, por mashtruesit mendjemëdhenj i rrëmbejnë ato, duke i lënë banorët e tyre të zhveshur e të uritur në tokën e zezë.

Mendjemëdhenj sikurse Karuni, i ndërtojnë pallatet mbi truallin e kasolleve të shembura të njerëzve të varfër. Nëse të pafuqishmit nuk do të bashkojnë duart e tyre për t’i fundosur mendjemëdhenjtë tiranë e mizorë në thellësi të tokës, ashtu siç u fundos Karuni, gjendja e botës nuk do të ndryshojë.

Mendjemëdhenjtë shtypës ndërtojnë pallate mbi kasollet e shembura të të varfërve, të cilët jetojnë në varfëri të tejskajshme. Këtyre të fundit u mungojnë deri edhe gjërat e domosdoshme, ose më saktë, mendjemëdhenjtë nuk ua lejojnë që t’i kenë.

2- Nga i erdhi Karunit kjo pasuri e madhe?

Nga ajetet 23 dhe 24 të sures “El Gàfir”, mësojmë se qysh në fillim, Musai (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) është ndeshur drejtpërdrejt me tre persona: me Faraonin, me ministrin e tij Hamanin dhe me të pasurin mendjemadh Karun. Në këto dy ajete lexojmë: **“Ne e dërguam Mùsà në me argumentet Tona e me fakte të qarta” dhe “Te Faraoni, Hàmàni e Kàrùni dhe ata thanë: magjistar gënjeshtar.”.**

Nga teksti i këtyre ajeteve të Kur'anit kuptohet se Karuni i përkiste grupit të Faraonit dhe linjës së tij. Gjithashtu, në histori lexojmë se Karuni ishte përfaqësues i Faraonit te Beni Israilët¹ si edhe sekretari arkës e përgjegjës i thesareve të tij.²

Këtu bëhet i qartë identiteti i Karunit. Në të vërtetë, për të poshtëruar Beni Israilët dhe për t'i grabitur pasuritë e tyre, Faraoni kishte zgjedhur një njeri hipokrit prej mesit të tyre, të cilit i la në dorë frerët e punëve të Beni Israilëve, i lejoi të shfrytëzonte pasuritë e tyre për t'i shërbyer sistemit të tij tiran, në një kohë kur i linte ata të zhveshur e të zbathur. Duke i grabitur Beni Israilët, Karuni grumbulloi pasuri shumë të madhe.

Shembujt krahasues tregojnë se pas vdekjes së Faraonit, pasuria dhe thesaret që administronte Karuni, mbetën në dorën e tij. Por Karuni nuk i tregoi Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) se ku ndodheshin ato, që t'ua shpërndante pasuesve të tij të varfër.

Sido që të ketë ndodhur, s'ka rëndësi nëse Karuni i vuri pasuritë e tij në kohën e Faraonit, nëse i mori në dorë thesaret pas vdekjes së Faraonit, apo nëse këtë pasuri të madhe e grumbulloi në sajë të alkimisë, ose të tregtisë, ose ngaqë dinte t'i shfrytëzonte njerëzit e pafuqishëm.

Sido që të ketë qenë, Karuni i besoi Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) pas fitores së tij mbi Faraonin dhe e ndërroi menjëherë maskën, madje u bë prej kënduesve të Teuratit dhe njëri prej dijetarëve të Beni Israilëve, por në zemrën e këtij hipokriti nuk kishte hyrë qoftë edhe një grimcë prej besimit.

¹ Tefsiri "Kebijr", vëll. 25, f. 13 dhe tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 7, f. 266, fundi i ajetit që është objekt studimi.

² Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll 8, f. 520, fundi i ajetit 24 të sures "El Gàfir".

Dhe, kur Musai (*Paqja e All'lahut qoftë mbi të!*) kërkoi të merrte zekatin prej Karunit, ky i fundit i mashtroi njerëzit. Tashmë ne e dimë se si qe përfundimi i tij.

3- Qëndrimi i Islamit ndaj pasurisë

Duke u nisur nga çfarë u tha më lart, nuk duhet të dalim në përfundimin se Islami mban një qëndrim negativ ndaj pasurisë dhe se ai e kundërshton pasurimin. Gjithashtu, nuk duhet të mendojmë se Islami ka për qëllim jetën e varfër dhe se varfërinë e sheh si vlerë morale.

Përkundrazi, pas Botës Tjetër, Islami e konsideron pasurinë si faktor shumë të rëndësishëm. Madje, në vend të fjalës “pasuri”, Kur’ani ka përdorur fjalën “të mirë”, ashtu siç ka ardhur në ajetin 180 të sures “El Bekare”: “**nëse ka lënë të mira**”, pra, nëse ka lënë pasuri.

Në një transmetim të ardhur prej Imam Bakirit në lidhje me këtë çështje, thuhet: “*Po, (pasuria) është ndihma e kësaj bote në kërkim të Botës Tjetër.*”.¹

Edhe ajetet që janë objekt studimi dhe që e qortojnë ashpër Karunin, i cili ndihej i kënaqur dhe krekosej me pasurinë, shërbejnë si dëshmi për këtë çështje. Si përfundim themi se Islami e pranon pasurinë me kusht që nëpërmjet saj të kërkohet Bota Tjetër, ose ashtu siç i thanë dijetarët e Beni Israilëve Karunit: “**Dhe mos harro që me atë (pasurinë) që të ka dhënë All'llahu, kërk**o (të fitosh) **Botën Tjetër.**”.

¹ “Uesàilu Shijah”, vëll. 12, f.17; pjesa e pestë, kapitulli 16: “Premisat e tregtisë”, paragrafi: Ndiham e kësaj bote për të kërkuar Botën Tjetër, është një veprim i lavdëruar.

Islami e miraton pasurinë dhe i nxit të pasurit të japin, ashtu siç u ka dhënë All'llahu atyre; Islami e miraton, madje e lavdëron pasurinë që vërtetohet në fjalën e ajetit: “...**prandaj mos e lër mangët atë që të takon të bësh në këtë botë**”.

Së fundi, Islami nuk e miraton atë pasuri që përdoret si mjet për ngatërresa e korrupsion dhe që injoron vlerat njerëzore, sepse rezultati i një pasurie të tillë është sprovimi me çmendurinë e garimit. Kjo lloj pasurie e nxjerr njeriun nga vetja e tij dhe e bën të urrejë të tjerët. Veç kësaj, dihet se pasuria e tepërt i ka çuar njerëzit deri aty sa t'u kundërvihen Profetëve të All'llahut, ashtu siç iu kundërvu Karuni Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*).

Islami e konsideron pasurinë si një mjet për të mbushur boshllëkun ekonomik. Sipas këndvështrimit islam, nga pasuria duhet të përfitojnë të gjithë dhe ajo duhet të jetë shëruese e plagëve të të privuarve nga të mirat e kësaj bote. Me pasurinë, Islami ka për qëllim plotësimin e nevojave shoqërore dhe që ajo të përdoret si mjet për të zgjidhur problemet e njerëzve të pafuqishëm.

Marrëdhënia ndërmjet pasurisë dhe këtyre qëllimeve të shenjta, nuk është marrëdhënie e kësaj bote, ose një lidhje me këtë botë. Jo, me pasurinë, Islami kërkon lidhjen me Botën Tjetër.

Në një transmetim të ardhur prej Imam Sadikut, lexojmë se njëri prej shokëve të tij shkoi tek ai, që t'i ankohej për punët e veta dhe i tha: “Le ta zbukurojmë botën. Dua që ajo të na jepet neve”. Imami i tha: “Çfarë dëshiron të bësh me të?”. Ai u përgjigj: “Të ushqej veten dhe ata që kam në ngarkim, të mbaj lidhjet me të afërmit, të jap lëmoshë, të kryej Haxhin dhe Umren.”. Pasi i dëgjoi

këto fjalë, Imam Sadiku i tha: “Kësaj nuk i thonë të kërkosh këtë botë, por Botën Tjetër.”.¹

Në problemin e shtruar në këto ajete bëhet e qartë prishja e besimit të dy grupeve: 1- një grupi të myslimanëve, ose më saktë, të atyre që hiqen si të tillë, por që janë shumë larg mësimëve të Islamit; këta e përshkruajnë Islamin si mbrojtës të të pafuqishmëve. 2- një grupi prej armiqve dashakeqës, të cilët dëshirojnë ta përbaltin imazhin e Islamit dhe thonë se ai është kundërshtar i pasurisë e se përkrah vetëm të varfrit.

Si normë bazë, një popull i varfër nuk mund të jetojë i lirë dhe me kokën lart. Varfëria bëhet shkak për t’u lidhur me të huajt dhe për të qenë satelit i të tjerëve; varfëria është bazë e turpërimit në këtë botë dhe në Tjetrën. Ajo i bën thirrje njeriut të mëkatojë e të gabojë.

Në një transmetim tjetër të ardhur prej Imam Sadikut në lidhje me këtë çështje, lexojmë se ai ka thënë: “*Pasuria që të mbron nga padrejtësia, është më e mirë sesa varfëria që të çon në mëkat.*”.²

Shoqëritë islame e kanë detyrë që të përparojnë për të qenë të pasura dhe për të arritur plotësimin e nevojave me forcat e veta. Ato duhet të qëndrojnë në këmbët e veta dhe të mos e sakrifikojnë pavarësinë, madhështinë dhe nderin e vet për shkak të asaj varfërie që të ul kokën dhe që detyrimisht të çon në varësi të gjithanshme.

¹ Burimi mësipërm, vëll. 3, f. 19, kapitulli: Premisat e tregtisë, paragrafi: Mbledhja e pasurisë në rrugë të lejuara është një veprim i lavdëruar.

² “Uesailu Shij’ah”, vëll. 12, f. 7; kapitulli 6: “Premisat e tregtisë”, paragrafi: Është veprim i pëlqyeshëm që të kërkohet ndihma e kësaj bote për të arritur Botën Tjetër.

Ajetet: 83 - 84

تِلْكَ الدَّارُ الْآخِرَةُ نَجْعَلُهَا لِلَّذِينَ لَا يُرِيدُونَ عُلُوًّا فِي الْأَرْضِ وَلَا فَسَادًا
وَالْعَاقِبَةُ لِلْمُتَّقِينَ ﴿٨٣﴾ مَنْ جَاءَ بِالْحَسَنَةِ فَلَهُ خَيْرٌ مِنْهَا وَمَنْ جَاءَ بِالسَّيِّئَةِ
فَلَا يُجْزَى الَّذِينَ عَمِلُوا السَّيِّئَاتِ إِلَّا مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴿٨٤﴾

“Atë, shtëpinë e Botës Tjetër, Ne e kemi bërë për ata që nuk duan as supremaci në këtë botë e as nuk bëjnë ngatërresa dhe, përfundimi (i mirë) është për të devotshmit.”

“Kush vjen me një të mirë, për atë do të ketë një më të mirë se ajo dhe kush vjen me një të keqe, ata që bëjnë të këqija do të dënohen vetëm për të keqen që kanë bërë.”

Komentimi

Rezultati i dëshirës për supremaci dhe ngatërresa

Pas shpjegimit mbresëlënës për atë që i ngjau të pasurit mendjemadh dhe shtypës, Karunit, ajeti i parë i ajeteve që janë objekt studimi, shpjegon rezultatin e asaj ngjarjeje dhe njofton:

“Atë, shtëpinë e Botës Tjetër, Ne e kemi bërë për ata që nuk duan as supremaci në këtë botë e as nuk bëjnë ngatërresa.”.

Vetëkuptohet që ata nuk janë as mendjemëdhenj e as ngatërrestarë në këtë tokë. Jo vetëm kaq, por edhe zemrat e tyre janë të pastra nga të tilla gjëra. Ata as nuk e duan mendjemadhësinë dhe as nuk i dëshirojnë ngatërresat.

Në të vërtetë, ndër shkaqet që e privojnë njeriun prej mirësive të Botës Tjetër, janë edhe këto dy gjëra: 1- dëshira për supremaci, pra mendjemadhësia për të qenë mbi të tjerët dhe 2- ngatërresat e shkatërrimet në këtë tokë. Që të dyja këto janë prej mëkateve të mëdha. Çdo gjë e ndaluar prej All’llahut, është në kundërshtim me sistemin e krijimit të njeriut dhe pa dyshim edhe me integrimin e vetë ekzistencës së tij. Bërja e një pune të ndaluar prej All’llahut e shkatërron sistemin e jetës së njeriut, prandaj ajo punë është edhe baza e ngatërresave dhe e shkatërrimit në tokë. Madje, mendjemadhësia në vetvete, është një prej veseve kryesore që shkakton ngatërresat e shkatërrimet në tokë.

Në tregimin e Karunit dhe shpjegimit të gjendjes së tij, pamë se shkakun kryesor që e bëri atë njeri të keq dhe që solli edhe shkatërrimin e tij, ishte mania për të qenë mbi të tjerët, pra mendjemadhësia.

Kësaj çështjeje i është kushtuar një rëndësi e madhe në transmetimet islame. Në një transmetim të ardhur prej prijësit të besimtarëve, Imam Ali bin Ebù Tàlibi lexojmë se ai ka thënë: *“Njeriu do që edhe rripat e sandaleve të tij të jenë më të mira se ato të*

shokut që ka në krah, ndonëse lidhëset hyjnë nën sandale (pra nuk duken).".¹ (Kjo është vetëm një copëz e vogël e mendjemadhësisë).

Duke komentuar këtë transmetim, autori i librit *"Et Tefsirul Kesh'shâf"*, thotë: Disa lakmitarë, fjalën *"tefed'dul"* – **"supremaci, mendjemadhësi"** të përmendur në ajetin që është objekt studimi, e adresojnë për Faraonin, duke e mbështetur mendimin e tyre në fjalën e All'Ilhut, të Lartit: **"...me të vërtetë Faraoni po mbahet me të madh në tokë"**²; edhe shkatërrimin e ngatërresat ia adresojnë Faraonit, gjithnjë duke u mbështetur në fjalën e All'Ilhut: **"mos bëj shkatërtime e ngatërresa në tokë."**³ Ata pretendojnë se kush nuk i ngjan Faraonit dhe Karunit, është prej banorëve të Xhennetit. Me këtë pretendim, ata përjashtojnë nga Xhenneti vetëm Faraonin dhe Karunin, kurse për të tjerët mendojnë se janë prej banorëve të tij. Por, ata nuk e kanë parë me vëmendje fundin e ajetit që njofton se: **"përfundimi (i mirë) është për të devotshmit."**⁴

Këtu duhet shtuar se ata pretendues lakmitarë kanë gabuar edhe në njohjen e Karunit e të Faraonit, sepse ky i fundit që mbahej me të madh në tokë, ishte edhe prej shkatërruesve e ngatërrestarëve, ashtu siç e përshkruan ajeti: **"...me të vërtetë, ai (Faraoni) ishte prej shkatërruesve."**⁵

Por edhe Karuni ishte shkatërrues e ngatërrestar; ai ishte edhe mendjemadh që kërkonte supremaci, ashtu siç cilësohet në fjalën e

¹ Tefsiri *"Xheuàmiul Xhàmi'i"*, fundi i ajetit që është objekt studimi.

² Sure *"El Kasas"*, ajeti 4.

³ Sure *"El Kasas"*, ajeti 77.

⁴ Tefsiri *"Kebijr"*, vëll. 20, fundi i ajetit që është objekt studimi.

⁵ Sure *"El Kasas"*, ajeti 4.

All'Ilahut, të Lartit: **“Dhe ai (Kàrùni) doli para popullit të tij me stolitë e veta.”**.¹

Në një transmetim tjetër të ardhur prej Imam Aliut, lexojmë se edhe kur ishte kalif, ai ecte nëpër tregje dhe ua tregonte rrugën atyre që nuk e dinin, ose ndihmonte të pafuqishmit. Kur kalonte te shitësit dhe vërente se ndonjë prej tyre mendohej të fitonte, ai këndonte ajetin: **“Atë, shtëpinë e Botës Tjetër, Ne e kemi bërë për ata që nuk duan as supremaci në këtë botë e as nuk bëjnë ngatërres.”**, pastaj thoshte: *“Ky ajet ka zbritur për njerëzit e drejtësisë, për qeveritarët dhe të fuqishmit kryeulët.”*²

Kuptimi i këtij transmetimi dhe i fjalëve të ajetit është:

Ashtu siç nuk është bërë kalifati mjet për supremaci, po ashtu nuk duhet që ju t'i bëni pasuritë dhe fuqitë tuaja, mjet për sundim mbi të tjerët, sepse ata që nuk duan as supremaci dhe as nuk bëjnë ngatërresa e shkatërrime në tokë, do të kenë përfundimin që njofton ajeti në frazën e fundit të tij: **“përfundimi (i mirë) është për të devotshmit.”**

Fjala e ajetit *“el àkibetu”* në kuptimin e saj të gjerë do të thotë: rezultat i mirë, pra fitore në këtë botë dhe hyrja në Xhennet në Botën Tjetër. Ne pamë se ku arriti Karuni dhe ç'përfundim pati ai dhe ata që shkonin pas tij. Ndonëse ishin njerëz të fuqishëm, ata u sprovuan me përfundimin më të keq dhe me të ardhmen më të zezë, për shkak se nuk qenë të devotshëm.

¹ Sure “El Kasas”, ajeti 79.

² Ky transmetim është cituar nga Zàdani prej prijësit të besimtarëve në tefsirin “Mexhmaul Bejan”; fundi i ajetit që është objekt studimi.

Në një transmetim të ardhur prej Imam Sadikut, thuhet se kur e lexoi këtë ajet, ai qau me dënesë dhe tha: *“Pasha All’llahun, me këtë ajet u shuan shpresat.”*¹

Në këtë ajet thuhet e vërteta, që Bota e Ardhshme nuk është për ata që duan pushtet e që janë mendjemëdhenj, por për të devotshmit kryeulët dhe për ata që kërkojnë të vërtetën. Ajeti i dytë vijues i grupit të ajeteve që janë objekt studimi, shpjegon një ligj të përgjithshëm, që në të vërtetë është një ndërthurje midis drejtësisë dhe preferencës. Kur përmendet shpërblimi për punën e mirë, në ajet thuhet: **“Kush vjen me një të mirë, për atë do të ketë një më të mirë se ajo.”**

Kjo është etapa e preferencës, çka do të thotë se All’llahu i Lartësuar nuk i merr njerëzit në llogari ashtu sikurse këta të fundit marrin në llogari njëri-tjetrin. Kur dikush ka dëshirë ta shpërblejë shokun e tij, ai mundohet t’i japë atij vetëm aq sa e meriton, kurse All’llahu e shumëfishon punën e mirë me dhjetë të mira të ngjashme me punën e bërë; madje e shumëfishon atë punë me qindra e me mijëra të mira të ngjashme. Shpërblimi më i vogël që i jep All’llahu robit të Tij, është sa dhjetëfishi i punës së mirë që ka bërë ai, ashtu siç njofton Kur’ani në ajetin 160 të sures “El En’àm”: **“...kush vjen me një të mirë, për atë do të ketë dhjetë fishin e saj.”**

Përsa i përket kufirit më të madh të shpërblimit që jep All’llahu, atë nuk e di askush përveç Tij; por edhe për këtë, në ajetin 261 të sures “El Bekare”, jepet një shenjë që ka lidhje me shpenzimin në rrugën e All’llahut. Për këtë, i Gjithëfuqishmi thotë: **“Shembulli i atyre që shpenzojnë në rrugën e All’llahut,**

¹ Tefsiri i Ali bin Ibrahim, vëll. 2, f. 146; fundi i ajetit që është objekt studimi.

ngjet me një kokërr prej së cilës mbijnë shtatë kallinj dhe çdo kalli ka njëqind kokrra; All'Ilahu e shumëfishon shpërblimin për atë që Ai dëshiron. Dituria e All'Ilahut është shumë e gjerë.”.

Shumëfishimi i shpërblimit nuk bëhet në mënyrë arbitrare. Përkundrazi, ai ka lidhje me pastërtinë e punës, me sinqeritetin, me qëllimin e mirë dhe me qartësinë e zemrës. Kjo është faza e begatimit të All'Ilahut për ata që bëjnë punë të mira.

Menjëherë pasi përmendet shumëfishimi i shpërblimit, në Kur'anin Famëlartë flitet për dënimin e atyre që bëjnë punë të këqija dhe thuhet: **“Kush vjen me një të mirë, për atë do të ketë një më të mirë se ajo dhe kush vjen me një të keqe, ata që bëjnë të këqija do të dënohen vetëm për punën që kanë bërë.”**.

Kjo është faza e drejtësisë hyjnore. Punëkeqi dënohet vetëm aq sa është masa e së keqes që ka shkaktuar puna e tij dhe mbi këtë dënim, atij nuk i shtohet asnjë dënim tjetër.

Kur përmendet dënimi për punën e keqe, Kur'ani Famëlartë shprehet për dënimin me aq sa është puna e bërë: **“vetëm për punën që kanë bërë”**, pra punët që janë në përputhje me ligjin që mundëson ekzistencën e qenieve në të gjithë botën e gjallë, mbeten të pandryshuara dhe në Ditën e Kiametit ato do të dalin në shesh të trupëzuara. Dita e Kiametit është Dita e daljes së punëve haptazi sipas formës së tyre. Ky dënim i shoqëron punëkëqinjtë dhe i torturon ata.

Hulumtime

1- Përse fjala *"es'sej'jieti"* - **"e keqe"** është përsëritur dy herë në këtë ajet?

Me këtë përsëritje, All'llahu i Lartësuar thekson se puna e keqe dënohet vetëm aq sa është e keqja e saj.

2- A e përfshin fjala e ajetit *"el haseneti"* - **"e mira"** imanin dhe *Teuhidin*? Nëse nuk do t'i përfshinte, atëherë ç'kuptim ka fraza e ajetit: **"Kush vjen me një të mirë, për atë do të ketë një më të mirë se ajo?"**. A mund të ketë punë më të mirë sesa *imani* dhe *Teuhidi*?

Në përgjigje të kësaj pyetjeje, themi: fjala e ajetit *"el haseneti"* - **"e mira"** ka një kuptim shumë të gjerë dhe përfshin gjithçka që ka të bëjë me besimin, me fjalët dhe me punët që bën njeriu. Por a mund të ketë punë më të mirë se besimi në All'llahun, Zotin Një e të Vetëm (*Teuhid*)?! Me këtë besim fitohet kënaqësia e All'llahut të Gjithëfuqishëm, por është edhe shpërblim për punëmirët. Në ajetin 72 të sures *"Et Teube"* lexojmë fjalën e All'llahut, të Lartit: **"dhe kënaqësinë prej All'llahut, që është mbi gjitha të tjerat."**

3- Përse fjala *"el haseneti"* - **"e mira"** ka ardhur në Kur'an në numrin njëjës, kurse fjala *"es'sej'jiati"* - **"të këqijat"** ka ardhur në numrin shumës?

Disa interpretues të Kur'anit mendojnë se kjo mënyrë shprehjeje ka të bëjë me faktin se punëkëqijtë janë shumicë, ndërsa punëmirët janë pakicë⁽¹⁾.¹

Gjithashtu, ata mendojnë se fjala “të mirat” përmbledhet në të vërtetën e *Teuhidit* (All'llahu është Zoti Një dhe i Vetëm). Sipas tyre, të gjitha të mirat kthehen në një “originë” të vetme, që është Teuhidi; ndërsa “të këqijat” kthehen te *shirku* (vënia shok All'llahut në adhurim), te llojshmëria dhe te shumica.

¹ Tefsiri “Rùhul Meàniy”, vëll. 20, f. 127.

Ajetet: 85 - 88

إِنَّ الَّذِي فَرَضَ عَلَيْكَ الْقُرْآنَ لَرَادُّكَ إِلَىٰ مَعَادٍ قُلْ رَبِّي أَعْلَمُ مَنْ جَاءَ
 بِالْهُدَىٰ وَمَنْ هُوَ فِي ضَلَالٍ مُّبِينٍ ﴿٨٥﴾ وَمَا كُنْتَ تَرْجُو أَنْ يُلْقَىٰ إِلَيْكَ الْكِتَابُ
 إِلَّا رَحْمَةً مِّنْ رَبِّكَ فَلَا تَكُونَنَّ ظَهِيرًا لِّلْكَافِرِينَ ﴿٨٦﴾ وَلَا يَصُدُّكَ عَنْ
 آيَاتِ اللَّهِ بَعْدَ إِذْ أُنزِلَتْ إِلَيْكَ وَادْعُ إِلَىٰ رَبِّكَ وَلَا تَكُونَنَّ مِنَ الْمُشْرِكِينَ
 ﴿٨٧﴾ وَلَا تَدْعُ مَعَ اللَّهِ إِلَهًا آخَرَ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ كُلُّ شَيْءٍ هَالِكٌ إِلَّا وَجْهَهُ ۚ لَهُ
 الْحُكْمُ وَإِلَيْهِ تُرْجَعُونَ ﴿٨٨﴾

“Pa dyshim, Ai që të zbriti ty Kur'anin, do të kthejë aty ku ishe
 (në Mekë); thuaj: Zoti im e di më mirë se kush është udhëzuar në
 rrugën e drejtë dhe kush është në rrugën e humbjes së qartë.”

“Ti nuk ke shpresuar se ty do të jepej libri përveçse si mëshirë
 prej Zotit tënd; prandaj ti kurrë mos të jesh ndihmës për
 mohuesit.”

“(Bëj kujdes) që ata mos të shmangin prej argumenteve që të
 janë zbritur prej Zotit tënd, bëju thirrje (njerëzve) për te Zoti yt
 dhe kurrë të mos jesh prej idhujtarëve.”

“Dhe mos adhuro së bashku me All'llahun ndonjë zot tjetër.
 S'ka të adhuruar tjetër përveç Atij. Të gjitha sendet do të
 asgjësohen, përveç Tij. Vetëm Atij i takon gjykimi dhe tek Ai do
 të ktheheni.”

Shkaku i zbritjes

Për shkakun e zbritjes së ajetit të parë të grupit të ajeteve që janë objekt studimi, një grup interpretuesish të Kur'anit kanë cituar një transmetim të përcjellë prej Ibn Ab'bàsit. Në këtë transmetim thuhet se gjatë rrugës së emigrimit të tij nga Meka për në Medine, Profeti (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) arriti në një vend të quajtur *Xhu'hfeh*, që nuk është shumë larg nga Meka. Meqenëse u detyrua ta linte këtë qytet, dashuria që kishte Profeti për "Shtëpinë e Shenjtë" filloi të dukej qartë në fytyrën e tij, por në këtë gjendje, kjo dashuri ishte e përzier me brengosje dhe emocione. Pikërisht në ato çaste, Profetit (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i erdhi besniku i Shpalljes, Xhebraili, dhe i tha: "A të merr malli për qytetin tënd, që është edhe vendlindja jote?". Profeti (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) iu përgjigj: "Po.". Atëherë, Xhebraili i kumtoi fjalën e All'llahut: "**Pa dyshim, Ai që të zbriti ty Kur'anin, do të të kthejë aty ku ishe** (në Mekë).".¹

Ne e dimë tashmë se ky premtim madhor u përmbush dhe Profeti (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) së bashku me ushtrinë e tij të fuqishme, hynë në Mekë me madhështi. Meka iu dorëzua atij pa luftë.

Duke u bazuar mbi ngjarjet e ndodhura, ky ajet numërohet prej njoftimeve të gradës së mrekullisë, pasi premtimi që i ishte

¹ Referohu në tefsirin "El Mijzàn", vëll. 16; në tefsirin e Kurtubij'jit, në tefsirin "Mexhmaul Bejan", vëll. 7, f. 268; tefsiri "Kebijr", vëll. 25, f. 21 si dhe në tefsire të tjerë.

bërë Profetit (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), se ai do të kthehej patjetër në Mekë pa asnjë kusht, shumë shpejt u bë realitet.

Komentimi

Premtimi për rikthimin e Profetit në Shtëpinë e sigurtë të All'llahut

Ajetet e këtij grupi, që janë edhe ajetet e fundit të sures “El Kasas”, i flasin Profetit të Islamit në vetën e dytë dhe e përgëzojnë atë për fitoren. Këto vijnë pas ajeteve të para, ku tregohet për Musain (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) e Faraonin dhe për fundin e Faraonit dhe të popullit të tij.

Në ajetet që janë objekt studimi, ka udhëzime të prera për të Dërguarin e Islamit.

Më sipër thamë se, sipas fjalës më të përhapur në mesin e interpretuesve të Kur'anit, ajeti i parë i këtij grupi ka zbritur në vendin e quajtur *Xhahfeh*, gjatë udhëtimit të Profetit (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për në Medine. Ai po shkonte në Jethrib, ashtu siç quhej Medina në atë kohë, që ta shndërronte atë në “qytetin e të Dërguarit”, ku do të hidhte themelet e para të qeverisë islame. Medina do të bëhej qendra e një qeverie të madhe hyjnore dhe aty, Profeti (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) do të

realizonte objektivat e saj. Por dashuria e madhe dhe lidhja që ai kishte me Mekën, i sillte dhimbje të mëdha dhe nuk e kishte të lehtë të rrinte larg “Shtëpisë së Shenjtë” të All’llahut.

Pikërisht në këtë kohë, në zemrën e tij të pastër vezulloi drita e Shpalljes, që e përgëzoi atë, se shumë shpejt do të kthehej në atdheun e tij të dashur: **“Pa dyshim, Ai që të zbriti ty Kur’anin, do të të kthejë aty ku ishe (në Mekë)”**; Prandaj mos u shqetëso, mos e lodh veten dhe mos kujto se ke humbur, sepse All’llahu që e ktheu Musain (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) pranë nënës së tij dhe më vonë, pas një mungese prej dhjetë vitesh që jetoi në tokën e Medjenit, e ktheu atë te populli i tij, që ai të ndizte pishtarin e *Teuhidit*, të besimit në All’llahun Zotin Një dhe të Vetëm, që të ndërtonte qeverinë e të pafuqishmëve, të asgjësonte Faraonin dhe shtetin e fuqinë e të gjithë faraonëve, - Ai do të të kthejë edhe ty në Mekë, do të të kthejë të fuqishëm e me mundësi të shumta. Ai do të mundësojë që llamba e Njëshmërisë së All’llahut të shndrisë me dorën tënde në atë tokë të bekuar.

All’llahu të zbriti ty Kur’anin, të urdhëroi që t’ua kumtosh njerëzve atë dhe të ngarkoi me detyrën e zbatimit të dispozitave të tij.

Patjetër që Zoti i Kur’anit, Zoti i qiellit dhe i tokës, Madhështori, e ka shumë të lehtë të të kthejë ty në vendin e në atdheun tënd, në Mekë.

Në vijim të bisedës me Profetin (*Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), All’llahu i Lartësuar e urdhëron atë që t’u përgjigjet kundërshtarëve që janë në rrugën e humbjes me atë që i ka mësuar All’llahu. Kështu, ajeti njofton:

“...thuj: Zoti im e di më mirë se kush është udhëzuar në rrugën e drejtë dhe kush është në rrugën e humbjes së qartë.”.

Rruga e udhëzimit në të vërtetën është e qartë. Edhe rruga e humbjes është e qartë, prandaj ata e lodhin veten kot, sepse All'illahu këtë e di shumë mirë. Gjithashtu, këtë të vërtetë e dinë edhe zemrat e dashuruara me All'illahun, të Vërtetin.

Interpretimi më i qartë i këtij ajeti është ai që kemi shpjeguar më lart. Megjithatë, një grup prej interpretuesve të Kur'anit japin disa mundësi të tjera interpretimi në lidhje me fjalën e ajetit “*meàd*”. Në vend të kuptimit: kthim në vendin tënd, - ata e kanë komentuar këtë fjalë në kuptimin: ringjallja pas vdekjes, ose vendgrumbullimi i llogaridhënies në Botën Tjetër, ose edhe në kuptimin e vdekjes; ose e kanë interpretuar në kuptimin e Xhennetit, ose në pozitën e ndërmjetësimit të madh, ose edhe të “Bejti Mukad'desit”, Xhamisë së Jeruzalemit, nga ku Profeti ynë është ngritur herën e parë në hapësirat jashtë tokës, për të qenë në praninë e All'illahut, etj.

Nëse do të shohim me vëmendje në brendinë e sures “El Kasas”, në ngjarjet që ndodhën midis Musait (*Paqja e All'illahut qoftë mbi të!*), Faraonit dhe Beni Israilëve, duke përfshirë dhe atë që cituam për shkakun e zbritjes së këtij ajeti, interpretimi i fjalës “*meàd*” – **“kthim në vendin tënd”**.me ndonjë kuptim tjetër, është shumë larg kuptimit: “do të të kthejmë në Mekë”. Këtu duhet shtuar se fjala “*meàd*” në kuptimin e kthimit në Ditën e Gjykimit, nuk është kthim i veçantë vetëm për Profetin tonë; kurse ajeti që është objekt studimi flet vetëm për Profetin dhe i drejtohet drejtpërdrejt vetëm atij. Gjithashtu, ardhja e këtij ajeti pas atij që fliste për shpërblimin dhe dënimin në Ditën e Kiametit, nuk mund

të jetë argument se kjo fjalë është në kuptimin e kësaj Dite. Në të kundërt, ajeti i mëparshëm flet vetëm për fitoren në Botën Tjetër. Prandaj, është në përputhje të plotë që fjala në ajetin që është objekt studimi të jetë për fitoren në këtë botë.

Ajeti vijues flet për një mirësi tjetër prej mirësive të mëdha të All'Ilahut, që i janë dhënë Profetit (*Paqja dhe bekimi i All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe njofton: **“Ti nuk ke shpresuar se ty do të jepej libri përveçse si mëshirë prej Zotit tend.”**¹

Shumë njerëz të asaj kohe kishin dëgjuar përgëzimin për shfaqjen e një feje të re dhe mbase një grup prej ithtarëve të librave të mëparshëm, si edhe të tjerë, po prisnin që tek ata të zbriste Shpallja dhe All'Ilahu t'i ngarkonte me këtë përgjegjësi. Por ti, o Profet, nuk e kishe menduar se All'Ilahu do të ta zbriste ty Shpalljen, ashtu siç njofton ajeti: **“Ti nuk ke shpresuar se ty do të jepej libri përveçse si mëshirë prej Zotit tënd”**; All'Ilahu kishte vendosur që të ishe ti personi që e meritonte këtë përgjegjësi, më shumë se kushdo tjetër, sepse kjo fe e re duhet të përhapet sa më shumë me dorën tënde në këtë botë të madhe.

Interpretues të tjerë të Kur'anit mendojnë se ky ajet është në përputhje me ajetet e mëparshme që flisnin për Musain (*Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!*), por në të i flitet edhe Profetit tonë, ashtu siç e lexojmë në fjalën e të Lartit: **“Ti nuk ishe pranë anës**

¹ Disa interpretues të Kur'anit kanë thënë se në këtë ajet, fjala “il’lâ” tregon përveçim. Për këtë, ata janë detyruar të shprehen për heqjen e një fjale dhe për rrjedhojë, vlerësimi i kuptimit të ata është: imponim. Të tjerë kanë thënë se fjala “il’lâ”ka kuptimin “lâkin” - **por** - dhe si fjalë tregon punën për të arritur kuptimin. Nga kjo pikëpamje, ky është edhe interpretimi më i afërt për këtë fjalë të ajetit.

perëndimore (të vendit) kur Ne i besuam Mùsàit Shpalljen... dhe ti nuk ishe pranë Tùrit kur Ne thirrëm (Musain), por kjo është mëshirë prej Zotit tënd...".¹

Duke u bazuar mbi këtë shpjegim, qëllimi këtu me fjalën e ajetit që është objekt studimi "*el kitàbu*" - "**libri**", është për tregimet e Profetëve të mëparshëm, prandaj ky komentim nuk është në kundërshtim me komentimin e mëparshëm, madje në fakt, mund të konsiderohet si pjesë e tij.

Në vijim të fjalës drejtuar Profetit (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), Kur'ani i thotë atij: meqenëse ti je në këtë mirësi të madhe: "**...prandaj ti kurrë të mos jesh ndihmës për mohuesit.**".

Dihet botërisht se Profeti (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) s'ka qenë kurrë ndihmës për mohuesit, por ajeti ka ardhur si përforcim dhe për t'i theksuar e për t'i shpjeguar atij përgjegjësinë që ka ndaj të tjerëve, për t'i thënë atij se detyra e tyre është që të sillen mirë ndaj Profetit dhe që vetë Profeti të mos shfaqë asnjë lloj prirjeje për të ndihmuar mohuesit.

Kjo çështje është në përputhje të plotë me atë që lexuam në lidhje me Musain (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), kur ai tha: "**Ai tha: Zoti im, betohem në të mirat që më ke dhënë, se kurrë nuk do të vihem në ndihmë të kriminelëve.**".

Këtë kuptim ne e kemi shpjeguar në lidhje me dhënien e ndihmës për të dhunuarit nga padrejtësitë në ajetin 17 të sures "El Kasas".

¹ Sure "El Kasas", ajetet 44 dhe 46.

Dy ajetet që janë objekt studimi, me të cilat mbyllet surja “El Kasas”, e vënë theksin mbi çështjen e Njëshmërisë së All’llahut (*Teuhidit*) dhe e shpjegojnë atë me argumente të shumta e të ndryshme.

Njëshmëria e All’llahut (*Teuhidi*) është baza e të gjitha çështjeve të fesë. Ajo është origjinë, degë, tërësi dhe pjesë.

Në këto dy ajete gjenden katër urdhra të All’llahut për Profetin e Tij si dhe katër cilësi të All’llahut të Lartësuar. Me këto urdhra dhe me këto cilësi plotësohen studimet që kanë ardhur në këtë sure.

Në fillim, ajeti thotë: “(Bëj kujdes) **që ata mos të shmangin prej argumenteve që të janë zbritur prej Zotit tënd**”; pavarësisht se ndalimi u adresohet mohuesve, ajeti nënkupton mosdorëzimin e Profetit (*Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) para pritave të mohuesve, para punëve të tyre ulëta dhe kompleteve të tyre. Kjo është për shembull, sikur ne t’i themi dikujt: “Nuk duhet të dëgjosh ato që të pëshpërit në vesh filani”, pra mos u bëj pre e fjalëve të tij.

Kështu e urdhëron All’llahu i Lartësuar Profetin e Tij dhe i thotë: Qëndro i palëkundur kur të zbresin ajetet dhe mos ngurro në punë; detyra jote është të heqësh të gjitha pengesat që të dalin rrugës, sado të shumta e të mëdha të jenë ato e të ecësh i sigurtë drejt qëllimit tënd. Ky urdhër, në brendinë e vet, do të thotë: All’llahu pa dyshim që të ruan dhe është gjithmonë me ty.

Ibni Ab’basi ka thënë: Edhe pse fjala i drejtohet Profetit (*Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*),

qëllimi është për të gjithë njerëzit, ashtu siç thuhet edhe në një proverb arab: “*ij'jake*” – “*Bëj kujdes, ruhu dhe dëgjo o komshie!*”.

Pas kësaj bisede të drejtpërdrejtë, ku përmenden jo vetëm gjëra për të cilat ai urdhërohet t'i mënjanojë, por edhe ndalime të formës së prerë, menjëherë vjen biseda e dytë, si shenjë dalluese e vërtetuese dhe i thotë: “**bëju thirrje** (njerëzve) **për te Zoti yt**”; bëju thirrje njerëzve të besojnë në All'llahun që të ka krijuar, që të rriti dhe që kujdeset për ty.

Urdhri i tretë pas urdhrit për të adhuruar një Zot të Vetëm (*Teuhidi*), besim që hedh poshtë të gjitha format e vënies shok All'llahut dhe adhurimin e idhujve, vjen urdhri: “**dhe kurrë të mos jesh prej idhujtarëve**”; sepse rruga e Njeshmërisë së All'llahut është krejt e qartë dhe ata që ecin në të, janë pa dyshim në rrugën e drejtë.

Edhe urdhri i katërt hedh poshtë të gjitha llojet e vënies shok All'llahut dhe All'llahu, i Larti, i thotë drejtpërdrejt: “**Dhe mos adhuro së bashku me All'llahun ndonjë zot tjetër.**”.

Këto urdhra të njëpasnjëshëm, ku çdonjëri prej të cilëve vërteton tjetrin, shpjegojnë rëndësinë e madhe të Njeshmërisë së All'llahut në programin islam, sepse pa besimin në një Zot të Vetëm, çdo punë është mashtrim dhe iluzion.

Pas këtyre katër urdhrave, vijnë katër cilësitë e larta të All'llahut, të cilat gjithashtu theksojnë Njeshmërinë e All'llahut të Lartësuar:

E para: “s'ka të adhuruar tjetër përveç Atij.”.

E dyta: “të gjitha sendet do të asgjësohen, përveç Tij.”.

Etreta: “**vetëm Atij i takon gjykimi**” vetëm All’liahut i takon gjykimi në fushën e legjislacionit dhe të krijimit.

E katërta: Ne do të rikthehemi tek Ai: “**dhe tek Ai do të ktheheni.**”.

Tri cilësitë e fundit janë argument për të vërtetuar Njëshmërinë e All’liahut (*Teuhidin*) dhe hedhin poshtë të gjitha llojet e adhurimit të idhujve, gjë për të cilën flitet në cilësinë e parë.

Ajeti thekson: Të gjithë do të asgjësoheni dhe vetëm Ai do të mbetet.

Përderisa do të ndodhë asgjësimi i sistemit të krijimit, gjykimi është vetëm në dorën e Tij.

Përderisa kthimi ynë pas Ringjalljes do të jetë vetëm tek Ai, kuptohet qartë se cili do të jetë roli i të adhuruarve të tjerë përveç Atij. Kush tjetër prej të adhuruarve përveç Tij, meriton të adhurohet?

Në mesin e interpretuesve të dëgjuar të Kur’anit ka mendime të ndryshme në lidhje me interpretimin e frazës së ajetit që është objekt studimi: “**të gjitha sendet do të asgjësohen, përveç Tij**”; diskutimi midis tyre është përqendruar rreth dy fjalëve të kësaj fraze: “*vexh’hun*” - “**fytyrë**” - dhe “*hàlikun*” - “**zhduket**” .

Nga pikëpamja gjuhësore, fjala “*vexh’hun*”- “**fytyrë**” përdoret për gjallesën që ka njeriu përballë, por kur kjo fjalë thuhet për Krijuesin, ka kuptimin e Qenies së Tij të lartë.

Edhe fjala *“hàlikun”* – **“zhdukët”** në rrënjën e saj *“heleke”* do të thotë: vdekje, mosekzistencë. Duke u bazuar mbi këtë shpjegim, kuptimi i frazës së lartpërmendur është: zhdukja e vdekja e të gjitha qenieve të gjalla, përveç Krijuesit të Lartësuar. Zhdukja e qenieve të gjalla është e mundur dhe nuk është e kushtëzuar me zhdukjen e me asgjësimin e kësaj bote. Në këtë gjendje, të gjitha qeniet janë të vdekura kundrejt Qenies së Shenjtëruar; të gjitha qeniet kanë nevojë për fuqinë e Tij çast pas çasti, pasi ato vetë nuk kanë asgjë dhe çdo gjë e kanë vetëm prej All'Ilahut.

Përveç kësaj, të gjitha qeniet e kësaj bote janë në transformim të vazhdueshëm, në përputhje me atë që quhet *“lëvizja esenciale”*, e cila gjithashtu i nënshtrohet transformimit. Ne dimë se *“lëvizje”* dhe *“transformim”* do të thotë: asgjësim dhe kthim i përhershëm; pra, qeniet e kësaj bote vdesin dhe ripërtërihen në çdo çast.

Duke u bazuar mbi këtë rregull, qeniet e kësaj bote janë të vdekshme dhe të asgjësueshme, kurse për Qenien e Shenjtë nuk mund të mendohet dhe jo më të flitet për vdekje e për asgjësim.

Gjithashtu, ne dimë se asgjësimi dhe mosekzistenca, do të dalin në dritë në formën më të qartë në fundin e kësaj bote, ashtu siç njofton Kur'ani në ajetet 26 dhe 27 të sures *“Err Rrahmàn”*: **“Çdo gjë që është mbi atë (tokën) është zhdukur”** dhe **“dhe mbetet vetëm Zoti yt, i Madhëruari, i Nderuari.”**

Asgjësimi nuk ndodh vetëm te qeniet e tokës, por përfshin edhe banorët e qiellit, ashtu siç njofton ajeti 68 i sures *“Ez Zumer”*: **“...i fryhet ‘Surit’ dhe menjëherë vdesin ato që janë në qiej e ato që janë në tokë.”**

Ky interpretim është në përputhje me kuptimin e fjalëve të ajetit dhe të ajeteve të tjera të Kur'anit që flasin për këtë çështje. Megjithatë, disa interpretues të Kur'anit e kanë interpretuar ndryshe. Le të shohim se ç'kanë thënë ata në lidhje me fjalën e ajetit *"vexh'hun"* – **"fytyrë"**:

1- Qëllimi me fjalën e ajetit *"uexh'hun"* – **"fytyrë"** është puna e mirë. Sipas këtij interpretimi, kuptimi i ajetit është: të gjitha punët e njeriut do të zhduken, përveç atyre që janë bërë vetëm për hir të All'llahut.

2- Të tjerë kanë thënë se qëllimi me fjalën *"uexh'hun"* – **"fytyrë"** është se të gjitha punët i adresohen All'llahut. Kështu, kuptimi i ajetit sipas këtij interpretimi është: asnjë nga sendet nuk ekziston në vetvete, përveçse duke ia mbështetur ato All'llahut.

3- Disa të tjerë kanë thënë se qëllimi me fjalën *"uexh'hun"* – **"fytyrë"** është feja. Kështu, kuptimi i ajetit sipas këtij interpretimi është: të gjitha shkollat juridike janë të gabuara, me përjashtim të fesë së All'llahut.

Frazën e ajetit: *"lehul hukmu"* – **"vetëm Atij i takon gjykimi"**, ata e kanë interpretuar në kuptimin e gjykitit ligjor. Shihet qartë se ky interpretim thekson interpretimin e mësipërm.

Gjithashtu, edhe frazën e fundit të këtij ajeti: **"dhe tek Ai do të ktheheni"**, ata e kanë interpretuar në kuptimin e kthimit tek All'llahu për marrjen e legjislacionit prej Tij. Ky është një përforcim tjetër për këtë kuptim.¹

¹ Në tefsirin "Nuruth Thekalejn" kanë ardhur disa transmetime në lidhje me interpretimin e fjalës së ajetit *"vexh'hun"* – **"fytyrë"**, si për shembull në fundin e

Në fakt, midis këtyre interpretimeve dhe asaj që kemi shpjeguar më lart, nuk ka asnjë kundërthënie, sepse ne dimë se i Vetmi që do të mbetet në këtë botë është All'llahu dhe asgjë tjetër përveç Tij; atëherë për ne bëhet e qartë se ajo që lidhet me All'llahun në njërën anë prej anëve, ajo meriton qëndrimin e përjetshëm.

Nga ky këndvështrim, edhe feja e All'llahut, e dalë prej Tij, është e përjetshme; edhe puna e mirë, e bërë për hir të All'llahut, është e përjetshme; edhe udhëheqësit hyjnorë të lidhur me All'llahun, cilësohen si të përjetshëm.

Si përfundim, mund të themi se çdo gjë që është e lidhur me All'llahun, në një mënyrë a në një tjetër, nuk asgjësohet e nuk zhduket.

Dy hulumtime

1- Si asgjësohen të gjitha sendet?

Nga tërësia e pyetjeve që dolën në fundin e ajetit, rezulton se në fundin e botës duhet të zhduken të gjitha sendet. Gjithashtu, do të asgjësohet edhe dheu, nga i cili janë të përbërë trupat e

ajeteve që janë objekt studimi etj. Në disa prej këtyre transmetimeve, fjala “fytyrë” është interpretuar në kuptimin e fesë së All'llahut, në disa të tjera në kuptimin e të Dërguarit të All'llahut dhe në disa të tjera, fjala “fytyrë” i adresohet Vetë All'llahut.

njerëzve. Mirëpo Kur'ani deklaron shpesh se All'llahu do ta mbledhë dheun dhe prej copëzave të tij të mbledhura, do të ringjallen njerëzit; në Ditën e Kiametit, njerëzit do të ringjallen prej varreve të tyre.

Në përputhje me kuptimin që shprehin fjalët e ajeteve, rezulton se si Xhenneti ashtu edhe Zjarri, janë përgatitur që më përpara, ashtu siç thuhet në ajetin 133 të sures "Ali Imran" për Xhennetin: **"është përgatitur për të devotshmit"**. Kjo frazë e ajetit tregon se Xhenneti është krijuar dhe se është përgatitur për njerëzit e devotshëm. E njëjta shprehje ka ardhur edhe në dy ajete të tjera të Kur'anit, në ajetin 24 të sures "El Bekare" dhe në ajetin 21 të sures "El Hadid".

Gjithashtu, në ajetet e Kur'anit tregohet edhe për zjarrin që është përgatitur për mohuesit, ashtu siç njoftohet në ajetin 24 të sures "El Bekare" dhe në ajetin 131 të sures "Ali Imran".

A do të asgjësohen Xhenneti dhe Zjarri në fundin e botës?!

Veç kësaj, ne besojmë në jetën që do të ketë njeriu pas vdekjes deri në Ditën e Kiametit, që në terminologjinë islame quhet *"el hajàtul berzekhiy'hetu"* - *"jeta gjatë intervalit kohor para ringjalljes"*, e cila e ndan jetën e kësaj bote me jetën në Botën e Ardhshme. Ekzistencën e kësaj jete të ndërmjetme, ne e mësojmë prej ajeteve të Kur'anit që flasin për shpirtrat, prandaj shtrohet pyetja: A do të asgjësohen shpirtrat?

Përgjigjja për këto pyetje jepet qartë si më poshtë:

Shumë herë është rënë dakord se qëllimi me vdekjen dhe mosekzistencën, është prishja e shkatërrimi i sistemit dhe jo

asgjësimi i vetë sistemit. Le të marrim një shembull nga jeta jonë: një ndërtesë e shembur prej tërmetit, është kthyer në gërmadhë, por materialet e ndërtimit vazhdojnë të jenë aty. Tashmë, funksioni i ndërtesës si e tillë është prishur.

Ne dimë se në fundin e botës do të shuhet dielli dhe do të errësohet hëna; malet do të rrafshohen dhe do të vdesin të gjitha qeniet e gjalla. Ky është kuptimi i asgjësimit të botës.

Nga ana tjetër, asgjësimi është i lidhur me këtë botë dhe me gjërat e saj; kurse Xhenneti dhe Zjarri, qoftë kur supozohet që janë brenda kësaj bote, qoftë kur supozohet se ato janë jashtë saj, të dyja, do me thënë: as Xhenneti e as Zjarri nuk janë pjesë e kësaj bote që të përfshihen në asgjësimin e zhdukjen e sitemit të tyre, sepse Xhenneti dhe Zjarri kanë të bëjnë me Botën Tjetër dhe jo me këtë botë!

Më lart kemi thënë se asgjësimi e zhdukja e qenieve nuk është e kushtëzuar me asgjësimin e kësaj bote. Kjo botë qysh tani është e zhdukur dhe e asgjësuar, sepse nuk zotëron asgjë nga vetja e saj. Çdo gjë që është në të, nuk është prej saj, por prej All'llahut dhe, meqenëse bota është e ndryshueshme dhe në lëvizje të përhershme, kjo do të thotë asgjësim e zhdukje graduale, e përbërë prej ekzistencës dhe mosekzistencës.

Me shpjegimet e mësipërme del qartë edhe përgjigjja për pyetjet përkatëse.

2- Interpretim i devijuar i frazës së ajetit: “Dhe mos adhuro së bashku me All’llahun ndonjë zot tjetër”

Disa interpretues kanë arritur në një përfundim të veçantë dhe kanë thënë se në disa raste, çështja e “ndërmjetësimit” (*shefâ’at*) nuk është në përputhje me të vërtetën e Njësimit të All’llahut (*Teuhidit*). Si argument, ata marrin ajetin që është objekt studimi dhe ajete të tjera të ngjashme të Kur’anit.

Ata thonë se Kur’ani është shprehur qartë se ndalohet adhurimi i ndonjë zoti tjetër përveç All’llahut. Gjithashtu, ata pretendojnë se Kur’ani e ndalon që ne t’i lutemi Zotit me emra të tjerë përveç emrit “All’llah”, ashtu siç thuhet në ajetin 18 të sures “El Xhinn”: “**dhe mos adhuro krahas All’llahut ndonjë tjetër.**”.

Qëllimi në këto ajete nuk është që ne të thërrasim për ndihmë, ose t’u lutemi personave të tjerë. Jo, qëllimi është kuptimi që del prej frazës së shkurtër të ajetit “**krahas All’llahut**”; pra, kush beson se përveç All’llahut gjendet edhe dikush tjetër, prej të cilit mund të kërkohet dhe kërkuesi ose adhuruesi mendon se i adhuruari i tij është i pavarur në realizimin e kërkesës, ai njeri është idhujtar; ai është prej atyre që i vënë shok All’llahut.

Ne besojmë se të gjitha fuqitë janë të veçanta vetëm për All’llahun dhe nuk besojmë se krahas Tij ekziston edhe dikush tjetër që është fillues në këtë krijim. Gjithashtu, ne besojmë se në Ditën e Gjykimit, njerëzit e zgjedhur prej All’llahut (Profetët), me lejen dhe me urdhrin e Tij, do të ndërmjetësojnë për ne tek Ai. Ky është Njësimi i All’llahut dhe për këtë Njësimit (Teuhid) tregojnë disa herë me radhë ajetet e Kur’anit.

Vallë, a është idhujtari (*shirk*), fjala që vëllezërit e Jusufit i thanë babait të tyre, që ai të kërkonte prej All’llahut faljen e

mëkatit për djemtë e tij? Për këtë çështje, ajeti i nderuar njofton:
“O baba, lutju All’llahut të na falë mëkatet tona!”.¹

Mos vallë është e tillë edhe fjala e Kur’anit në ajetin 64 të sures “En Nisà”: **“Sikur ata që i kishin bërë padrejtësi vetes së tyre, të vinin te ti dhe ata vetë t’i kërkonin All’llahut faljen e mëkateve; gjithashtu, edhe i Dërguari të kërkonte për ata faljen e mëkateve, patjetër do të kuptonin se vetëm All’llahu është Pranues i pendimit dhe Mëshirëploti.”**?!
 E vërteta e ndërmjetësimit (*shefâ’at*) nuk ka kuptim tjetër përveç atij që kemi shpjeguar më lart.²

O Zoti ynë, frymëzo në zemrat tona dritën e Njeshmërisë dhe të njohjes Tënde! Bëj që ne të mendojmë vetëm për Ty dhe jo për ndonjë tjetër, të kërkojmë vetëm prej Teje dhe jo prej ndonjë tjetri dhe të shpresojmë vetëm prej Teje dhe jo prej ndonjë tjetri.

O Zoti ynë, forcoje lidhjen e zemrave tona me madhërinë Tënde ditë pas dite dhe bëji shpirtrat tanë të kenë pjesë prej pishtarit të përjetësisë Tënde.

*O Zoti ynë, largoje prej shpirtrave tanë dashurinë për këtë botë e dëshirën për supremaci dhe për të bërë ngatërresa e shkatërrime në tokë. Na bëj prej të devotshmëve dhe na e mundëso që edhe përfundimi ynë të jetë ashtu siç thuhet në premtimin Tënd për të devotshmit: **“dhe përfundimi i mirë u takon të devotshmëve”**.*

¹ Sure “Jusuf”, ajeti 97.

² Për shpjegime më të zgjeruara, referohu në këtë tefsir në ajetin 35 të sures “El Mâide” dhe në fundin e ajetit 48 të sures “El Bekare”.

Surja “Ankebut”

E zbritur në Mekë, 69 ajete

Përmbajtja e sures

Është e njohur në mesin e studiuesve dhe të komentuesve se të gjitha ajetet e kësaj sureje kanë zbritur në Mekë. Për këtë, përmbajtja e kësaj sureje është në përputhje me përmbajtjen e sureve të zbritura në Mekë, sepse në to ka ajete që flasin për fillimin e krijimit dhe për Ringjalljen, për misionin e Profetëve të shkuar madhështorë dhe për qëndrimin e tyre përballë politeistëve dhe idhujtarëve, të padrejtëve dhe tiranëve. Surja “Ankebut” flet për triumfin e Profetëve dhe mposhtjen e të padrejtëve. Gjithashtu, kjo sure flet për thirrjen në të vërtetën, për sprovat e All’llahut ndaj njerëzve dhe për justifikimet e ndryshme të jobesimtarëve.

Mirëpo, një grup komentuesish thonë se njëmbëdhjetë ajetet e para të kësaj sureje kanë zbritur në Medine. Ka mundësi, ashtu siç do ta shohim më poshtë, që shkakut i këtij mendimi është se disa ajete kanë zbritur për xhihadin dhe për gjendjen e dyfytirakëve, gjë që është në përputhje me suret që kanë zbritur në Medine.

Pas kësaj, do të shohim se këto çështje nuk e mohojnë të qenit e sures mekase.

Emërtimi i kësaj sureje me emrin “Ankebut” është marrë nga ajeti 41 i saj, i cili i ngjason idhujtarët, që nuk e adhurojnë All’llahun, me merimangën (Ankebut-in), e cila e ndërton vendbanimin e saj me fijet e veta dhe ky është vendbanimi më i dobët.

Përgjithësisht, mund të thuhet se hulumtimet e kësaj sureje përmbledhen në katër pjesë:

Pjesa parë: Kjo pjesë flet për sprovën e All'llahut dhe për çështjen e dyfytyrakëve. Të dyja këto çështje janë të pandashme, sepse dyfytyrakët mund të njihen vetëm nëpërmjet sprovave.

Pjesa e dytë: Në të vërtetë, kjo pjesë është ngushëllim për zemrën e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe të besimarëve të parë, që ishin të pakët. Kjo pjesë paraqet disa anë nga jeta e Profetëve të mëparshëm si, Nuhu, Ibrahim, Luti, Shuajbi (*Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!*) dhe fundin e tyre, të cilët u përballën me armiqtë më të ashpër e më tiranë, më të padrejtë dhe kopracë, siç ishte Nemrudi etj. Kjo pjesë e sures sqaron mënyrën e përgatitjes, përballjes dhe fundin triumfues të besimtarëve. E gjitha kjo, me qëllim forcimin e zemrave të besimtarëve që ishin me Profetin në fillim të Shpalljes. Po ashtu, këto ajete përmbajnë edhe tërheqje vëmendjeje për politeistët, idhujtarët dhe të padrejtët e kohës së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), zemrat e të cilëve ishin si guri.

Pjesa e tretë: Kjo pjesë e kësaj sureje, veçanërisht në fund të sures, flet për monoteizmin, për argumentet e pranisë së All'llahut dhe për përballjen me idhujtarët. Kjo pjesë, e cila është nga fundi i sures, fton natyrën e krijuar (el fitretu) të njeriut dhe ndërgjegjen e tij që të gjykojnë drejtë.

Pjesa e katërt: Kjo pjesë ka hulumtime të ndryshme rreth paaftësisë së idhujve që adhurohen në vend të All'llahut, paaftësia e adhuruesve të idhujve, të cilët janë si merimanga. Gjithashtu, ajo

sqaron madhështinë e Kur'anit, ka fakte të vërtetësisë së Profetit Islam dhe tregon kundërshtimin e kokëfortëve. Po ashtu, kjo pjesë paraqet disa çështje edukative si, falja e namazit, kryerja e punëve të mira, nderimi i prindërve, mënyra e diskutimit me kundërshtarët etj.

Mirësia e kësaj sureje

Në tefsirin “Mexhmaul Bejan” është transmetuar një thënie nga Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për mirësitë e kësaj sureje. Në të thuhet: “*Ai që e lexon suren “Ankebut”, do të shpërblehet me dhjetë të mira me numrin e besimtarëve dhe hipokritëve.*”¹

Leximi i sures “Ankebut” dhe i sures “Rrum” në muajin e Ramazanit, veçanërisht në natën e njëzet e tretë të këtij muaji, ka mirësi të mëdha. Në një hadith të Imam Sadikut thuhet: “*Betohem në All'llahun, se kush e lexon suren “Ankebut” dhe suren “Rum” në natën e njëzet e tretë të muajit të Ramazanit, është prej banorëve të Xhennetit! Vërtet, këto dy sure kanë pozitë të lartë tek All'llahu.*”²

S'ka dyshim se përmbajtja e këtyre dy sureve është mjaft e pasur me mësim praktikë. Prej tyre është monoteizmi, i cili është i mjaftueshëm për çdo mendimtar, logjikues dhe arsyetues, që ta drejtojë kah puna e mirë që të çon në Xhennetin e përhershëm.

Nëse frymëzohemi prej fillimit të kësaj sureje dhe marrim këshillë, mund të jemi pjesë e betimit të Imam Sadikut (*Paqja qoftë*

¹ Tefsiri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 8, f. 271, sipas komentimit “Nuruth Thekalejn”, vëll. 4, f. 147.

² Theuabul A'mal, sipas tefsirit “Nuruth Thekalejn”, vëll. 4, f. 147. Duhet përmendur se ne po e shkruajmë këtë pjesë të komentimit në fillim të natës së 23-të të muajit të Ramazanit, viti 1403 i Hixhrit.

mbi të!). Ajetet që flasin për sprovën e përgjithshme të të gjithë njerëzve, u çjerrin maskën gënjeshtarëve dhe mashtruesve.

Si ka mundësi që njeriu ta dëshmojë këtë provim dhe të mos përgatitet për të? E pse të mos jetë prej të devotshmëve?

Ajetet: 1 - 3

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

اَلَمْ اَحْسِبِ النَّاسَ اَنْ يُّتْرَكُوْا اَنْ يَقُوْلُوْا ءَامَنَّا وَهُمْ لَا يُفْتَنُوْنَ ﴿١﴾ وَلَقَدْ فَتَنَّا الَّذِيْنَ مِنْ قَبْلِهِمْ فَلَيَعْلَمَنَّ اللّٰهُ الَّذِيْنَ صَدَقُوْا وَلَيَعْلَمَنَّ الْكٰذِبِيْنَ ﴿٢﴾

Me emrin e All'Ilahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"Elif, Lâm, Mîm."

"Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lihen të thonë 'Ne besojmë', pa u vënë në provë?!"

"Ne i kemi sprovuar ata që kanë qenë para tyre, në mënyrë që, All'Ilahu t'i dallojë ata që thonë të vërtetën dhe ata që gënjejnë."

Shkaku i zbritjes

Sipas thënies së disa komentuesve, njëmbëdhjetë ajetet e para të sures "Ankebut" kanë zbritur në Medine për myslimanët në Mekë dhe që nuk dëshironin të emigronin. Ata morën letër prej

vëllezërve të vet në Medine, ku thuhej: “Vërtet, All’llahu nuk e pranon dëshminë e besimit tuaj derisa të emigroni në Medine.”. Atëherë, ata vendosën të emigronin dhe dolën nga Meka. Ata i ndoqi një grup politeistësh mekas dhe i luftuan. Disa u vranë e disa u plagosën. (Ndoshta disa u dorëzuan dhe u kthyen në Mekë.)

Disa komentues të tjerë thonë: “Ajeti i dytë i kësaj sureje ka zbritur për Ammar ibn Jasir dhe për një grup myslimanësh të parë, të cilët i besuan Mesazhit të Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe provuan lloje të ndryshme torturash prej armiqve.

Kurse disa të tjerë, kanë thënë: “Ajeti i tetë ka zbritur për pranimin e Islamit nga Sa’ad ibn ebi Uekkas.”.

Mirëpo, të menduarit e thellë në ajete zbulon se nuk ka argument që i lidh këto ajete me emigrimin e atyre personave. Ajetet sqarojnë presionet e armiqve mbi besimtarët në atë kohë. Ka patur raste që besimtarëve u bënë presion si nënat, ashtu edhe baballarët e tyre idhujtarë.

Këto ajete i nxisin myslimanët që të jenë të palëkundshëm dhe të fortë përballë dallgëve të presioneve të armikut. Kur në to përmendet edhe xhihadi, kuptimi i tij është që të jenë të durueshëm në sakrifica. Nuk është kuptimi për xhihad ushtarak, sepse xhihadi i armatosur është ligjërur në Medine.

Kur në këto ajete flitet për hipokritët, ka mundësi të tregojnë për myslimanët me besim të dobët, sepse në Mekë, herë shiheshin me myslimanët dhe herë shiheshin me politeistët. Pra, nuk ishin të prerë në qëndrime.

Sido që të jetë, lidhja mes ajeteve dhe përputhshmëria e tyre, bëjnë që kjo sure të jetë e tëra mekase. Hadithet e mëparshëm, të cilët kundërshtojnë njëri-tjetrin, nuk mund ta këpusin lidhjen mes ajeteve.

Komentimi

Sprovat e All'Ilahut janë ligj i përjetshëm

Në fillim të kësaj sureje hasim gërma të veçuara **“Elif, Lam, Mim.”**. Komentimin e tyre e kemi sqaruar disa herë dhe në forma të ndryshme.¹

Pas këtyre gërmave, Kur'ani tregon një prej çështjeve më të rëndësishme të jetës së njeriut. Ajo është ashpërsia, presionet dhe provimi i All'Ilahut.

Së pari, Kur'ani thotë: **“Vërtet mendojnë njerëzit se do të lihen të thonë ‘Ne besojmë’, pa u vënë në provë?!”**.²

Pastaj, Kur'ani thotë se ky provim nuk është vetëm për ju, o myslimanë. Ai është ligj i vazhdueshëm për të gjithë popujt. All'Ilahu thotë: **“Ne i kemi sprovuar ata që kanë qenë para**

¹ Shih fillimin e komentimit të sures “Bekare”, fillimin e sures “Ali Imran” dhe fillimin e komentimit të sures “A’raf”.

² Fjala “*juftunune*” vjen nga fjala “*el fitnetu*”, që në origjinalitet ka kuptimin e vendosjes së floririt në zjarr për të njohur sasinë e pastërtisë së tij. Më pas është përdorur për çdo provim të dukshëm dhe atë shpirtëror. Për sqarime të mëtejshme, shiko komentimin e ajetit 193 të sures “El Bekare”.

tyre...". Pra, i sprovuam me provime të ashpra. Edhe ata u përballën me presione nga armiqtë, nga të padrejtët dhe nga të paditurit kokëfortë. Fusha e provimit ka qenë gjithmonë e hapur dhe në të kanë marrë pjesë grupe të shumtë njerëzish.

Ky provim duhet patjetër, sepse kushdo mund të pretendojë se është më i miri, më fisniku, më sakrifikuesi dhe më besimtari. Prandaj, duhet që këto pretendime të njihen me anë të provimit. Duhet patjetër që të njihen vlerat e këtyre pretendimeve me provim. Duhet të njihet se sa janë qëllimet dhe të fshehtat në përputhje me këto pretendime. Sigurisht, provimi bëhet: **"...në mënyrë që, All'llahu t'i dallojë ata, që thonë të vërtetën dhe ata që gënjejnë."**

Është e natyrshme se All'llahu është i Ditur për të gjitha këto gjëra. Kuptimi i dijes në ajet është që dija e All'llahut të njihet nga të gjithë. Pra, duhet që dija e All'llahut të shihet në praktikë nga njeriu dhe ai t'i zbulojë të fshehtat e vetvetes.

Argumenti për këtë çështje është i qartë, sepse për qëllimet dhe veçoritë e brendshme, nëse nuk praktikohen në veprat e njeriut, nuk ka kuptim as shpërblimi dhe as ndëshkimi. Me fjalë të tjera: kjo botë i ngjan një "shkolle" apo një "are". Këto shembëllesime i gjejmë edhe në tekstet e haditheve islame.

Duhet që farat në këtë shkollë të rriten dhe të zhvillohen, të mbijnë të shëndosha e të bëhen pemë të vogla, e më pas, të bëhen pemë të mëdha me rrënjë të forta, me degë të fuqishme dhe prodhuese. Frytet e mira nuk arrihen vetëm me sprovim. Nga këtu kuptojmë se provimi i All'llahut nuk është për të njohur

personin, por ka për qëllim edukimin e aftësive, që ato të rriten në formën më të përkryer.

Për këtë, sikur të duam të provojmë diçka, e bëjmë që të zbulojmë të panjohurën. Por provimi i All'llahut nuk është për të zbuluar të panjohurën, sepse Ai është i Gjithëditur për çdo gjë. Provimi i All'llahut është për të edukuar aftësitë dhe për të përkthyer “fuqinë” në “veprim.”.¹

Hulumtime

Sprovat në forma të ndryshme

Sqarimi i sprovave ndaj popujve dhe kombeve kishte ndikim të madh te besimtarët mekas, të cilët përbënin pakicën në atë kohë. Kjo e vërtetë ishte shkak i përballjes së tyre me durim dhe vendosmëri para armikut. Mirëpo, kjo e vërtetë nuk ishte e kufizuar vetëm për besimtarët mekas, sepse çdo grup ka pjesën e vet në këtë ligj të All'llahut (sprova). Këto sprova të All'llahut vijnë në forma të ndryshme.

Ai grup që jeton në një ambient të infektuar me shthurje dhe me vese, ka provë të madhe në këtë situatë. Kjo provë

¹ Për sqarime të mëtejshme rreth çështjes së sprovimit të All'llahut dhe llojeve të tij të ndryshme, shiko komentimin e jetit 157 të sures “El Bekare” në xhuzin e parë.

është që ata të mos ndikohen prej ngjyrave të ambientit dhe ta mbrojnë origjinën dhe pastërtinë e tyre.

Ai grup që jeton nën presionin e varfërisë e të skamjes, e që mendon se po të heqë dorë nga kapitali bazë, që është besimi, shumë shpejt do të shpëtojë prej varfërisë dhe skamjes. Por çmimi i kësaj është humbja e besimit, e nderit, e lirisë dhe e devotshmërisë. Këtu fshihet sprova e tyre.

Një grup tjetër, janë e kundërta e grupit të varfër. Ata i kanë të gjitha mundësitë materiale. Vallë, a e kryejnë detyrën e falënderimit për këto mirësi apo do të qëndrojnë të zhytur në mirësi, në pavëmendshmëri (gaflet) e vetëpëlqim, të zhytur në llumin e epsheve dhe në distancimin e shoqërisë prej tyre?!

Fatkeqësitë, problemet, konfliktet, luftrat, shtrenjtësitë, thatësia e të tjera dallë problemesh psikologjike dhe sociale, janë sprova për njerëzit, me qëllim që të njihet personaliteti i tyre dhe të dallohen besimi, devotshmëria, pastëritia, liria etj.

Por nuk ka rrugë tjetër triumfi ndaj këtyre sprovave, veçse me përpjekjen e vazhdueshme dhe mbështetjen në mirësinë dhe në mëshirën e All'Ilahut të Madhëruar.

Në një hadith të transmetuar në librin *"Usulul Kafij"* rreth komentimit të ajetit: **"Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lihen të thonë 'Ne besojmë', pa u vënë në provë?!"** thuhet: *"Të sprovohen ashtu si sprovohet floriri! Pastaj tha: 'Të pastrohen ashtu siç pastrohet floriri!'"*.¹

¹ *"Usulul Kafij"*, vëll. 1, f. 370, sipas transmetimit në tefsirin *"Nuruth Thekalejn"*, vëll. 4, f. 148.

Sigurisht, gabojnë rëndë kërkuesit e shpëtimit, të cilët mendojnë se shfaqja e besimit mjafton që të jenë në një rresht me besimtarët dhe në pozitë të lartë në Xhennet me Profetët, punëmirët dhe dëshmorët.

Sipas një thënieje të prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) transmetohet: *“Për Atë Zot, që dërgoi Profetin me besimin e të Vërtetën! Ju do shembeni me tërsëllimë, do të shkundeni fort, si në sitë dhe do trazoheni nga i pari tek i fundit, siç trazohet me lugë nëpër kazanët e gatimit, deri sa më të fundmit e më të ndyrët tuaj, të dalin në krye, e ata të kreut të bien në fund; deri sa ata që ishin prapa,¹ të arrijnë vendet e përparme, e ata që ishin përpara,² të dalin në vendet e prapme.”.*³

Këto fjalë Prijësi i Besimtarëve (*Paqja qoftë mbi të!*) i ka thënë në fillim të besëdhënies së njerëzve. Ata prisnin se çfarë do të bënte me thesarmbajtësen: a do t'i ndante sipas pozitës dhe postit dhe do të bënte dallim, ku më shumë t'i jepte atij me pozitë të lartë dhe më pak të tjerëve, siç veprohej më parë? Apo do të zbatonte drejtësinë e Profetit Muhammed?

¹ Fjala është për hipokritët, që në kohën e ardhjes e të ngritjes së Islamit kishin mbetur prapa të tjerëve, duke pritur në hije shembjen e tij.

² Njerëzit, që gjatë asaj periudhe kishin patur arritje dhe merita të mëdha në përhapjen dhe mbrojtjen e fesë.

³ Nehxhul Belaga, fjalimi 16.

Ajetet: 4 - 7

أَمْ حَسِبَ الَّذِينَ يَعْمَلُونَ السَّيِّئَاتِ أَنْ يَسْبِقُونَا سَاءَ مَا يَحْكُمُونَ ﴿٤﴾ مَنْ كَانَ
يَرْجُوا لِقَاءَ اللَّهِ فَإِنَّ أَجَلَ اللَّهِ لَآتٍ وَهُوَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ ﴿٥﴾ وَمَنْ جَاهِدَ فَإِنَّمَا
يُجَاهِدُ لِنَفْسِهِ إِنَّ اللَّهَ لَغَنِيٌّ عَنِ الْعَالَمِينَ ﴿٦﴾ وَالَّذِينَ ءَامَنُوا وَعَمِلُوا
الصَّالِحَاتِ لَنُكَفِّرَنَّ عَنْهُمْ سَيِّئَاتِهِمْ وَلَنَجْزِيَنَّهُمْ أَحْسَنَ
الَّذِي كَانُوا
يَعْمَلُونَ ﴿٧﴾

“A mos mendojnë ata që bëjnë vepra të këqija, se do t’i shpëtojnë dënimit Tonë?! Sa keq që gjykojnë ata!”

“Kush shpreson takimin e All’llahut, ta dijë se Dita e caktuar nga Ai do të arrijë. Ai dëgjon dhe di gjithçka.”

“Kush përpiqet, përpiqet vetëm për të mirën e vetvetes, se All’llahu, në të vërtetë nuk ka nevojë për asgjë.”

“Atyre, që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, me siguri që do t’ua shlyejmë të këqijat dhe do t’u japim shpërblim më të mirë se puna që kanë bërë.”

Komentimi

Ajetet e mëparshme flisnin për provimin dhe sprovën e përgjithshme të besimtarëve. Ajeti i parë, prej ajeteve në fjalë, është kërcënim i ashpër për jobesimtarët dhe gjynahqarët që të mos mendojnë se kur i bëjnë keq besimtarëve, All'llahu nuk do t'i dënojë. As të mos mendojnë se All'llahu është i pavëmendshëm apo i paaftë për t'i ndëshkuar ata. Ajeti thotë: **“A mos mendojnë ata që bëjnë vepra të këqija, se do t'i shpëtojnë dënimit Tonë?! Sa keq që gjykojnë ata!”**.

Ata nuk duhet t'i mashtrojë mosdënimi i All'llahut, sepse kjo është sprovë për ta. Po ashtu, është momenti për pendim dhe kthim tek All'llahu i Plotfuqishëm.

Ajo që thonë disa komentues se ky ajet tregon për besimtarët gjynahqarë, nuk përputhet fare me përmbajtjen e ajetit. Përkundrazi, të gjitha argumentet tregojnë se qëllimi në ajet është për idhujtarët dhe jobesimtarët.

Më pas, Kur'ani flet përsëri për sjelljen e besimtarëve dhe i këshillon ata duke u thënë: **“Kush shpreson takimin e All'llahut...”**, ai duhet të veprojë, aq sa mundet, për të zbatuar urdhrat e All'llahut, ligjet dhe rregullat e Tij, sepse koha e caktuar për të dalë para All'llahut do të vijë: **“...ta dijë se Dita e caktuar nga Ai do të arrijë...”**.¹

¹ Në të vërtetë, kjo fjali ka mosprani fraze dhe aludimi është: Ai që shpreson takimin me All'llahun, të thotë: *unë besova në All'llahun*, dhe të jetë i vendosur dhe i duruar në rrugën e Tij, sepse koha e caktuar nga All'llahu do të vijë.

Sigurisht, premtimi i All'Ilahut është i vërtetë dhe Ai nuk e shkel premtimin. Rruga për tek All'Ilahu është e patjetërsueshme. Ai e dëgjon bisedën tuaj. Ai është i Gjithëditur për punët tuaja dhe për qëllimet tuaja. Kjo sepse: **“Ai dëgjon dhe di gjithçka.”**.

Çfarë kuptimi ka thënia “Takimi me All'Ilahun?”

Disa komentues thonë se ka kuptimin e takimit me melekët. Disa të tjerë e kanë komentuar se ka kuptimin e takimit të llogarisë dhe shpërblimit. Disa të tjerë kanë thënë se ka kuptimin e takimit të rregullit dhe të çështjes së vërtetë. Disa kanë thënë se ka kuptim metaforik për Ditën e Kiametit. Ndërkohë që s'ka argument që këto ajete të komentohen me kuptim metaforik.

Duhet thënë se thënia *“likaullah”* – *“takimi i All'Ilahut”* në Ditën e Kiametit, nuk është takim i dukshëm, por është një lloj takimi prej shikimit të brendshëm. Sepse perdet e mëdha të botës materiale do të hiqen prej syve të shpirtit të njeriut dhe do të duket si gjendje vegimi shpirtëror për të!

Eruditi Tabatabai, në tefsijrin *“El Mijzan”*, thotë: *“Kuptimi i thënies ‘likaullah’ është se robtë do të jenë në një gjendje, ku nuk do të ketë perde mes tyre dhe All'Ilahut, sepse natyra e Ditës së Kiametit është shfaqja e të vërtetave, siç thotë All'Ilahu i Madhëruar në suren ‘Nur’, ajeti 25: ‘...dhe ata do ta marrin vesh se All'Ilahu është e Vërteta e qartë.’”*¹

¹ Këtë temë e kemi trajtuar në komentimin e ajetit 46 të sures *“El Bekare”*, në xhuzin e parë të këtij komentimi.

Kurse ajeti i mëposhtëm, në të vërtetë, është shpjegim për ato hulumtime që u thanë më parë në ajetin paraardhës se: Duhet që besimtarët, të cilët dëshirojnë takimin me All'llahun, të përpiqen me të gjitha mundësitë dhe aftësitë e dhëna për realizimin e kësaj dëshire, sepse rezultati i të gjitha atyre përpjekjeve dhe mundimeve, si dhe frytet e durimit, do t'i kthehen po sakrifikuesit dhe përpjekësit: **"Kush përpiket, përpiket vetëm për të mirën e vetvetes, se All'llahu, në të vërtetë nuk ka nevojë për asgjë."**

Vërtet, qëllimi i provimit të All'llahut është lufta me vetveten, lufta me armiqtë e përbetuar, ruajtja e besimit, e devotshmërisë dhe e pastërtisë. Të gjitha këto dobi janë për njeriun, sepse All'llahu nuk ka nevojë për askënd dhe për asgjë. Ai nuk ka nevojë për adhurimin e njerëzve. Çdo gjë që ata kanë, janë prej mirësive të All'llahut dhe asgjë nuk kanë nga vetja e tyre.

Këtu sqarohet se xhihadi ndaj armikut nuk duhet të jetë vetëm me armë, por ai ka kuptimin e çdo përpjekjeje dhe sakrifice për të përballuar problemet dhe fatkeqësitë, për të ruajtur besimin dhe përkushtimin dhe për të sfiduar armiqtë e përbetuar e smirakë.

Përmbledhje: Të gjitha dobitë e këtij xhihadi (përpjekjeje) i kthehen po njeriut përpjekës. Ai është fituesi i të mirave të kësaj jete dhe të Jetës Tjetër me anë të përpjekjeve të tij. Kur shoqëria përfiton prej përpjekjeve të tij, atëherë ai fiton akoma më shumë mirësi.

Për këtë, sa herë që njeriu mbarësohet në përpjekje dhe merr pjesën që i takon, duhet ta falënderojë All'llahun për atë mirësi.

Ajeti i fundit, prej ajeteve në fjalë, është sqarues për ato që përmendën ajetet e mëparshme. Këtu, Kur'ani zbulon të vërtetën e xhihadit, ku thotë: **“Atyre, që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, me siguri që do t’ua shlyejmë të këqijat dhe do t’u japim shpërblim më të mirë se puna që kanë bërë.”**.

Pra, dobia e madhe e kësaj përpjekjeje (besimi dhe puna e mirë) është falja e gjynaheve dhe mosshfaqja e tyre para të tjerëve. Po ashtu, edhe shpërblimi do të jetë pjesë e tyre, siç thotë edhe Kur'ani në fund të këtij ajeti: **“...dhe do t’u japim shpërblim më të mirë se puna që kanë bërë.”**.

Fjala *“nukeffiru”* vjen nga rrënja *“tekfijr”*, që në origjinalitet do të thotë *mbulim*. Kuptimi i saj në këtë ajet është mbulimi i gjynaheve dhe falja e All'Ilahut.

Ajeti thotë: **“...më të mirë se puna që kanë bërë.”**. Edhe pse All'Ilahu i shpërblen të gjitha punët e mira, kjo thënie mund të tregojë se Ne i shpërblejmë të gjitha punët e mira me shpërblimin më të mirë. Nëse disa punë janë të mira dhe disa janë më të mira, Ne i shpërblejmë me shpërblimin më të mirë.

Në Kur'an ka ajete të tjera që flasin për këtë temë, siç është edhe ajeti 38 i sures “Nur”: **“(Këta shpresojnë) që All'Ilahu t'i shpërblejë sipas veprave më të mira që kanë bërë e t'ua shtojë dhuntinë e Tij. All'Ilahu i jep kujt të dojë, pa llogari.”**.

Ajetet: 8 - 9

وَوَصَّيْنَا الْإِنْسَانَ بِوَالِدَيْهِ حُسْنًا وَإِنْ جَاهَدَاكَ لِتُشْرِكَ بِي مَا لَيْسَ لَكَ بِهِ عِلْمٌ
فَلَا تُطِعْهُمَا إِلَىٰ مَرْجِعِكَمْ فَأُنَبِّئُكُمْ بِمَا كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ ﴿٨﴾ وَالَّذِينَ ءَامَنُوا
وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ لَنُدْخِلَنَّهُمْ فِي الصَّالِحِينَ ﴿٩﴾

“Ne e kemi urdhëruar njeriun që të sillet mirë me prindërit e vet dhe: ‘Nëse ata të nxisin ty që të më shoqërosh Mua (në adhurim) atë, për të cilin ti nuk di asgjë, atëherë mos i dëgjo ata! Tek Unë do të ktheheni të gjithë e do t’ju lajmëroj për gjithçka që keni bërë.’”

“Ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, me siguri do t’i radhisim në mesin e të mirëve.”

Shkaku i zbritjes

Ka transmetime të ndryshme që flasin për shkakun e zbritjes së këtij ajeti. Por, përmbajtja e këtyre transmetimeve është e njëjtë, ku tregohet se disa burra në Mekë e pranuan Islamin.¹ Kur nënat e tyre e dëgjuan këtë gjë, vendosën që të mos hanin e të

¹ Në disa transmetime përmendet emri i Sa’ad ibn ebi Uekas dhe në disa të tjera, emri i Ajash ibn ebi Rabiati el Mekhzumij.

mos pinin, derisa fëmijët e tyre ta linin Islamin. Edhe pse ato nëna nuk e zbatuan thënien e tyre dhe e braktisën grevën e urisë, ajeti i lartpërmendur zbriti që t'u sqaronte të gjithëve metodën e bashkëpunimit mes fëmijëve dhe prindërve, qofshin besimtarë a jobesimtarë.

Komentimi

Porosia më e përkryer për prindërit

Një prej provimeve më të rëndësishme të All'llahut është çështja e kundërvënies (et tedhadu) mes vijës së besimit e devotshmërisë dhe marrëdhënieve emocionale e afërsisë me të afërmit. Në këtë vend, Kur'ani ua sqaron shumë qartë myslimanëve detyrën e tyre.

Në fillim, Kur'ani flet për ligjin e përgjithshëm që i ka rrënjët tek emocionet njerëzore dhe humanizmi: **"Ne e kemi urdhëruar njeriun që të sillet mirë me prindërit e vet..."**. Edhe pse ky është ligj i All'llahut, kjo çështje para se të jetë detyrë Sheriati, është çështje e natyrës së pastër njerëzore (el fitratu). Ajo që tërheq vëmendjen në këtë ajet është prania e fjalës *"el insan"* (njeri). Kjo do të thotë se ky rregull nuk është i posaçëm për besimtarët, por duhet që çdo njeri t'i dijë të drejtat ndaj prindërve të tij. Nuk duhet ta harrojë kurrë respektin, nderimin e tyre, edhe nëse ata nuk i zbatojnë të drejta e tyre ndaj tij.

Pas kësaj, me qëllim që të mos mendohet se marrëdhëniet me prindërit mund të jenë mbi marrëdhëniet e njeriut me

All'Ilahun dhe me besimin e Tij, vjen një përveçësim i qartë në këtë ajet që thotë: **“...dhe: ‘Nëse ata të nxisin ty që të më shoqërosh Mua (në adhurim) atë, për të cilin ti nuk di asgjë, atëherë mos i dëgjo ata!’”**.

Fjala *“xhahedake”* ka kuptimin e përpjekjeve të shumta të prindërve dhe këmbënguljes së tyre për ta shkëputur fëmijën nga besimi në All'Ilahun.

Fraza **“për të cilin ti nuk di asgjë”** tregon se idhujtaria (*shirku*) nuk është e logjikshme, sepse po të ishte e drejtë dhe e saktë, do të kishte argument të qartë për të. Thënë ndryshe: Në qoftë se njeriu nuk e njeh diçka, nuk duhet ta pasojë. Si mund ta pasojë diçka që e di se është e kotë dhe e pavlerë? Ky pasim është pasim i mbështetur në padije: Sikur prindërit të të urdhërojnë për të ndjekur të paditurën, mos iu bind atyre! Sigurisht, imitimi i verbër është i gabuar, qoftë edhe në besim. Si do të jetë gjendja kur imitimi është në mosbesim dhe idhujtari?!

Porosia për mirësjellje ndaj prindërve përmendet, gjithashtu, edhe në suren *“Lukman”*, ku thuhet: **“...por sillu mirë me ata në këtë jetë...”**.¹

Megjithë refuzimin e ftesës së tyre për t'i vënë ortak All'Ilahun, duhet që t'i respektosh, t'i nderosh dhe t'u bësh mirë prindërve. Askush të mos mendojë se kur prindërit nuk pajtohen me fëmijët, siç mund të jetë rasti i ftesës për t'i vënë shok All'Ilahun, kjo nuk është argument për keqtrajtimin e tyre.

Islami urdhëron për respekt ndaj prindërve. Kështu, nëpërmjet këtij rregulli bazë përfitohet që: asgjë nuk mund të jetë

¹ Sure *“Lukman”*, ajeti 15.

shkak i shkëputjes (largimit) së marrëdhënieve të njeriut me All'llahun, sepse marrëdhëniet me All'llahun janë mbi të gjitha, deri edhe mbi marrëdhëniet prind-fëmijë, të cilat janë marrëdhëniet më të afërta. Në një transmetim të njohur nga prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), thuhet: *“Nuk ka përulje ndaj krijesës kur në atë përulje i bëhet gjynah Krijuesit.”*. Kjo thënie na jep të kuptojmë kriterin bazë të çështjes së mësipërme.¹

Në fund të ajetit thuhet: **“Tek Unë do të ktheheni të gjithë e do t’ju lajmëroj për gjithçka që keni bërë.”**. Në të vërtetë, kjo fjali është kërcënim për ata që ecin në rrugën e idhujtarisë e të politeizmit dhe për ata që i ftojnë të tjerët në këtë rrugë. Sepse thënia qartëson se All'llahu i sheh punët dhe veprat tuaja, i ruan ato, e pastaj ua kthen juve në Ditën e Ringjalljes e të Llogarisë.

Ajeti në vijim përforcon të vërtetën e besimtarëve punëmirë dhe e përsërit këtë përmbajtje: **“Ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, me siguri do t’i radhisim në mesin e të mirëve.”**. Sigurisht, puna e njeriut lë ndikim tek ai. Puna e mirë e ngjyros njeriun me ngjyrën e saj dhe e bashkon vepruesin e saj me punëmirët. Po ashtu, edhe puna e keqe e bashkon njeriun me punëkeqët dhe të gabuarit.

¹ “Nehxhul Belaga”, *Thëniet e shkurtra*, thënia 165.

Vallë, cili është qëllimi i kësaj përsëritjeje?

Disa kanë thënë: Në ajetet e mëparshme flitej për ata që ndjekin rrugën e drejtë e të vërtetë. Kurse në këtë ajet flitet për ata që janë tregues dhe udhëzues në rrugën e monoteizmit, sepse thënia **“e të mirëve”** është përmendur për shumë të Dërguar, të cilët i kërkonin All'llahut që t'i bashkonte me të mirët.

Po ashtu, mendohet se ajetet e mëparshme flisnin për faljen e gjynaheve dhe për shpërblimin që meritojnë besimtarët. Mirëpo, këtu flitet për pozitën e lartë të tyre, e cila në vetvete është shpërblim i madh, sepse ata janë në radhët e të mirëve, të të sinqertëve, të dëshmorëve dhe të të vërtetëve në Xhennet.

Hulumtime

Mirësia ndaj prindërve

Nuk është hera e parë këtu, që Kur'ani flet për këtë çështje mjaft të rëndësishme njerëzore. Ai e përmend këtë edhe në suren “Isra”, ajeti 23, në suren “Lukman”, ajetet 14 dhe 15 dhe në suren “Ahkaf”, ajeti 15.

Vërtet, Islami fton në respektimin e prindërve dhe duhet që ai respekt të jetë në gradën më të lartë, edhe nëse ata janë jobesimtarë apo ftojnë në mosbesim, që është prej gjërave më të këqija sipas Islamit. Islami e ka bërë detyrë respektin e tyre dhe në

të njëjtën kohë e ka ndaluar përuljen ndaj tyre për t'iu përgjigjur thirrjes që ata bëjnë për shirk.

Sigurisht, kjo është një prej sprovave të mëdha nga ana e All'llahut, e cila përmendet në fillim të kësaj sureje. Kjo, sepse durimi i prindërve në moshë të thyer, ka raste që është i pakët. Këtu duhet që fëmijët ta kryejnë provimin e tyre për të qenë mirënjohës, të bindur ndaj urdhrit të All'llahut dhe të përkujdesen në mënyrën më të mirë për prindërit.

Në një thënie të Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) lexojmë se një burrë shkoi tek ai dhe i tha: “O i Dërguari i All'llahut! Kush e meriton më shumë respektin?” Profeti iu përgjigj: ‘Nëna jote.’ Pastaj i tha: ‘Po më pas?’ Profeti iu përgjigj: ‘Nëna jote.’ Përsëri e pyeti: ‘Po më pas?’ Profeti iu përgjigj: ‘Nëna jote.’ Përsëri e pyeti: ‘Po më pas?’ Profeti iu përgjigj: ‘Më i afërti.’¹

Në një thënie tjetër, që përmendet në shumë libra, Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Xhenneti ndodhet nën këmbët e nënave.”²

¹ Tefsiri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 8, f. 274. Fundi i ajeteve në fjalë.

² i njëjti burim.

Ajetet: 10 - 13

وَمِنَ النَّاسِ مَن يَقُولُ ءَامَنَّا بِاللَّهِ فَإِذَا أُوذِيَ فِي اللَّهِ جَعَلَ فِتْنَةً النَّاسِ
 كَعَذَابِ اللَّهِ وَلَئِن جَاءَ نَصْرٌ مِّن رَّبِّكَ لَيَقُولُنَّ إِنَّا كُنَّا مَعَكُمْ أَوْ لَيْسَ اللَّهُ
 بِأَعْلَمَ بِمَا فِي صُدُورِ الْعَالَمِينَ ﴿١٠﴾ وَلَيَعْلَمَنَّ اللَّهُ الَّذِينَ ءَامَنُوا وَلَيَعْلَمَنَّ
 الْمُنَافِقِينَ ﴿١١﴾ وَقَالَ الَّذِينَ كَفَرُوا لِلَّذِينَ ءَامَنُوا اتَّبِعُوا سَبِيلَنَا وَلْنَحْمِلْ
 خَطَايَكُمْ وَمَا هُم بِحَامِلِينَ مِنْ خَطَايَهُمْ مِّن شَيْءٍ إِنَّهُمْ لَكَاذِبُونَ ﴿١٢﴾
 وَلَيَحْمِلُنَّ أَثْقَالَهُمْ وَأَثْقَالًا مَّعَ أَثْقَالِهِمْ وَلَيُسْأَلُنَّ يَوْمَ الْقِيَمَةِ عَمَّا كَانُوا
 يَفْتَرُونَ ﴿١٣﴾

“Ka disa njerëz, që thonë: ‘Ne besojmë All’lahun’. Por kur vuajnë për çështjen e All’liahut, e quajnë pëndjekjen prej njeriut njëlloj si dënimin e All’liahut. Ndërsa, kur u vjen fitorja prej Zotit tënd, ata, me siguri - do të thonë: ‘Ne kemi qenë me ju’. Vallë! A nuk e di All’lahu më së miri se ç’ka në zemrat e çdokujt?”

“Sigurisht, All’lahu i njeh më mirë ata që kanë besuar dhe hipokritët.”

“Mohuesit u thonë besimtarëve: ‘Ndiqni rrugën tonë e ne atëherë do t’i mbartim gjynahet tuaja!’. Por ata nuk do të jenë në

gjendje të mbartin nga gjynahet e tyre. Në të vërtetë, ata janë gënjeshtarë.”

“Ata (mohuesit), do t’i mbartin barrët e veta e bashkë me to edhe barrë të tjera dhe patjetër, që do të pyeten Ditën e Kiametit për gjithçka që trillonin.”

Komentimi

Partnerë në triumf, jo në vështirësi

Ajetet e mëparshme folën qartë për besimtarët punëmirë dhe për jobesimtarët politeistë. Në ajetet e para të ajeteve në fjalë flitet për grupin e tretë, që janë hipokritët. Ajeti thotë: **“Ka disa njerëz, që thonë: ‘Ne besojmë All’llahun’. Por, kur vuajnë për çështjen e All’llahut, e quajnë pëndjekjen prej njeriut njësoj si dënimin e All’llahut...”**. Ata nuk janë të durueshëm ndaj të këqijave dhe vështirësive. Dënimin e politeistëve jobesimtarë dhe padrejtësitë e njerëzve ndaj tyre i llogarisin se janë dënim prej All’llahut: **“...ndërsa, kur u vjen fitorja prej Zotit tënd, ata, me siguri - do të thonë: ‘Ne kemi qenë me ju.’”**. Ne jemi me ju në këtë krenari dhe fitore.

Vallë, a mendojnë se All’llahut i fshihet ndonjë gjë që kanë në thellësinë e zemrave të tyre dhe Ai nuk i di qëllimet?! **“...Vallë! A nuk e di All’llahu më së miri se ç’ka në zemrat e çdokujt?”**.

Ka mundësi që fraza **“besuam”** në numrin shumës, të ketë kuptimin që hipokritët donin të futeshin në radhët e besimtarëve, e për këtë, thanë **“ne besuam”**, ashtu siç besuan njerëzit e tjerë, edhe pse fraza që vjen më pas është në numrin njëjës.

Këtu, në këtë ajet, është diçka tërheqëse, sepse Kur'ani i Shenjtë i përmend veprat e All'llahut me fjalën *“adhab”* – *“dënim”* dhe të këqijat e njerëzve me fjalën *“fitneh”*. Kjo shprehje tregon se të këqijat e njerëzve nuk janë dënim, por në të vërtetë, janë sprovë dhe rrugë drejt përsosurisë.

Për këtë, Kur'ani u mëson atyre që të mos bëjnë krahasim mes dënimit dhe keqbërjes. Nuk duhet të heqin dorë nga besimi me argumentin se idhujtarët dhe kundërshtarët u bëjnë keq atyre, sepse përndjekja dhe të bërit keq janë prej sprovave në këtë jetë.

Pyetje: Cila është ajo fitore, me të cilën, All'llahu i mirësoi myslimanët dhe që munafikët pretendojnë se janë partnerë të myslimanëve në këtë fitore?

Përgjigja: Fjala e lartpërmendur është në formë kushtore. Kuptimi i saj është: sikur të ndodhë që ju të triumfoni në të ardhmen, atëherë ata dyfytyrakë me besim të dobët do të mendojnë se do të jenë partnerët tuaj në këtë triumf.

Në shtesë të asaj që u tha, myslimanët triumfuan joushtarakisht disa herë mbi idhujtarët, si për shembull në predikim, në përhapjen e mendimeve të përgjithshme, në përfaqimin e Islamit nga shtresat e ndryshme të shoqërisë së asaj kohe etj.

Në përmbajtje të kësaj teme delikate, u sqarua se shprehja *“munafik”* – *“dyfytyrak”*, nuk është e posaçme vetëm për atë që s'ka

besim në zemër dhe pretendon se është besimtar. Por, kjo fjalë përfshin deri edhe personat me besim të dobët, të cilët, si pasojë e presioneve apo e ndikimeve të ndryshme, e lënë besimin. Edhe këta njerëz quhen dyfytyrakë (munafikë). Edhe ajeti në fjalë flet për këta lloj hipokritësh dhe sqaron se All'llahu është i Mirinformuar për qëllimet dhe të fshehtat e tyre.

Në ajetin e mëposhtëm, me shumë përforsim, Kur'ani thotë: **“Sigurisht, All'llahu i njeh më mirë ata që kanë besuar dhe hipokritët.”** Nëse ata mendojnë se kur i fshehin të vërtetat, All'llahu nuk i di ato, vërtet gabojnë rëndë. Edhe një herë e përmendim se fjala *“munafik”* që gjendet në ajet nuk është argument se ajetet kanë zbritur në Medine. Është e vërtetë që hipokrizia, në të shumtën e rasteve, ndodh pas triumfit të një grupi dhe marrjes së pushtetit, ku kundërshtarët ndërrojnë maskën e tyre dhe veprojnë në fshehtësi. Prandaj, fjala *“nifak”* ka kuptim të gjerë dhe përfshin njerëzit me besim të dobët, të cilët e ndryshojnë besimin për shkak të goditjes më të vogël që mund t'i ndodhë.

Ajeti tjetër tregon për logjikën e zbrazët të idhujtarëve, e cila vazhdon të jetë e pranishme në shtresat e shoqërisë. Ajeti thotë: **“Mohuesit u thonë besimtarëve: ‘Ndiqueni rrugën tonë e ne atëherë do t'i mbartim gjynahet tuaja!’”**.¹

¹ Frazja *“le nehmilu”* është folje urdhërore. Kjo thënie ka lindur polemika te disa komentues, si p.sh.: a mundet që njeriu ta urdhërojë vetveten?! Pastaj kanë thënë si përgjigje për këtë problem: Kjo çështje është në rregullin e çështjes së kushtores, që do të thotë: “Nëse na ndiqni neve, do të mbartim gjynahet tuaja”, ka thënë Fakhru Raziu. Mirëpo, sipas mendimit dhe besimit tonë, nuk ka problem që njeriu ta urdhërojë veten e tij ku urdhëruesi dhe i urdhëruari të jetë një person i vetëm.

Sot shohim shumë të këqinj e të pandërgjegjshëm, të cilët u thonë të tjerëve, kur i ftojnë për diçka: Nëse në këtë vepër ka gjynah, ajo është në qafat tona. Ndërkohë që ne e dimë se askush nuk i mban gjynahet e tjetrit. Sigurisht, që kjo nuk është as logjike e as e arsyeshme, sepse All'Ilahu është i Drejtë dhe nuk e gjykon një njeri për gjynahet e tjetrit.

Askush nuk duhet t'i besojë kësaj thënieje. Secili të mbajë e të kryejë përgjegjësitë që i takojnë. Nëse dikush bën keq a bën gjynah, askush nuk ia pakëson dënimin, qoftë sa maja e gjilpërës. Kjo thënie nuk pranohet në asnjë gjykatë. Nuk pranohet që fajtori të thotë: Filani e merr përsipër gjynahin tim. Është e vërtetë se dikush mund të shtyjë një tjetër për krim dhe është ortak me të në krim. Mirëpo, kjo ortakësi nuk ia largon përgjegjësinë e krimit.

Për këtë, Kur'ani i Shenjtë flet qartë: **“...Por ata nuk do të jenë në gjendje të mbartin nga gjynahet e tyre. Në të vërtetë, ata janë gënjeshtarë.”.**

Pyetje: Sigurisht, e vërteta dhe gënjeshtra janë prej pjesëve përbërëse të fjalisë informuese, ndërkohë që fjalia **“...do t'i mbartim gjynahet tuaja...”** është fillestare dhe në fjalinë shprehëse nuk ka të vërtetë e gënjeshtër. Atëherë përse Kur'ani thotë për ata se janë gënjeshtarë?!

Përgjigja: Përgjigja e kësaj pyetjeje sqarohet nga përmendja e asaj që thamë më parë se fjalia informuese këtu shndërrohet në fjali kushtore dhe kuptimi i saj është: nëse na ndiqni, ne do të mbartim gjynahet tuaja. Kjo fjali pranon të vërtetën dhe gënjeshtren.

Pas kësaj, me qëllim që politeistët, idhujtarët dhe të padrejtët të mos mendojnë se nuk do të ndëshkohen për këtë punë, Kur'ani thotë në ajetin pasardhës: **“Ata (mohuesit), do t'i mbartin barrët e veta, e bashkë me to edhe barrë të tjera...”**. Barra e gjynahut është ajo e gjynahut të mashtrimit dhe e nxitjes së të tjerëve për të bërë gjynahe. Ajo është barra për të cilën Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e tij qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: *“Ai që shpik një traditë të keqe, do të mbartë gjynahun e saj dhe të atyre që e zbatojnë atë, pa iu pakësuar asgjë prej gjynahut të tij.”*¹

Ajeti përfundon me thënien: **“...dhe patjetër, që do të pyeten Ditën e Kiametit për gjithçka që trillonin.”**. Këtu lind pyetja: “Çfarë është *iftirau* (trillimi, shpifja), për të cilin do të pyeten? Ka mundësi që të jenë trillimet dhe shpifjet që ia mvëshën All'llahut. Ata thoshin: “All'llahu na ka urdhëruar që t'i adhurojmë idhujt.”. Ose mund të jetë tregues për thënien e tyre: **“...do t'i mbartim gjynahet tuaja!”** sepse ata pretendonin që këto vepra apo thënie nuk konsiderohen gjynah. Të gjitha këto janë trillime dhe ata do të pyeten për të gjitha ato shpifje e trillime. Ose ka kuptimin që atyre do t'u thuhet në Ditën e Gjykimit: Ejani dhe mbartni gjynahet e të tjerëve! Ata nuk do të pranojnë dhe do të shfaqet gënjeshtria dhe trillimi i tyre. Ose e dukshmja e thënieve të tyre nënkupton që çdo njeri mund të mbartë gjynahun e tjetrit dhe të jetë përgjegjës ndaj atij gjynahu. Ndërkohë që kjo thënie është trillim dhe shpifje, sepse çdo njeri është përgjegjës për punët e tij.

¹. Tefsiri “El Kebijr, vëll. 25, f. 40

Dy hulumtime

Traditat e mira dhe traditat e këqija

Programimi dhe planifikimi i një pune në pikëpamjen e Islamit ka ndikim dhe personi që programon dhe planifikon mban përgjegjësinë e asaj pune, do apo s' do. Ai është ortak me të tjerët që punojnë me programin dhe planifikimin e asaj pune. Ne e dimë se çdo njeri që merr pjesë në fillimin e punës së një njeriu tjetër, është ortak i tij. Por ai njeri është ortak edhe me programuesin e planifikuesin.

Dëshmi e qartë e kësaj thënieje është hadithi i përcjellë nga Profeti i nderuar, që thotë: *“Ai që sjell një traditë të mirë dhe e zbaton atë, do të ketë shpërblimin e saj dhe shpërblimet e atyre që e pasojnë atë, pa u pakësuar asgjë nga shpërblimi. Ai që sjell një traditë të keqe, do të ketë gjynahin e saj dhe gjynahin e atyre që e pasojnë atë, pa u pakësuar asgjë prej tyre.”*¹ Ky hadith është i njohur dhe i transmetuar me fjalë të ndryshme, nga synitët dhe shiitët.

Përgjigjja e pyetjes

Disa kanë shtruar pyetjen: Nganjëherë ne shohim në ligjet islame se *“ed dijetu”* - *“shpagesa”*, i takon personit tjetër. Për shembull në rastin e vrasjes gabimisht, *“ed dijetu”* - *“shpagesa”* i ngarkohet *“el akiletu”* që janë të afërmit e mashkullit nga ana e babait. Atyre u ndahet shpagesa e vrasjes gabimisht dhe

¹ Tefsiri “Durul Menthur.”

gjithësecili i jep pjesën e vet. A nuk është kjo çështje në kundërshtim me ajetet e lartpërmendura?

Përgjigjja: Sigurimi i *“el akiletu”*, në të vërtetë, është një lloj siguracioni i detyrueshëm mes anëtarëve të një fisi.

Islami, me qëllim që *“ed dijetu”* të mos jetë në kurriz të një personi të vetëm, i ka detyruar anëtarët e fisit që të paguajnë një pjesë të *“ed dijetu”* – *“shpagesës”* së vrasjes gabimisht; shumën ta ndajnë mes tyre dhe secili të paguajë pjesën që i takon. (Për më shumë, sqarim shih librat e jurisprudencës, kreu i *“ed dijetu”* – *“shpagesa”*).

Sido që të jetë, ky rregull është një lloj bashkëpunimi në rrugën e mbrojtjes së interesave reciproke. Dhe nuk ka kuptimin e mbartjes së gjynahut të tjetrit. Veçanërisht, shpagimi i vrasjes gabimisht nuk është gjynah, por kompensim humbjeje.

Ajetet: 14 - 19

وَلَقَدْ أَرْسَلْنَا نُوحًا إِلَىٰ قَوْمِهِ ۖ فَلَبِثَ فِيهِمْ أَلْفَ سَنَةٍ إِلَّا خَمْسِينَ عَامًا فَأَخَذَهُمُ الطُّوفَانُ وَهُمْ ظَالِمُونَ ﴿١٤﴾ فَأَنجَيْنَاهُ وَأَصْحَابَ السَّفِينَةِ وَجَعَلْنَاهَا آيَةً لِلْعَالَمِينَ ﴿١٥﴾ وَإِبْرَاهِيمَ إِذْ قَالَ لِقَوْمِهِ اعْبُدُوا اللَّهَ وَاتَّقُوهُ ذَلِكُمْ خَيْرٌ لَّكُمْ إِن كُنْتُمْ تَعْلَمُونَ ﴿١٦﴾ إِنَّمَا تَعْبُدُونَ مِن دُونِ اللَّهِ أَوْثَانًا وَتَخْلُقُونَ إِفْكًا إِنَّ الَّذِينَ تَعْبُدُونَ مِن دُونِ اللَّهِ لَا يَمْلِكُونَ لَكُمْ رِزْقًا فَابْتَغُوا عِنْدَ اللَّهِ الرِّزْقَ وَاعْبُدُوهُ وَاشْكُرُوا لَهُ ۚ إِلَيْهِ تُرْجَعُونَ ﴿١٧﴾ وَإِن تَكْذِبُوا فَقَدْ كَذَّبَ أُمَمٌ مِّن قَبْلِكُمْ وَمَا عَلَى الرَّسُولِ إِلَّا الْبَلَاغُ الْمُبِينُ ﴿١٨﴾ أَوَلَمْ يَرَوْا كَيْفَ يُبْدِئُ اللَّهُ الْخَلْقَ ثُمَّ يُعِيدُهُ ۚ إِنَّ ذَٰلِكَ عَلَى اللَّهِ يَسِيرٌ ﴿١٩﴾

“Ne e dërguam Nuhun te populli i tij. Ai qëndroi tek ata një mijë pa pesëdhjetë vjet, e megjithatë, ata i përfshiu përmbytja dhe ishin të padrejtë.”

“Ne e shpëtuam Nuhun së bashku me ata që qenë në barkë dhe e bëmë shenjë për të gjithë brezat.”

“Kujtoje Ibrahimin, kur i tha popullit të vet: ‘Adhuroni All’lahun dhe frikësojuni Atij! Kjo është më e mirë për ju, nëse e dini.’”

“Vërtet, ata që ju i adhuron në vend të All’llahut, janë vetëm idhuj. Ju po shpifni gënjeshtër. Në të vërtetë, ata që ju i adhuron në vend të All’llahut, nuk kanë pushtet t’ju furnizojnë, andaj, vetëm tek All’llahu kërkoni risk dhe adhuron e falënderoni vetëm Atë. Tek Ai do të ktheheni.”

“Nëse ju nuk më besoni, dijeni se edhe popujt e mëparshëm i kanë quajtur gënjeshtarë (të Dërguarit) dhe se i Dërguari ka për detyrë vetëm që të shpallë qartazi.”

“Vallë, a nuk e vërejnë ata se si All’llahu e zë fill krijimin, pastaj e ripërsërit atë? Natyrisht, kjo është e lehtë për All’llahun.”

Komentimi

Përmendja e dy historive, ajo e hazreti Nuhut dhe e hazreti Ibrahimit (*Paqja e All’llahut qoftë mbi ta!*)

Ajetet e mëparshme flisnin për sprovat e njerëzve pa përjashtim. Ajetet në fjalë dhe ato më pas flasin për sprovat e ashpra e të vështira të Profetëve, se si jetonin nën presionin e armiqve të tyre dhe për persekutimet dhe padrejtësitë që i bëheshin Profetëve, se si duruan dhe se si fundi i durimit të tyre ishte triumfi.

Kur’ani i përmend këto me qëllim që nga njëra anë të forcojë anën shpirtërore të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut*

qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe nga ana tjetër, të jetë kërcënim për kundërshtarët dhe armiqtë, fundi i të cilëve do të jetë si ai i armiqve të Profetëve të mëparshëm.

Së pari, ajetet fillojnë me thëniet për Profetin e parë të vendosmërisë së lartë (Ulul Azm), i cili është hazreti Nuhu (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*). Ajetet flasin me fraza të përmbledhura rreth jetës së tij, e cila i ngjason shumë jetës së myslimanëve në këto ditë. Ajeti thotë: **“Ne e dërguam Nuhun te populli i tij. Ai qëndroi tek ata një mijë pa pesëdhjetë vjet...”**.

Hazreti Nuhu ditë e natë e ftonte popullin e tij në monoteizëm. Ai fliste me të gjithë, qofshin individë apo edhe grupe njerëzish, duke përfutur prej të gjitha momenteve të moshës së tij (nëntëqind e pesëdhjetë vjet). Ai kurrë nuk ndiente lodhje nga këto përpjekje dhe as nuk dukej në të dobësia e as plogështia. Por, nga këto përpjekje të vazhdueshme e të lodhshme, atij i besuan një grup i vogël prej rreth tetëdhjetë njerëz, siç thotë historia (një njeri në dymbëdhjetë vjet!). Për këtë, askush prej predikuesve nuk duhet të lodhet e as të ndiejë dobësi në rrugën e thirrjes e të predimikimit, sepse situatat e sotme, në krahasim me ato të hazreti Nuhut, janë më të lehta dhe më të favorshme. Fundi i armiqve të Nuhut (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) ishte: **“...e megjithatë, ata i përfshiu përmytja dhe ishin të padrejtë.”**.

Kështu *“Tumaret”* e mbyllën jetën të poshtëruar. Kështjellat, trupat dhe gjithçka që kishin u mbytën me dallgët e përmytjes së madhe.

Përdorimi i frazës **“një mijë pa pesëdhjetë vjet”**, ndërkohë që mund të përdorej fraza *“nëntëqind e pesëdhjetë vjet”*, tregon

për madhështinë e kohës dhe gjatësinë e saj, sepse “njëmijëshi” është numër i madh përse i përket kohës së predikimit.

Sipas këtij ajeti, kjo kohë nuk ka qenë mosha e plotë e jetës së hazreti Nuhut - edhe pse në Teuratin e sotëm, në Sefer Tekvijin, kreu i nëntë, thuhet se kjo ka qenë mosha e tij - sepse pas përmytjes, hazreti Nuhu ka jetuar përsëri. Sipas disa komentuesve thuhet se ka jetuar treqind vjet pas përmytjes.

Sigurisht, kjo moshë krahasuar me moshën e kohëve të sotme është shumë e madhe dhe nuk mund të duket normale. Sipas burimeve që na kanë mbërritur, thuhet se populli i Nuhut ka jetuar gjatë dhe mosha e Profetit të tyre, po ashtu, ka qenë mbi moshën e njohur. Kjo tregon edhe për strukturën e ndërtimit të trupave të tyre, gjë që i mundësonte të jetonin gjatë.

Vërtet, studimet e dijetarëve të sotëm tregojnë se mosha e njeriut nuk ka kufi të caktuar. Disa thonë se është i kufizuar me njëqind e njëzet vjet, më pak apo më shumë, por kjo thënie e tyre nuk është e vërtetë, sepse mosha ndryshon sipas ndryshimit të situatave dhe rrethanave.

Sot, nëpërmjet eksperimenteve, dijetarët kanë arritur t'i shtojnë moshën disa bimëve apo edhe krijesave të tjera të gjalla në dymbëdhjetëfish nga mosha normale. Nuk është për t'u habitur kur thuhet se disa e kanë shumëfishuar moshën e disa bimëve apo gjallesave të tjera në nëntëqindfish nga mosha e tyre normale.

Nëse do të mbarësohen, ata mund të shtojnë edhe moshën e njerëzve dhe njeriu mund të jetojë me mijëra vite.¹

Këtu themi se kuptimi i fjalës “*Tufan*” në origjinalitet ka kuptimin e një ndodhie që e rrethon njeriun. Ajo vjen nga rrënja “*et tauaf*” - rrotullim, rrethrotullim. Pastaj, kjo fjalë është përdorur për ujin e rrëmbyeshëm që vërshon dhe që mbulon sipërfaqe të shumta të tokës dhe i përmyt ato. Po ashtu, përdoret për çdo gjë të shumtë e të ashpër që është në gjendje të përfshijë, qoftë erë, zjarr apo ujë. Të gjitha këto janë quajtur “*tufan*”. Gjithashtu, vjen edhe me kuptimin e errësirës së madhe të natës.²

E habitshmja është se Kur’ani thotë: **“dhe ishin të padrejtë”**. Që do të thotë, se kur ndodhi dënimi i përmytjes, ata ndodheshin në padrejtësinë e tyre. Kjo tregon se ata nuk kishin hequr dorë prej punëve të tyre të këqija, nuk ishin penduar për atë që bënë dhe nuk i kërkuan kurrë All’llahut që t’ia lehtësonte atë provë të madhe e të dhimbshme.

Në ajetin tjetër Kur’ani thotë: **“Ne e shpëtuam Nuhun së bashku me ata që qenë në barkë dhe e bëmë shenjë për të gjithë brezat.”**³

Pas historisë së Nuhut (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) me popullin e tij, përmendet historia e hazreti Ibrahimit (*Paqja e*

¹ Për sqarime të tjera rreth çështjes së jetëgjatësisë dhe për hulumtimet që flasin për jetëgjatësinë e Imam Mehdiut, lexoni librin “El Mehdi Tehaulun Kebijr”.

² “Mufredatet” e Ragibit.

³ Për çështjen se kujt i kthehet përemri pronor në thënien “e bëmë atë” komentuesit kanë mendime të ndryshme. Disa thonë se tregon për këtë ndodhi në përgjithësi. Disa të tjerë kanë thënë se tregon për shpëtimin e Nuhut (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) me pasuesit e tij. Disa të tjerë kanë thënë se tregon anijen. Mesa duket nga e jashtëmja e frazës, ajo tregon për anijen. Është e vërtetë se kjo anije është argument, shenjë në atë kohë dhe në atë ndodhi madhështore.

All'Ilahut qoftë mbi të!), i dyti prej Profetëve të vendosmërisë së lartë. Ajeti thotë: **“Kujtoje Ibrahimin, kur i tha popullit të vet: ‘Adhuroni All’Ilahun dhe frikësojuni Atij! Kjo është më e mirë për ju, nëse e dini.’”**.¹

Këtu, Kur’ani sqaron dy vepra të rëndësishme të Profetëve: besimin dhe zbatimin. Që të dyja përbëjnë thirrjen në monoteizëm.

Në fund ajeti thotë se sikur të mendonit drejtë, do të ishte në dobinë tuaj, sepse All’Ilahu do t’ju shpëtonte prej jetës suaj të mbushur me gjynahe dhe fundi juaj do të ishte lumturia e përjetshme.

Më pas hazreti Ibrahim (Paqja e All’Ilahut qoftë mbi të!) përmend argumentet e pavlerësisë së adhurimit të idhujve. Ai e përmend këtë me thënie të ndryshme, ku secila thënie përmban argument për pavlefshmërinë e rrugës së idhujtarëve. Në fillim, ajeti thotë: **“Vërtet, ata që ju i adhuronin në vend të All’Ilahut, janë vetëm idhuj...”**.

Këto idhuj janë të zbrazëta nga shpirti, dëshira dhe logjika. Pamja e tyre është argument i pavlefshmërisë së besimit të tyre në ato idhuj.

Fjala *“euthan”* është shumësi i fjalës *“uthan”* dhe ka kuptimin e gurit të gdhendur të vendosur për adhurim.

¹ Mesa duket fjala “Ibrahim” është e lidhur me fjalën “Nuh” dhe folja është “erselna” - “dërguam”. Disa komentues e lidhën me kundrinor “enxhejnah” - “e shpëtuar”. Disa të tjerë kanë thënë se është kundrinor i foljes së papërmendur dhe aludimi i saj është “kujto”.

Më poshtë Kur'ani e zgjeron thënien e tij dhe shkon më larg duke thënë se nuk janë ato idhuj me gjithë pamjen e tyre argument që nuk e meritojnë adhurimin, por ju e dini se gënjeni dhe i vendosni emrin “zota” këtyre idhujve. **“...Ju po shpifni gënjeshtër.”**. A keni argument tjetër për këtë gënjeshtër përveç iluzionin dhe paganizmin e kotë?!

Përderisa fjala “*teklukune*”, vjen nga fjala “*el khalk*” që ka kuptimin e gjetjes, të prodhimit e të krijimit. Në disa raste vjen edhe me kuptimin e gënjeshtres. Disa komentues kanë përmendur komentim tjetër për këtë fjali të ajetit. Ata kanë thënë se kuptimi i kësaj fraze është se ju i gdhendni me duart tuaja këto idhuj të kotë që adhuroni. Për këtë kuptimi i fjalës “*ifk*” është për adhuruesit e rremë e të pavlerë.¹

Pastaj, sqaron argumentin e tretë ku thotë se adhurimi i këtyre idhujve nga ana juaj është ose për fitime materiale ose për Ahiretin. Që të dy qëllimet tuaja janë të kota e të pavlera sepse: **“...Në të vërtetë, ata që ju i adhuroni në vend të All'llahut, nuk kanë pushtet t'ju furnizojnë.”**.

Ju e dini se këto idhuj nuk ju kanë krijuar, por është All'llahu Krijuesi. Furnizimi juaj është në dorë të All'llahut dhe të askujt tjetër. Ai ka marrë përsipër furnizimin tuaj: **“...prandaj, vetëm tek All'llahu kërkon risk...”**, sepse është Ai që ju furnizon: **“...dhe adhuroni e falënderoni vetëm Atë...”**.

Thënë ndryshe: Një prej shkaqeve të adhurimit është ndjenja e falënderimit të Furnizuesit të vërtetë. Ju e dini se

¹ Fjala “*ifkun*” përdoret për çdo gjë që është në kundërshtim me të vërtetën. Po ashtu, përdoret edhe për gënjeshtër, sidomos gënjeshtër e madhe. Gjithashtu, kjo fjalë përdoret edhe për erërat që fryjnë kundër drejtimit të tyre.

furnizuesi i vërtetë është vetëm All'llahu, prandaj adhurimi dhe falënderimi i takojnë vetëm Atij, nëse dëshironi Ahiretin: **“...Tek Ai do të ktheheni.”**. Ato idhuj që adhuronin nuk sjellin asnjë dobi për ju si në këtë jetë, ashtu edhe në Jetën Tjetër.

Më pas Profeti Ibrahim (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) shfaq se nuk do t'ia dijë për thëniet e tyre duke u thënë: **“Nëse ju nuk besoni, dini se edhe popujt e mëparshëm i kanë quajtur gënjeshtarë (të Dërguarit)...”**. Ata i përgënjeshtrojnë të Dërguarit e tyre dhe morën poshtërimin dhe ndëshkimin si pasojë e përgënjeshtërimit të tyre, sepse: **“...dhe se i Dërguari ka për detyrë vetëm që të shpallë qartazi.”**.

Kuptimi i fjalës popuj këtu është për popullin e Ibrahimit, të Nuhut dhe të popujve pas tyre. Lidhshmëria e këtyre ajeteve bën që kjo fjali të jetë prej fjalëve të Ibrahimit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*). Këtë e thonë shumica e komentuesve në komentimin e këtij ajeti.

Një tjetër supozim është se fjalët këtu u drejtohen idhujtarëve prej banorëve të Mekës në kohën e Profetit. Fjalja **“edhe popujt e mëparshëm i kanë quajtur gënjeshtarë (të Dërguarit)...”**, përputhet me këtë supozim. Në shtesë të kësaj thënieje, janë edhe thëniet në ajetin 25 të sures “Zumer” dhe në ajetin 25 të sures “Fatir” që flasin për Profetin dhe për idhujtarët arabë në Mekë. Sido që të jetë dhe për këdo që të jetë, për popullin e Ibrahimit apo për idhujtarët e Mekës, nuk ka dallim në rezultat.

Këtu e ndërpret Kur'ani historinë e Profetit Ibrahim (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) dhe e plotëson hulumtimin për Ibrahimin (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) rreth monoteizmit dhe të sqarimit të

mesazhit të tij me argumentin e Ringjalljes duke thënë: **“Vallë, a nuk e shikojnë ata se si All’llahu e zë fill Krijimin, pastaj e ripërsërit atë...?”**.

Kuptimi i fjalës *“ru’jetun”* - shikim, ka kuptimin e shikimit të zemrës dhe të dijes. Kjo do të thotë: Si ka mundësi që ata nuk e njohin krijimin e All’llahut? Ai që është i Plotfuqishëm për krijim, Ai është i Plotfuqishëm edhe për ringjalljen e tyre. Fuqia për diçka është për të dhe për të tjera.

Po ashtu, mund të jetë edhe për shikimin me sy, sepse njeriu e shikon me sytë e tij se si ringjallet toka dhe se si mbijnë dhe rriten bimët në të; shikon me sytë e tij kur pula bën vezë dhe prej vezës del zogu; shikon fëmijën që vjen prej spermës etj. All’llahu që ka fuqi në krijim, sigurisht që ka fuqi edhe për rikthim.

Në ajetin e fundit All’llahu i Madhëruar thotë: **“...Natyrisht, kjo është e lehtë për All’llahun.”**.

Sepse ripërtëritja e jetës në krahasim me krijimin e parë të saj konsiderohet më e lehtë. Sigurisht që kjo thënie është në përputhje me logjikën e të gjithë njerëzve dhe me botëkuptimin e tyre. Lehtësia dhe vështirësia nuk kanë kuptim tek All’llahu i Plotfuqishëm, Poseduesi i fuqisë absolute. Përderisa fuqitë tona janë të kufizuara, kanë lindur “kuptimin” e lehtësisë dhe të vështirësisë tek ne.

Ajetet 20 - 23

قُلْ سِيرُوا فِي الْأَرْضِ فَانظُرُوا كَيْفَ بَدَأَ الْخَلْقَ ثُمَّ اللَّهُ يُنشِئُ النَّشْأَةَ الْآخِرَةَ
 إِنَّ اللَّهَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿٢٠﴾ يُعَذِّبُ مَن يَشَاءُ وَيَرْحَمُ مَن يَشَاءُ وَإِلَيْهِ
 تُقْلَبُونَ ﴿٢١﴾ وَمَا أَنْتُمْ بِمُعْجِزِينَ فِي الْأَرْضِ وَلَا فِي السَّمَاءِ وَمَا لَكُم مِّن دُونِ
 اللَّهِ مِن وَلِيٍّ وَلَا نَصِيرٍ ﴿٢٢﴾ وَالَّذِينَ كَفَرُوا بِعِلَالِ اللَّهِ وَلِقَائِهِ أُولَٰئِكَ يَئِسُوا
 مِن رَّحْمَتِي وَأُولَٰئِكَ لَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ ﴿٢٣﴾

“Thuj: ‘Udhëtoni nëpër Tokë dhe shikoni se si Ai e ka zënë fill krijimin. Pastaj do të jetë All’Ilahu Ai që do të bëjë krijimin e dytë (Ringjalljen). Me të vërtetë, All’Ilahu është i Fuqishëm për çdo gjë.”

“Ai ndëshkon kë të dëshirojë dhe mëshiron kë të dëshirojë; tek Ai do të ktheheni.”

“Ndëshkimit të Tij nuk mund t’i shpëtoni as në Tokë e as në qiell dhe, përveç All’Ilahut, nuk keni as mbrojtës, as ndihmës.”

“Ata që mohojnë shenjat e All’Ilahut dhe takimin e Tij, pikërisht ata e kanë humbur shpresën në mëshirën Time dhe për ta do të ketë dënim të dhembshëm.”

Komentimi

Të pashpresët ndaj mëshirës së All'Ilahut

Ajetet në fjalë vazhdojnë hulumtimin rreth Ringjalljes në një formë ndryshe.

Kjo nuk është hera e parë që e hasim këtë lloj metode. Kjo është metoda e përhershme e Kur'anit të Shenjtë. Kur arrin në fazën delikate të përmendjes së një historie, e ndërpret historinë dhe pastaj jep konkluzionin e duhur.

Sido që të jetë, në këtë pjesë të ajetit të parë, Kur'ani i fton njerëzit të udhëtojnë në Tokë për çështjen e Ringjalljes, ndërkohë që ajeti paraardhës më shumë ftonte të "udhëtonin në brendinë e tyre!". Kur'ani thotë: **"Thuaj: 'Udhëtoni nëpër Tokë dhe shikoni se si Ai e ka zënë fill krijimin...'"**; shikojini llojet e krijesave të gjalla, popujt e ndryshëm se si All'Ilahu i krijoi ata. Pastaj, All'Ilahu i Madhërrur që i krijoi krijesat nga asgjëja, është i Plotfuqishëm t'i ringjallë ato. **"Pastaj do të jetë All'Ilahu Ai që do të bëjë krijimin e dytë (Ringjalljen)..."**. Kjo sepse All'Ilahu i Madhërruar e konstatoi fuqinë e Tij të pakufizuar dhe absolute në kohën që krijoi gjithçka dhe Ai: **"...Me të vërtetë, All'Ilahu është i Fuqishëm për çdo gjë."**

Ky ajet dhe ajeti para tij, nëpërmjet fuqisë absolute të All'Ilahut konstatojnë çështjen e Ringjalljes; por me një ndryshim, se ajeti i parë flet për njeriun dhe krijimin e tij, kurse ajeti i dytë urdhëron për të shikuar dhe për të menduar për gjendjen e popujve të shkuar dhe për krijesat e tjera që të mendojmë për

krijimin e parë, që të njihen me fuqinë e All'llahut dhe të binden se Ai është i Plotfuqishëm për Ringjalljen. Pra, ashtu siç konstatohet dhe vërtetohet monoteizmi, në të shumtën e rasteve, duke parë dhe menduar në argumentet në veta e në hapësirë, po ashtu konstatohet dhe vërtetohet Ringjallja.

Në këtë kohë që jetojmë, këto ajete u sqarojnë dijetarëve dhe shkencëtarëve të vërteta të shumta. Ata duhet të mendojnë për krijesat e shumëllojshme që jetojnë në thellësinë e ujërave, në zemër të maleve dhe në shtresat e tokës, me qëllim që të njihen me sekretet e fillimit të jetës mbi sipërfaqen e tokës dhe të kuptojnë madhësinë dhe fuqinë e All'llahut të Madhëruar. Po ashtu, të kuptojnë se Ai është i Plotfuqishëm për Ringjalljen.¹

Fjala *"nesh'ateun"* në origjinalitet ka kuptimin e gjetjes së diçkaje dhe edukimi i saj. Në disa raste i thuhet edhe dun'jasë *"nesh'etun ula"* - *"krijimi i parë"*, dhe për Ahiretin *"nesh'etul ahireh"* - *"Jeta Tjetër"*.

Më pas Kur'ani i Shenjtë flet për një prej çështjeve që ka lidhje me Ringjalljen, e cila është çështja e mëshirës dhe e dënimit. Ai thotë: **"Ai ndëshkon kë të dëshirojë dhe mëshiron kë të dëshirojë; tek Ai do të ktheheni."**

Edhe pse mëshira e All'llahut është më parësore ndaj zemërimit të Tij, ky ajet fillon me përmendjen e dënimit e pastaj përmend mëshirën. Kjo, sepse përmendja është në pozitën e kërcënimit dhe kjo metodë është në përshtatje me kërcënimin.

¹ Më parë ne folëm rreth frazës "udhëtoni nëpër tokë" dhe ndikimet e tij. Në hulumtimet e shkuara kishte mësimë prej popujve të shkuar dhe tiranët e tyre. Këtë e përmendëm në komentimin e ajetit 137 të sures "Ali imran".

Këtu lind pyetja: Përse Kur'ani në fillim flet për dënimin dhe mëshirën e pastaj flet për kthimin e njerëzve tek All'llahu ku thotë: **"...tek Ai do të ktheheni."**, ndërkohë çështja është e kundërt, sepse në fillim kthehen njerëzit tek Ai dhe pastaj ata ose i përfshin dënimi, ose mëshira. Kjo mund të jetë e përshtatshme me atë që besojnë disa komentues se dënimi dhe mëshira që përmenden në këtë ajet janë për këtë jetë (dynjanë).

Në përgjigje të kësaj pyetjeje themi: Dënimi dhe mëshira me faktet shoqëruese në ajetet e mëparshme dhe të mëpasme janë për në Kiamet. Fjala **"tek Ai do të ktheheni"** është argument për këtë dhe do të thotë: përderisa ju do të ktheheni tek All'llahu, dhe llogaria juaj është tek Ai, edhe dënimi edhe mëshira janë prej dëshirës së Tij dhe me urdhrin e Tij. Nuk është e largët që dënimi dhe mëshira në këtë ajet të kenë kuptim të gjerë, ku të përfshijnë të dyja jetët.

Siç kuptohet, fjala *"men jeshau"* – *"atë që do"*, ka kuptimin e dëshirës së All'llahut të shoqëruar me urtësinë dhe dijen e Tij. Kjo do të thotë se kushdo do të marrë atë që meriton dhe se dëshira e All'llahu nuk është pa baza, por është në përputhje me pëpjekjet dhe meritimin.

Fraza *"tuklebune"* vjen nga rrënja *"el kalb"*, që në origjinalitet do të thotë ndryshimi i diçkaje nga një formë në një formë tjetër. Meqenëse njeriu në Ditën e Kiametit kthehet në formën e qenies së plotë e të gjallë, pasi ishte dhë e pluhur, për këtë kjo thënie thuhet edhe për ringjalljen e tij.

Kjo thënie mund të ketë edhe këtë kuptim të thellë dhe mund të tregojë që njeriu në Botën Tjetër ndryshon në atë masë, saqë zbulohet e brendshmja e tij dhe shfaqen sekretet e tij. Me këtë

kuptim, ky ajet është në përputhje me ajetin 9 të sures “Tarik”, që thotë: **“Ditën, kur do të zbulohen të fshehtat.”**

Si plotësim i hulumtimit që sqaron se mëshira dhe dënimi janë në dorën e All’llahut dhe kthimi është tek Ai, Kur’ani thotë se nëse ju mendoni se mund të largoheni prej sundimit të All’llahut dhe nuk do t’ju kapë dënimi i Tij, ju gaboni rëndë dhe çështja nuk është e tillë sepse: **“Ndëshkimit të Tij nuk mund t’i shpëtoni as në Tokë e as në qiell...”**.¹

Nëse mendoni se do të gjeni përkrahës dhe mbrojtës tjetër përveç All’llahut që t’ju mbrojtë, përsëri gaboni: **“...dhe, përveç All’llahut, nuk keni as mbrojtës, as ndihmës.”**

Përgjigjja e dy pyetjeve

Pyetja e parë: Ajeti flet për jobesimtarët dhe politeistët dhe që ata banojnë në Tokë. Çfarë kuptimi ka thënia “e as në qiell” që përmendet në ajet?

Përgjigjja: Kjo thënie përmban një lloj përforcimi, që do të thotë se ju nuk mund të dilni prej fuqisë së All’llahut dhe prej pushtetit të Tij as në tokë e as në qiell, sepse edhe sikur të supozojmë se ju mund të ngjiteni në qiell, përsëri jeni nën fuqinë dhe pushtetin e All’llahut.

¹ Fjala “mu’xhizijne” vjen nga rrënja “axhizun”, që në origjinlitet do të thotë vonim dhe prapambetje prej diçkaje. Po ashtu, përdoret për dobësimin që shtyn në prapambetje dhe vonesë. Fjala “el mu’xhizeh” ka kuptim e bërjes së dikujt të paaftë. Përderisa njerëzit largohen prej sundimit të dikujt dhe të fuqisë së tij, e pastaj janë të paaftë t’i ndjekin ata, për këtë është përdorur edhe fjala “mu’xhiz” në këtë ajet.

Ose: Ju, o politeistë, o jobesimtarë, nuk mund ta bëni të paaftë All'llahun në dëshirën e Tij me anë të çdo gjëje që gjendet në tokë e as me anë të asaj që adhuron në qiell, qofshin melekët apo xhindet. (Sigurisht, komentimi i parë është më i përshtatshëm)

Pyetja e dytë: Çfarë dallimi ka mes fjalës “el uelij” dhe “en nasijr”?

Përgjigja: Eruditi Tabarsij në tefsijrin “Mexhmaul Bejan” kanë thënë: *El uelij* është ai që merr përsipër përkrahjen dhe ndihmën e vetes së tij. *En nesijr* nganjëherë e merr vetë përsipër triumfin dhe herë tjetër, urdhëron të tjerët për triumf.¹

Mund të thuhet përsëri se fjala “*el ueliju*” tregon për atë që caktohet pa kërkesë (prej atij që ka kujdestari) dhe “*en nesijr*” është ai që ndihmon të tjerët pasi ata i kërkojnë atij ndihmë.

Në këtë mënyrë, Kur'ani i Shenjtë ia mbyll të gjithë gjynahqarëve rrugët e ikjes e të largimit. Për këtë, në ajetin pasardhës, thotë prerazi: **“Ata që mohojnë shenjat e All'llahut dhe takimin e Tij, pikërisht ata e kanë humbur shpresën në mëshirën Time...”**. Pastaj thotë: **“...dhe për ta do të ketë dënim të dhembshëm.”**.

Ky dënim vjen si pasojë e humbjes së shpresës prej mëshirës së All'llahut.

Kuptimi i thënies “*ajatil'lahi*” mund të jetë për shenjat e krijimit, pra madhështia e All'llahut në krijim. Kështu ajo tregon për monoteizmin. Kurse thënia **“takimin e Tij”** tregon për

¹ Tefsijri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 8, f. 279.

Ringjalljen. Kështu që kuptimi i thënies **“shenjat e All’llahut”** ka kuptimin se ata mohojnë krijimin dhe Ringjalljen.

Ose ka kuptimin e sheriateve (legjislacioneve) që All’llahu ua zbriti të Dërguarve të Tij, të cilat flasin dhe sqarojnë krijimin dhe Ringjalljen. Në këtë mënyrë, kuptimi i thënies **“takimin e Tij”** është si përmendja e të posaçmit pas të përgjithshmit.

Po ashtu thënia *“ajatull’llahi”* mund të ketë kuptimin e të gjitha krijesave të All’llahut në këtë gjithësi. Këtu duhet thënë, gjithashtu, se fjala *“jeisuu”* është folje në kohën e shkuar, qëllimi i së cilës është e ardhmja, Dita e Kiametit. Zakonisht, arabët kur flasin për një çështje të ardhme në formë të sigurtë, e shprehin në kohën e shkuar si argument i patjetërsisë së realizimit të saj.

Ajetet 24 - 27

فَمَا كَانَ جَوَابَ قَوْمِهِ إِلَّا أَنْ قَالُوا اقْتُلُوهُ أَوْ حَرِّقُوهُ فَأَنْجَاهُ اللَّهُ مِنَ النَّارِ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِّقَوْمٍ يُؤْمِنُونَ ﴿٢٤﴾ وَقَالَ إِنَّمَا اتَّخَذْتُمْ مِّنْ دُونِ اللَّهِ أَوْثَانًا مَّوَدَّةَ بَيْنِكُمْ فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا ثُمَّ يَوْمَ الْقِيَمَةِ يَكْفُرُ بَعْضُكُم بِبَعْضٍ وَيَلْعَنُ بَعْضُكُم بَعْضًا وَمَأْوَىٰكُمُ النَّارُ وَمَا لَكُم مِّنْ نَّاصِرِينَ ﴿٢٥﴾ فَتَأْمَنَ لَهُ وَ لُوطٌ وَقَالَ إِنِّي مُهَاجِرٌ إِلَىٰ رَبِّي إِنَّهُ هُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ ﴿٢٦﴾ وَوَهَبْنَا لَهُ إِسْحَاقَ وَيَعْقُوبَ وَجَعَلْنَا فِي ذُرِّيَّتِهِ النُّبُوَّةَ وَالْكِتَابَ وَءَاتَيْنَاهُ أَجْرَهُ فِي الدُّنْيَا وَإِنَّهُ فِي الْآخِرَةِ لَمِنَ الصَّالِحِينَ ﴿٢٧﴾

“Populli i tij nuk kishte tjetër përgjigje, përveçse: ‘Vriteni atë ose digjeni!’. Por All’lillahu e shpëtoi atë nga zjarri. Vërtet, këtu ka shenja të qarta për njerëzit që besojnë.”

“Dhe ai tha: ‘Ju, në vend të All’lilahun, keni zgjedhur idhujt, për shkak të dashurisë midis jush në këtë jetë. Por, në Ditën e Kiametit do ta mohoni njëri-tjetrin dhe do ta mallkoni njëri-tjetrin. Streha juaj do të jetë zjarri dhe nuk do të ketë për ju kurrfarë ndihmësi.’”

“Luti i besoi atij dhe tha: ‘Unë do të mërhoj te Zoti im; me të vërtetë, Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti.’”

“Dhe Ne i dhuruam atij Is’hakun dhe Jakubin dhe pasardhësve të tij u dhamë Profecinë dhe Librin. Ne i dhamë atij shpërblim në këtë botë, ndërsa në Jetën Tjetër, me siguri, ai do të jetë prej njerëzve të mirë.”

Komentimi

Metoda e mendjemëdhenjve në përgjigjen e Ibrahimit

Tani duhet të dimë se çfarë i tha populli i humbur Profetit Ibrahim (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*), kur ua paraqiti atyre tre argumentet e tij për çështjen e monoteizmit, Profetësisë dhe Ringjalljes.

Sigurisht, ata nuk kishin përgjigje logjike. Si të gjithë kokëfortët mendjemëdhenj, ata u strehuan te mundësitë e tyre djallëzore dhe urdhëruan që Ibrahim (i) (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) të vritej, siç thotë ajeti i parë në fjalë: **“Populli i tij nuk kishte tjetër përgjigje, përveçse: ‘Vriteni atë ose digjeni!...’”**.

Nga këto thënie kuptohet se një grup njerëzish anonin te djegia e Ibrahimit (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) me zjarr dhe një grup tjetër propozoi vrasjen me shpatë apo me diçka tjetër. Së fundi, u vendos mendimi i parë, pra djegia, sepse ata besonin se rasti më i fortë i ekzekutimit është djegia me zjarr. Po ashtu, supozohet se ata të gjithë mendonin që të vritej me mjete të natyrshme, mirëpo në fund ranë dakort që të digjej me zjarr. Në

këtë ajet të bekuar nuk flitet për mënyrën e djegies së Ibrahimit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*). Pastaj ajeti thotë: **"...Por All'llahu e shpëtoi atë nga zjarri..."**.

Detajet e historisë së hedhjes së Ibrahimit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) në zjarr përmenden në ajetet 68-70 të sures "Enbija". Ajeti përfundon me thënien: **"...Vërtet, këtu ka shenja të qarta për njerëzit që besojnë."**

Në këtë ndodhi nuk ishte vetëm një shenjë apo mrekulli, por kishte shenja dhe mrekulli të shumta. Nga njëra anë, mosdjegia e trupit të Ibrahimit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) është një mrekulli e qartë. Shndërrimi i zjarrit në lulishte paqeje për Ibrahimin (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) është një tjetër mrekulli. Paftësia e atyre njerëzve për të mposhtur një njeri të vetëm, duarbosh, është mrekulli. Gjithashtu, mosndikimi i kësaj ndodhie madhështore në zemrat e errëta, është shenjë prej shenjave të All'llahut, sepse ata kokëfortë e të pabindur janë të zhveshur nga mbarësia e ndikimit prej ndodhive më madhështore.

Në disa transmetime thuhet se kur hazreti Ibrahim (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) u hodh në zjarr me duar dhe këmbë të lidhura, gjëja e vetme që dogji zjarri ishte litari me të cilin e kishin lidhur.¹

Vërtet, zjarri i injorancës dhe krimi i të devijuarve i dogji mjetet e robërisë dhe e çliroi Ibrahimin prej tyre. Edhe kjo në vetevete është një shenjë tjetër. Ndoshta, për këto shkaqe, Kur'ani

¹ Tefsiri "Ruhul Meanij", vëll. 20, f. 130.

kur flet për historinë e hazreti Nuhut (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) dhe anijen e tij, thotë: **“E bëmë atë shenjë”** në numrin njëjës. Mirëpo, këtu thotë *“ajatun”* – *“shenjat”*, në numrin shumës.

Sido që të jetë, hazreti Ibrahim (i) (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) shpëtoi mrekullisht prej zjarrit me ndihmën e All'llahut të Plotfuqishëm. Ai (Ibrahimi) kurrë nuk e braktisi qëllimin e tij. E vazhdoi atë duke ia shtuar më shumë përkushtimin dhe energjitë.

Më pas hazreti Ibrahim (i) (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) iu drejtua politeistëve dhe jobesimtarëve: **“Dhe ai tha: ‘Ju, në vend të All'llahut, keni zgjedhur idhujt, për shkak të dashurisë midis jush në këtë jetë...’”**. Kjo dashuri dhe ky pasion do të zhduket në Ahiret: **“...Por, në Ditën e Kiametit do ta mohoni njëri-tjetrin dhe do ta mallkoni njërit-jetrin. Streha juaj do të jetë zjarri dhe nuk do të ketë për ju kurrfarë ndihmësi.”**.

Si mund të jenë idhujt themeli i dashurisë mes idhujtarëve?! Kjo pyetje ka disa përgjigje:

Së pari: Idhujtaria ishte simbol i unitetit në çdo fis dhe popull, sepse çdo grup zgjodhi për veten e tij një idhull, siç thonë për idhujt e paraislamit, dhe çdo idhull i përkiste një fisi prej fiseve arabe. Idhulli “el Uzza” ishte i kurejshitëve, idhulli “el Late” ishte i posaçëm për Thakifin, kurse “Menatu” ishte i posaçëm për fisin Aus dhe Khazrexh.¹

Së dyti: Idhujtarët i bashkon justifikimi me njëri-tjetrin, sepse në të shumtën e rasteve ata justifikoheshin duke thënë se

¹ Sijretu ibn Hisham, vëll. 1, f. 86 dhe 87.

këto idhuj i adhuronin të parët tanë dhe ne i pasojmë ata dhe ndjekim fenë e baballarëve tanë.

Pas gjithë kësaj, të mëdhenjtë e jobesimtarëve i ftonin pasuesit e tyre në adhurimin e idhujve. Ky urdhër ishte si “hallkë bashkimi” mes të mëdhenjve dhe pasuesve. Mirëpo, të gjitha këto lidhje dhe hallka bashkuese do të këputen të gjitha në Ditën e Kiametit. Çdo njeri do të shohë atë që ka bërë prej gjynaheve. Pasuesit e idhujtarëve do të shkëputen dhe do të mallkojnë urdhëruesit në idhujtari; deri edhe ato që adhuronin dhe thonin se ishin mjet afrimi tek All’llahu i Madhëruar: **“Ne u lutemi atyre vetëm që të na afrojnë tek All’llahu”**¹ do të largohen prej tyre.

Edhe Kur’ani i Shenjtë e paraqet këtë gjendje në suren “Merjem”, ajeti 82, ku thotë: **“Por jo! Ata do ta mohojnë adhurimin e tyre dhe do të bëhen armiq të tyre.”**.

Kështu që qëllimi në thënien e All’llahut të Madhëruar: **“...do ta mohoni njëri-tjetrin dhe do ta mallkoni njëri-tjetrin...”** është se ata do të largohen nga njëri-tjetri në atë Ditë. Ato marrëdhënie dashurie të rreme në këtë jetë do të jenë shkak i armiqësisë dhe i urrejtjes në Jetën Tjetër, siç thotë Kur’ani i Shenjtë në suren “Zuhruf”, ajeti 67: **“Atë Ditë miqtë do të bëhen armiq të njëri-tjetrit, përveç të devotshmëve.”**.

Në disa transmetime përfohet se ky rregull nuk është i posaçëm vetëm për idhujtarët, por për të gjithë ata të cilët kanë zgjedhur edhe prijës të pabazë dhe të pameritueshëm dhe pastaj e pasojnë atë duke i dhënë besën se do ta duan në këtë jetë. Në

¹ Sure “Zumer”, ajeti 3.

Ditën e Kiametit këta do të jenë armiq me njëri-tjetrin, do ta mohojnë dhe do ta mallkojnë njëri-tjetrin.¹

Marrëdhëniet e besimtarëve janë të bazuara mbi Njëtimin (Teuhidin), adhurimin e All'llahut dhe mbi zbatimin e urdhrave të Tij në këtë jetë. Këto marrëdhënie janë të përhershme dhe të qëndrueshme në këtë jetë dhe do të jenë më të forta në Botën Tjetër, kurse jobesimtarët dhe idhujtarët do ta mohojnë dhe do ta mallkojnë njëri-tjetrin.²

Ajeti në vijim tregon për besimin e Lutit dhe për emigrimin e hazreti Ibrahimit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) dhe thotë: **“Luti i besoi atij...”**.

Luti (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) është prej Profetëve të mëdhenj të All'llahut. Ai ishte i afërt me Ibrahimin (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*). Thuhet se ka qenë djali i motrës së Ibrahimit. Meqenëse ai ndiqte një njeri të madh si Ibrahim, i cili kishte pozitën e një bashkësie të plotë, All'llahu i Madhëruar flet duke sqaruar besimin e Lutit, personalitetin e tij të lartë dhe saktëson se ishte bashkëkohës i hazreti Ibrahimit. Me sa duket në tokën e Babilonisë kishte zemra të përgatitura për pranimin e ftesës së Ibrahimit të madh. Vërtet mbartësit e atyre zemrave, pasi panë atë mrekulli madhështore, u bashkuan me të, edhe pse ishin të pakët.

¹ “Usulul Kafij”, sipas asaj që transmetohet në tefsirin “Nuruth Thekalejn”, vëll. 4, f. 155.

² “Teuhijdi” i Sadukut, sipas asaj që transmetohet në tefsirin “Nuruth Thekalejn”, vëll. 4, f. 155.

Pastaj ajeti flet për emigrimin e hazreti Ibrahimit dhe thotë: **“...dhe tha: ‘Unë do të mërgoj te Zoti im; me të vërtetë, Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti.’”**.

Është e qartë se kur udhëheqësit e caktuar nga All'llahu përçojnë mesazhin e tyre në ambientin e njollosur dhe të sunduar nga tiranët dhe thirrja e tyre nuk përparon shumë, ata duhet të emigrojnë në një vend tjetër me qëllim që të zgjerohet thirrja dhe predikimi i tyre.

Prandaj edhe Ibrahim (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) së bashku me bashkëshorten e tij, me ndihmën e Lutit (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!), emigruan prej Babilonisë në tokat e Shamit, djepi i Profetëve dhe i monoteizmit, me qëllim që të përhapnin thirrjen në besimin në një Zot të Vetëm e të Pashoq.

Ajo që tërheq vëmendjen është se Ibrahim (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) thotë: **“Unë do të mërgoj te Zoti im...”** sepse ajo rrugë që kishte nisur ishte rruga e All'llahut, rruga e kënaqësisë së Tij dhe rruga e fesë së Tij.

Disa komentues kanë supozuar se përemri në thënien: **“Unë do të mërgoj te Zoti im...”** është për Lutin (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!). Dhe do të thotë që Luti tha: “Unë do të mërgoj te Zoti im.” E dukshmja e ajetit është në përputhje me këtë kuptim. Mirëpo, dëshmitë historike tregojnë se përemri “unë”, që përmendet në këtë fjali, është për Ibrahim (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) dhe se emigrimi i Lutit (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) ishte me ndihmën e Ibrahimit.

Dëshmues i kësaj thënieje është edhe fjala e All'Ilahut në ajetin 99 të sures "Safat", që thotë: **"Ai tha: 'Unë po shkoj te Zoti im. Ai do të më udhëzojë.'"**¹

Në ajetin e fundit të ajeteve në fjalë flitet për katër dhuntitë të mëdha, të cilat All'Ilahu ia dhuroi Ibrahimit (*Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!*) pas emigrimit:

Dhuntia e parë: Fëmijë të mirë si Is'haku dhe Jakubi që ta mbajnë të ndezur dritën e besimit dhe të profecisë në shtëpinë e tij dhe ta ruajnë atë. Ajeti thotë: **"Dhe Ne i dhuruam atij Is'hakun dhe Jakubin..."**. Të dy janë Profetë të mëdhenj dhe që të dy ecin në rrugën e Ibrahimit, thyresit të idhujve.

Dhuntia e dytë: **"...dhe pasardhësve të tij u dhamë Profecinë dhe Librin..."**. Profecia nuk ka qenë vetëm te Is'haku dhe Jakubi (*Paqja e All'Ilahut qoftë mbi ta!*), por ajo vazhdoi në gjenezën e Ibrahimit deri te vula e Profetëve hazreti Muhammedi (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), të cilët ndriçuan mbarë botën me dritën e monoteizmit.

Dhuntia e tretë: **"...Ne i dhamë atij shpërblim në këtë botë..."**. Cili është ky shpërblim që nuk e përmend Kur'ani? Ka mundësi që të tregojë për çështje të ndryshme si emri i mirë, thënia e së vërtetës, lavdërimi të të gjithë popujt, sepse të gjithë popujt e respektojnë Ibrahimin (*Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!*) dhe të gjithë e pranojnë se ai është Profet i madh dhe me pozitë të lartë. Ata krenohen me praninë e tij dhe e quajnë "Babai i Profetëve".

¹ Hulumtimi i plotë rreth emigrimit të hazreti Ibrahimit (*Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!*) nga Babilonia për në Sham gjendet në komentimin e ajetit 71 të sures "Enbija" të këtij komentimi, prandaj mund ta lexoni.

Lulëzimi i tokës së Mekës është bërë për shkak të lutjes së hazreti Ibrahimit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*). Miliona njerëz, çdo vit shkojnë në Mekë për të kujtuar besimin dhe sakrificat e Profetit Ibrahim. E gjitha kjo është prej shpërblimit të tij që përmendet në ajet.

Dhuntia e katërt: “...ndërsa në Jetën Tjetër, me siguri, ai do të jetë prej njerëzve të mirë.”. Këto janë katër dhuntitë madhështore që All'llahu i Madhëruar ia dhuroi hazreti Ibrahimit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*).

Dy hulumtime

Krenaria më e madhe

Shoqërimi me të mirët, ashtu siç rezulton në shumë ajete të Kur'anit, është kurora e krenarisë. Këtë pozitë e fiton një njeri që e meriton. Për këtë, shumë prej të Dërguarve e lusnin All'llahun që t'i bashkonte me të mirët dhe t'i fuste në radhët e tyre.

Ky është Jusufi (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*). Kur arriti fitoren dhe triumfin e madh, e luti All'llahun duke thënë: **“...Më bëj që të vdes si mysliman dhe më shoqëro me punëmirët (në Botën Tjetër)!”**.¹

¹ Sure “Jusuf”, ajeti 101.

Edhe hazreti Sulejmani (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) me gjithë postin dhe pasurinë e madhe që kishte, i kërkoi All'llahut: **"...Më prano, me mëshirën Tënde, në gjirin e robve të Tu punëmirë!"**.¹

Edhe Shuajbi (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) ky Profet i madh, kur lidhi kontratën e bashkëpunimit me Musain (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), i tha atij: **"...Ti do të shohësh, në dashtë All'llahu, se jam një njeri i mirë."**²

Edhe Ibrahimimi (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) i kërkoi All'llahut që të ishte në radhët e punëmirëve duke thënë: **"O Zoti im, më dhuro dituri dhe më radhit me të mirët!"**.³

Po ashtu, hazreti Ibrahimimi (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) i lutej All'llahut duke thënë: **"O Zoti im, dhuromë një fëmijë prej të mirëve!"**.⁴

Gjithashtu, në shumë ajete të Kur'anit vërehet se All'llahu i Madhëruar kur i lavdëron Profetët e Tij të mëdhenj, i cilëson se janë prej "njerëzve të mirë". Nga të gjitha këto ajete përfitohet se faza më e lartë e njeriut është të jetë rob i mirë.

Ç'është **"islahu"**? Me fjalë të tjera: Çfarë do të thotë që njeriu të jetë i mirë? Kuptimi është që të jetë besimtar, punëmirë, i sinqertë në vepra dhe në thënie dhe të mbartë moral të lartë e të pëlqyer.

¹ Sure "Neml", ajeti 19.

² Sure "Kasas", ajeti 27.

³ Sure "Shuara", ajeti 83.

⁴ Sure "Safat", ajeti 100.

E kundërta e të mirit është i keqi. Ne e dimë se thënia “shkatërrim në tokë” përfshin të gjitha llojet e padrejtësisë dhe të punëve të këqija. Në Kur'an herë përdoret fjala “*salah*” dhe e kundërta “*el fesad*” dhe herë tjetër përdoret fjala “*sejjietun*” dhe ka kuptimin e gjynahut dhe të asaj që nuk është e përshtatshme.

Dhuntitë madhështore të Ibrahimit

Disa komentues kanë thënë: Ajeti i lartpërmendur ka një çështje tërheqëse dhe delikate, sepse All'llahu i ndryshoi të gjitha gjërat dhe gjendjet që e shqetësonin dhe e mërzitnin Ibrahimin, në të kundërtën e tyre.

Idhujtarët e Babilonisë deshën ta digjin me zjarr, i cili u shndërua në lulishte paqeje.

Donin që Ibrahim (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) të qëndronte në vetmi dhe larg njerëzve, kurse All'llahu i dha atij bashkësi madhështore dhe profecinë e vendosi në gjenezën e tij.

Disa prej të afërmeve të tij ishin idhujtarë si Azeri, mirëpo All'llahu, në vend të tyre i dhuroi atij fëmijë të udhëzuar, besimtarë dhe udhëzues për të tjerët.

Në fillim të jetës së tij Ibrahim (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) nuk kishte as post e as pasuri dhe All'llahu Fuqiplotë i dhuroi atij pasuri dhe post.

Në fillim ishte i panjohur dhe njerëzit nuk e njihnin deri edhe idhujtarët e Babilonisë, kur në fillim thanë: “...Dëgjuam një djalosh që i përgojonte, quhej Ibrahim.”¹ Por All'llahu i

¹ Sure “Enbija”, ajeti 60.

Madhruar e lartësoi atë në majat më të larta. E ka lartësuar deri në atë masë, saqë ka marrë epitetin “Babai i Profetëve”.¹

¹ Tefsiri “El Kebijr”, vëll. 25, f. 56.

Ajetet: 28 – 30

وَلَوْ ظَا إِذْ قَالَ لِقَوْمِهِ ۖ إِنَّكُمْ لَتَأْتُونَ الْفَاحِشَةَ مَا سَبَقَكُمْ بِهَا مِنْ أَحَدٍ مِّنَ
 الْعَالَمِينَ ﴿٢٨﴾ أَيْنَكُمْ لَتَأْتُونَ الرِّجَالَ وَتَقْطَعُونَ السَّبِيلَ وَتَأْتُونَ فِي نَادِيَكُمُ
 الْمُنْكَرَ ۖ فَمَا كَانَ جَوَابَ قَوْمِهِ ۖ إِلَّا أَنْ قَالُوا أَتَيْنَا بِعَذَابِ اللَّهِ إِنْ كُنْتَ مِنَ
 الصَّادِقِينَ ﴿٢٩﴾ قَالَ رَبِّ أَنْصُرْنِي عَلَى الْقَوْمِ الْمُفْسِدِينَ ﴿٣٠﴾

“Kur Luti i tha popullit të vet: ‘Vërtet, ju bëni të tilla lapërdhi, që askush para jush nuk ka bërë në botë.’”

“Ju bëni marrëdhënie me meshkuj, u zini pusi atyre dhe në tubimet tuaja bëni punët më të ndyra.”

“Populli i tij nuk kishte tjetër përgjigje, përveçse: ‘Na e sill dënimin e All’lلاهut, nëse thua të vërtetën!’”

“Ai tha: ‘O Zoti im, më ndihmo kundër popullit që bën mbrapshti!’”

Komentimi

Të devijuarit (të shthururit) seksualë

Pas sqarimit të asaj që i ndodhi Ibrahimit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), Kur'ani flet për një pjesë të historisë së Profetit bashkëkohës të Profetit Ibrahim, Profeti Lut (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) duke thënë: **“Kur Luti i tha popullit të vet: ‘Vërtet, ju bëni të tilla lapërdhi, që askush para jush nuk ka bërë në botë.’”**.

Fjala *“el fahishatu”* siç e kemi thënë edhe më parë vjen nga rrënja *“fehashe”*, që në origjinalitet do të thotë çdo punë dhe thënie shumë e keqe. Këtu ka kuptimin e devijimit seksual, homoseksualitetit. Nga fjalia: **“...që askush para jush nuk ka bërë në botë”** kuptohet fare qartë se kjo punë e ndytë dhe e poshtër nuk kishte ndodhur më parë në formë të përgjithshme te asnjë popull apo komb, ashtu siç ndodhi me popullin e Lutit.

Për gjendjen e popullit të Lutit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) kanë përmendur se një prej faktorëve të njollosjes së tyre me këtë gjynah ka qenë se ata ishin shumë kopracë. Përderisa vendbanimet e tyre ndodheshin në rrugët ku kalonin karvanet e Shamit, ata ua shfaqnin këtë devijim seksual disa miqve të tyre apo kalimtarëve me qëllim që të neveriteshin dhe të mos i prisnin në shtëpitë e tyre. Mirëpo, atyre iu bë zakon kjo punë e ndytë, iu forcua dëshira e homoseksualitetit dhe dalëngadalë ranë në baltën e poshtërimit e të degjenerimit.

Ata do të mbajnë gjynahet e veta dhe të atyre që e bëjnë atë, siç thotë ajeti i Kur'anit: **“Ata, do t'i mbartin barrët e veta e bashkë me to edhe barrë të tjera dhe patjetër, që do të pyeten Ditën e Kiametit për gjithçka, që trillonin.”**. Kjo sepse ata janë themeluesit e kësaj veprë të fëlliqur e shkatërruese. Ne e dimë se kushdo që shpik diçka, ai është bashkëpunëtor me ata që e veprojnë atë shpikje.

Luti (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), ky Profet i madh u tha atyre: **“Juve bëni marrëdhënie me meshkuj...”**. Vallë ju doni të ndërprisni shtimin e njerëzimit?¹ Gjithashtu, nuk u vjen turp për punët poshtëruese në vendet e përgjithshme publike: **“...u zini pusi atyre dhe në tubimet tuaja bëni punët më të ndyra...”**.

Fjala *“nadij”* që përmendet në ajet, rrjedh nga fjala *“en nidau”*, që do të thotë tubim i përgjithshëm. Gjithashtu, ka raste që vjen me kuptimin e shëtijes (shëtitores), sepse personat atje thërrasin njëri-tjetrin dhe ngrihen zërat.

Këtu Kur'ani sqaron se çfarë të këqijash bënin në tubimet e tyre. Por, sigurisht që ato vende kanë qenë në përputhje me punët poshtëruese të tyre. Siç përmendet në histori, ata ofendonin njëri – tjetrin me fjalë banale, rriheshin, luanin bixhoz, godisninin njëri-tjetrin me guralecë apo godisnin kalimtarët, përdornin mjete të

¹ Disa komentues kanë mendime të tjera rreth fjalisë **“dhe ndërprisni rrugën”**. Prej atyre mendimeve është se ata thonë se duhet parë të shkuarën e tyre dhe historinë e tyre të njohur. Kjo ka kuptimin e ndërprerjes së rrugës njerëzve që udhëtonin. Sepse karvanet detyroheshin të ecnin në rrugë të pashkelur për t'ju larguar të keqes së tyre dhe të mos sprovoheshin me ta. Disa të tjerë e kanë komentuar si vjedhje e pasurisë së udhëtarëve me karvane. Por me sa duket, komentimi i parë që përmendet në tekst është më i përshtatshëm me ajetin. Kjo se prej shkaqeve dhe filozofisë së ndalimit të homoseksualitetit është ndërprerja e gjenezës dhe e pasardhësve, siç kanë thënë edhe transmetimet.

ndryshme muzikore dhe zbulonin pjesët e turpshme në shoqërinë e tyre, dilnin të zhveshur etj.¹

Në një hadith të transmetuar nga Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) siç e ka përcjellë Ummu Hanij, për komntimin e thënies: “...u zini pusi atyre dhe në tubimet tuaja bëni punët më të ndyra...”, ai ka thënë: “Ata i gjuanin atij që kalonte dhe e tallnin.”² Që do të thotë i gjuanin me gurë dhe talleshin me të.

Tani të shohim se cila ishte përgjigja e atij populli të humbur e të devijuar ndaj fjalëve logjike të hazreti Lutit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*). Kur’ani thotë: “...**populli i tij nuk kishte tjetër përgjigje, përveçse tha: ‘Na e sill dënimin e All'llahut, nëse thua të vërtetën!’**”. Vërtet kjo ishte përgjigja e atyre që kishin humbur logjikën dhe dijen. Ata iu përgjigjën në mënyrë tallëse dhe ofenduese fjalëve logjike dhe arsyetuese të hazreti Lutit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*).

Nga kjo përgjigje e tyre kuptohet mirë se Luti (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), përveç thënieve të qarta dhe argumenteve bindëse për të hequr dorë nga vepra e tyre e shëmtuar, i kërcënoi ata me dënimin e All'llahut. Por ata i hodhën pas shpine porositë e tij dhe e kërcënuan me ndëshkim. Ata thanë: “...**Na e sill dënimin e All'llahut...**” në mënyrë tallëse dhe qesharake. Kjo çështje përmendet edhe në ajetin 36 të sures “Kamer” ku thuhet: “**Në fakt, Luti i paralajmëroi ata për fuqinë e dënimit Tonë, por ata i vunë në dyshim paralajmërimet.**”.

¹ “Sefinetul Bihar”, vëll. 2, f. 517.

² Tefsijri “El Kurtubij”, komentimi i ajetit në fjalë.

Sipas thënies së tyre, ata donin të konkludonin moszbritjen e dënimit, ndërkohë që mëshira e All'llahut u jep atyre kohë që të llogarisin vetat e tyre dhe të mendojnë thellë.

Këtu Lutit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) nuk i mbeti gjë tjetër, veçse t'i drejtohet All'llahut me zemër të hidhëruar e i shqetësuar: **“Ai tha: ‘O Zoti im, më ndihmo kundër popullit që bën mbrapshti!’”**.

Më ndihmo ndaj popullit të devijuar dhe shkatërues të tokës, të cilët braktisën moralet njerëzore dhe devotshmërinë; e hodhën pas shpine pastërtinë dhe nderin; e nëpërkëmbën drejtësinë shoqërore; e përzinë idhujtarinë me moralet e këqija dhe me padrejtësinë; kërcënuan vazhdimësinë e njerëzisë me zhdukje. Prandaj, o Zoti im, më ndihmo ndaj atij populli shkatërues.

Fatkeqësia e devijimit seksual

Devijimi seksual, qoftë mes meshkujve “homoseksualiteti” apo mes femrave “lesbizmi” është prej devijimeve më të shëmtuara morale dhe burimi i shkatërrimit të shumë shoqërive. Në parim, natyra e mashkullit dhe e femrës janë krijuar në atë formë që secili i jep qetësi dhe ngopje të rregullt epshit seksual me marrëdhënien seksuale mes tyre nëpërmjet martesës së rregullt. Çfarëdo lloj epshi seksual jashtë martesë është devijim nga natyra e drejtë e njeriut. Ai është një lloj sëmundje psikike, e cila nëse qëndron, rreziku i saj bëhet akoma më i madh dhe rezultati i saj çon në ftohje seksuale mes mashkullit dhe femrës

dhe në përhapjen e marrëdhënieve të devijuara burrë me burrë dhe grua me grua.

Marrëdhëniet e jashtëligjshme kanë ndikim të madh shkatërrues në trup, në sistemin nevor dhe në dobësimin e lartë seksual. Ata nuk kanë mundësi të jenë prindër në të ardhmen. Për shkak të këtij devijimi seksual mund të humbasin aftësinë e lindjes së fëmijëve në të ardhmen.

Të devijuarit seksualë, dalëngadalë largohen nga shoqëria dhe mbeten në vetmi. Kanë ndjenjën se janë të huaj në shoqërinë e tyre. Po ashtu, kanë problem edhe në personalitetin e tyre. Nëse nuk i ndreqin vetat e tyre, ata mund të goditen me sëmundje të ndryshme trupore dhe psikike. Për këtë shkak dhe për shkaqe të tjera morale e sociale, Islami e ka ndaluar rreptësisht devijimin seksual i cilitdo lloji qoftë dhe në çfarëdo forme. Për vepruesit e kësaj marrëdhënieje, Islami ka caktuar dënim të rëndë e të ashpër që arrin deri në vrasje. Është për të ardhur keq se në shoqëritë e përparuara materialiste, shumë të rinj dhe të reja po zhyten në llumin e këtij devijimi të rrezikshëm seksual. Ajo që është më e keqja, është se ky devijim ka marrë edhe ngjyra ligjore, duke e konsideruar këtë vepër të zakonshme dhe të padënueshme. Por, lapsi turpërohet të shkruajë më tepër për këtë vepër të ndytë, të shëmtuar, të rrezikshme, degjeneruese dhe shkatërruese.¹

¹ Në fundin e komentimit të ajetit 81 të sures "Hud" nga ky komentim, kemi folur më gjerë për devijimin seksual.

Ajetet: 31 - 35

وَلَمَّا جَاءَتْ رُسُلُنَا إِبْرَاهِيمَ بِالْبُشْرَى قَالُوا إِنَّا مُهْلِكُوا أَهْلَ هَذِهِ الْقَرْيَةِ إِنَّا أَهْلُهَا كَانُوا ظَالِمِينَ ﴿٣١﴾ قَالَ إِنَّ فِيهَا لُوطًا قَالُوا نَحْنُ أَعْلَمُ بِمَن فِيهَا لَنُنَجِّيَنَّهُ وَأَهْلَهُ إِلَّا أُمَّرَأَتَهُ كَانَتْ مِنَ الْغَابِرِينَ ﴿٣٢﴾ وَلَمَّا أَن جَاءَتْ رُسُلُنَا لُوطًا سِئَاءَ بِهِمْ وَضَاقَ بِهِمْ ذَرْعًا وَقَالُوا لَا تَخَفْ وَلَا تَحْزَنْ إِنَّا مُنْجُوكَ وَأَهْلَكَ إِلَّا أُمَّرَأَتَكَ كَانَتْ مِنَ الْغَابِرِينَ ﴿٣٣﴾ إِنَّا مُنْزِلُونَ عَلَى أَهْلِ هَذِهِ الْقَرْيَةِ رِجْزًا مِّنَ السَّمَاءِ بِمَا كَانُوا يَفْسُقُونَ ﴿٣٤﴾ وَلَقَدْ تَرَكْنَا مِنْهَا آيَةً بَيِّنَةً لِّقَوْمٍ يَعْقِلُونَ ﴿٣٥﴾

“Dhe, pasi të dërguarit Tanë i sollën lajmin e mirë Ibrahimit, i thanë: ‘Ne do t’i zhdukim banorët e këtij vendbanimi, sepse banorët e tij janë vërtet të padrejtë.’. Ai tha: ‘Por atje banon edhe Luti!’. Ata thanë: **‘Ne e dimë më mirë kush është atje. Ne do ta shpëtojmë atë dhe familjen e tij, përveç gruas së tij: ajo do të qëndrojë me ata që do të mbesin.’”**

“Kur të dërguarit Tanë shkuan te Luti, ai u shqetësua dhe iu ngushtua zemra. Ata i thanë: ‘Mos u frikëso dhe mos u brengos! Ne do të të shpëtojmë ty dhe familjen tënde, përveç gruas tënde. Ajo do të mbesë me ata që janë për dënim.’”

“Në të vërtetë, Ne do të lëshojmë dënim nga qielli, mbi banorët e këtij vendbanimi, ngase ata janë të prishur.”

“Dhe tashmë Ne e kemi lënë atë një shenjë të dukshme për njerëzit që kuptojnë.”

Komentimi

Fundi i të devijuarve

Më së fundi, All'llahu iu përgjigj lutjes së Lutit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) dhe Ai urdhëroi për dënim të rëndë e të dhemshëm të atij populli devijues e të shthurur. Melekët e urdhëruar për ndëshkimin e popullit të Lutit, kaluan nga vendi ku banonte Ibrahimimi (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), me qëllim që të përcillnin një mesazh tjetër para dënimit të popullit të Lutit. Mesazhi paraprijës i ndëshkimit ishte përgëzimi i hazreti Ibrahimit: “Ata e përgëzuan për Is’hakun dhe pas Is’hakut për Ja’kubin.”

Ajetet e larpërmendura, së pari, përmendin shkuarjen e melekëve tek Ibrahimimi. Ajeti thotë: **“Dhe, pasi të dërguarit Tanë i sollën lajmin e mirë Ibrahimit, i thanë: ‘Ne do t’i zhdukim banorët e këtij vendbanimi, sepse banorët e tij janë vërtet të padrejtë.’”**.

Shprehja **“banorët e këtij vendbanimi”** tregon se vendbanimet e popullit të Lutit ndodheshin afër tokës ku banonte Ibrahimimi.

Shprehja “dhalimijne” – “të padrejtë” është përdorur për ata, të cilët i bënë padrejtësi vetave të tyre duke ndjekur rrugën e politeizmit, të degjenerimit moral dhe të ndytësisë. Padrejtësia e tyre përfshiu edhe karvanët, edhe këmbësorët që kalonin në rrugën e tyre.

Kur Ibrahim (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) e dëgjoi këtë lajm për Profetin Lut (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!), u hidhërua: **“Ai (Ibrahimi) tha: ‘Por atje banon edhe Luti!’”**. Cili do të jetë fundi i tij? Ata iu përgjigjën menjëherë: **“Ata thanë: ‘Ne e dimë më mirë kush është atje.’”**. Prandaj mos u shqetëso për të! Ne nuk do të djegim gjithçka, sepse plani ynë është i studiuar dhe i saktë. Pastaj thanë: **“Ne do ta shpëtojmë atë dhe familjen e tij, përveç gruas së tij: ajo do të qëndrojë me ata që do të mbesin (për t’u dënuar).”**.

Nga ky ajet përfitohet se vetëm një familje ishte besimtare dhe e papërlyer në të gjitha ato vende, të cilën e shpëtoi All'llahu. Këtë e lexojmë edhe në ajetin 36 të sures “Dharijat” që thotë: **“ndonëse aty gjetëm vetëm një shtëpi myslimane”** edhe pse ishte gjendja e tillë, gruaja e Lutit ishte jashtë grupit besimtar dhe e përfshiu dënimi.

Fjala “*el gabjrine*” është shumësi i fjalës “*gabirun*”, që do të thotë i prapambeturi i grupit që përshkon një rrugë. Gruaja, që ishte në familjen Profetike, nuk duhet të ndahej nga besimtarët dhe myslimanët. Por, idhujtaria, paganizmi, politeizmi e bënë atë të ndahet!. Nga kjo kuptohet se devijimi i saj ka qenë në besim. Nuk është e largët që ky devijim i saj ishte për shkak të ndikimit nga ambienti rrethues. Në fillim ka qenë besimtare monoteiste.

Për këtë, Luti (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) nuk ka patur probleme me martesën me të.

Një grup besimtarësh që i besuan Lutit, patjetër që emigruan nga ajo tokë e përlyer para ndodhisë së dënimit, përveç Lutit dhe familjes së tij, sepse për të ishte detyrë të qëndronte deri në momentet e fundit në atë vend se ndoshta mund të ndikonte predikimi dhe tërheqja e vëmendjes.

Këtu lind pyetja: Vallë, a e mendonte Ibrahimimi se dënimi i All'llahut do ta përfshinte edhe Lutin kur shfaqti ndikimin e tij para melekëve mesazhsjellës dhe ata e qetësuan me shpëtimin e Lutit?

Përgjigjja e kësaj pyetjeje është e qartë. Ibrahimimi (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) e dinte të vërtetën, por i pyeti ata për të qetësuar zemrën e tij. E njëjtë si kjo pyetje ishte edhe ajo që pyeti hazreti Ibrahimimi për çështjen e Ringjalljes së të vdekurve dhe All'llahu Fuqiplotë ia sqaroi me ringjalljen e katër shpendëve që t'i qetësohej zemra.

Eruditi dhe komentuesi i madh Tabatabai beson se qëllimi në pyetjen e Ibrahimimit ishte se prania e Lutit në mesin e atij populli do të jetë argument i largimit të dënimit prej tyre. Për argument, ai sjell ajetet 74-76 të sures "Hud". Këto ajete sqarojnë se Ibrahimimi, me thënien e tij: "**atje banon edhe Luti!**", ka patur si qëllim largimin e dënimit, sepse në të ndodhej Luti dhe shkatërrimi i popullit të atij vendi do ta përfshinte edhe Lutin. Ata

iu përgjigjën se e dinin këtë dhe se ka të tjerë me të që nuk i përfshin, që janë familja e tij, me përjashtim të gruas së vet.”¹

Por ne besojmë se kjo përgjigje prej melekëve, për shpëtimin e Lutit dhe të familjes së tij, tregon qartë se në ajet bëhet fjalë vetëm për Lutin. Ajetet e sures “Hud” flasin me detaje për temën. Ashtu siç e thamë, Ibrahim i donte të qetësohej zemra e tij.

Këtu mbaruan fjalët e melekëve me Ibrahimin dhe ata iu drejtuan vendbanimit të Lutit dhe të popullit të tij. Për këtë Kur’ani thotë: **“Kur të dërguarit Tanë shkuan tek Luti, ai u shqetësua dhe iu ngushtua zemra...”**. Shqetësimi i tij ishte sepse nuk i njihte ata. Ata i shkuan atij në formën e djelmoshave me mjekra. Ardhja e këtyre lloj miqve në atë ambient të përlyer e të ndytë e shqetësonte shumë Lutin me qëllim që të mos turpërohej prej tyre. Për këtë mendoi se si do të reagoonte ai popull i devijuar, i çmendur, i paturpshëm dhe i shthurur ndaj këtyre miqve?!

Fjala “*sii’e*” rrjedh nga fjala “*sāe*” që do të thotë gjendje e keqe.

Fjala “*edh dher’u*” ka kuptimin e zemrës dhe moralit. Kështu që kuptimi i thënies “*daka bihim dher’u*” është “*daka kalbuhu ue inzeaxhe*” – “*iu ngushtua zemra dhe u shqetësua*”.

Disa komentues kanë thënë se në origjinalitet kjo fjalë ka kuptimin e distancës mes anëve të mushkave gjatë ecjes. Kur i ngarkojnë me barra të rënda, ecin më ngadalë dhe e ngushton distancën. Për thënien “*daka dheran*” kanë thënë që është metaforë për ndodhinë e rëndë e të vështirë, që nuk durohet.

¹ Tefsiri “El Mijzan”, vëll. 16, f. 129.

Kur miqtë e vunë re shqetësimin e tij, e zbuluan identitetin e tyre dhe ia larguan shqetësimin: **“Ata i thanë: ‘Mos u frikëso dhe mos u brengos! Ne do të të shpëtojmë ty dhe familjen tënde, përveç gruas tënde. Ajo do të mbesë me ata që janë për dënim.’”**.

Prej ajeteve në suren “Hud” përfitohet se ai popull i ulët e i poshtër kur morën vesh për praninë e miqve të Luti, shpejtuan për tek ai. Qëllimi i tyre ishte t’i përdhunonin ata miq. Hazreti Luti akoma nuk e dinte të vërtetën e miqve dhe për këtë ishte shumë i shqetësuar. Ai herë i këshillonte, herë i kërcënonte, herë i thoshte: **“A nuk ka midis jush një njeri me mend?”**¹ që të zgjonte ndërgjegjen e tyre. Ai u propozoi atyre edhe martesën me vajzat e veta për t’i ndaluar që t’i afroreshin miqve të tij. Por ata të devijuar e të paturpshëm nuk pranuan asgjë dhe mendonin vetëm për qëllimin e tyre të poshtër e të ulët. Të dërguarit e All’llahut (melekët) ia prezantuan hazreti Lutit (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) veten e vet. Ata ia verbuan shikimin atij populli dhe ia qetësuan zemrën hazreti Lutit.²

Ajo që duhet përmendur është se të dërguarit e All’llahut (melekët) i thanë Lutit: Mos u frikëso dhe mos u shqetëso! Çfarë dallimi ka mes fjalës “frikë” dhe “hidhërim”?

Autori i tefsijrit “El Mijzan” përmend se frika vjen prej ndodhive që supozohet se mund të ndodhin, kurse hidhërimi vjen prej ndodhive që ndodhin vërtet.

Disa të tjerë kanë thënë: Frikë quhen ndodhitë e ardhshme, kurse shqetësim ato që kanë ndodhur në të shkuarën. Po ashtu,

¹ Sure “Hud”, ajeti 78.

² Detajet e këtij hulumtimi i kemi përmendur në komentimin e ajeteve 77-81 të sures “Hud”, prandaj mund ta lexoni.

thuhet se frika është për çështje të rrezikshme, kurse hidhërimi për çështje të dhimbshme, edhe nëse në të nuk ka rrezik.

Këtu lind çështja: Sipas ajeteve të sures “Hud”, frika e Lutit nuk ishte për veten e tij, por ai i frikësohej miqve të tij.¹ Kurse përgjigja e melekëve lidhej me shpëtimin e Lutit dhe të familjes së tij. Këto dy çështje nuk përputhen me njëra-tjetrën.

Përgjigja e kësaj çështjeje gjendet në formë përmbledhëse në ajetin 81 të sures “Hud”, sepse populli i devijuar, kur zgjatën duart e tyre drejt miqve, melekët thanë: O Lut, ne jemi të dërguarit e Zotit tënd. Ata nuk do të mbërrijën tek ti. Kjo është e thjeshtë për ne. Tek ti nuk mbërrin e keqja e tyre. Për këtë, melekët besonin se shpëtimi ishte i thjeshtë për ta, prandaj u përqëndruan vetëm në përgëzimin e Lutit dhe të familjes së tij.

Pas kësaj, me qëllim që të sqaroheshin hapat e veprës së tyre (melekëve), për dënimin e atij populli të devijuar, thanë: **“Në të vërtetë, Ne do të lëshojmë dënim nga qielli, mbi banorët e këtij vendbanimi, ngase ata janë të prishur.”**

Kuptimi i fjalës “*el karjetu*” është për “Sodomin”² dhe ato që e rrethonin prej vendbanimeve në të cilat banonin populli i Lutit. Disa thonë se numri i banorëve të tyre ka qenë shtatëqind mijë vetë.³

¹ Fjala “*dajfun*”- “*mik, miqtë*”, përdoret edhe për njëjës, edhe për shumës. Shumësi i tij është edhe “*dujuf*” dhe “*edjaf*”.

² Bëhet fjalë për qytetin e Sodomit, që ndodhej në Palestinë, në jug të Detit të Vdekur.

³ Tefsiri “*Ruhul Bejan*”, vël. 6, f. 467.

Kuptimi i fjalës “rixhzun” është për dënimin. Kuptimi origjinal i kësaj fjale është “shqetësimi”, e pastaj thanë se çdo gjë që çon në “idhtirab” është rixhz. Po kështu, arabët e kanë përdorur fjalën rixhz në shumë kuptime si, sprovat e mëdha, sëmundja e murtajës, ftohti, idhujt, cytjet e djallit, dënimi i All’llahut etj.

Fjalja “ngase ata janë të prishur” është shkak i dënimit të tyre, sepse ata nuk iu bindën All’llahut. Prania e foljes në kohën e tashme “jefsukune” është argument për vazhdimësinë e tyre në këtë vepër të shëmtuar.

Kjo thënie e këtë të vërtetë: Sikur ata të mos vazhdonin në gjynah, të pendoheshin dhe të ktheheshin në rrugën e drejtë e të devotshmërisë, nuk do të sprovoheshin me këtë dënim dhe gjynahet e shkuara do t’u faleshin atyre. Kur’ani nuk përmend këtu mënyrën e dënimit të rëndë veçse thotë: **“Dhe tashmë Ne e kemi lënë atë një shenjë të dukshme për njerëzit që kuptojnë.”**

Mirëpo në suren “Hud” ajeti 81 dhe në ajetin 84 është detajimi i dënimit. Vendbanimet e tyre i goditi një tërmet i fuqishëm, ku çdo gjë e ktheu përmbys, e pastaj ranë gurë prej qiellit të cilët mbuluan gjithçka.

Fraza **“një shenjë të dukshme”** tregon për gjurmët e mbetura të qytetit “Sodom”, i cili ndodhej në rrugën e karvaneve të banorëve të Hixhazit, sipas ajeteve të Kur’anit. Ai ishte deri në kohën e ardhjes së Profetit, siç lexojmë në ajetin 76 të sures “Hixhr”: **“Qyteti i rrënuar është në rrugë, ku gjendet edhe tani.”** dhe në ajetet 137-138 të sures “Safat”: **“Ju që kaloni pranë rrënojave të tyre në mëngjes dhe natën, a nuk po e mblidhni mendjen?”**.

Ajetet 36 - 40

وَالِى مَدْيَنَ أَخَاهُمْ شُعَيْبًا فَقَالَ يٰقَوْمِ اعْبُدُوا اللَّهَ وَارْجُوا الْيَوْمَ الْآخِرَ وَلَا تَعْتَوْا فِي الْأَرْضِ مُفْسِدِينَ ﴿٣٦﴾ فَكَذَّبُوهُ فَأَخَذَتْهُمُ الرَّجْفَةُ فَأَصْبَحُوا فِي دَارِهِمْ جِثْمِينَ ﴿٣٧﴾ وَعَادًا وَثَمُودًا وَقَدْ تَبَيَّنَ لَكُمْ مِّن مَّسْكِنِهِمْ^ط وَزَيْنَ لَهُمُ الشَّيْطٰنُ أَعْمَلَهُمْ فَصَدَّهُمْ عَنِ السَّبِيلِ وَكَانُوا مُسْتَبْصِرِينَ ﴿٣٨﴾ وَقُرُونِ وَفِرْعَوْنَ وَهَمٰنَ^ط وَلَقَدْ جَاءَهُمْ مُّوسَىٰ بِ الْبَيِّنٰتِ فَلَسْتُكْبِرُوا فِي الْأَرْضِ وَمَا كَانُوا سَابِقِينَ ﴿٣٩﴾ فَكَلَّا أَخَذْنَا بِذَنبِهِ^ط ۖ فَمِنْهُمْ مَّنْ أَرْسَلْنَا عَلَيْهِ حَاصِبًا وَمِنْهُمْ مَّنْ أَخَذَتْهُ الصَّيْحَةُ وَمِنْهُمْ مَّنْ خَسَفْنَا بِهِ الْأَرْضَ وَمِنْهُمْ مَّنْ أَغْرَقْنَا وَمَا كَانَ اللَّهُ لِيُظْلِمَهُمْ وَلٰكِنْ كَانُوا أَنْفُسَهُمْ يَظْلِمُونَ ﴿٤٠﴾

“Edhe banorëve të Medjenit (i dërguam) vëllanë e tyre, Shuajbin. Ai u tha: ‘O populli im! Adhuroni All’Ilahun, shpresoni në Ditën e Fundit dhe mos bëni keq në tokë, si ngatërrestarë!’”

“Por, ata e përgënjeshtroan atë, prandaj i goditi një tërmet i tmerrshëm e si pasojë u gdhinë në shtëpitë e tyre të vdekur e të gjunjëzuar.”

“E njëjta gjë u ndodhi edhe fiseve Ad dhe Themud, gjë që ju është bërë e qartë prej (gjurmëve të) banimeve të tyre. Atyre

shejtani ua kishte zbukuruar veprat e veta dhe i kishte shmangur nga rruga e drejtë, edhe pse qenë largpamës.”

“Kështu ndodhi edhe me Karunin, Faraonin dhe Hamanin! Atyre u vajti Musai me prova të qarta, por ata treguan mendjemadhësi në Tokë dhe nuk i shpëtuan dënimit.”

“Ne të gjithë i dënuam për gjynahun e vet: disave u dërguam furtunë, disa syresh i goditi një zë i tmerrshëm, disa prej tyre i gëlltiti toka dhe të tjerët i përmbyti uji. All’llahu nuk u bëri atyre padrejtësi, por ata i bënë padrejtësi vetvetes.”

Komentimi

Llojshmëria e dënimeve të të padrejtëve

Pas paraqitjes së historisë së hazreti Lutit (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) dhe popullit të tij, këtu bëhet fjalë për popuj të tjerë si ai i Shuajbit, Adit, Themudit, si dhe, për Karunin dhe Faraonin. Në ajetet në fjalë përmenden të gjithë në mënyrë të përmbledhur e të ngjeshur për të nxjerrë përfundime dhe mësim. Në fillim, ajeti thotë: **“Edhe banorëve të Medjenit (i dërguam) vëllanë e tyre, Shuajbin...”**¹

Përdorimi i shprehjes **“vëllanë e tyre”**, siç e kemi thënë gjithmonë, tregon për dashurinë e madhe të Profetëve për popujt

¹ Kjo fjali është e lidhur me fjalinë “Ne e dërguam Nuhun.”.

e tyre. Sigurisht që ata të Dërguar kanë patur afrimet me popullin.

Medjeni është qyteti që ndodhet në jugperëndim të Jordanisë dhe në lindje të gjirit të Akabes, i cili sot quhet Mean. Në këtë vend banonte Shuajbi (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) së bashku me popullin e tij.¹

Edhe Shuajbi, si Profetët e tjerë të mëdhenj, e filloi thirrjen e tij me ftesën në besimin tek All'llahu dhe te Ringjallja, që janë themelet e çdo feje: **“Ai u tha: ‘O populli im! Adhuroni All'llahun, shpresoni në Ditën e Fundit...’”**.

Besimi në All'llahun është shkak i ndjenjës së njeriut se All'llahu e mbikëqyr dhe gjithmonë ia shënon punët dhe veprat. Besimi në Ringjalljen i kujton njeriut gjykatën madhështore në të cilën do të japë llogari për gjithçka, sado e vogël dhe e pavlerë që mund t'i duket një vepër që bën. Dihet se besimi në këto dy parime ka ndikim të madh në edukimin e njeriut dhe në ndreqjen e tij.

Parimi i tretë, është si planprojkti i përgjithshëm, i cili i shpalos të gjitha planet shoqërore: **“...dhe mos bëni keq në tokë, si ngatërrestarë!”**.

Fjala *“mufsid”*, ka kuptim të gjerë dhe përfshin çdo të metë, devijim, shkatërrim, padrejtësi etj. Të kundërtat e kësaj fjale janë *“es salah”* dhe *“el islah”*, kuptimi i të cilave përfshin të gjitha planet ndreqëse dhe rregulluese.

¹ Rreth Medjenit kemi folur në fundin e ajetit 23 të sures “Kasas”.

Kurse fjala “*ta’tuu*” vjen nga rrënja “*atha*” dhe ka kuptimin e të keqes dhe të shkatërrimit. Në të shumtën e rasteve, kjo fjalë përdoret kur ka shkatërrim moral. Për këtë, përmendja e fjalës “*mufsidijne*” pas kësaj fjale e forcon këtë kuptim. Mirëpo, ai grup njerëzish, në vend që t’i dëgjonin këshillat dhe porositë e Profetit me veshët e zemrës, e kundërshtuan atë dhe e përgënjeshtruan. Ky përgënjeshttrim ishte shkak i goditjes së tyre nga tërmeti i fuqishëm: **“Por, ata e përgënjeshtruan atë, prandaj i goditi një tërmet i tmerrshëm e si pasojë u gdhinë në shtëpitë e tyre të vdekur e të gjunjëzuar.”**.

Fjala “*el xhathim*” ka kuptimin e uljes në gjunjë dhe të qëndrimit në një vend. Ka mundësi që ai popull të kenë qenë në gjumë kur ndodhi tërmeti i tmerrshëm. Kjo frazë tregon se kur ndodhi kjo ngjarje, ata u ngritën dhe qëndruan në gjunjë. Mirëpo, ndodhia nuk zgjati shumë, e muret u shembën mbi ta dhe në atë kohë zbriti edhe vetëtima dhe ata vdiqën.¹

Ajeti në vijim flet për Adin dhe Themudin, popujt e Hudit dhe të Salihut. Ai nuk përmend se çfarë u thanë Adi dhe Themudi të Dërguarve të tyre Hudit dhe Salihut dhe si iu përgjigjën atyre popujt e vet të pabindur. Kjo sepse ata janë përmendur në shumë ajete të Kur’anit dhe të dy ata kombe - kombi i Hudit dhe kombi i Salihut - janë të njohur. Për këtë ajeti thotë: **“Edhe (kombi) Ad dhe Themud...”**.

Më pas ajeti shton e thotë: **“...gjë që ju është bërë e qartë prej banimeve të tyre...”**. Pra, banimet e shkatërruara në rrugën tuaj, në zonën “Hexhr” dhe “Jemen”.

¹ Detajet e kësaj ndodhie të tmerrshme i kemi sqaruar tek ajetet 84-95 të sures “Hud”, në historinë e Shuaibit.

Për çdo vit ju kaloni me karvanët tuaj për tregti në tokën e “Hexher”, e cila ndodhet në veri të Gadishullit Arabik. Po ashtu, ju kaloni në “Ahkak”, që ndodhet në jug të Jemenit dhe i shihni gjurmët e banesave të shembura dhe mbetjet e tyre, që ishin të Adit dhe Themudit. A nuk po mësoni?!

Ajeti tregon shkakun kryesor të ndëshkimit dhe fundin e keq të tyre, duke thënë: **“Atyre shejtani ua kishte zbukuruar veprat e veta dhe i kishte shmangur nga rruga e drejtë...”**. Natyra e të Dërguarve ishte ajo që ka krijuar All’l-lahu. Ata ishin të devotshmëm. Kurrë nuk u kursyen në udhëzimin e njerëzve. U përpoqën mjaftueshëm duke i këshilluar dhe duke i porositur popujt e tyre. Edhe pse Profetët u përpoqën, popujt e tyre nuk besuan: **“...edhe pse qenë largpamës.”**.

Disa komentues kanë thënë se fjalia **“...edhe pse qenë largpamës”**, ka kuptimin se ata kanë qenë zotërues të mendjes. Disa të tjerë kanë thënë se ka kuptimin që ata kanë pasur natyrë të pastër. Një pjesë tjetër ka thënë se ka kuptimin e udhëzimit të Profetëve për ta.

Nuk është problem bashkimi i të gjitha këtyre kuptimeve në këtë ajet, sepse ata nuk kanë qenë të paditur, por e njihnin mirë të vërtetën. Ndërgjegjet e tyre ishin të gjalla dhe logjika e mjaftueshme. Profetët u sollën atyre argumente të qarta. Edhe pse ishin të tillë, ata devijuan nga rruga dhe shejtani u pëshpëriste atyre. Dita ditës, punët e këqija që bënin i shihnin të mira. Ata arritën në një fazë që nuk mund të ktheheshin nga ajo gjendje që ishin dhe kështu e pësuan.

Ajeti në vijim tregon emrat e tre tiranëve, ku secili prej tyre shfaqte aftësitë e tij djallëzore. **“Kujto edhe Karunin, Faraonin dhe Hamanin...!”**.¹

Karuni ishte i pasur dhe mendjemadh. Ai ishte i pavëmenshëm dhe adhuronte egon e tij. Faraoni e shfaqte fuqinë tiranike të shoqëruar me djallëzi, ndërsa Hamani ishte si ai që ndihmon të padrejtët dhe tiranët.

Pastaj Kur’ani thotë: **“Atyre u vajti Musai me prova të qarta...”** me argumente domethënëse: **“...por ata treguan mendjemadhësi në Tokë...”**. Karuni mbështetej te dija e tij për pasurinë dhe depozitat që kishte. Faraoni dhe Hamani mbështeteshin tek ushtria e tyre, te fuqia ushtarake dhe te fuqia e reklamimit të tyre në mesin e shtresave të paditura e të dobëta. Por, edhe pse çështja e tyre ishte e tillë, nuk shpëtuan, siç thotë edhe fundi i këtij ajeti: **“...dhe nuk i shpëtuan dënimit.”**. All’llahu e urdhëroi tokën që ta përpinte Karunin; urdhëroi ujin që është burimi i jetës, që t’i përpinte Faraonin dhe Hamanin; urdhëroi melekët për shkatërrimin e tyre. Çdo gjë që ishte burim i jetës së tyre, u bë shkak i zhdukjes së tyre.²

Fjala *“es sabikune”* ka kuptimin e atij që përparon dhe është para të tjerëve. Kuptimi i thënies **“nuk ishin të parë”**, është se ata nuk mundën të iknin prej sundimit të All’llahut edhe pse zotëronin gjithë ato mundësi. All’llahu i shkatërroi në kohën që Ai

¹ Fjalët: *Karunin, Faraoni dhe Hamanin*, janë kondrinorë të foljes aluduese *“kujto”*.

² Historia e Karunit është sqaruar në komentimin e ajeteve të sures *“Kasas”*. Shkatërrimi i Faraonit dhe i ndjekësve të tij është sqaruar në komentimn e sures *“Kasas”*. Po ashtu, përmendet edhe në suren *“A’raf”*.

dëshiroi, duke i poshtëruar ata. Pastaj ajeti thotë: **“Ne të gjithë i dënuam për gjynahun e vet...”**.

Në dy ajetet paraardhës Kur'ani përmend katër grupe dhe nuk përmend dënimin e tyre. Ata popuj ishin: 1- populli i Hudit (Adi), 2- populli i Salihut (Themudi) 3- Karunin 4- Faraonin dhe Hamanin. Në këtë ajet, sipas renditjes, Kur'ani përmend llojet e dënimit të tyre: **“...disave u dërguam furtunë...”**.

Fjala *“el hasib”* ka kuptimin e furtunës që mbart shumë gurë. *“El husbau”* janë gurët e vegjël. Frazja *“minhum”* ka për qëllim popullin e Hudit. Ashtu siç thuhet edhe në suret: *“Dharijat”*, *“Hakkah”* dhe *“Kamer”*, ata i goditi një furtunë e fortë për shtatë net dhe tetë ditë duke i shkatërruar. Kur'ani thotë: **“...të cilën All'Ilahu ua dërgoi atyre shtatë net dhe tetë ditë pa reshtur. Atëherë mund t'i vëreje njerëzit të përmbysur si trungjet e hurmave të kalbura. A sheh ndonjë gjurmë të tyre?”** (Sure *“Hakah”*, ajetet 7-8).

“...e disa prej tyre i goditi një zë i tmerrshëm...”. E kemi thënë se oshëtima qiellore vjen si rezultat i rrufesë, e cila është e shoqëruar me lëkundje (tërmet) në kohën e rënies. Ky është dënimi me të cilin All'Ilahu e dënoi Themudin (popullin e Adit). Në ajetin 67 të sures *“Hud”*, rreth Themudit, thuhet: **“Kurse ata që bënë të këqija, i kaploi një zë i tmerrshëm dhe në shtëpitë e tyre u gdhinë të vdekur e të palëvizshëm.”**.

Ajeti thotë: **“...disa prej tyre i gëlltiti toka...”**. Ky është dënimi i Karunit të pasur, mendjemadh dhe egoist, që ishte prej bijve të Izraelit. Për të flitet edhe në ajetin 81 të sures *“Kasas”*.

“... dhe të tjerët i përmbysi uji...”. Ky ishte dënimi i Faraonit dhe i Hamanit së bashku me ushtrinë e tyre. Kjo histori përmendet në sure të shumta në Kur’anin e Shenjtë.

Këto ishin katër llojet e dënimeve për grupet e përmendura në dy ajetet e lartpërmendura. Ato ajete treguan për devijimin, humbjen dhe gjynahet e tyre pa përmendur dënimin e secilit prej tyre. Dënimet që morën ata ishin për shkak të punëve të tyre. Ata mbollën gjynahe dhe korrën dënim. Në fund të ajetit All’llahu i Madhëruar thotë: **“...All’llahu nuk u bëri atyre padrejtësi, por ata i bënë padrejtësi vetvetes.”**.

Vërtet, dënimi i atyre popujve në këtë jetë dhe në Jetën Tjetër, është për shkak të punëve që ata bënë. Ata ia mbyllën vetes të gjitha rrugët e ndreqjes. All’llahu nuk i bën njeriut padrejtësinë më të vogël, sepse Ai është i Drejti dhe urdhëron për drejtësi.

Ky ajet, si shumë ajete të tjera të Kur’anit, konstaton parimin e lirisë, të vullnetit dhe të zgjedhjes të njeriut. Ai pohon se vendosmëria në çdo punë buron nga njeriu. All’llahu e krijoi atë të lirë dhe do që ai të jetojë i lirë. Me këtë thënie bie poshtë mendimi i pasuesve të medh’hebit të “*xhebrit*”, për imponim, detyrim, e që, fatkeqësisht, ndodhen në mesin e myslimanëve.

Ajetet: 41 - 44

مَثَلُ الَّذِينَ اتَّخَذُوا مِنْ دُونِ اللَّهِ أَوْلِيَاءَ كَمَثَلِ الْعَنْكَبُوتِ اتَّخَذَتْ بَيْتًا وَإِنَّ أَوْهَنَ الْبُيُوتِ لَبَيْتُ الْعَنْكَبُوتِ لَوْ كَانُوا يَعْلَمُونَ ﴿٤١﴾ إِنَّ اللَّهَ يَعْلَمُ مَا يَدْعُونَ مِنْ دُونِهِ ۚ مِنْ شَيْءٍ وَهُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ ﴿٤٢﴾ وَتِلْكَ الْأَمْثَلُ نَضْرِبُهَا لِلنَّاسِ ۚ وَمَا يَعْقِلُهَا إِلَّا الْعَالِمُونَ ﴿٤٣﴾ خَلَقَ اللَّهُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ بِالْحَقِّ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَةً لِلْمُؤْمِنِينَ ﴿٤٤﴾

“Rasti i atyre që zgjedhin mbrojtës të tjerë në vend të All’llahut, është si rasti i merimangës që zgjedh rrjetën e vet për shtëpi. Por shtëpia më e dobët është pikërisht rrjeta e merimangës. Veç sikur ta dinin ata!”

“Sigurisht, All’llahu e di se çfarë adhurojnë ata në vend të Tij; Ai është i Plotfuqishmi, i Gjithëdituri.”

“Këta shembuj Ne ua paraqesim njerëzve, por ata nuk i kupton kush, përveç dijetarëve.”

“All’llahu i ka krijuar qiejt dhe Tokën me qëllim të plotë. Kjo është një shenjë për besimtarët!”

Komentimi

Mbështetja e pabazë është si shtëpia e merimangës

Ajetet e mëparshme sqaruan fundin e dhimbshëm e të errët të idhujtarëve shkatërrues, të padrejtë dhe kryeneçë. Në ajetet në fjalë, Kur'ani sqaron një shembull për ata që adhurojnë tjetërkënd përveç All'llahut dhe zgjedhin të tjerë për mbrojtës përveç All'llahut. Sa më shumë të mendohemi në këtë shembull, aq më shumë do të ndriçohen mendjet me të vërteta. All'llahu i Madhëruar thotë: **“Rasti i atyre, që zgjedhin mbrojtës të tjerë në vend të All'llahut, është si rasti i merimangës që zgjedh rrjetën e vet për shtëpi. Por shtëpia më e dobët është pikërisht rrjeta e merimangës. Veç sikur ta dinin ata!”**.

Sa i mrekullueshëm ky shembëllsim! Mendoni thellë! Çdo kafshë dhe çdo insekt ka vendbanimin e vet, por s'ka shtëpi më të dobët sesa shtëpia e merimangës. Çdo shtëpi ka tavan, dyer dhe mure. Ajo e mbron të zotin e saj prej ndodhive dhe është vend i sigurtë për vendosjen e ushqimeve dhe për ruajtjen e sendeve të tjera. Disa shtëpi nuk kanë tavan, por të paktën kanë mure. Gjithashtu, ka shtëpi që nuk kanë as mure e as tavan.

Shtëpia e merimangës, e thurur me fijet e saj të dobëta, nuk ka as tavan, as mure, as oborr dhe as dyer. Kjo nga njëra anë. Nga ana tjetër, elementët e ndërtimit të saj janë shumë të dobëta dhe shkatërrohen shumë shpejt.

Shtëpia e merimangës nuk ka mundësi rezistence. Një erë e lehtë të fryjë, fijet e saj këputen. Po t'i bjerë një pikë shiu,

shkatërrohet. Sikur të takohet me një shkëndijë të lehtë, digjet. Edhe kur mbi të ngjiten pluhurat, ajo shkatërrohet dhe mbetet e varur dhe e këputur.

Zotat e atyre njerëzve dhe të adhuruarit e tyre “të rremë” janë si kjo shtëpi, e cila nuk sjell as dëm e as dobi dhe nuk zgjidh asnjë problem. Ajo nuk është strehë as për një njeri në kohë fatkeqësish dhe vështirësish.

Vërtet, kjo është shtëpia e merimangës. Edhe pse ajo ka këmbë të gjata, që janë vendpushimi i saj dhe mjeti i gjuetisë së insekteve për t’u ushqyer, sërish kjo shtëpi, në krahasim me shtëpitë e kafshëve e të insekteve të tjera, është më e dobëta.

Ai që i mbështetet tjetërkujt përveç All’llahut dhe nuk e zgjedh Atë për mbrojtës, ai është mbështetur në shtëpinë e merimngës! Edhe pushteti i Faraonit dhe kurora e tij, pasuria e madhe e Karunit, kështjellat e mbretërve dhe depozitat e tyre, të gjitha janë të ngjashme me shtëpinë e merimangës.

Ajo nuk qëndron dhe nuk mund të mbështetesh në të. Ajo nuk ka themele që të jetë e fortë përballë furtunave. Historia tregon se nuk mund të mbështetesh tek asgjë e tillë. Kurse, ata të cilët iu mbështetën All’llahut, vërtet i janë mbështetur një dige të fortë e të pathyeshme, që është Mbrojtësi i Pamposhtur.

Ajo që duhet përmendur është se shtëpia e merimangës dhe thurja e fijeve të saj, që sillen si shembull, janë prej mrekullive të Krijimit. Fijet e merimangës janë të prodhuara prej lënde e lëngëshme dhe ngjitëse. Kjo lëndë ndodhet në një vrimë të vogël, sa koka e gjilpërës, nën barkun e merimangës. Kjo lëndë ka karakteristikë të veçanta dhe përbërje të posaçme. Sapo bie në

kontakt me ajrin, ngrin dhe forcohet. Këtë lëndë merimanga e nxjerr nëpërmjet një aparati të posaçëm, prej të cilit prodhon edhe fijet e saj. Thuhet se çdo merimangë ka mundësi që nga kjo sasi shumë e pakët e kësaj lënde të prodhojë pesëqind metër fije. Disa të tjerë thonë se dobësia në fijet e saj e ka burimin te delikatesa e madhe e tyre. Sikur të mos ishte kjo hollësi, ajo është më e fortë se çeliku.

E habitshmja është se këto fije ka raste që thuren në katër gërsheta, të cilat janë të thurura nga një mijë gërshetë. Çdo gërshet del nga një vrimë shumë e vogël në trupin e merimangës. Mendoni në këto fije prej së cilës formohet gërsheti sesa të buta, sa të sakta dhe sa interesante që janë!

Në shtesë të çudirave në ndërtimin e shtëpisë (rrjetës) së merimangës dhe në thurjen e saj, gjithashtu, është edhe forma e ndërtimit dhe arkitektura e saj, që janë shumë interesante. Po të shohim me vëmendje shtëpinë e merimangës, do të vërejmë një pamje interesante, njësoj si dielli dhe rrezet e tij. Natyrisht që kjo shtëpi është e mjaftueshme për merimangën, por nuk mund të përfytyrohet shtëpi më e dobët se ajo. Kështu janë edhe zotat e të humburve dhe adhuruesit e tyre, të cilët e braktisën adhurimin e All'llahut dhe u strehuan në adhurimin e idhujve prej guri e prej druri.

Duhet përmendur se merimangat nuk janë vetëm një lloj, por sipas thënies së disa dijetarëve, deri tani janë njohur njëzet mijë lloje merimangash. Çdo lloj ka karakteristikat e tij, të cilat sqarojnë madhësitë e Krijuesit dhe fuqinë e Tij në krijimin e kësaj ekzistence të vogël e të qartë.

Fjala “*eulija*”, që përdoret në këtë ajet, është shumësi i fjalës “*uelijun*”. Përdorimi i saj në vend të fjalës “*esnam*” – “*idhuj*”, ka mundësi të tregojë për diçka interesante që është se rregulli nuk është i posaçëm vetëm për idhujt dhe zotat e rremë, por përfshin edhe udhëheqësit në tokë.

Fraza “**sikur ta dinin**” ka lidhje me idhujt dhe të adhuruarit përveç All’llahut dhe nuk ka lidhje me shtëpinë e merimangës, sepse shtëpia e merimangës njihet nga të gjithë. Për këtë, kuptimi i fjalisë është si vijon: sikur ata ta dinin dobësinë e të adhuruarve të tyre, përveç All’llahut, nuk do të anonin kah ato, por do të zgjidhnin Atë. Po ashtu, do ta kuptonin se ata janë të dobët njësoj si shtëpia e merimangës.!

Ajeti pasardhës ka kërcënim për ata politeistë injorantë e të pavëmenshëm. Ajeti thotë: **“Sigurisht, All’llahu e di se çfarë adhurojnë ata në vend të Tij; Ai është i Plotfuqishmi, i Gjithëdituri.”**

Sigurisht, Ai është i Gjithëdituri dhe i Plotfuqishmi absolut. Nëse i lë ata, nuk e bën nga paaftësia dhe dobësia, apo nga padituria apo se fuqia e Tij është e kufizuar. Asnjëherë kurrë. Por çdo gjë që vepron, e vepron bazuar në urtësinë e Tij, me qëllim që atyre t’u plotësohen argumentet dhe të udhëzohet ai që do të udhëzohet.

Disa komentues kanë thënë: Kjo fjali tregon për argumentet e politeistëve dhe për pretendimet e tyre se kur adhurojnë idhujt, kanë parasysh pamjet dhe simbolet e yjeve qiellorë, të Profetëve dhe të melekëve. Ata, siç thonë, i bëjnë sexhde atyre dhe jo idhujve. E mira e keqja, dobia dhe dëmi janë në dorën e tyre dhe jo të idhujve.

Kur’ani sqaron se All’llahu është i Ditur për ato që adhurojnë dhe i luten, cilido dhe çfarëdo qoftë. Të gjitha

adhurimet e tjera, përveç All'llahut, përballë fuqisë së Tij janë si shtëpia e merimangës.

Ajeti në vijim tregon për atë që armiqtë e Islamit i thanë Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) rreth sjelljes së këtyre shembujve nga All'llahu. Ata thoshin: Si ka mundësi që All'llahu, i Cili krijoi qiejt dhe tokën, të sjellë shembull merimangën, mizën dhe insekte të ngjashme me to?

Kur'ani u përgjigjet duke thënë: **“Këta shembuj Ne ua paraqesim njerëzve, por ata nuk i kupton kush, përveç dijetarëve.”**.

Vërtet, rëndësia e shembujve dhe të qëniet e tyre interesante nuk qëndron te madhësia e tyre. Por rëndësia e tyre duket në përputhjen e shembëllsimit me qëllimin.

Për sjelljen e shembujve kanë thënë: Duhet që në fjalët për gjërat e dobëta të shembëllsohen me shtëpinë e merimangës, sepse kjo është gjëja më e mirë për dobësinë dhe lëkundshmërinë. Ky shembull është vetë retorika dhe elokuenca. Prandaj thuhet: Të vërtetat dhe hollësitë e shembujve nuk i dinë, vetëm dijetarët.

Në ajetin e fundit, Kur'ani thotë: **“All'llahu i ka krijuar qiejt dhe Tokën me qëllim të plotë. Kjo është një shenjë për besimtarët!”**.

Në veprat e All'llahut nuk ka as kotësi e as paqëllimësi. Edhe shembëllsimi me merimangën dhe me shtëpinë e saj të dobët, është i përlogaritur me saktësi. Nëse zgjedh një krijesë të vogël për shembëllsim, e bën për të sqaruar të vërtetën. Sigurisht, Ai është Krijuesi i planeteve dhe i galaktikave madhështore.

Është interesante se ajeti këtu përfundon me dijen dhe besimin. Në një vend Kur'ani thotë: **"...sikur ta dinin"** dhe në një vend tjetër thotë: **"...por ata nuk i kupton kush, përveç dijetarëve."** Në ajetin në fjalë thotë: **"...Kjo është një shenjë për besimtarët!"**, që do të thotë se e vërteta është gjithmonë e ndritshme dhe e dukshme. Por frytet e saj ndodhen në zemrën hulumtuese, në mendjen e zgjuar dhe ftuese në të vërtetën. Nëse ata që u janë verbuar zemrat nuk e shohin bukurinë e së vërtetës, kjo nuk do të thotë se e vërteta është e padukshme. Por ata janë të verbër e të humbur.

Ajeti: 45

أَتْلُ مَا أُوحِيَ إِلَيْكَ مِنَ الْكِتَابِ وَأَقِمِ الصَّلَاةَ إِنَّ الصَّلَاةَ تَنْهَى عَنِ الْفَحْشَاءِ
وَالْمُنكَرِ ۗ وَلَذِكْرُ اللَّهِ أَكْبَرُ ۗ وَاللَّهُ يَعْلَمُ مَا تَصْنَعُونَ ﴿٤٥﴾

“Lexo atë që të është zbritur ty prej Librit dhe fale namazin! Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar dhe vërtet që përmendja e All’Ilahut është më e madhe! All’Ilahu di gjithçka që ju bëni.”

Komentimi

Namazi ndalon nga të këqijat

Pas sqarimit të pjesëve të ndryshme prej historive të popujve të shkuar dhe të Profetëve të mëdhenj, sesi vepronin popujt ndaj tyre, si dhe pas sqarimit të fundit të hidhur të të padrejtëve, fjalët e këtij ajeti janë forcuese të mendjes dhe të shpirtit të Profetit duke e urdhëruar për ato që duhet të bëjë.

Ajeti fillon me thënien: **“Lexo atë që të është zbritur ty prej Librit!”** pra, lexoji këto argumente dhe në to do të gjesh ato që

dëshiron dhe ato që të duhen prej dijes, urtësisë dhe këshillës!. Do të gjesh kriteret e njohjes së të vërtetës nga e pavërteta, rrugët e ndriçimit të shpirtit e të zemrës, rrugën përshkruese të çdo grupi dhe drejtimin e tyre. Lexo dhe vazhdo në rrugën e atyre argumenteve në jetën tënde! Lexo dhe frymëzohu prej tyre! Lexo dhe ndriço zemrën tënde me leximin e atyre argumenteve!

Pas përmendjes së kësaj çështjeje, e cila përmban natyrë mësimore, vjen urdhri i dytë, i cili është boshti kryesor i edukimit. All'llahu i Madhëruar thotë: **“...dhe fale namazin!”**.

Më pas ajeti sqaron filozofinë e madhe të namazit duke thënë: **“...Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar...”**.¹

Natyrisht, namazi, i cili përmend besimin në All'llahun dhe në Ringjalljen, ndalon nga shthurja dhe e shëmtuara. Njeriu që qëndron në namaz dhe lexon tekbin (All'llahu Ekber, beson se All'llahu është mbi gjithçka. Ai njeri kujton mirësitë e Tij. E falënderon, e lavdëron dhe e cilëson Atë se është i Gjithëmëshirshëm, Mëshirplotë. Ai njeri kujton Ditën e Llogarisë dhe pohon se është rob i All'llahut dhe se vetëm Atë adhuron. Ai i kërkon Atij ta udhëzojë në rrugën e drejtë dhe i kërkon që ta mbrojë prej rrugës së atyre që Ai është i zemëruar dhe për çdo gjë i drejtohet Atij dhe vetëm Atij i mbështetet (përmbajtja e sures “Fatiha”).

¹ Dallimin mes “*fahshait*” dhe “*munkeri*” e kemi sqaruar në formë të përmbledhur në komentimin e ajetit 90 të sure “Nahl”. Atje thamë: Këto dy fjalë mund të dallohen mes njëra-tjetrës sepse “*fahshai*” tregon për gjynahet e mëdha të padukshme. Kurse “*munker*” janë gjynahet e mëdha të dukshme. Ose, “*fahshai*” janë gjynahet që vijnë si pasojë e triumfit të fuqisë epshore dhe “*munkeri*”, prej ndikimeve të fuqisë nervozuese.

S'ka dyshim se zemra e këtij njeriu dhe shpirti i tij do të jenë gjithmonë të drejtur kah e vërteta dhe drejta. Do të jenë të pastër dhe të devotshëm. Ato zemra i përulen vetëm All'llahut. I bëjnë sexhde (vënë ballinin në tokë) vetëm Atij. Duke menduar thellë për madhësinë e Tij, harron egon dhe unin e vet. Namazfalësi dëshmon se All'llahu është Një e i Vetëm. Gjithashtu, dëshmon mesazhin e Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe i dërgon salavate atij. I lutet All'llahut që të jetë me Profetin dhe me punëmirët në Ditën e Kiametit. Të gjitha këto i sjellin njeriut një valë shpirtërore që është digë penguese përballë gjynaheve.

Kjo vepër përsëritet disa herë “ditën dhe natë”. Çohet në sabah dhe qëndron para All'llahut, Krijuesit të tij që t'i lutet dhe t'i kërkojë ato që dëshiron.

Edhe në mesin e ditës, në kohën që është i zhytur në jetën materiale, papritur dëgjon zërin e ezanit. E ndërpret punën dhe shpejton në adhurimin e All'llahut. Po ashtu, në fund të ditës e në fillim të natës dhe në kohën para se të shtrihet e të qetësohet prej lodhjeve të ditës, namazfalësi i lutet dhe i kërkon All'llahut nevojat që ka. I kërkon që t'ia bëjë zemrën qendër të dritave të Tij.

Përveç atyre që u përmendën, para se njeriu të hyjë në namaz, ai pastron trupin e tij dhe heq dorë nga të ndaluarat dhe i drejtohet të Dashurit. Të gjitha këto ndikojnë në ndalimin prej shthurjeve dhe të shëmtuarve.

Çdo namaz, sipas kushteve të përsosurisë dhe të shpirtit adhurues, ndikon në ndalimin prej shthurjeve dhe të

shëmtuarave. Por në disa raste, ndalojnë plotësisht, në disa raste të tjera pjesërisht dhe në mënyrë të kufizuar.

Nuk është e mundur që dikush të falë namaz e të mos ndikojë në të namazi, edhe sikur namazi të jetë sa për t'u dukur, edhe sikur të jetë ai njeri i përlyer me gjynahe. Sigurisht, një namaz i tillë me dobi të pakët dhe të tillë njerëz, nëse nuk do të faleshin, do të ishin edhe më të këqinj se ç'janë. Për më tepër sqarim, themi: Ndalimi nga shthurja dhe të shëmtuarat ka shkallë dhe grada të shumta. Çdo namaz me ruajtjen e kushteve të tij ka ndikim në këtë ndalim.

Nga ajo që përmendëm më parë, sqarohen paqartësitë e disa komentuesve në komentimin e këtij ajeti dhe zgjedhja e komentimeve jo të përshtatshme. Ka mundësi që ata që e komentuan në formë të papërshtatshme, kanë parë disa njerëz që falen dhe bëjnë gjynahe. Për këtë e komentuan ajetin me kuptim të pakufizuar. Ata zgjodhën rrugë të tjera në komentimin e këtij ajeti. Disa prej tyre thanë: Vërtet, namazi ndalon nga shthurja dhe e shëmtuara përderisa njeriu e kryen atë. Kjo është thënie e habitshme, sepse namazi nuk dallohet vetëm me këtë, sepse shumë punë janë në këtë formë.

Disa të tjerë kanë thënë se namazi dhe pjesët e tij, është si fjalët dhe fjalitë. Çdo fjali e ndalon njeriun nga shthurja dhe e shëmtuara. Për shembull, çdo *tekbijr* (kur thuhet All'illahu Ekber në fillim të namazit), *tesbijh* (lartësim dhe madhështim i All'illahut dhe *tehlil* ("la ilahe il'All'illah" nuk Zot tjetër përveç All'illahut), i thotë njeriut të mos bëj gjynah. Por a e kupton njeriu këtë ndalim apo jo? Kjo është çështje tjetër.

Mirëpo, ai që e thotë për këtë komentim, është i pavëmendshëm ndaj kësaj të vërtete se ndalimi nuk është vetëm teshriien (i legjitimuar), por edhe ndalim tekuinij (i caktuar që në krijim). Nga pamja e jashtme, duket se namazi ka ndikim ndalimi dhe komentim i saktë është ai që përmendëm më lart. Sigurisht, nuk është problem të thuhet se namazi ndalon nga shthurja dhe e shëmtuara me ndalim tek'uinij dhe teshriij.

Hadithe të cilat duhen përmendur

Në një hadith të transmetuar nga Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) thuhet: *"Atë që namazi i tij nuk e ndalon nga shthurja dhe e shëmtuara, largohet më shumë nga All'llahu."*¹

Dhe: *"Nuk ka namaz ai që nuk i bindet atij. Bindja e namazit është që të nalojë nga shthurja dhe e shëmtuara."*²

Dhe: *"Një djalosh prej ensarëve u fal me Profetin por ai djali kishte qenë i përlyer me gjynahe të shëmtuara. Për këtë i thanë Profetit. Profeti u tha: "Vërtet, namazi i tij do ta ndalojë një ditë."*³

Ky ndikim i namazit ka shumë rëndësi. Në transmetimet islame lexojmë se ky ndikim është kriteri bazë i pranimit dhe i

¹ Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 8, f. 285, komentimi i ajetit në fjalë. (Hadithi i dytë të jep ndjesinë e ndalimit *teshriij* - legjislativ).

² I njëjti burim.

³ Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 8, f. 285, komentimi i ajetit në fjalë. (Hadithi i dytë të jep ndjesinë e ndalimit *teshriij* - legjislativ).

mospranimi të namazit. Nga Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është transmetuar se ka thënë: *“Ai që dëshiron të dijë se a është pranuar namazi i tij apo jo, le të shohë se a e ka ndaluar namazi i tij nga shthurja dhe e shëmtuara! Për aq sa e ka ndaluar, aq është i pranuar.”*¹

Kur'ani i Shenjtë, rreth asaj që u përmend për namazin, thotë: **“...dhe vërtet që përmendja e All'llahut është më e madhe...”**.

Nga fjalia e ajetit duket se qëllimi dhe urtësia tjetër e namazit, përveç ndalimit nga shthurja dhe e shëmtuara, ai është përkujtues i Zotit. Ky përkujtim është themeli i lumturisë dhe i mirësisë. Ai është faktori bazë i ndalimit nga shthurja dhe e shëmtuara. Të qëniet e përmendjes së All'llahut më e madhja, është shkak dhe bazë për namazin.

Sigurisht, përmendja e All'llahut ringjall zemrat dhe i qetëson ato, siç thotë edhe Kur'ani i Shenjtë: **“...ata që besojnë dhe zemrat e të cilëve, kur përmendet All'llahu, qetësohen. Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e All'llahut!”**²

S'ka dyshim se shpirti i adhurimit me gjithë pjesët e tij, qoftë namaz, apo diçka tjetër, është përmendja e All'llahut. Thëniet e namazit, veprat e tij dhe parahrjet në të, të gjitha ripërtërisin përmendjen e All'llahut në zemrën e njeriut.

Ajo që tërheq vëmendjen është se në ajetin 14 të sures “Ta Ha”, tregohet kjo urtësi e namazit. Në këtë ajet lexojmë thënien

¹ I njëjti burim.

² Sure “Rra’d”, ajeti 28.

për Musain (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*): **"...dhe kryej faljen për të më kujtuar Mual!"**.

Mirëpo, disa komentues të mëdhenj për këtë fjali kanë përmendur komentime të ndryshme. Disa kanë thënë: "Vërtet, qëllimi në fjalinë e mësipërme është se të kujtuarit e All'llahut ndaj jush me mëshirë është më e madhe se përmendja juaj me bindjen ndaj Tij."

Disa të tjerë kanë thënë: Përmendja e All'llahut të Madhëruar është më e madhe dhe më e lartë se namazi, sepse shpirti i të gjitha adhurimeve është "përmendja e All'llahut" (dhikrullah).

Disa prej këtyre komentimeve përmenden edhe në transmetimet islame, e ndoshta flasin për brendësinë e ajetit. Mirëpo, e jashtëmja e ajetit përputhet me komentimin e pare, sepse në të shumtën e rasteve, në Kur'an përdoren frazat: "*dhikrullah*" – "*përmendja e All'llahut*", "*udhkurullahe*" – "*përmendeni All'llahun*", "*dhekerullahe*" – "*e përmendën All'llahun*" etj. Të gjitha këto fraza kanë kuptimin e përmendjes së All'llahut nga njerëzit.

Në një hadith të transmetuar nga Muadh ibn Xhebel thuhet: "*S'ka punë më të madhe, e cila e shpëton birin e Ademit nga dënimi i All'llahut sesa përmendja e Tij*". Atë e pyetën: "*Deri edhe xhihadi në rrugën e All'llahut*"?! Ai u përgjigj: "*Po, sepse All'llahu thotë: "...dhe vërtet që përmendja e All'llahut është më e madhe!..."*".

Me sa duket Meadh ibn Xhebel e ka dëgjuar këtë thënie nga i Dërguari i All'llahut, sepse transmetohet nga vetë ai, i cili e ka pyetur të Dërguarin: "*Cilat janë punët më të mira*". Profeti i ka

thënë: *"Të vdesësh dhe gjuha jote është e zbutur me përmendjen e All'llahut."*

Nijeti i njerëzve, prania e zemrave të tyre në namaz dhe në adhurimet e tjera janë të ndryshme. Për këtë All'llahu i Madhëruar në fund të ajetit thotë: **"...All'llahu di gjithçka që ju bëni."** Që do të thotë se Ai i di punët që bëjnë njerëzit, haptazi apo fshehurazi; di qëllimet që mbartin njerëzit në zemrat e tyre; di edhe kuptimin e vërtetë të thënieve që dalin nga gjuhët e tyre.

Ndikimet e namazit në edukimin e individit dhe të shoqërisë

Edhe pse dobia e namazit nuk është e fshehur nga askush, tekstet islame na tregojnë më tepër hollësira dhe gjëra interesante rreth këtij adhurimi.

1- Vërtet, shpirti i namazit, themeli i tij, qëllimi i tij, parahyrjet e tij, rezultati i tij dhe së fundmi urtësia dhe filozofia¹ e tij, të gjitha këto janë përmendja e All'llahut, siç e sqaroi edhe ajeti në fjalë duke na thënë se përmendja e All'llahut është rezultati më i madh. Natyrisht, kuptimi i përmendjes në këtë ajet është për atë përmendje që të çon në meditim, i cili nxit për veprim. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) rreth komentimit të fjalisë **"...vërtet, përmendja e All'llahut është më e madhe..."** ka thënë: *"Përmendja e All'llahut në të ndaluarat dhe të lejuarat (që do të thotë*

¹ Fjala "filozofi" është fjalë greke dhe ka kuptimin e "el hikmetu" – "urtësi". Ajo nuk është fjalë arabe, por është e përhapur në këtë gjuhë.

të përmendet All'llahu dhe të zbatohet hallalli dhe të mbyllet sytë nga harami).".¹

2- Namazi është mjeti për larjen e gjynaheve, për pastrimin prej tyre dhe për fitimin e faljes së All'llahut. Kjo për arsye se namazi e fton njeriun në pendim dhe në ndreqjen e së shkuarës. Prandaj, në një hadith të Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) lexojmë se kur i tha disa shokëve të tij: *"Sikur para derës së shtëpisë së ndonjërit prej jush të kalonte një lumë dhe të laheshit në të pesë herë në ditë, a do të ngelte papastërti mbi trupin tuaj?!* Ata thanë: *"Jo."* Ai tha: *"Namazi është njësoj si ky lumë. Sa herë që njeriu falet, në kohën mes dy namazeve të ditës, pastrohet prej gjynaheve."*²

Plagët që lënë gjynahet në shpirtin e njeriut dhe që bëhen mbulojë për zemrën e tij, nuk i mbyll vetëm namazi, por me anë të namazit hiqet ndryshku i zemrave.

3- Namazet janë diga përballë gjynaheve goditëse, sepse namazi forcon shpirtin e besimit të njeriut dhe edukon virtytin e devotshmërisë në zemra. Ne e dimë se besimi dhe devotshmëria janë dy digat më të forta përballë gjynaheve. Këtë e sqaroj edhe ajeti i lartpërmendur. Në shumë hadithe lexojmë se disa persona ishin gjynahqarë. Gjendja e tyre u përmend te Imamët e Islamit. Ata thanë: Mos u shqetësoni sepse namazi e ndreq gjendjen e tyre dhe i ka ndrequr ata!

4- Namazi e zgjon njeriun prej pavetëdijes. Fatkeqësia më e madhe e përshkruesve të rrugës së vërtetë e të drejtë është harresa

¹ "Biharu Anuar", vëll. 82, f. 200.

² "Uesailu Shiah", vëll. 3, f. 7, kapitulli i dytë prej kapitujve të detyrave, hadithi 3.

e qëllimit të krijimit të tyre. Ata zhyten në kënaqësitë materiale të kësaj jete kalimtare. Mirëpo, namazi, duke qenë se falet në kohë të ndryshme në çdo ditë dhe natë, ai i tërheq vëmendjen njeriut dhe i kujton qëllimin e krijimit, e kujton për pozitën e tij në këtë jetë. Kjo është mirësi e madhe për njeriun sepse në çdo kohë namazi i thotë: “Ji i vëmendshëm!”.

5- Namazi largon egoizmin dhe mendjemadhësinë. Kjo sepse njeriu në çdo ditë dhe në çdo natë fal shtambëdhjetë rekate (vetëm në namazet farze), dhe në çdo rekat vendos ballin e tij në tokë në shenjë modestie ndaj All'llahut. Namazfalësi e sheh veten e tij grimcë të vogël përballë madhështisë së All'llahut. E sheh veten e tij zero në krahasim me Atë që nuk ka Fund. Prijësi i besimtarëve (*Paqja qoftë mbi të!*) ka një thënie të njohur në të cilën trupëzohet filozofia e adhurimeve islame pas besimit në All'llahun. Në fillim flet për namazin e shoqëruar me largimin e egos e të mendjemadhësisë. Ai ka thënë: “All'llahu e ka bërë besimin pastrues për politeizmin dhe namazin stoli prej mendjemadhësisë.”.¹

6- Namazi është mjeti për edukimin me morale të mira dhe për përsosurinë shpirtërore të njeriut, sepse namazi e nxjerr njeriun nga bota e kufizuar dhe e fton për në botën qiellore. Namazi e bën njeriun partner me melekët me zërin e tij dhe me lutjen e tij. Namazfalësi e sheh veten e vet se nuk ka nevojë për ndërmjetës tek All'llahu. Po ashtu, ai e bën që të mendojë se nuk ka pengesë mes tij dhe All'llahut prandaj flet me Të dhe i kërkon Atij ato që dëshiron. Vërtet, kjo vepër ditën dhe natën, duke u mbështetur në cilësitë e All'llahut, të të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit, të Lartit, si dhe me ndihmën e sureve të Kura'nit që

¹ “Nehxhul Belaga”, fjalët e shkurtra, fjala 252.

lexohen pas “Fatihasë” në namaz, ndikon shumë në edukimin e virtyeteve të njeriut. Për këtë lexojmë edhe thënien e prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili ka thënë: “*Namazi është kurbani i çdo të devotshmi.*”.¹

7- Namazi i jep vlerë shpirtit dhe punëve të tjera të njeriut, sepse namazi zgjon sinqeritetin në shpirtin e njeriut. Ai përbëhet nga nijeti i mirë, fjalët e pastra dhe punët e sinqerta. Përsëritja e këtyre gjërave çdo ditë dhe çdo natë, mbjell në shpirtin e njeriut farën e punëve të tjera të mira dhe forcon shpirtin e sinqeritetit në të. Ndaj lexojmë në disa transmetime të përcjella nga Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) në përmbajtjen e testamentit pas goditjes së ibn Mulxhemit në kokë, i cili ka thënë: “*Betohem në All’llahun, betohem në All’llahun! Kujdesuni për namazin tuaj! Sepse ai është shtylla e fesë tuaj.*”.²

Ne e dimë që shtylla e çadres, nëse thyhet apo rrëzohet, mbajtëset tjera nuk kanë shumë dobi, sado që të forcohen. E tillë është edhe lidhja e robve me All’llahun nëpërmjet namazit. Nëse s’ka namaz, punët e tjera nuk kanë ndikim.

Nga Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) lexojmë se ai ka thënë: “*E para punë për të cillën njeriu do të japë llogari është namazi. Nëse ai pranohet, pranohen edhe punët e tjera. Nëse refuzohet, refuzohen edhe punët e tjera.*”.³

Ka mundësi që argument i këtij hadithi është se namazi përbën simbolin e lidhjes dhe të marrëdhënies mes Krijuesit dhe krijesës. Nëse namazi kryhet në formë të mirë me qëllim afrimi

¹ “Nehxhul Belaga”, fjalët e shkurtra, fjala 136.

² “Nehxhul Belaga”, prej shkresave të tij, porosia 47.

³ “Uesailu Shiah”, vëll. 4, f. 34. (Botimet e shtëpisë botuese Alel Bejt).

dhe singeriteti, ai është shkaktari i pranimit të punëve të tjera. Përndryshe, edhe punët e tjera janë të dyshueshme, të njollosura dhe të pakonsiderueshme.

8- Namazi fton për pastrimin e jetës. Ne e dimë se vendi i faljes, veshja e faljes, uji i abdesit dhe i larjes (guslit), vendi ku merr abdes dhe gusl, duhet të jenë të pastra nga çdo uzurpim, apo shkelje e të drejtave të të tjerëve. Ai që është i njollosur me padrejtësi, që peshon dhe mat mangët, që merr ryshfet, që fiton pasuri në rrugë të ndaluar (haram) etj., si mund të përgatitet për të falur namaz? Vetë përsëritja e namazit pesë herë në ditë, është ftesë për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve.

9- Namazi është faktor ndikues dhe i rëndësishëm për braktisjen e shumë gjynaheve. Në librat e jurisprudencës dhe në burimet e hadithit ka shumë transmetime me titull: *Pengesat e pranimit të namazit*. Prej tyre është pirja e alkoolit. Në disa transmetime thuhet: *“Nuk i pranohet namazi pirësit të alkoolit për dyzet ditë, derisa të pendohet.”*¹

Po ashtu, në shumë transmetime lexojmë se nuk i pranohet namazi Imamit të padrejtë.²

Në disa hadithe të tjera thuhet se namazi nuk i pranohet atij që nuk jep zekatin. Në hadithe të tjera thuhet: *“Namazi nuk i pranohet atij që ushqehet me haram. As atij që mburret dhe i pëlqen vetja.”*. Kështu sqarohet urtësia dhe dobia e madhe e pranisë së këtyre kushteve.

¹ Biharul Anuar, vëll. 84, f. 317 dhe 320.

² Biharul Anuar, vëll. 84, f. 317.

10- Namazi forcon te njeriu shpirtin e disiplinës dhe të përgjegjësisë, sepse ai duhet të kryhet në kohën e caktuar. Kryerja e tij jashtë kohës së caktuar çon në pavlefshmërinë e tij.

Po kështu është edhe përsa i përket rregullave dhe etikave të tjera që kanë të bëjnë me njetin, leximin, rukunë, sexhden e të tjera. Interesimi ndaj tyre bën që njeriu të interesohet edhe për çështjet e ndryshme të jetës.

Të gjitha këto dobi të namazit, pa marrë parasysh namazin me xhemat dhe pa shtuar karakteristikat e veçanta të xhematit, i cili ka mirësi të shumta e të panumërta, të cilat nuk mund të përmenden këtu, duhet të njihen dhe të kuptohen nga të gjithë.

Këtu përfundojmë fjalët tona për urtësinë, filozofinë dhe sekretet e namazit me një hadith të transmetuar nga Imam Rizai (Paqja qoftë mbi të!) kur e pyetën rreth namazit dhe ai u përgjigj: *“Shkaku i namazit është se pohon sundueshmërinë e All’llahut të Madhëruar; zhvoshjen e Tij prej ngjashmërive; qëndrimin para të Pamposhturit në mënyrë të përlulur, të qetë e pohuese për t’i kërkuar faljen e gjynaheve të shkuara; për vendosjen e fytyrës në tokë çdo ditë si madhështi për All’llahun; që njeriu të jetë përmendës dhe jo harrues dhe as i shkëputur nga All’llahu; të jetë i frikësuar; të jetë dëshirues dhe kërkuar që t’i shtohen të mirat në fe e në dynja. Namazi është caktuar që përmendja e All’llahut të jetë e vazhdueshme, ditën dhe natën, me qëllim që rob i mos e harrojë Zotërinë e tij, Drejtuesin e tij, Krijuesin e tij, sepse po e harroi, bën tirani dhe padrejësi. Kur të përmendë Zotin*

e tij, namazfalësi të heqë dorë nga gjynahet dhe të ndalojë llojet e shkatërrimit.”¹

¹ “Uesailu Shiah”, vëll. 3, f. 4.

PËRMAJTJA E LIBRIT

TEMA

Sure “Neml”	5
Ajetet 56 - 59	5
Komentimi.....	6
Kur pastërtia konsiderohet si një e metë e madhe.....	6
Ajetet 60 - 64	11
Komentimi.....	12
Edhe me kaq shumë argumente, ju vazhdoni t’i bëni shok All’llahut në adhurim!.....	12
Hulumtime.....	21
1- Cilit nevojtar i përgjigjet All’llahu kur ai i lutet Atij?.....	21
2- Arsyetim logjik në të gjitha çështjet.....	23
3- Përmbledhje e përgjithshme mbi ajetet që janë objekt studimi.....	24
Ajetet 65 - 68	27
Komentimi.....	28
Ajetet 69 - 75	32
Komentimi.....	33
Zemra ime nuk ngushtohet prej kompleteve që ata kurdisin.....	33
Hulumtime.....	39
Ajetet 76 - 81	41
Komentimi.....	42
Ata që kanë zemra të verbuara nuk e pranojnë thirrjen tënde.....	42
Dy hulumtime.....	48
1- Shkaqet e mbështetjes tek All’llahu.....	48
2- Vdekja dhe jeta në logjikën e Kur’anit.....	51
Ajetet 82 - 85	53
Komentimi.....	54
Hulumtime.....	58

Ç'është "dab'betu erdi"?	58
Ajetet 86 - 88	62
Komentimi	63
Lëvizja e Tokës, njëra prej mrekullive shkencore të Kur'anit	63
Shpjegimi i lëvizjes së Tokës	68
Ajetet 89 - 93	71
Komentimi	72
Gjëja e fundit për të cilën u urdhërua Profeti	72
Sure Kasas	79
Përmbajtja	80
Mirësia e leximit të sures "El Kasas"	83
Ajetet 1 - 6	85
Komentimi	86
Vullneti hyjnor kërkon fitore	86
Hulumtime	96
Qeveria botërore e të pafuqishmëve	96
Kush janë të pafuqishmit dhe kush janë mendjemëdhenjtë?	98
Rruga që kanë ndjekur mendjemëdhenjtë përgjatë historisë	100
Ajetet 7 - 9	102
Komentimi	103
Në pallatin e Faraonit	103
Hulumtime	112
Plani i mahnitshëm i All'llahut	112
Ajetet 10 - 13	114
Komentimi	115
Kthimi i Musait në prehërin e nënës së tij	115
Ajetet 14 - 17	122
Komentimi	123
Musai (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>) dhe mbrojtja e të shtypurve	123
Dy hulumtime	130
1- A nuk ishte kjo vepër e Musait në kundërshtim me pamëkatshmërinë (<i>ismetin</i>)?	130
2- Mbështetja dhe ndihma e dhënë e mizorëve është gjynahu më i madh	132
Ajetet 18 - 22	135

Komentimi.....	136
Musai (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>) drejtohet për në Medjen fshehurazi.....	136
Ajetet 23 - 25.....	141
Komentimi.....	142
Një punë e mirë hap portat e mirësive për Musain.....	142
Dy hulumtime.....	147
1- Ku ndodhej Medjeni?.....	147
2- Mësime të shumta që frymëzojnë përvojë.....	148
Ajetet 26 - 28.....	151
Komentimi.....	152
Musai (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>) në shtëpinë e Shuajbit.....	152
Hulumtime.....	154
1- Dy kushte themelore për një administrim të mirë.....	154
2- Pyetje rreth martesës së Musait (<i>Paqja e All'llahut qoftë mbi të!</i>) me vajzën e Shuajbit (<i>Paqja e All'llahut qoftë mbi të!</i>).....	156
3- Emrat e dy vajzave të Shuajbit.....	159
Ajetet 29 - 35	160
Komentimi.....	162
Shkëndija e parë e shpalljes hyjnore.....	162
Ajetet 36 - 37.....	171
Komentimi.....	171
Musai (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>) përballë Faraonit.....	171
Ajetet 28 - 42.....	175
Komentimi.....	176
Si qe fundi i mizorëve?.....	176
Hulumtime.....	184
Prijësit e “dritës” dhe prijësit e “zjarrit”	184
Ajetet 43 - 46.....	187
Komentimi.....	188
Njoftimet e fshehta vijnë vetëm prej All'llahut.....	188
Ajetet 47 - 50	193
Komentimi.....	194
Pretekst për t'iu shmangur të vërtetës.....	194
Hulumtime.....	200

Ndjekësit e dëshirave bëjnë thirrje për në rrugën e humbjes.....	200
Ajetet 51 - 55.....	202
Shkaku i zbritjes.....	203
Komentimi.....	205
Kërkuesit e së vërtetës prej ithtarëve të librave të mëparshëm besuan në Kur'an.....	205
Hulumtime.....	210
Zemrat e gatshme për të besuar.....	210
Ajetet 56 - 57.....	213
Komentimi.....	214
Udhëzimi vjen vetëm prej All'Ilahut!.....	214
Hulumtime.....	220
Besimi i Ebu Talibit dhe diskutimi rreth tij.....	220
Ajetet 58 - 60	227
Komentimi.....	228
Të mos ju mashtrojnë gjërat që ju lidhin me këtë botë.....	228
Ajetet 61 - 64.....	234
Komentimi.....	235
Ata janë adhurues të dëshirave.....	235
Ajetet 65 - 70.....	241
Komentimi.....	242
Ajetet 71 - 75	248
Komentimi.....	249
Nata dhe dita, dy mirësitë e mëdha.....	249
Ajetet 76 - 78	255
Komentimi.....	256
I pasuri izraelit koprac.....	256
Ajetet 79 - 82	268
Komentimi.....	269
Çmenduria e pasurisë.....	269
Hulumtime.....	278
1- Modele të Karunit dje dhe sot.....	278
2- Nga i erdhi Karunit kjo pasuri e madhe?.....	281
3- Qëndrimi i Islamit ndaj pasurisë.....	283
Ajetet 83 - 84.....	286

Komentimi.....	286
Rezultati i dëshirës për supremaci dhe ngatërresa.....	286
Hulumtime.....	292
Ajetet 85 – 88.....	294
Shkaku i zbritjes.....	295
Komentimi.....	296
Premtimi për rikthimin e Profetit në shtëpinë e sigurtë të All’liahut.....	296
Dy hulumtime.....	307
Si asgjësohen të gjitha sendet?.....	307
Interpretim i devijuar i frazës së ajetit: “Dhe mos adhuro së bashku me All’liahun ndonjë zot tjetër”	309
Sure “Abkebut”	312
Përmbajtja e sures.....	313
Mirësia e kësaj sureje.....	315
Ajetet 1 - 5.....	317
Shkaku i zbritjes.....	317
Komentimi.....	319
Sprovat e All’liahut janë ligj i përjetshëm.....	319
Hulumtime.....	321
Sprovat në forma të ndryshme.....	321
Ajetet 4 - 7.....	324
Komentimi.....	325
Çfarë kuptimi ka thënia “Takimi me All’liahun?”	326
Ajetet 8 – 9.....	329
Shkaku i zbritjes.....	329
Komentimi.....	330
Porosia më e përkryer për prindërit.....	330
Vallë, cili është qëllimi i kësaj përsëritjeje?.....	333
Hulumtime.....	331
Mirësia ndaj prindërve.....	331
Ajetet 10 – 13.....	335
Komentimi.....	336
Partnerë në triumf, jo në vështirësi.....	336

Dy hulumtime.....	341
Traditat e mira dhe traditat e këqija.....	341
Ajetet 14 - 19	343
Komentimi.....	344
Përmendja e dy historive, ajo e hazreti Nuhut dhe e hazreti Ibrahimit.....	344
Ajetet 20 - 23	352
Komentimi.....	353
Të pashpresët ndaj mëshirës së All'llahut.....	353
Ajetet 24 - 27	359
Komentimi.....	360
Metoda e mendjemëdhenjve në përgjigjen e Ibrahimit.....	360
Dy hulumtime.....	367
Krenaria më e madhe.....	367
Dhuntitë madhështore të Ibrahimit.....	369
Ajetet 28- 30	371
Komentimi.....	372
Të devijuarit (të shthururit) seksualë.....	372
Fatkeqësia e devijimit seksual.....	375
Ajetet 31 - 35	377
Komentimi.....	378
Fundi i të devijuarve.....	378
Ajetet 36 - 40	386
Komentimi.....	387
Llojshmëria e dënimeve të të padrejtëve.....	387
Ajetet 41 - 44	394
Mbështetja e pabazë është si shtëpia e merimangës.....	395
Ajeti 45	401
Komentimi.....	401
Namazi ndalon nga të këqijat.....	401
Ndikimet e namazit në edukimin e individit dhe të shoqërisë.....	406

أأمثل فى تفسير كتاب الله المنزل

مؤلف: العلامة الفقيه المفسر ناصر مكارم الشيرازى

الجزء العشرون

الترجمة الى اللغة الألبانية:

تيرانا: 2018

نام کتاب: الامثل فی تفسیر کتاب الله المنزل (جزء بیستم)

نویسنده: فقیه مفسر حضرت آية الله العظمی ناصر مکارم شیرازی (دام ظلّه)

ترجمه به زبان آلبانی: حاجی سلیم الصطفی (ره)

زیر نظر: وُلْنَتْ مِرْيَا

ویرایش: لیسدا رامای

تصحیح ادبی: ویولسا کارای

صفحه بندی و جلد: صبریه فزا

ناشر: جمعیت “نسیم”

چاپ: انتشارات “لیلو”

تیرانا: 2018